# BULETINI EKONOMIK

dhjetor 2009

Banka e Shqipërisë

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.
Botuar nga: Banka e Shqipërisë, sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë.
Tel: 355-4-2222230; 2222152; 2235569.
Faks: 355-4-2223558.
E-mail: public@bankofalbania.org

www.bankofalbania.org

Tirazhi: 650 kopje.
*Shtypur në shtypshkronjën AdelPrint.*

# P Ë R M B A J T J A


*Raporti i politikës monetare për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2009* 7

*Fjala e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, z.Ardian Fullani*
*Në konferencën e përbashkët për shtyp të misionit të FMN-së me Ministrinë e Financave dhe Bankën e Shqipërisë, 27 tetor 2009* 67

*Fjala e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, z.Ardian Fullani*
*Në konferencën për shtyp mbi vendimin e Këshillit Mbikëqyrës për uljen e normës bazë të interesit me 0.5 pikë përqindjeje, 28 tetor 2009* 69

*Fjala e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, z.Ardian Fullani*
*Në konferencën ndërkombëtare për 10-vjetorin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, 30 tetor 2009, Prishtinë* 75

*Fjala e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, z.Ardian Fullani*
*Në forumin e Bankës së Shqipërisë me përfaqësuesit e bizneseve kryesore që operojnë në Shqipëri, 23 nëntor 2009* 83

*Fjala e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, z.Ardian Fullani*
*Në konferencën për shtyp mbi vendimmarrjen e politikës monetare të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, 25 nëntor 2009* 91

*Fjala e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, z.Ardian Fullani*
*Në takimin "Ndërtimi i kapaciteteve për hartimin dhe zbatimin e politikave", 3 dhjetor 2009* 95

*Fjala e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, z.Ardian Fullani*
*Në pritjen e organizuar nga Shoqata Shqiptare e Bankave, me rastin e mbylljes së vitit 2009, 18 dhjetor 2009* 98

*Fjala e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, z.Ardian Fullani*
*Në konferencën për shtyp mbi vendimmarrjen e politikës monetare të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, 23 dhjetor 2009* 101

*Artikujt e botuar në Buletinin Ekonomik 2009* 105

*Faktorët përcaktues të rritjes ekonomike në Shqipëri - Vasilika Kota* 108

*Indekset e Kushteve Monetare dhe Financiare. Rasti i Shqipërisë - Oriela Kodra* 119

*Banka e Shqipërisë në harkun kohor tetor - dhjetor 2009* 124

*Kronologji e vendimeve të politikës monetare* 129

*Ngjarjet juridike, tetor - dhjetor 2009* 131

*Drejtimi i Bankës së Shqipërisë, 31 dhjetor 2009* 137

*Lista e subjekteve të licencuara nga Banka e Shqipërisë* 138

*Publikime të botuara nga Banka e Shqipërisë që prej vitit 2008* 142

# P Ë R M B A J T J A  E  T A B E L A V E

Raporti i politikës monetare për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2009

*Tabelë 1. Disa tregues kryesorë makroekonomikë.* 12
*Tabelë 2. Disa tregues makroekonomikë për vendet BRIK.* 13
*Tabelë 3. Tregues ekonomikë për vendet e rajonit.* 14
*Tabelë 4. Kontributi i kategorive në inflacionin vjetor (në pikë përqindjeje).* 20
*Tabelë 5. Treguesit vjetorë të bilancit të energjisë elektrike (në GWh).* 29
*Tabelë 6. Tregues të bilancit të pagesave në vite.* 30
*Tabelë 7. Ecuria në eksporte dhe importe (milionë euro) dhe ndryshimi vjetor sipas grupmallrave (në %).* 31
*Tabelë 8. Të dhëna mbi familjet emigrante, kursimet dhe remitancat e tyre.* 34
*Tabelë 9. Realizimi i treguesve kryesorë fiskalë për 11-mujorin 2009, krahasim me vitet e mëparshme.* 36
*Tabelë 10. Deficiti buxhetor dhe mënyra e financimit të tij, gjatë 11-mujorit 2006-2009, në miliardë lekë.* 39
*Tabelë 11. Ecuria e treguesve të tregut të punës.* 50

# P Ë R M B A J T J A  E  G R A F I K Ë V E

Raporti i politikës monetare për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2009

*Grafik 1. Ecuria e normave bazë të interesit. 15*
*Grafik 2. Ecuria e kursit të këmbimit Eur / Usd (majtas) dhe Liborit Usd, Eur (djathtas). 16*
*Grafik 3. Ndryshimi vjetor i çmimit të naftës në tregun ndërkombëtar dhe i kursit të këmbimit euro/usd. 16*
*Grafik 4. Ecuria e indekseve të çmimeve sipas grupmallrave kryesore. 17*
*Grafik 5. Inflacioni vjetor sipas tremujorëve (në përqindje). 17*
*Grafik 6. Ecuria e Indeksit të Kushteve Monetare dhe e komponentëve të tij. 19*
*Grafik 7. Kontributi i kategorive në inflacionin vjetor (në pikë përqindjeje). 19*
*Grafik 8. Inflacioni vjetor sipas kategorive të mallrave dhe shërbimeve (në përqindje). 21*
*Grafik 9. Kontributi i inflacionit bazë dhe jobazë në inflacionin vjetor (në pikë përqindjeje). 22*
*Grafik 10. Kontributi i sektorëve në inflacionin vjetor (në pikë përqindjeje). 22*
*Grafik 11. Inflacioni vjetor i mallrave të tregtueshme dhe të patregtueshme. 23*
*Grafik 12. Kontributet e sektorëve në rritjen vjetore të PBB-së (në pp). 24*
*Grafik 13. Treguesi i tendencës ekonomike dhe PBB-ja tremujore. 24*
*Grafik 14. Tregues nga vrojtimet e besimit të biznesit të përmbledhur në nivel ekonomie. 24*
*Grafik 15. Shfrytëzimi i kapaciteteve në ekonomi dhe sipas sektorëve, në përqindje ndaj shfrytëzimit të plotë. 25*
*Grafik 16. Të ardhurat nga tatimet dhe treguesi nga vrojtimet mbi gjendjen financiare të bizneseve. 25*
*Grafik 17. Tregues të konsumit privat dhe të shpenzimeve buxhetore. 26*
*Grafik 18. Ecuria e indeksit të çmimit të banesave dhe e indeksit të qirasë së banesave. 27*
*Grafik 19. Ecuria e çmimeve të prodhimit në ndërtim dhe ndryshimet tremujore të IÇP (majtas) dhe raporti i çmimit ndaj qirasë së banesave dhe prirja afatgjatë e tij (djathtas). 28*
*Grafik 20. Ecuria e shifrës së afarizmit në vëllim për ndërtimin dhe industrinë. 28*
*Grafik 21. Ecuria e shifrës së afarizmit në vëllim për tregtinë, transportin dhe komunikacionin dhe hotelet. 29*
*Grafik 22. Vlera e importeve, eksporteve dhe bilanci tregtar (milionë euro). 32*
*Grafik 23. Vëllimi i eksporteve, importeve dhe prirja e tyre historike në 1000 tonë. 32*
*Grafik 24. Ndryshimet vjetore në importin e kategorive mallra kapitalë, të ndërmjetëm dhe konsumi (në përqindje). 32*
*Grafik 25. Dërgesat e emigrantëve, eksportet e mallrave dhe shërbimeve dhe IHD-të (në % të PBB–së). 33*
*Grafik 26. Shuma rrëshqitëse e balancës primare për 12 muaj, nëntor 1999 – nëntor 2009. 36*
*Grafik 27. Ritmi vjetor i rritjes të të ardhurave buxhetore, të ardhurave nga TVSH-ja dhe të ardhurave nga akcizat (në %), janar '99-nëntor '09. 37*
*Grafik 28. Ndryshimi vjetor (në %) i shpenzimeve dhe kontributi i shpenzimeve korente e kapitale, për periudhën janar 1999-nëntor 2009. 38*
*Grafik 29. Të ardhurat, shpenzimet dhe balanca buxhetore (në miliardë lekë), për periudhën 11-mujore 1998-2009. 38*
*Grafik 30. Deficiti buxhetor dhe financimi i tij sipas burimeve kryesore, për periudhën janar-nëntor 1999:2009, në miliardë lekë. 38*
*Grafik 31. Shkalla e prekjes nga kriza botërore dhe ndryshimi i pozicionit fiskal. 39*
*Grafik 32. Deficitet e llogarisë korente (2008) dhe ndikimi nga kriza. 40*
*Grafik 33. Ndryshimi në pozicionin fiskal, 2009. 40*
*Grafik 34. Kontributi i aktivitetit bankar në ecurinë vjetore të M3 (në miliardë lekë). 41*
*Grafik 35. Ecuria e agregatëve monetarë në lekë dhe shumëzuesi i parasë. 41*
*Grafik 36. Rritja vjetore e depozitave sipas monedhës dhe strukturës kohore (në miliardë lekë dhe në %). 42*
*Grafik 37. Rritja vjetore e depozitave sipas monedhës dhe strukturës kohore (pa efekt kursi). 43*
*Grafik 38. Ecuria e portofolit të kredisë sipas monedhave. 44*
*Grafik 39. Kontributet në rritjen vjetore të kredisë për sektorin privat (majtas) dhe rritjet vjetore të kredisë së re (djathtas), sipas kredimarrësve. 45*
*Grafik 40. Kontributet në rritjen vjetore të kredisë për biznese (majtas) dhe rritjet vjetore të kredisë për likuiditet dhe investime (djathtas). 45*
*Grafik 41. Ecuria e portofolit të kredisë dhe e KNP sipas sektorëve të ekonomisë (në %). 46*
*Grafik 42. Kontributet në rritjen vjetore të kredisë për individë (majtas) dhe rritjet vjetore të kredisë për banesa dhe konsum (djathtas). 46*

*Grafik 43. Ndryshimet në standardet e aplikuara në kreditë për bizneset dhe ndikimi i faktorëve të ndryshëm në to (balanca neto, në përqindje). 48*
*Grafik 44. Ndryshimet në standardet e aplikuara në kreditë e individëve për banesa dhe për konsum, dhe ndikimi i faktorëve të ndryshëm (balanca neto), në përqindje). 48*
*Grafik 45. Kontributet e të punësuarve dhe të papunëve të regjistruar në rritjen vjetore të forcës së aftë për punë, në pp (grafiku majtas) dhe PBB me çmime bazë dhe numri i të punësuarve (ndryshime vjetore në për qind, grafiku djathtas). 49*
*Grafik 46. Ecuria e indeksit të punësimit sipas aktiviteteve ekonomike. 50*
*Grafik 47. Ecuria e pagës mesatare mujore në sektorin shtetëror (grafiku majtas) dhe në sektorin prodhues dhe të shërbimeve (djathtas). 51*
*Grafik 48. Ecuria e pagës mesatare në disa prej degëve të ekonomisë. 51*
*Grafik 49. Ndryshimet vjetore të inflacionit të importuar dhe të inflacionit të mallrave të tregtueshme (grafiku majtas) dhe ndryshimet vjetore të çmimeve të huaja dhe kursi i këmbimit (djathtas). 52*
*Grafik 50. Ndryshimi vjetor i çmimit të naftës në vend dhe jashtë dhe i kursit të këmbimit lekë/usd. 53*
*Grafik 51. Pritjet e konsumatorëve dhe ekspertëve të bankave për inflacionin vjetor pas një viti dhe norma vjetore aktuale e inflacionit (në %). 53*
*Grafik 52. Ecuria e normave të interesit në tregun ndërbankar (majtas) dhe vëllimi i huamarrjes ditore (djathtas). 55*
*Grafik 53. Yield-et e letrave me vlerë të qeverisë në tregun primar (majtas) dhe kurba e yield-eve (djathtas). 56*
*Grafik 54. Yield-et e obligacioneve në tregun primar. 57*
*Grafik 55. Ecuria e interesave të depozitave 12-mujore në Shqipëri dhe BE me normat bazë. 58*
*Grafik 56. Ecuria e normës mesatare të ponderuar për kreditë në lekë. 58*
*Grafik 57. Ecuria e normës së interesave për kreditë e reja në lekë (djathtas) dhe në euro (majtas) 58*
*Grafik 58. Ecuria e normës mesatare të ponderuar të interesit për kreditë në euro, Euribor 12-mujore dhe normës mesatare të ponderuar të depozitave në euro. 59*
*Grafik 59. Normat mesatare të ndërmjetësimit për lekë dhe euro (majtas) dhe diferenca midis interesit mesatar të kredisë në lekë dhe asaj në euro (djathtas). 59*
*Grafik 60. Ndryshimet vjetore të lekut në terma nominalë efektivë (NEER) dhe mesatarja rrëshqitëse e tyre (djathtas). Ecuria ditore e raportit euro/lek dhe usd/lek (majtas). 60*
*Grafik 61. Luhatshmëria e këmbimit të lekut në tremujorë. 61*
*Grafik 62. Ecuria ditore e raportit euro/usd dhe usd/lek. 61*
*Grafik 63. Ecuria e raportit euro/lekë në krahasim me mesataren e rajonit. 61*

Artikull: Faktorët përcaktues të rritjes ekonomike në Shqipëri
*Grafik 1. Indeksi i PBB-së reale (1990=100) për Shqipërinë (majtas) dhe për vende të Evropës Qendrore dhe Lindore për vitin 2009 (djathtas). 108*
*Grafik 2. Norma e rritjes reale ekonomike në Shqipëri gjatë periudhës 1990-2009 (boshti djathtas) dhe përbërja sektoriale e PBB-së (boshti majtas). 109*
*Grafik 3. Rritja ekonomike dhe faktorët e prodhimit. 111*
*Grafik 4. Produktiviteti i punës dhe punësimi sipas sektorëve. 113*
*Grafik 5. Produktiviteti i punës në Shqipëri. 115*

Artikull: Indekset e Kushteve Monetare dhe Financiare. Rasti i Shqipërisë
*Grafik 1. IKM në krahasim me REER dhe normat reale të interesit. 121*
*Grafik 2. IKF në krahasim me REER dhe normat reale të kredive. 122*

# RAPORTI I POLITIKËS MONETARE PËR GJASHTËMUJORIN E DYTË TË VITIT 2009

## I. FJALA E GUVERNATORIT

Ekonomia shqiptare la pas një vit të vështirë. Kriza e thellë e ekonomisë botërore u ndje shpejt në Shqipëri, duke testuar themelet e ekonomisë: stabilitetin financiar dhe ekuilibrat makroekonomikë. Megjithatë, gjendja e mirë fillestare e ekonomisë sonë dhe reagimi i politikave makroekonomike ndihmuan në përballimin me sukses të këtij testi. Ekonomia shqiptare ka siguruar një rritje ekonomike pozitive gjatë tre tremujorëve të parë të vitit, duke ruajtur stabilitetin financiar dhe treguesit kryesorë të stabilitetit makroekonomik: qëndrueshmërinë e çmimeve, nivelin e borxhit publik dhe qëndrueshmërinë e bilancit të pagesave.

***

Kriza financiare dhe ekonomike botërore, e cila u intensifikua ndjeshëm gjatë gjashtëmujorit të parë, vuri në pikëpyetje qëndrueshmërinë e sistemit financiar, stabilitetin makroekonomik dhe perspektivat e zhvillimit afatgjatë të ekonomisë botërore. Reagimi i vendosur i autoriteteve publike, koordinimi në rritje i politikave ekonomike dhe mbajtja hapur e kanaleve të tregtisë botërore, evituan krijimin e spiraleve ekonomike negative. Të dhënat më të fundit mbi ekonominë globale sinjalizojnë një rikuperim të aktivitetit ekonomik në tremujorin e tretë e në vazhdim. Paketat e masave stimuluese monetare dhe fiskale kanë rezultuar të suksesshme në drejtim të stabilizimit të ekonomisë globale. Rifillimi i rritjes ekonomike në vendet kryesore të zhvilluara dhe ecuria pozitive e ekonomive më të mëdha në zhvillim, janë shoqëruar me rritjen e kërkesës e të tregtisë në nivel botëror dhe me uljen e pasigurisë në tregjet financiare. Këto sinjale pozitive, të konfirmuara edhe nga përmirësimi i treguesve të besimit, janë reflektuar në parashikime më optimiste për të ardhmen.

Megjithatë, qëndrueshmëria e rritjes ekonomike botërore do të mbetet e brishtë, për sa kohë që aktiviteti ekonomik mbështetet ende në stimuj të konsiderueshëm monetarë e fiskalë. Në veçanti, qëndrueshmëria e borxhit publik, i cili është rënduar me faturën fiskale të masave të ndërmarra për kalimin e krizës, është një problem që po vjen duke u rënduar në shumë vende. Nga ana tjetër, rritja e çmimeve të naftës dhe të lëndëve të para po krijon një ambient me presione të shtuara inflacioniste. Rritja e papunësisë dhe bilancet ende problematike të agjentëve ekonomikë përbëjnë sfida të mëtejshme për ekonominë dhe vendimmarrësit. Në këtë situatë komplekse, zgjedhja e momentit të duhur të tërheqjes së stimulit ekonomik do të ketë një rëndësi vendimtare për ecurinë e ardhshme të ekonomisë.

Në një aspekt më strukturor, kriza e fundit pritet të lërë gjurmë të dukshme në zhvillimin ekonomik. Në një horizont afatgjatë, duket se po ravijëzohen ekuilibra të rinj ekonomikë dhe strategjikë, të cilët do të ridimensionojnë polet e rritjes ekonomike botërore. Në një horizont afatmesëm, ritmi i rritjes ekonomike botërore pritet të konvergojë në një ekuilibër më të ulët se ai që ka mbizotëruar gjatë dy dekadave të fundit. Ky ngadalësim mund të shoqërohet me probleme ekonomike e sociale për ato vende që nuk do të dinë të lexojnë implikimet e duhura të tyre. Në një horizont afatshkurtër, diskutimet mbi rolin e shtetit në ekonomi, mbi modelet e rritjes e të zhvillimit ekonomik, mbi filozofinë dhe praktikat e duhura për rregullimin e tregjeve financiare, do të dominojnë tryezat e debatit politik. Në veçanti, modeli i rritjes ekonomike do të jetë një temë sensitive për ekonomitë e prekura ndjeshëm nga kriza, ku përfshihen edhe shumë vende të Evropës Lindore. Nxitja e avantazheve konkurruese dhe rritja e konkurrueshmërisë në tregjet botërore do të jenë kryefjala e diskutimeve dhe e reformave të synuara.

Duke u kthyer në zhvillimet e ekonomisë së brendshme, analiza e treguesve të disponueshëm tregon se ekonomia shqiptare ka patur një rritje ekonomike pozitive gjatë nëntë muajve të parë të vitit. Megjithatë, këta tregues sugjerojnë se ritmi i rritjes është karakterizuar nga një ngadalësim progresiv gjatë vitit 2009. Kjo ecuri është kushtëzuar nga reduktimi i kërkesës së jashtme dhe ngadalësimi i kërkesës së brendshme, në prani të një situate të shtrënguar likuiditeti, të kufizimit të financimit dhe të rritjes së pasigurisë. Sipas të dhënave paraprake të INSTAT-it, rritja ekonomike për nëntëmujorin e parë të vitit rezultoi 4.9 për qind, kundrejt vlerës 7.8 për qind të shënuar në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Në terma sektorialë, sektorët që kanë përfituar më shumë nga rritja ekonomike janë sektorët e shërbimeve dhe të ndërtimit, ndërkohë që sektori i industrisë ka patur një ecuri më problematike.

Ritmi pozitiv i rritjes ekonomike është mbështetur nga stimuli fiskal, ndërkohë që kërkesa konsumatore dhe kontributi i sektorit të jashtëm të ekonomisë kanë qenë relativisht të qëndrueshëm ndërsa investimet private kanë shënuar rënie. Kërkesa konsumatore është mbështetur nga rritja e lehtë e punësimit dhe e pagave, ndërkohë që tkurrja e kredisë konsumatore dhe hipotekare, si dhe reduktimi i remitancave dhe rritja e pasigurisë, kanë dhënë efektin e kundërt. Investimet private janë tkurrur, si pasojë e burimeve të kufizuara të financimit, mbështetjes së reduktuar me kredi të sistemit bankar dhe aksesit të kufizuar në tregjet ndërkombëtare të kapitalit. Në këtë reduktim kanë ndikuar edhe rritja e pasigurisë, ecuria e ngadaltë e kërkesës finale për produktet e tyre dhe reduktimi i shkallës së shfrytëzimit të kapaciteteve. Efektet e ngadalësimit ekonomik vendas dhe të krizës ekonomike botërore janë shfaqur edhe në tregtinë e jashtme. Aktiviteti ekonomik me jashtë është karakterizuar nga një rënie e njëkohshme e eksporteve dhe importeve të mallrave e shërbimeve, duke bërë që efekti i këtij sektori në rritjen ekonomike të jetë i ndjeshëm gjatë vitit 2009. Nga ana tjetër, stimuli fiskal, i injektuar kryesisht gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit, ka ndikuar në rritjen e shpejtë të shpenzimeve buxhetore dhe të borxhit publik.

Rritja nën potencial e ekonomisë ka krijuar një ambient me presione përgjithësisht të reduktuara inflacioniste. Inflacioni vjetor në muajin dhjetor

shënoi vlerën 3.5 për qind, ndërkohë që norma mesatare vjetore e inflacionit ishte 2.2 për qind. Të dy këta tregues janë në përputhje me objektivin e Bankës së Shqipërisë për stabilitetin e çmimeve. Ngadalësimi i aktivitetit ekonomik, çmimet e ulëta të produkteve kryesore në tregjet botërore, ekspansioni i ulët monetar në ekonomi dhe pritjet e kontrolluara inflacioniste kanë kompensuar presionet inflacioniste të ardhura nga nënçmimi i kursit të këmbimit gjatë vitit 2009.

Tendenca rritëse e inflacionit gjatë tremujorit të fundit të vitit 2009 ishte një zhvillim i pritur nga Banka e Shqipërisë. Ai është formuar në masën më të madhe nga faktorë me natyrë kalimtare, të cilët nuk pritet të gjenerojnë presione të qëndrueshme inflacioniste. Në veçanti, ky zhvillim është ndikuar nga rritja e çmimit të produkteve ushqimore, të cilat reflektojnë efektin e vonuar të nënçmimit të kursit të këmbimit, konjukturat e tregjeve ndërkombëtare dhe problemet strukturore të tregut shqiptar. Këta faktorë pritet të ushtrojnë presione inflacioniste edhe gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, duke u plotësuar ndoshta edhe nga reduktimi i pritshëm i ofertës së produkteve bujqësore si pasojë e përmbytjeve që sapo kaluan. Megjithatë, prirja e qëndrueshme e inflacionit bazë dhe vlerat e ulëta të inflacionit të mallrave të patregtueshme konfirmojnë se presionet inflacioniste të ushtruara nga kërkesa e brendshme janë të moderuara. Në mungesë të goditjeve të tjera të ofertës, ecuria e ngadaltë e kërkesës së brendshme, rritja e ulët e ofertës monetare dhe pritjet e ankoruara inflacioniste, janë premisë për mbajtjen e inflacionit brenda kufijve të objektivit në periudhën afatmesme.

Banka e Shqipërisë ka ndjekur një politikë monetare të kujdesshme gjatë vitit 2009, duke krijuar një ambient të përshtatshëm për zhvillimin e ekuilibruar të ekonomisë dhe për kontrollin e presioneve inflacioniste. Në prani të rënies së presioneve inflacioniste dhe të pritjeve të stabilizuara për të, sinjalet për ngadalësimin e kërkesës së brendshme në periudhën e ardhshme kanë motivuar rritjen progresive të stimulit monetar gjatë vitit 2009. Gjatë kësaj periudhe, Banka e Shqipërisë ka ulur me një pikë përqindjeje normën bazë të interesit, duke e zbritur atë në nivelin 5.25 për qind. Gjithashtu, ne kemi rritur në mënyrë të vazhdueshme injektimin e likuiditetit, në përputhje me nevojat e sistemit bankar për likuiditet dhe kërkesat e ekonomisë për financim. Në terma relativë, injektimi i likuiditetit nga Banka e Shqipërisë dhe ekspansioni i bazës së saj monetare janë ndër më të lartët në rajon. Për injektimin e likuiditetit, Banka e Shqipërisë ka përdorur të gjithë gamën e instrumenteve injektuese të politikës monetare, duke lehtësuar në të njëjtën kohë aksesin dhe koston e operimit të sistemit bankar me Bankën e Shqipërisë. Kështu, gjatë kësaj periudhe, ne kemi ulur normën e interesit të kredisë njëditore, kemi rritur shkallën e lejuar të përdorimit të rezervës së detyruar dhe kemi rritur bazën e kolateralit të pranuar në operacionet tona.

Në prani edhe të nënçmimit të kursit të këmbimit, kjo politikë ka sjellë një lehtësim të kushteve monetare, duke i shërbyer nxitjes së aktivitetit ekonomik. Megjithatë, përcjellja e politikës lehtësuese monetare në normat e interesit të produkteve bankare ka qenë e kufizuar, si pasojë e problemeve të likuiditetit të sistemit bankar dhe e kërkesës së sektorit publik për fonde. Nga ana tjetër,

edhe vetë sistemi bankar ka qenë i rezervuar në rritjen e kredidhënies, si pasojë e rrezikut të shtuar në ekonomi dhe ecurisë së cilësisë së portofolit të kredive. Eliminimi i këtyre problemeve do të ndihmonte në përcjelljen më të plotë të politikës monetare dhe në rritjen e efektivitetit të saj.

Pozicioni i jashtëm i vendit vazhdon të karakterizohet nga një deficit i lartë dhe në rritje i llogarisë korente. Gjatë tre tremujorëve të parë të vitit, ky deficit është mbuluar plotësisht nga flukset hyrëse të llogarisë kapitale dhe financiare, duke rezultuar në rritjen e rezervave valutore të Bankës së Shqipërisë. Megjithatë, flukset hyrëse janë favorizuar dukshëm nga të ardhurat e privatizimit dhe nga huamarrja e sektorit publik. Të dy këta zëra janë të kufizuar në kohë dhe në madhësi, duke bërë të nevojshëm një korrektim më të qëndrueshëm të pozicionit të jashtëm të ekonomisë sonë. Ky korrektim duhet të synojë që deficiti tregtar të mbulohet me burime të qëndrueshme financimi, në formën e investimeve të huaja direkte dhe nxitjes së industrive eksportuese në degët të cilat mund të përbëjnë avantazh konkurrues për Shqipërinë.

Megjithatë, zhvillimet afatshkurtra në tregtinë e jashtme për muajt tetor-nëntor shfaqin një ecuri disi të ndryshme në krahasim me nëntë muajt e parë të vitit, duke dëshmuar për një modifikim të trendeve të vërejtura më parë. Kështu, eksportet e vendit ranë në terma mesatarë vjetorë me rreth 7.4 për qind, duke shënuar një ngadalësim në krahasim me rënien mesatare prej 19 për qind gjatë nëntë muajve të parë të vitit. Nga ana tjetër, importet kanë shënuar një rënie mesatare vjetore prej 17 për qind në këto dy muaj, kundrejt rënies mesatare vjetore prej 7 për qind të shfaqur gjatë vitit 2009. Këto zhvillime përmbajnë shenja inkurajuese për qëndrueshmërinë e bilancit të pagesave në periudhën afatshkurtër.

Politika fiskale ka patur natyrë ekspansioniste gjatë pjesës më të madhe të vitit, duke u materializuar në një deficit buxhetor rreth nivelit 6 për qind të PBB-së. Rritja e deficitit buxhetor pasqyron si veprimin e stabilizatorëve automatikë, në formën e uljes së të ardhurave, ashtu edhe karakterin e synuar kundërciklik të politikës fiskale, nëpërmjet rritjes së pagave dhe të shpenzimeve kapitale. Ngadalësimi i aktivitetit ekonomik në vend ka diktuar një ritëm të ngadaltë të rritjes së të ardhurave buxhetore, veçanërisht pas tremujorit të parë të vitit. Në fund të muajit nëntor, rritja vjetore e të ardhurave buxhetore ishte vetëm 2 për qind, duke reflektuar thuajse tërësisht ritmin e ulët të gjenerimit të të ardhurave tatimore. Nga ana tjetër, shpenzimet publike kanë ruajtur norma të larta rritjeje, duke shënuar vlerën 16.4 për qind në muajin nëntor. Deficiti buxhetor arriti vlerën 65 miliardë lekë në muajin nëntor. Deficiti është financuar në pjesën më të madhe nëpërmjet huamarrjes së huaj dhe të ardhurave të privatizimit, duke kufizuar presionet në tregun financiar vendas.

Rritja e shpejtë e shpenzimeve dhe e deficitit buxhetor gjatë vitit 2009 ka rritur më tej nivelin e borxhit publik, i cili vlerësohet rreth nivelit 58 për qind të PBB-së në fund të muajit nëntor. Banka e Shqipërisë gjykon se orientimi i politikave të ardhshme buxhetore drejt konsolidimit fiskal, me qëllim reduktimin e borxhit publik, përbën tashmë një parakusht për stabilitetin makroekonomik në vend. Siç e kemi theksuar në vazhdimësi, reduktimi i borxhit publik do të

ulë presionin e sektorit publik mbi tregjet financiare, duke krijuar më shumë hapësirë për sektorin privat. Konsolidimi i financave publike do të ulë gjithashtu primet e rrezikut në ekonomi dhe do të rrisë efektivitetin e politikës monetare.

Oferta monetare është ngadalësuar më tej në gjashtëmujorin e dytë, duke reflektuar në një masë të madhe rritjen gjithnjë e më të ulët të kreditimit. Rritja vjetore e portofolit të kredisë për sektorin privat u ngadalësua në 10 për qind në muajin nëntor. Ndryshe nga gjashtë muajt e parë të vitit 2009, ku frenimi i rritjes së kredisë ishte më shumë i ndikuar nga shtrëngimi i ofertës, në pjesën e dytë të vitit është rënia e kërkesës për kredi ajo që po dikton ecurinë e kredisë. Ngadalësimi i aktivitetit ekonomik dhe pasiguria për të ardhmen, përballë kushteve ende të shtrënguara të kredidhënies nga ana e bankave, kanë udhëhequr vendimet e agjentëve ekonomikë për të shtyrë planet e investimeve dhe për të financuar më pak konsumin nëpërmjet huamarrjes.

Megjithatë, zhvillimet monetare konfirmojnë një përmirësim të situatës së depozitave gjatë gjysmës së dytë të vitit 2009. Ndryshimi i sjelljes së depozituesve në kuadrin e masave të marra për parandalimin e përhapjes së efekteve të krizës globale, si edhe flukset valutore në formën e remitancave gjatë muajve të verës, kanë ndikuar në stabilizimin e situatës së likuiditetit të sistemit bankar.

Tregjet financiare janë karakterizuar nga një situatë më e qetë gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit. Gjatë kësaj periudhe, sistemi bankar ka vazhduar të karakterizohet nga mungesa e likuiditetit, mungesë e cila është plotësuar nga injektimet e likuiditetit të Bankës së Shqipërisë. Përmirësimi i situatës së likuiditetit si rrjedhojë e rritjes së depozitave në sistem dhe forcimi i sigurisë në treg krijuan një mjedis të përshtatshëm për transmetimin e sinjalit të politikës monetare në tregun ndërbankar. Ulja e normës bazë në fund të muajit tetor është ndjekur nga *yield*-et e letrave me vlerë të qeverisë, pas një trendi rritës që i ka karakterizuar ato gjatë gjithë vitit. Ndërkohë, në përputhje me vonesat kohore që karakterizojnë mekanizmin e transmetimit të politikës monetare, Banka e Shqipërisë pret dhe kërkon që ulja e normës bazë të përcillet më tej në tregjet e kredisë.

## II. ZHVILLIMET NË EKONOMINË E JASHTME

Sinjalet pozitive që vijnë nga tregjet e ekonomive të zhvilluara dhe ato në zhvillim, prej disa muajsh kanë përforcuar mendimin e kthimit të rritjes ekonomike në vlera pozitive. Të dhënat më të reja tregojnë se pas ngadalësimit ekonomik të gjysmës së parë të vitit, ekonomitë e vendeve kryesore në zhvillim dhe të një pjese të vendeve me ekonomi të zhvilluara kanë shënuar rritje ekonomike në tremujorin e tretë dhe në vijim. Përmirësimi i situatës ekonomike vjen si pasojë e politikave stimuluese monetare dhe fiskale të suksesshme të ndërmarra që në fillimet e recesionit ekonomik botëror, si dhe rritjen e aktivitetit tregtar në botë. Efekti bazë i çmimeve të larta të një viti më parë ka bërë që inflacioni të vijojë të qëndrojë në nivele të ulëta por në muajt e fundit ai ka arritur në territor pozitiv, si pasojë e rritjes së çmimit të naftës.

## II.1 RRITJA EKONOMIKE DHE BALANCAT MAKROEKONOMIKE

Pas ngadalësimit ekonomik të gjysmës së parë të vitit, ekonomitë e vendeve kryesore në zhvillim dhe të një pjese të vendeve me ekonomi të zhvilluar përjetuan rritje ekonomike në tremujorin e tretë dhe në vijim. Përmirësimi i treguesve të besimit, rritja e kërkesës dhe e tregtisë në nivel botëror janë disa nga sinjalet që shprehin momentin pozitiv të ekonomisë botërore. Megjithatë, natyra e përkohshme e shumë prej stimujve që qëndrojnë mbrapa kësaj ecurie pozitive kështillojnë për një interpretim të kujdesshëm dhe të matur të shumë treguesve.

*Tabelë 1. Disa tregues kryesorë makroekonomikë.*

| | Ndryshimi i PBB-së | | Norma e papunësisë | Norma e inflacionit |
|---|---|---|---|---|
| Vendet | T3-09/T3-08 | T3-09/T2-09 | Nëntor-09 | Dhjetor-09/ Dhjetor-08 |
| ShBA | -2.6 | 2.2 | 10.0[1] | 1.8[3] |
| Eurozonë | -4.0 | 0.4 | 10.0 | 0.9 |
| Gjermani | -4.8 | 0.7 | 7.6 | 0.8 |
| Greqi | -1.7 | -0.4 | 9.1[2] | 2.6 |
| Itali | -4.6 | 0.6 | 8.3 | 1.1 |
| Japoni | -3.7 | 0.3 | 5.2 | -1.9[3] |

*Burimi: Eurostat, Institutet statistikore përkatëse.*
*[1] Të dhënat për muajin dhjetor. [2] Të dhënat për muajin shtator.*
*[3] Të dhënat për muajin nëntor.*

Në tremujorin e tretë të vitit 2009, aktiviteti ekonomik në Eurozonë ka shënuar një rritje prej 0.4 për qind krahasuar me tremujorin paraardhës, ndërsa në terma vjetorë është tkurrur me 4 për qind. Kjo rritje ka shënuar daljen e Eurozonës nga recesioni dhe vjen pas pesë tremujorësh rritjeje negative të aktivitetit ekonomik. Ajo është mbështetur kryesisht në rritjen e aktivitetit tregtar dhe të shpenzimeve qeveritare si pasojë direkte e paketave të stimujve ekonomikë të ndërmarra nga qeveritë e këtyre vendeve. Ndërsa shpenzimet konsumatore dhe investimet ndikuan negativisht[1] në normën e rritjes ekonomike. Të dhënat e anketave tregojnë se e njëjta sjellje pritet të shfaqet edhe në tremujorin e katërt të vitit 2009, si edhe në vitin 2010 ku rritja do vijojë të qëndrojë pozitive, por në nivele të përmbajtura. Norma e papunësisë ka vijuar prirjen e saj rritëse duke arritur në 10 për qind në muajin nëntor 2009, normë e cila është edhe nga vlerat më të larta të kësaj dekade. Sipas të dhënave paraprake, inflacioni vjetor në Eurozonë në muajin dhjetor arriti 0.9 për qind duke vijuar tendencën e tij rritëse. Norma mesatare për tremujorin e katërt është 0.4 për qind, ndërsa në tremujorin e tretë shënonte vlera negative. Zbehja e efektit bazë të çmimeve të larta të vitit të kaluar ka bërë që vetëm në muajt e fundit të vitit, norma e inflacionit të kalojë në vlera pozitive.

Situata ekonomike në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ka njohur përmirësim të përshkallëzuar që prej tremujorit të tretë të vitit 2009. Kështu, vlerësimet përfundimtare mbi ecurinë e PBB-së paraqesin një rritje ekonomike me rreth 2.2 për qind në terma tremujorë. Treguesit kryesorë ekonomikë të cilët ndikuan në rritjen e PBB-së ishin shpenzimet për konsum, investimet agregate dhe eksportet. Këta tregues u rritën me përkatësisht 2.8, 5.0 dhe 17.8 për qind në terma tremujorë. Në të njëjtën kohë, rritje shënuan edhe importet të cilat kanë efekt të kahut negativ në përllogaritjen e PBB-së. Për sa i përket ecurisë ekonomike gjatë tremujorit të katërt të vitit, treguesit e industrisë prodhuese

në ShBA tregojnë për një prirje rritëse më të përshpejtuar krahasuar me tremujorin e tretë të tij. Mesatarja e normës vjetore të inflacionit për periudhën korrik-nëntor ishte -2.9 për qind, ndërsa norma mesatare e papunësisë për gjysmën e dytë të vitit ishte 9.8 për qind.

Ekonomitë e vendeve BRIK[2], pasi përjetuan dobësim të ritmeve rritëse të ekonomisë madje deri në kontraktim të saj si në rastin e Brazilit e Rusisë, regjistruan përmirësim të kushteve ekonomike gjatë gjysmës së dytë të vitit. Ekonomia e Kinës, gjatë gjysmës së dytë të vitit, është ndihmuar nga shpenzimet e përshpejtuara të qeverisë si dhe nga përmirësimi i treguesve të prodhimit. Ndërkohë, rritja e prodhimit në industrinë përpunuese indiane ka ndikuar në rifitimin e prirjes rritëse në nivelin e vërejtur përpara krizës ekonomike. Në Rusi, rritja e çmimit të naftës gjatë gjysmës së dytë të vitit ka ndihmuar vendin të dalë nga kriza. Në Brazil, rritja e kërkesës së brendshme dhe e eksporteve ndihmuan në zgjerimin e moderuar të PBB-së gjatë tremujorit të tretë të vitit krahasuar me një tremujor më parë.

| Vendet | Ndryshimi vjetor i PBB-së reale | | | Inflacioni vjetor |
|---|---|---|---|---|
| | T3-09 | 2009[1] | 2010[1] | Nëntor-09 |
| Brazil | -1.2 | -0.7 | 3.5 | 4.3[2] |
| Rusi | -9.4 | -7.5 | 1.5 | 9.1 |
| Indi | 7.1 | 5.4 | 6.4 | 12.0[3] |
| Kinë | 8.9 | 8.5 | 9.0 | 0.6 |

*Burimi: FMN, OECD, Institutet statistikore përkatëse.*
*[1] Vlerësime të FMN-së, tetor 2009. [2] Të dhëna për muajin dhjetor.*
*[3] Të dhënat për muajin tetor.*

*Tabelë 2. Disa tregues makroekonomikë për vendet BRIK.*

Gjatë gjysmës së dytë të vitit, aktiviteti ekonomik në Italì ka regjistruar shenjat e para të rimëkëmbjes. Kështu, gjatë tremujorit të tretë të vitit u shënua ritëm pozitiv rritjeje i PBB-së pas 5 tremujorësh kontraktim të njëpasnjëshëm. PBB-ja u zgjerua me 0.6 për qind në terma vjetorë ku kontributin kryesor e dhanë rritja e shpenzimeve për konsum dhe rritja e investimeve. Ndërkohë, shpenzimet e qeverisë italiane shënuan rënie. Të dhënat më të fundit ekonomike mbi ecurinë e aktivitetit gjatë tremujorit të katërt të vitit paraqesin një përmirësim të mëtejshëm të disa prej treguesve kryesorë. Norma e papunësisë vijon prirjen rritëse dhe për muajin nëntor ajo regjistroi vlerën 8.3 për qind. Inflacioni mesatar vjetor gjysmën e dytë të vitit ishte 0.5 për qind.

Ekonomia e Greqisë, gjatë gjysmës së dytë të vitit 2009, ka shfaqur shenja të ngadalësimit ekonomik, pas një periudhe relativisht të kënaqshme rritjeje gjatë gjysmës së parë të tij. Kështu, tremujori i tretë i vitit regjistroi një kontraktim të PBB-së me përafërsisht 1.7 për qind krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraardhës. Kontributin kryesor në këtë kontraktim e dhanë rënia e investimeve agregate dhe rënia e eksporteve të cilët u zvogëluan me përkatësisht 18.6 dhe 21.7 për qind në terma vjetorë. Përsa i përket tremujorit të katërt të vitit, të dhënat më të fundit dëshmojnë për një përkeqësim të mëtejshëm të aktivitetit ekonomik. Rreziku më i madh i manifestuar gjatë tremujorit të fundit të vitit buron nga rritja e përshpejtuar e deficitit buxhetor dhe e raportit të borxhit publik ndaj PBB-së. Ky i fundit shënoi 112 për qind gjatë vitit 2009 dhe pritet të rritet më tej gjatë vitit të ardhshëm. Norma e

papunësisë për muajin shtator ishte 9.1 për qind, ndërsa norma mesatare vjetore e inflacionit për gjysmën e dytë të vitit ishte 1.5 për qind.

Në tremujorin e tretë të vitit 2009, ekonomia e Turqisë shënoi një rritje ekonomike vjetore negative prej -3.3 për qind, ndërsa krahasuar me një tremujor më parë shënon një rritje prej 2.7 për qind. Shpenzimet konsumatore ndikuan pozitivisht duke shtuar rreth 0.5 pikë përqindjeje në rritjen vjetore. Investimet private ndonëse kontribuan negativisht, shënuan një ngadalësim të ritmit të rënies. Të dhënat paraprake tregojnë për një kërkesë të ulët dhe prodhim të kufizuar, që sugjerojnë se tremujori i katërt do të ruajë të njëjtat nivele të tremujorit të tretë. Papunësia në muajin shtator ka qëndruar 13.4 për qind, sa vlera e muajit gusht, por krahasuar me një vit më parë ka një rritje prej 2.7 pikë përqindjeje. Inflacioni ka shënuar normën vjetore 5.7 për qind në tremujorin e katërt të vitit 2009.

Ekonomia e Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë vijoi prirjen rënëse edhe në tremujorin e tretë të vitit 2009, duke u tkurrur me -1.8 për qind krahasuar me të njëjtën periudhë një vit më parë. Kjo rënie vjen si pasojë e rënies së shpenzimeve konsumatore dhe rënies së shpejtë të investimeve, efekti i të cilave është zbutur disi nga një rënie e madhe e importeve dhe rritje e shpenzimeve publike. Ndonëse në një situatë ekonomike të përkeqësuar, rritja e shpenzimeve publike ka bërë që papunësia në tremujorin e tretë të shënojë ulje duke arritur në 31.7 për qind nga 33 për qind që ishte në vitin 2008. Norma vjetore e inflacionit në tremujorin e katërt ka shënuar -2.1 për qind, duke e çuar normën mesatare vjetore për vitin 2009 në -0.8 për qind, ndërsa në 2008 kjo ishte 8.3 për qind.

Sipas statistikave të Zyrës Statistikore të Kosovës rritja ekonomike në vitin 2008 ishte 6.1 për qind, ku rritje domethënëse kanë pësuar shpenzimet konsumatore dhe investimet, ndërsa eksportet janë dobësuar ndjeshëm. Parashikimet e FMN-së tregojnë për një rritje prej 4 për qind në vitin 2009. Indeksi i çmimeve të konsumit vijoi të qëndrojë në vlera negative duke shënuar vlerën vjetore prej -1.3 për qind në muajin nëntor 2009, ndërsa në tremujorin e tretë shënonte -3.1 për qind. Këto vlera të ulëta kanë qenë të pranishme që prej muajit janar 2009, ndërsa vlera më e ulët u shënua në muajin maj (-4.4 për qind). Këto zhvillime deflacioniste janë shkaktuar nga rënia e çmimit të ushqimeve dhe transportit, ndërsa çmimi i energjisë elektrike dhe karburantit shënuan një rritje të lehtë.

*Tabelë 3. Tregues ekonomikë për vendet e rajonit.*

| | Ndryshimi i PBB-së | Inflacioni vjetor | Norma e papunësisë |
|---|---|---|---|
| | T3:09 | Dhjetor-09 | Nëntor-09 |
| Itali | -4.6 | 1.1 | 8.3 |
| Greqi | -1.7 | 2.6 | 9.1[2] |
| IRJ-Maqedoni | -1.8 | -1.6 | 31.7[3] |
| Serbi | -2.3 | 6.6 | 16.6[4] |
| Kroaci | -5.7 | 1.9 | 16.1 |
| Turqi | -3.3 | 6.5 | 13.0[4] |
| Kosovë | : | -1.3[1] | : |
| Shqipëri | 4.1 | 3.5 | 12.8[3] |

*Burimi: Institutet statistikore përkatëse, EuroStat, EcoFin, FMN.*

*[1] Të dhëna për muajin nëntor.*

*[2] Të dhëna për muajin shtator. [3] Të dhëna për tremujorin e tretë të vitit.*

*[4] Të dhëna për muajin tetor. : Të dhëna të padisponueshme.*

## II.2 POLITIKA MONETARE, TREGJET FINANCIARE DHE KURSI I KËMBIMIT

Gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit, asnjëra nga bankat qendrore kryesore nuk ndryshoi normën bazë të interesit. Këto banka kanë gjykuar që normat aktuale janë të përshtatshme për të krijuar një mjedis stimulues për rritjen ekonomike.

Grafik 1. Ecuria e normave bazë të interesit.




Burimi: BQE, FED, Banka e Anglisë, Banka e Japonisë.

Banka Qendrore Evropiane ka lënë normën e saj në 1 për qind, ndërsa në gjashtëmujorin e parë e kishte ulur katër herë. Rezerva Federale e ka mbajtur gjatë gjithë vitit normën e saj në 0-0.25 për qind. Banka e Anglisë e ka lënë normën bazë të interesit në 0.5 për qind gjatë gjysmës së dytë të vitit, ndërsa në gjashtëmujorin e parë e kishte ulur atë tre herë. Banka e Japonisë e ka lënë të pandryshuar gjatë gjithë vitit 2009 normën referencë të interesit (norma njëditore për tregun ndërbankar) në 0.1 për qind.

Tregjet financiare gjatë këtyre muajve kanë paraqitur ecuri pozitive dhe luhatshmëri të përmbajtur. Normat e interesit në këto tregje kanë vijuar rënien e nisur që prej fillimit të vitit duke konfirmuar kështu shuarjen e tensioneve dhe përmirësimin e përgjithshëm që po ndodh në të gjitha segmentet e tregut. Sinjalet pozitive që vijnë nga tregjet e ekonomive të zhvilluara dhe atyre në zhvillim prej disa muajsh kanë përforcuar kthimin e rritjes ekonomike në vlera pozitive. Ndonëse pjesa kryesore e kësaj rritjeje i atribuohet stimujve dhe politikave nxitëse që ndërmorën institutet kryesore qendrore të botës, ecuria pozitive aktuale reflekton përmirësim të qëndrueshëm në një kontekst me rreziqe të përmbajtura.

Që prej korrikut dhe në vazhdim, normat e interesit Libor dhe Euribor në tregun e parasë vijuan rënien duke përcjellë sheshimin e presioneve për likuiditet dhe uljen e primeve të rrezikut. Normat e interesit Euribor me afat 1-, 3- dhe 6- mujor në fund të këtij viti u zvogëluan mesatarisht me 43, 55 dhe 44 pikë bazë[3] në krahasim me fundin e gjashtëmujorit të parë, ndërsa norma Libor me afat tremujor u zvogëlua me 37 pikë bazë. Në vlerë mesatare gjatë këtij muaji normat e interesit Euribor me afat 1-, 3- dhe 6- mujor shënuan respektivisht 0.48, 0.68 dhe 0.99 për qind, ndërsa norma Libor me afat tremujor ka zbritur në 0.25 për qind.

Në tregjet valutore gjatë këtij gjashtëmujori është dalluar ecuria vlerësuese e euros ndaj dollarit amerikan, paundit britanik si dhe ndaj shumë monedhave aziatike të lidhura me atë amerikane. Gjithashtu, euro është vlerësuar në raport me jenin japonez dhe ndaj grupit të monedhave të tjera evropiane. Në fund të këtij viti, një euro këmbehej me 1.44 dollarë amerikanë ndërkohë që mesatarisht në këtë gjashtëmujor u vlerësua me 9.1 për qind në krahasim me periudhën paraardhëse.

Grafik 2. Ecuria e kursit të këmbimit Eur / Usd (majtas) dhe Liborit usd, Eur (djathtas).




Burimi: BQE, Reuters.

## II.3 ECURIA E ÇMIMEVE TË NAFTËS DHE TË LËNDËVE TË PARA

Çmimi i naftës për fuçi në tregun ndërkombëtar ka shënuar rritje gjatë gjysmës të dytë të vitit krahasuar me gjysmën e parë të tij, kur arriti dhe vlera të përafërta me ato të vitit 2005. Kështu, ky çmim shënonte mesatarisht 70.9 dollarë amerikanë për periudhën në analizë, vlerë kjo afërsisht 40 për qind më e lartë se mesatarja e gjysmës së parë të vitit. Përmirësimi i ambientit ekonomik në vendet e zhvilluara, kryesisht ecuria pozitive në ShBA, si dhe kërkesa e lartë prej vendeve në zhvillim ndikuan në përforcimin e trendit rritës të çmimit të naftës.

Ndërkohë, gjatë muajit të fundit të vitit paqartësitë për ritmet e ardhshme të rritjes ekonomike në vendet e OECD-së, problemet me borxhin e lartë të akumuluar në disa prej vendeve të Gjirit Persik si dhe forcimi i dollarit amerikan ndaj disa prej monedhave kryesore ndërkombëtare ndikuan në rënien e çmimit të naftës. Përsa i përket ofertës, ajo rezulton e rritur gjatë gjysmës së dytë të vitit krahasuar me gjysmën e parë të tij, kryesisht gjatë periudhës tetor-dhjetor. Kjo erdhi si pasojë e rritjes së prodhimit në Rusi e në vendet anëtare të OPEC-ut.

Grafik 3. Ndryshimi vjetor i çmimit të naftës në tregun ndërkombëtar dhe i kursit të këmbimit euro/usd.




Burimi: Eurostat, EIA.0

Në gjashtëmujorin e dytë të vitit, indekset kryesore kanë shfaqur ndryshime negative krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë ndërsa ato tregojnë rritje pozitive kur krahasohen me gjashtëmujorin e parë të vitit 2009. Duke konsideruar se ndryshimet tremujore shfaqin një prirje rritëse gjatë gjithë vitit për gati të gjithë treguesit, vlerat negative të rritjes vjetore shkaktohen nga efekti bazë i çmimeve të larta të vitit të kaluar.

Në tremujorin e katërt të vitit 2009, Indeksi i Çmimit të Mallrave shfaqi një rritje vjetore prej 16 për qind, dhe krahasuar me tremujorin e tretë të vitit u rrit me 8.4 për qind. Shtytësit kryesorë të kësaj rritjeje kanë qenë rritja e çmimeve të ushqimeve, karburanteve dhe metaleve, që dëshmojnë për përmirësimin e kushteve ekonomike botërore. Indeksi i Çmimit të Ushqimeve në tremujorin e katërt të vitit është rritur me 10 për qind krahasuar me tremujorin e katërt të 2008, ndërsa rritja tremujore ka qenë 1.3 për qind. Indeksi i Çmimit të Karburanteve ka shënuar një rritje vjetore prej 17.1 për qind, ndërsa në terma tremujorë është rritur me 10.2 për qind.

Grafik 4. Ecuria e indekseve të çmimeve sipas grupmallrave kryesore.




Burimi: FMN.

## III. STABILITETI I ÇMIMEVE DHE OBJEKTIVI I BANKËS SË SHQIPËRISË

Objektivi kryesor i Bankës së Shqipërisë është arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve. Stabiliteti i çmimeve është kontributi më i madh që banka qendrore mund të japë për të garantuar një rritje të qëndrueshme dhe afatgjatë, nëpërmjet rritjes së investimeve afatgjata, rritjes së eficiencës së shpërndarjes së fondeve në ekonomi dhe mbështetjes së stabilitetit financiar. Në përputhje me strategjinë e saj, Banka e Shqipërisë angazhohet në arritjen dhe ruajtjen e inflacionit vjetor në nivelin 3.0 për qind me kufij tolerance +/- 1 pikë përqindjeje. Shpallja e objektivit sasior për inflacionin synon ankorimin e pritjeve të agjentëve ekonomikë dhe uljen e primeve të rrezikut të inflacionit.

### III.1 ÇMIMET E KONSUMIT, OBJEKTIVI I INFLACIONIT DHE POLITIKA MONETARE

Norma e inflacionit shënoi vlerën 3.5 për qind në fund të vitit 2009. Inflacioni mesatar vjetor rezultoi 2.2 për qind, duke qenë pranë kufirit të poshtëm të intervalit dhe afër objektivit 3.0 për qind të Bankës së Shqipërisë. Në krahasim me një vit më parë, inflacioni mesatar vjetor qëndron 1.2 pikë përqindje më poshtë duke dëshmuar për presione të moderuara inflacioniste. Ulja e çmimit të lëndëve të para, efekti statistikor i çmimeve të administruara dhe presionet e dobëta ushtruar nga kërkesa në vend kontribuan në normat e ulëta të inflacionit brenda një mjedisi me prirje nënçmuese të kursit të këmbimit.

Grafik 5. Inflacioni vjetor sipas tremujorëve (në përqindje).




Burimi: INSTAT dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

Zhvillimet makroekonomike në vend gjatë vitit 2009 u formuan në kontekstin e rënies ekonomike globale. Këto zhvillime u karakterizuan nga një ngadalësim progresiv i ritmit të rritjes ekonomike si pasojë e reduktimit të kërkesës të jashtme e të brendshme dhe në prani të shtrëngimit të kushteve të likuiditetit. Ato u shoqëruan gjithashtu nga presione të reduktuara inflacioniste. Sipas të dhënave paraprake të INSTAT, rritja ekonomike për nëntëmujorin e parë të këtij viti rezultoi 4.9 për qind, duke u ngadalësuar nga 5.4 për qind në tremujorin e parë në 4.1 për qind në tremujorin e tretë. Një vit më parë, rritja ekonomike për të njëjtën periudhë ishte 7.8 për qind. Paralelisht me rënien në kërkesën e jashtme[4], investimet private u tkurrën. Burimet e kufizuara financiare të huaja dhe vendase si edhe kujdesi i shtuar në kryerjen e shpenzimeve, kryesisht për investime në një kontekst pasigurie përsa i përket realizimit të të ardhurave të ardhshme – kanë kontribuar në tkurrjen e investimeve private.

Deficiti tregtar u ngushtua me rreth 6 për qind në nivel vjetor në nëntëmujorin e parë të vitit. Qëndrueshmëria e kërkesës konsumatore[5] dhe stimuli fiskal[6], krahas kushteve të lehtësuara monetare, mbështetën normat pozitive të rritjes së kërkesës së brendshme megjithëse me ritme më të ulëta se vitet e kaluara. Ngadalësimi i kërkesës dhe i aktivitetit ekonomik solli rritjen e lehtë të papunësisë. Treguesit e ndryshëm të kostove në ekonomi sinjalizojnë për tendencë të lehtë rënëse në koston e punës për njësi të prodhuar dhe rënie në çmimet e importit dhe të prodhimit[7]. Veprimi i faktorëve të kërkesës dhe të ofertës ka rezultuar në zgjerimin e hendekut negativ të prodhimit[8] që ka balancuar presionet inflacioniste të nënçmimit të kursit të këmbimit. Nënçmimi i lekut gjatë këtij viti është përçuar në masë më të madhe në çmimet e konsumit të mallrave të tregtueshme. Inflacioni i mallrave të tregtueshme është rritur në mënyrë progresive që nga muaji qershor duke shënuar normën më të lartë të rritjes 4.9 për qind në muajin dhjetor. Mbështetur në studime empirike[9], masa e përçimit të efektit të kursit të këmbimit në çmimet e konsumit arrin maksimumin pas nëntë muajve.

Gjatë vitit 2009, Banka e Shqipërisë ndoqi një politikë të kujdesshme monetare, duke krijuar kushte të përshtatshme për një zhvillim të ekuilibruar në një situatë pasigurie të lartë. Në kushtet kur inflacioni, parashikimet për të dhe pritjet e agjentëve ekonomikë qëndrojnë brenda intervalit të tolerancës rreth objektivit 3 për qind, sinjalet për ngadalësimin e kërkesës së brendshme në periudhën e ardhshme motivuan rritjen e stimulit monetar. Banka e Shqipërisë mori vendimin për uljen e normës bazë të interesit në dy raste, në muajt janar dhe tetor 2009, duke e çuar atë në nivelin 5.25 për qind nga 6.25 për qind që ishte në fund të vitit 2008. Krahas uljes së normës bazë të interesit, Banka e Shqipërisë ka shfrytëzuar të gjithë kuadrin e saj operacional për të injektuar likuiditet në ekonomi. Rikthimi i kursit të këmbimit në kahun nënçmues, në fund të tremujorit të tretë dhe pothuajse gjatë gjithë tremujorit të katërt, i përforcuar dhe nga masa lehtësuese e uljes së normës së interesit, ndihmuan në vijimin e tendencës rënëse të indeksit të kushteve monetare. Në prani të tendencave ngadalësuese të ekonomisë, lehtësimi i kushteve monetare ka krijuar premisat e nevojshme për nxitjen e kërkesës agregate dhe respektimin e objektivit të inflacionit.

Grafik 6. Ecuria e Indeksit të Kushteve Monetare dhe e komponentëve të tij.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Të dhënat më të fundit për ekonominë botërore sinjalizojnë një stabilizim të parashikimeve për rritjen ekonomike dhe të çmimeve të lëndëve të para në tregun ndërkombëtar. Rreziqet ndaj stabilitetit të çmimeve në vend për periudhën në vazhdim vlerësohen të jenë relativisht të balancuara, në mungesë të goditjeve të papritura nga ana e ofertës. Ngadalësimi i ofertës monetare, zbutja e stimulit fiskal, vlerësimet për ngadalësimin e kërkesës së brendshme dhe të ritmeve të aktivitetit ekonomik si dhe niveli i ulët i shfrytëzimit të kapaciteteve prodhuese vlerësohet se do të balancojnë presionet inflacioniste të gjeneruara nga faktorë të ofertës, si kursi i këmbimit dhe rritja e planifikuar e çmimit të administruar të energjisë.

## III.2 ECURIA E KATEGORIVE KRYESORE TË SHPORTËS SË MALLRAVE TË KONSUMIT

Norma vjetore prej 3.5 për qind e inflacionit të muajit dhjetor shënoi vlerën më të lartë të inflacionit vjetor për vitin 2009. Kjo vlerë ishte 1.3 pikë përqindje më e lartë krahasuar me vlerën mesatare të inflacionit gjatë vitit 2009, duke konfirmuar tendencën e fortë në rritje në tremujorin e fundit të këtij viti. Gjatë gjysmës së dytë të vitit është vënë re një rritje e normës së inflacionit të mallrave ushqimore të përdorimit të përditshëm, në mënyrë të veçantë të perimeve dhe të frutave. Kjo rritje është më e theksuar në muajt e fundit të vitit, të cilët mendohet të jenë karakterizuar nga dukuria tipike e rritjes së çmimeve të produkteve ushqimore në tregun shqiptar gjatë festave.

Grafik 7. Kontributi i kategorive në inflacionin vjetor (në pikë përqindjeje).




Burimi: INSTAT dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

Inflacioni total vjetor, gjatë këtij gjashtëmujori, është formuar pothuajse plotësisht nga kontributi i kategorisë "Ushqime të papërpunuara", ndërkohë që kontributi i kategorive të tjera të shportës ka ndikuar pak në formimin e normës totale të inflacionit.

Ecuria e normës së inflacionit të kategorisë "Ushqime të papërpunuara" ka një rëndësi të veçantë në shpjegimin dhe parashikimin e luhatjeve afatshkurtra të inflacionit[11]. Gjatë këtij viti kontributi i kësaj kategorie pësoi një rritje progresive deri në muajin dhjetor, duke kulmuar në vlerën 2.8 pikë përqindjeje. Inflacioni i kësaj kategorie u shfaq në vlerë dyshifrore që prej muajit qershor të këtij viti, duke shënuar vlerën më të lartë në muajin dhjetor me 15.1 për qind. Artikujt e kësaj kategorie ndikohen kryesisht nga çmimet e frutave dhe të perimeve, të cilat janë shumë të luhatshme dhe me natyrë sezonale. Pamundësia e prodhimit vendas për të plotësuar kërkesën për këto mallra, si edhe fakti që pjesa e importuar e këtyre produkteve është vendosur nën trysninë e sjelljes së kursit të këmbimit, është përkthyer në çmime më të larta për to. Gjithashtu kjo kategori ka reflektuar rritjen e ndjeshme të çmimeve të këtyre mallrave në tremujorin e fundit në vendet kryesore partnere tregtare të Shqipërisë.

*Tabelë 4. Kontributi i kategorive në inflacionin vjetor (në pikë përqindjeje).*

| | T3-08 | T4-08 | T1-09 | T2-09 | T3-09 | T4-09 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Ushqime të përpunuara (pp) | 2.3 | 1.7 | 0.9 | 0.3 | -0.1 | -0.1 |
| Bukë dhe drithëra (pp) | 1.3 | 1.0 | 0.6 | 0.2 | -0.1 | -0.3 |
| Alkol dhe duhan (pp) | 0.0 | 0.1 | 0.1 | 0.1 | 0.1 | 0.2 |
| Ushqime të papërpunuara (pp) | -0.9 | -0.1 | 0.6 | 1.8 | 2.3 | 2.5 |
| Fruta* (pp) | -0.1 | -0.1 | 0.0 | 0.3 | 0.5 | 0.6 |
| Perime*(pp) | -1.3 | -0.7 | -0.3 | 1.4 | 0.9 | 1.0 |
| Shërbime (pp) | 0.5 | 0.5 | 0.4 | 0.3 | 0.1 | 0.1 |
| Çmime të administruara (pp) | 0.8 | 0.3 | 0.1 | -0.4 | -0.4 | 0.1 |
| Lëndë djegëse dhe energji (pp) | 0.6 | 0.7 | 0.4 | 0.0 | 0.0 | -0.1 |
| Strehim (pp) | 0.0 | 0.0 | 0.1 | 0.2 | 0.2 | 0.2 |
| Mallra konsumi joushqimorë | 0.3 | 0.2 | -0.2 | -0.2 | -0.2 | -0.1 |
| Mallra konsumi afatgjatë (pp) | 0.0 | 0.0 | 0.0 | 0.1 | 0.1 | 0.2 |
| Indeksi i çmimeve të konsumit (v/v, %) | 3.0 | 2.5 | 1.9 | 2.1 | 2.1 | 2.9 |

*Burimi: INSTAT dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.*

Kategoria "Ushqime të përpunuara" regjistroi një rënie të çmimeve gjatë vitit 2009, duke manifestuar ecuri krejtësisht të ndryshme krahasuar me një vit më parë. Inflacioni vjetor i kësaj kategorie gjatë vitit 2008 ishte 2.3 për qind, ndërsa në vitin që sapo përfundoi shënoi vlerën 0.3 për qind. Ndërkohë që pjesa e importuar e këtyre produkteve ka patur një periudhë qetësie si rezultat i rënies së ndjeshme të çmimeve të tyre në tregun botëror që prej gati një viti, prirja në rënie e inflacionit duket se është përcaktuar nga një "zhvendosje" poshtë e kurbës së çmimeve si rezultat i shuarjes së efektit të rritjes së çmimit të bukës në muajt shkurt e mars të vitit 2008.

Zhvillime të rëndësishme në ecurinë e çmimeve gjatë këtij gjashtëmujori u shënuan në çmimet e kategorisë "Mallra me çmime të administruara". Inflacioni vjetor i kësaj kategorie ishte negativ (mesatarisht -2.2 për qind) deri

Grafik 8. Inflacioni vjetor sipas kategorive të mallrave dhe shërbimeve (në përqindje).




Burimi: INSTAT dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

në muajin shtator, për shkak të efektit statistikor të krahasimit me një bazë më të lartë si rezultat i rritjes së çmimit të energjisë elektrike gjatë vitit 2008 dhe të rënies së tarifave të telefonisë celulare gjatë vitit 2009. Këta tre muajt e fundit, inflacioni vjetor i kësaj kategorie shënoi një rritje të lehtë prej 0.5 për qind, duke dhënë një kontribut pozitiv prej 0.1 për qind, kundrejt kontributit negativ (mesatarisht -0.4 për qind) që jepte kjo kategori tek norma e përgjithshme e inflacionit. Inflacioni i kësaj kategorie pritet të pësojë rritje të ndjeshme duke filluar nga muaji janar i vitit 2010 me rritjen e re të çmimit të energjisë.

Ndër kategoritë e tjera, kontributi i kategorisë "Shërbime", ashtu si dhe i kategorive "Strehim" dhe "Mallra konsumi afatgjatë" në normën vjetore të inflacionit, është luhatur brenda intervalit 0.1 – 0.2 pikë përqindje gjatë muajve të fundit. Brenda këtyre kategorive vlen të përmendet fakti që tarifat e pagesave për shërbimin arsimor, kryesisht të universiteteve private, kanë shënuar rritje prej 4.7 për qind në muajin nëntor.

Çmimet e mallrave të konsumit joushqimor vazhdojnë të kontribuojnë negativisht në inflacionin total (-0.1 pikë përqindje). Megjithatë, rënia e vërejtur në nënkategorinë "Operacione ndaj mjeteve personale" ku bën pjesë dhe çmimi i naftës duke filluar nga nëntori i vitit të kaluar, pothuajse është shuar në tremujorin e fundit të vitit, madje për herë të parë në muajin dhjetor çmimet e karburanteve kanë pësuar rritje me 4.4 për qind në nivel vjetor. Gjatë periudhës dhjetor 2008- shtator 2009, çmimet e kësaj kategorie ranë mesatarisht me 11 për qind. Ky faktor[12], nëse ritmet e rritjes vazhdojnë të jenë të tilla si në muajin dhjetor, mendohet të gjenerojë presione të reja inflacioniste në mënyrë të veçantë në çmimet e mallrave të konsumit të përditshëm.

## III.3 PRIRJET KRYESORE TË INFLACIONIT

Inflacioni bazë[13] vjetor gjatë pjesës së dytë të vitit 2009 u luhat mesatarisht rreth vlerës 1 për qind duke vijuar prirjen në rënie të pjesës së parë të tij.

Vlerat e tij gjatë muajve të tremujorit të fundit të këtij viti, përkatësisht 0.9, 1.0 dhe 1.2 për qind, theksuan konvergjencën drejt mesatares afatgjatë të komponentit të përhershëm të inflacionit[14].

Përbërësi jobazë i inflacionit, si përfaqësues i luhatjeve afatshkurtra në çmimet e konsumit, rezultoi me kontribut relativisht të lartë dhe në rritje në inflacionin total vjetor gjatë periudhës qershor-dhjetor 2009. Kontributi mesatar përkatës për periudhën referuese rezultoi rreth 1.7 pikë përqindjeje, ndërkohë që në muajin dhjetor 2009 arriti vlerën 2.7 pikë përqindjeje. Rritja e dukshme vjetore dhe mujore e çmimeve në kategorinë e ushqimeve të papërpunuara, kryesisht në muajt nëntor e dhjetor, janë "përgjegjëset" kryesore të vlerave të larta të inflacionit jobazë dhe atij total. Megjithë zhvillimet e muajve të fundit të vitit, pjesa e dytë e tij rezultoi me një inflacion bazë vjetor më të ulët se sa ai i së njëjtës periudhë të një viti më parë (1.6 pikë përqindje më poshtë).

Grafik 9. Kontributi i inflacionit bazë dhe jobazë në inflacionin vjetor (në pikë përqindjeje).




Burimi: INSTAT dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

Grafik 10. Kontributi i sektorëve në inflacionin vjetor (në pikë përqindjeje).




Burimi: INSTAT dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

Inflacionet mesatare vjetore për sektorët e mallrave të tregtueshme dhe të patregtueshme të shportës së IÇK-së, për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2009, rezultuan përkatësisht 3.5 dhe 1.1 për qind. Rritja e çmimeve në sektorin e mallrave të tregtueshme u theksua në tremujorin e fundit të vitit referues. Në muajin dhjetor 2009, inflacioni në këtë sektor arriti nivelin maksimal, 5 për qind, me një kontribut në inflacionin total vjetor prej rreth 3 pikë përqindjeje.

Inflacioni i tregtueshëm neto[15] në terma mesatarë vjetorë për pjesën e dytë të vitit 2009, rezultoi rreth 0.6 për qind apo 2.9 pikë përqindje më poshtë se sa ai i tregtueshëm në periudhën përkatëse. Sezonaliteti i lartë në çmimet e disa produkteve të papërpunuara si edhe efektet e shtuara të sjelljes së çmimeve në fundvite u amplifikuan ndjeshëm në praninë e sjelljes relativisht të gjatë nënçmuese të kursit të këmbimit gjatë vitit të fundit. Vlerësimet tregojnë se në inflacionin e sektorit të tregtueshëm të mallrave, si sektori më i ekspozuar ndaj rrezikut të luhatjes së kursit të këmbimit, është përçuar në një masë të konsiderueshme efekti i nënçmimit relativisht të thellë të kursit të këmbimit lekë/euro.[16]

Zhvillimet në inflacionin vjetor të mallrave dhe të shërbimeve të patregtueshme të shportës së IÇK-së, ndihmuan në sheshimin e vlerave të inflacionit total pranë nivelit 2.5 për qind për pjesën e dytë të vitit 2009. Inflacioni i këtij sektori dhe ai i patregtueshëm neto[17], vijuan të qëndrojnë në nivele të ulëta historike deri në muajt e fundit të vitit referues.

Grafik 11. Inflacioni vjetor i mallrave të tregtueshme dhe të patregtueshme.




Burimi: INSTAT, llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

Tendencat e analizuara të zhvillimeve në çmimet e konsumit sugjerojnë se presionet inflacioniste nga krahu i kërkesës së brendshme kanë qenë të moderuara, duke ndihmuar në zbutjen e efekteve pro-inflacioniste të shkaktuara nga nënçmimi i kursit të këmbimit gjatë periudhës janar-dhjetor 2009.

## IV. ZHVILLIMET MAKROEKONOMIKE DHE NDIKIMET NË INFLACION

Zhvillimet në tregues të tërthortë të kërkesës agregate në ekonominë e vendit janë në mbështetje të tkurrjes së saj gjatë tremujorit të tretë të vitit 2009 dhe në vijim. Tregues të konsumit dhe të investimeve private si edhe të eksporteve vijonë të shënojnë ritme më të ulëta se sa ato të një viti më parë. Karakteri ekspansionist i politikës fiskale gjatë periudhës qershor – nëntor 2009 në krahun e shpenzimeve afatshkurtra dhe të investimeve publike, vlerësohet të ketë qenë një nga mbështetësit kryesorë të kërkesës agregate në ekonomi. Kërkesa e tkurrur ka ndikuar në ngadalësimin e ritmeve të rritjes së aktivitetit ekonomik në vend gjatë pjesës së dytë të vitit 2009 krahasuar me ato të një viti më parë.

### IV.1 PRODHIMI I BRENDSHËM BRUTO DHE ECURIA E KËRKESËS AGREGATE

Ekonomia shqiptare ka shënuar një rritje ekonomike pozitive gjatë nëntë muajve të parë të vitit, ndonëse me ritme rritjeje të cilat kanë ardhur duke u ngadalësuar. Kështu, PBB-ja regjistroi një rritje mesatare vjetore prej 4.9[18]

Grafik 12. Kontributet e sektorëve në rritjen vjetore të PBB-së (në pp).




Burimi: INSTAT (PBB, tremujori i dytë dhe i tretë 2009) dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

Grafik 13. Treguesi i tendencës ekonomike dhe PBB-ja tremujore.




Burimi: Vrojtimi i besimit të bizneseve, Banka e Shqipërisë.

Grafik 14. Tregues nga vrojtimet e besimit të biznesit të përmbledhur në nivel ekonomie.




Burimi: Vrojtimi i besimit të bizneseve, Banka e Shqipërisë.

për qind, ose rreth 2.3 pikë përqindje më të ulët se norma mesatare vjetore e një viti më parë. Bazuar në të dhënat paraprake të INSTAT[19], prodhimi i brendshëm vendas në tremujorin e tretë u rrit me rreth 4.1 për qind në terma vjetorë ndërkohë që ritmet e shënuara në dy tremujorët e parë të vitit ishin përkatësisht 5.4 dhe 5.3 për qind. Dinamika e këtij treguesi bazuar në ritmet tremujore të rritjes së tij, për periudhën janar-shtator 2009 është në një linjë me prirjen vjetore. Ecuria e treguesit të shifrës së afarizmit për ekonominë në total shfaq tendencë të njëjtë me ecurinë e PBB-së në tre tremujorët e parë të vitit, duke konfirmuar kështu ngadalësimin e normave të rritjes.

*Hapësirë informuese 1. Çfarë tregojnë treguesit e besimit për zhvillimin ekonomik në vend gjatë vitit 2009?*

*Treguesit e besimit të ndërtuar nga Banka e Shqipërisë në përfundim të përpunimit të pyetësorëve të vrojtimit të besimit të bizneseve dhe të konsumatorëve, përmbledhin në një tregues të vetëm opinionet për aspekte të ndryshme për secilin sektor dhe besimin në ekonomi në përgjithësi të bizneseve dhe të konsumatorëve[20]. Përdorimi i treguesve të besimit në analizat periodike që i bëhen zhvillimeve ekonomike bazohet në supozimin se gjykimet dhe opinionet e shprehura të bizneseve dhe të konsumatorëve do të pasqyrohen në veprime konkrete, me pasoja ekonomike në aktivitetin e tyre dhe më pas në ekonominë e vendit. Lidhja e treguesve të besimit me treguesit sasiorë zyrtarë të ekonomisë reale varet nga kjo shkallë e pasqyrimit të opinioneve në veprime konkrete.*

*Treguesi i tendencës ekonomike (TTE), i cili përmbledh zhvillimet në sektorin e industrisë, të ndërtimit, të shërbimeve dhe të konsumatorit, ka përafruar qartë ngadalësimin e normave rritëse të PBB-së tremujore gjatë vitit 2009 (grafiku 13). Treguesit e besimit të bizneseve dhe të konsumatorëve regjistruan një rënie të thellë në tremujorin e parë të këtij viti, të ndikuar nga ngadalësimi i kërkesës dhe pritjet negative në kushtet e një krize ekonomike botërore. Treguesi i tendencës ekonomike ra me 28 pikë përqindjeje në këtë tremujor, duke qëndruar poshtë mesatares së tij historike me 27 pikë përqindjeje. Megjithëse besimi i bizneseve dhe i konsumatorëve në dy tremujorët e ardhshëm rezultoi në një nivel më të lartë se sa në tremujorin e parë të vitit, treguesit e besimit për të katër sektorët aktualisht qëndrojnë poshtë mesatareve të tyre afatgjata. Balancat e prodhimit të agreguar për*

*sektorët prodhues dhe balanca e kërkesës së perceptuar e agreguar për ekonominë kanë shënuar vlera negative në tre tremujorët e parë të vitit 2009 (grafiku 14).*

*Në linjë me rënien e prodhimit dhe ngadalësimin e kërkesës, shfrytëzimi i kapaciteteve aktuale të bizneseve, si një tregues i gjendjes në të cilën ndodhet ekonomia, ka rënë ndjeshëm gjatë vitit 2009. Bizneset në nivel ekonomie i kanë shfrytëzuar mesatarisht 69 për qind kapacitetet e tyre për nëntëmujorin e parë të këtij viti, 10 pikë përqindjeje më e ulët se gjatë vitit 2008 (grafiku 15). Norma më e ulët e shfrytëzimit të kapaciteteve gjatë nëntëmujorit të parë të vitit 2009 është regjistruar për sektorin e industrisë, mesatarisht 65 për qind. Si pasojë e shfrytëzimit të ulët të kapaciteteve prodhuese, e ngadalësimit të kërkesës konsumatore dhe e shtrëngimit të kushteve të kreditimit[21], investimet private janë kontraktuar gjatë vitit 2009. Balanca e investimeve sipas vlerësimeve të bizneseve ka qenë negative dhe në rënie gjatë vitit 2009. Kjo është shprehur edhe në rënien vjetore me 13 për qind të importit të mallrave kapitale për periudhën janar-tetor 2009.*

*Gjithashtu, gjendja financiare e bizneseve në nivel ekonomie vijoi prirjen rënëse gjatë tre tremujorëve të parë të vitit 2009, si pasojë e tkurrjes së kërkesës së brendshme dhe të jashtme, duke u reflektuar edhe në rënien e ritmit rritës të të ardhurave nga tatimet (grafiku 16).*

*Ecuria e treguesit të besimit të konsumatorit gjatë vitit 2009 ka reflektuar nga njëra anë vlerësimin e tyre mbi situatën e përgjithshme ekonomike dhe atë financiare dhe nga ana tjetër zhvillimet pozitive në situatën e kursimit. Balanca e kësaj të fundit u rrit me 4.5 pikë përqindjeje në tremujorin e tretë të vitit 2009.*

Grafik 15. Shfrytëzimi i kapaciteteve në ekonomi dhe sipas sektorëve, në përqindje ndaj shfrytëzimit të plotë.




Burimi: Vrojtimi i besimit të bizneseve, Banka e Shqipërisë.

Grafik 16. Të ardhurat nga tatimet dhe treguesi nga vrojtimet mbi gjendjen financiare të bizneseve.




Burimi: Vrojtimi i besimit të bizneseve, Banka e Shqipërisë.

Konsumi privat, bazuar në tregues të tërthortë të matjes së tij, ka shënuar një rritje modeste gjatë vitit 2009. Rritja e moderuar e punësimit, ngadalësimi i normave të rritjes së pagave në sektorin privat, ulja e remitancave dhe e kredisë për konsum, si dhe rritja e pasigurisë përgjatë vitit 2009 kanë ndikuar në stabilizimin e konsumit gjatë vitit 2009. Sipas të dhënave indirekte sasiore, indeksi i tregtisë me pakicë dhe importi i mallrave të konsumit kanë qenë relativisht të qëndrueshëm gjatë vitit. Në veçanti, indeksi i tregtisë me pakicë shënoi rritje vjetore negative në tremujorin e parë të këtij viti, rritje të lehtë vjetore në tremujorin e dytë dhe ra me 2.3 për qind në tremujorin e tretë. Bazuar në të dhëna cilësore nga vrojtimet, treguesi i besimit të konsumatorit, pas një përmirësimi të lehtë në tremujorin e dytë, pësoi një rënie në tremujorin e tretë të vitit 2009. Pritjet nga vrojtimet e bizneseve dhe të konsumatorëve sugjerojnë se ritmet e rritjes së konsumit privat do të mbeten në nivele modeste edhe gjatë tremujorit të katërt të vitit 2009.

Grafik 17. Tregues të konsumit privat dhe të shpenzimeve buxhetore.




Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Tregues jo të drejtpërdrejtë dëshmojnë për një kontraktim të investimeve private gjatë vitit 2009, të diktuar nga ngadalësimi i kërkesës, nga niveli i ulët i besimit të bizneseve, nga norma e ulët e shfrytëzimit të kapaciteteve si dhe nga kushtet e shtrënguara të kreditimit. Importi i mallrave kapitale, si përafrues i investimeve në ekonomi, ka pësuar rënie vjetore me 12.8 për qind në periudhën janar-nëntor 2009. Kjo rënie konfirmohet dhe nga të dhënat e vrojtimeve të besimit të bizneseve, për investimet, balanca e të cilave ka mbetur negative dhe në rënie gjatë tre tremujorëve të parë të vitit. Nga ana tjetër, investimet publike janë rritur me 23 për qind gjatë periudhës janar-nëntor të vitit 2009, krahasuar me të njëjtën periudhë një vit më parë. Treguesit cilësorë nga vrojtimi i bizneseve për të dytin tremujor radhazi tregojnë për një rënie të inventarëve në tremujorin e tretë të vitit 2009, pas një serie tremujorësh në të cilët bizneset kishin raportuar akumulim të tyre.

Shpenzimet qeveritare kanë dhënë kontribut pozitiv në kërkesën agregate gjatë vitit 2009, krahasuar me komponentët e tjerë të saj. Shpenzimet publike kanë regjistruar një rritje vjetore prej 16 për qind për 11-mujorin e parë të vitit 2009. Kjo rritje është reflektuar në rritjen e deficitit buxhetor dhe është financuar nëpërmjet huamarrjes së jashtme dhe përdorimit të të ardhurave të privatizimit.

Eksportet neto kanë vijuar të japin një kontribut negativ në PBB gjatë tre tremujorëve të parë të vitit 2009, për sa kohë që niveli i importeve tejkalon ndjeshëm nivelin e eksporteve. Megjithatë, gjatë kësaj periudhe, kontributi i eksportit neto të mallrave dhe shërbimeve në nivelin e aktivitetit ekonomik ka ruajtur të njëjtën peshë[22] me vitin e kaluar.

### IV.1.1 Ecuria e prodhimit sipas sektorëve

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2009, në nivel sektorial[23] kontributin më të lartë në rritjen vjetore të PBB-së e dhanë aktivitetet e shërbimeve të ndikuara kryesisht prej normave të larta të rritjes vjetore në degët e postë-telekomunikacionit (rreth 34.3 për qind), transportit (rreth 15.5 për qind) dhe tregti, hoteleri dhe restorante (rreth 6.4 për qind). Aktivitetet e përfshira në shërbimet e tjera u rritën me një normë vjetore rreth 2.3 për qind ose mesatarisht 7 herë më e ulët se ajo e tremujorit të parë dhe të dytë të vitit.

Aktiviteti prodhues industrial vijoi të shënojë tkurrje edhe në tremujorin e tretë të vitit, ndonëse me një ritëm vjetor më të ulët se në tremujorin e dytë, duke regjistruar një rënie vjetore prej 4.5 për qind. Dega e ndërtimit regjistroi gjithashtu tkurrje prej 0.7 për qind në terma vjetorë, ndryshe nga rritja e shënuar në pjesën e parë të vitit.

## SEKTORËT PRODHUES NË EKONOMI

Bazuar në treguesin e shifrës së afarizmit në vëllim, dega e industrisë regjistroi një rritje modeste vjetore në tremujorin e tretë të vitit me rreth 0.2 për qind duke shënuar normën më të ulët vjetore që prej vitit 2004. Kjo ecuri në aktivitetin industrial reflektohet edhe prej treguesit të konsumit jofamiljar të energjisë elektrike. Pas kontraktimit të regjistruar që prej tremujorit të katërt të vitit 2008, industria nxjerrëse në këtë tremujor u rrit me 1.8 për qind, në nivel vjetor. Gjatë këtij tremujori, në terma të shifrës së afarizmit të gjeneruar, degë tjetër që shfaqi përkeqësim ishte ajo e industrisë përpunuese, duke rënë me 5.7 për qind, ndërkohë që ecuri më të mirë regjistroi kategoria "Energji elektrike, gaz, ujë", duke u rritur me rreth 20 për qind në terma vjetorë.

Dega e ndërtimit ngadalësoi ritmet e larta të rritjes vjetore, duke gjeneruar një shifër afarizmi në vëllim 24.5 për qind më të lartë se tremujori i tretë i vitit të mëparshëm, por duke shënuar një kontraktim në terma tremujorë, prej 8.3 për qind. Gjatë kësaj periudhe, vëllimi i ndërtimit ka ngadalësuar ritmet vjetore të rritjes, çka mbështetet edhe prej treguesve të tjerë të tërthortë, siç është rritja me ritme më të ulëta e konsumit të çimentos.

*Hapësirë informuese 2. Ecuria e çmimeve të banesave*[24].

*Gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2009, indeksi i çmimeve të banesave për qytetin e Tiranës ka shënuar norma rritjeje më të larta krahasuar me gjysmën e parë të vitit. Në tremujorin e tretë dhe të katërt të vitit 2009, ky indeks shënoi rritje përkatësisht me 17.3 dhe 11.6 për qind. Ndryshimet tremujore për këto periudha janë përkatësisht 5.6 dhe 5.8 për qind. Kjo rritje ka reflektuar kryesisht ecurinë nënçmuese të lekut gjatë kësaj periudhe.*

*Çmimet e prodhimit në sektorin e ndërtimit, bazuar në opinionet e bizneseve të mbledhura nga vrojtimi i besimit, kanë njohur rritje në tremujorin e tretë të vitit 2009 pas një prirje rënëse që nga tremujori i dytë i vitit 2008 (grafiku 19). Nga të dhënat e këtij vrojtimi, vlerësimi i bizneseve ndërtuese mbi kontratat porositëse është përmirësuar dhe pakësimi i inventarëve ka vijuar për të dytin vrojtim radhazi gjatë tremujorit të tretë të vitit 2009.*

Grafik 18. Ecuria e indeksit të çmimit të banesave dhe e indeksit të qirasë së banesave.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

*Në ndryshim me zhvillimet në çmimet e banesave, indeksi i qirasë ka rënë përsëri gjatë tremujorit të katërt të vitit 2009, me 15.5 për qind, krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2008. Në krahasim me tremujorin e tretë të vitit 2009, indeksi i qirasë së banesave është 1.2 për qind më i ulët. Raporti i indeksit të çmimit me qiranë[25] është rritur në tremujorin e katërt duke qëndruar 0.2 pikë përqindjeje sipër mesatares së tij historike.*

Grafik 19. Ecuria e çmimeve të prodhimit në ndërtim dhe ndryshimet tremujore të IÇP (majtas) dhe raporti i çmimit ndaj qirasë së banesave dhe prirja afatgjatë e tij (djathtas).




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Prodhimi i energjisë elektrike[26] gjatë periudhës janar - nëntor 2009 u rrit me 35.2 për qind krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Të dhënat e disponueshme tregojnë se gjatë muajit nëntor 2009, prodhimi i energjisë elektrike u rrit 94.8 për qind në terma vjetorë dhe me rreth 55.7 për qind krahasuar me një muaj më parë.

Grafik 20. Ecuria e shifrës së afarizmit në vëllim për ndërtimin dhe industrinë.




Burimi: INSTAT, Statistikat afatshkurtra tremujori i tretë 2009.

Bilanci i importit dhe eksportit të energjisë elektrike është përmirësuar gjatë periudhës janar – nëntor 2009. Kështu, gjatë këtij njëmbëdhjetëmujori, vëllimi i eksportit të energjisë elektrike arriti në 438.5 GWh. Për të njëjtën periudhë, vëllimi i importit të energjisë elektrike ra me 97.2 për qind krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë (53.1 GWh nga 2232.5 GWh që ishte në periudhën janar – nëntor 2008). Niveli i energjisë së eksportuar për periudhën njëmbëdhjetëmujore ishte 385.5 GWh më i lartë se ai i energjisë së importuar. Konsumi i energjisë elektrike për periudhën janar – nëntor 2009 u rrit me 5.65 për qind krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Kjo rritje i detyrohet më shumë rritjes së konsumit familjar të energjisë elektrike. Nga ana tjetër, konsumi i energjisë elektrike nga bizneset është rritur në mënyrë të papërfillshme, përkatësisht me 0.04 për qind.

*Tabelë 5. Treguesit vjetorë të bilancit të energjisë elektrike (në GWh).*

| | 11M '05 | 11M '06 | 11M '07 | 11M '08 | 11M '09 | Ndryshimi vjetor 11M '09 / 11M '08 (në %) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Prodhimi | 5089.0 | 5163.9 | 2591.8 | 3423.5 | 4628.8 | 35.21 |
| Import ( - ) | 149.8 | 507.4 | 2517.8 | 2232.5 | 53.1 | -97.2 |
| Eksport ( + ) | 0.0 | 0.0 | 0.0 | 0.0 | 438.5 | - |
| Humbjet në shpërndarje | 1793.0 | 2028.3 | 1513.7 | 1520.4 | 1881.1 | 23.73 |
| Humbje në shpërndarje/Prodhimi | 35.2% | 39.3% | 58.4% | 44.4% | 40.6% | -3.8 |
| Energjia e konsumuar | 4075.0 | 5151.4 | 4931.8 | 5422.4 | 5729.0 | 5.65 |
| Konsumi i faturuar | 3225.6 | 3123.1 | 3278.2 | 3736.1 | 3847.9 | 2.99 |
| Konsumi i pafaturuar | 849.4 | 2028.3 | 1653.5 | 1686.3 | 1881.1 | 11.55 |
| Konsumi familjar | 1943.1 | 1939.9 | 1870.1 | 2072.8 | 2183.9 | 5.36 |
| Konsumi jofamiljar | 1282.5 | 1183.2 | 1408.1 | 1663.3 | 1664.0 | 0.04 |

*Burimi: KESH; OSSH.*

## *SEKTORI I SHËRBIMEVE*

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2009, shifra e afarizmit në vëllim e gjeneruar prej degës së shërbimeve ka shënuar ritëm pozitiv rritjeje në terma vjetorë, ndonëse rezulton një ritëm më i ulët se në dy tremujorët e parë të vitit. Sipas këtij treguesi, aktiviteti tregtar me shumicë u rrit me rreth 12.6 për qind në nivel vjetor, duke rezultuar 5.2 pikë përqindje më pak se mesatarja e dy tremujorëve

Grafik 21. Ecuria e shifrës së afarizmit në vëllim për tregtinë, transportin dhe komunikacionin dhe hotelet.




Burimi: INSTAT, Statistikat afatshkurtra tremujori i tretë 2009.

paraardhës. Norma vjetore pozitive të këtij treguesi kanë shënuar edhe degët e postës dhe komunikacionit si edhe aktiviteti i hotelerisë, ndonëse ritmet e tyre në këtë tremujor janë më të ulëta se ato të tremujorëve paraardhës.

### IV.1.2 Zhvillimet në sektorin e jashtëm të ekonomisë

Bilanci i përgjithshëm i pagesave për periudhën korrik–shtator të vitit 2009 rezultoi me një rritje të mjeteve valutore prej rreth 44 milionë eurosh. Zhvillimet kryesore në sektorin e jashtëm të ekonomisë ishin:

- Rënie e transaksioneve korente hyrëse dhe dalëse;
- Thellim i mëtejshëm i deficitit korent dhe ngushtim modest i deficitit tregtar;
- Tkurrje e prurjeve neto në llogarinë kapitale dhe financiare;
- Rritje e rezervave valutore të autoritetit monetar.

*LLOGARIA KORENTE*

Transaksionet korente të kryera gjatë periudhës korrik-shtator të vitit 2009, vlerësohen në rreth 2.68 miliardë euro duke qenë 7.4 për qind më të larta se transaksionet e së njëjtës periudhë të një viti më parë[27]. Deficiti i bilancit të llogarisë korente gjatë kësaj periudhe arriti në 330.6 milionë euro, duke regjistruar një rritje vjetore prej rreth 43 për qind.

Thellimi i deficitit korent ka ardhur si pasojë e ndryshimit të kahut në bilancin e të ardhurave nga suficit në deficit[28], dhe e ngushtimit të suficitit të *transfertave korente*[29]. Për pasojë, raporti i deficitit korent ndaj PBB-së[30] është rritur ndjeshëm në terma vjetorë duke u vlerësuar në rreth 17 për qind. Shkëmbimet tregtare në mallra dhe shërbime përfaqësojnë pjesën më të madhe të transaksioneve korente të vendit tonë. Mbi 90 për qind e shpenzimeve korente të kësaj periudhe ka shkuar për blerje mallrash dhe shërbimesh, ndërkohë që rreth 22 për qind e të ardhurave korente ka hyrë në formën e transfertave. Eksportet e mallrave dhe shërbimeve siguruan përkatësisht rreth 17 dhe 57 për qind të të ardhurave korente. Ndërkohë, deficiti i tregtisë së mallrave është tkurrur në 591 milionë euro ose rreth 2 për qind në terma vjetorë dhe raporti i tij ndaj PBB-së vlerësohet në 28.4 për qind.

*Tabelë 6. Tregues të bilancit të pagesave në vite.*

| | Në milionë euro | | | | Në përqindje ndaj PBB-së[31] | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | T3'06 | T3'07 | T3'08 | T3'09 | T3'06 | T3'07 | T3'08 | T3'09 |
| Llogaria korente | -106.9 | -170.1 | -230.7 | -330.6 | -8.2 | -8.4 | -13.9 | -17.3 |
| Bilanci tregtar | -415.3 | -527.4 | -601.9 | -590.8 | -22.7 | -25.1 | -27.9 | -28.4 |
| - Eksport | 153.2 | 197.3 | 242.0 | 201.8 | 8.3 | 9.7 | 10.9 | 9.2 |
| - Import | -568.5 | -724.7 | -843.9 | -792.6 | -31.0 | -34.9 | -38.7 | -37.6 |
| Shërbime (neto) | -18.6 | 11.2 | 87.2 | 88.1 | -1.3 | 0.2 | 1.0 | 0.5 |
| Të ardhura (neto) | 50.5 | 74.4 | 54.8 | -33.5 | 2.4 | 3.1 | 1.2 | 0.1 |
| Transferta korente (neto) | 276.4 | 271.7 | 229.2 | 205.7 | 13.4 | 13.6 | 11.7 | 10.5 |
| Llogaria kapitale dhe financiare | 41.0 | 298.8 | 208.1 | 187.1 | 7.4 | 11.5 | 11.5 | 19.8 |
| Gabime dhe harresa | 141.9 | 6.4 | 141.1 | 187.4 | 3.6 | 0.2 | 3.3 | -0.8 |
| Bilanci i përgjithshëm | 76.1 | 135.1 | 118.5 | 43.9 | 2.8 | 3.3 | 0.9 | 1.7 |

*Burimi: Banka e Shqipërisë dhe vlerësime të FMN-së.*

*TREGTIA E JASHTME*

Të dhënat mbi tregtinë e jashtme për periudhën korrik-nëntor[32] të vitit 2009 dëshmojnë për një dobësim të flukseve tregtare hyrëse dhe dalëse. Shkëmbimet tregtare për këtë periudhë arritën vlerën 1.7 miliardë euro, vlerë kjo rreth 11 për qind më e ulët krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Deficiti tregtar shënoi një ngushtim prej përafërsisht 10 për qind në terma vjetorë. Treguesi relativ i mbulimit të importeve prej eksporteve qëndron në nivelin 24.6 për qind dhe paraqet një rënie me rreth 2.4 pikë përqindjeje.

*Tabelë 7. Ecuria në eksporte dhe importe (milionë euro) dhe ndryshimi vjetor sipas grupmallrave (në %).*

| | Eksporte (milionë euro, korrik-nëntor) | Ndryshimi vjetor (në %, korrik-nëntor) | Ndryshimi vjetor (në %, nëntor) | Importe (milionë euro, korrik-nëntor) | Ndryshimi vjetor (në %, korrik-nëntor) | Ndryshimi vjetor (në %, nëntor) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Ushqime dhe kafshë të gjalla | 16.1 | 7.7 | -8.6 | 170.5 | 1.9 | -12.3 |
| Pije dhe duhan | 0.5 | -58.1 | -59.9 | 62.4 | 20.4 | -19.3 |
| Materiale të papërpunuara | 43.8 | -24.0 | 4.5 | 43.2 | 31.6 | -0.2 |
| Lëndë djegëse | 39.1 | -5.4 | 167.0 | 185.2 | -28.5 | -26.1 |
| Yndyrna bimore dhe shtazore | 0.2 | 94.6 | 1337.1 | 16.6 | -19.5 | 29.7 |
| Produkte kimike | 6.3 | 37.7 | 25.7 | 148.5 | -4.7 | 4.1 |
| Mallra të përpunuar | 61.0 | -33.3 | -32.7 | 353.9 | -7.2 | -11.9 |
| Makineri dhe pajisje | 18.1 | 8.7 | -21.0 | 287.5 | -15.7 | -23.4 |
| Mallra të tjerë të përpunuar | 157.1 | -5.2 | -7.0 | 121.3 | -18.9 | 4.6 |
| Të tjera | - | - | | - | - | |
| Total | 342.2 | -13.1 | -5.7 | 1,389.1 | -10.9 | -12.8 |

*Burimi: Banka e Shqipërisë.*

Meqenëse një përqindje tepër e lartë e eksporteve vendase kanë si destinacion final vendet e Bashkimit Evropian, e më specifikisht Greqinë e Italinë, dobësimi i kërkesës së jashtme në këto vende ka ndikuar ndjeshëm ecurinë e eksporteve. Ndonëse, nënçmimi i monedhës vendase ndaj monedhës së përbashkët evropiane ka shërbyer si zbutës ndaj rënies së kërkesës në këto vende, rënia e çmimeve në tregjet përkatëse ka ushtruar presion në kah të kundërt për eksportuesit në vend. Kështu, eksportet ranë me 13.1 për qind gjatë periudhës korrik-nëntor'09 krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraardhës. Kategoritë e eksporteve "Materiale të papërpunuar" dhe "Mallra të përpunuar" kanë dhënë ndikim kryesor duke regjistruar një rënie me përkatësisht 24 dhe 33 për qind në terma vjetorë. Ndërkohë, edhe grupi me peshën më të madhe në eksporte, "Mallra të tjerë të përpunuar", ka shënuar një rënie vjetore prej rreth 5 për qind. Pesha e kombinuar që këto tre kategori zënë ndaj totalit të eksporteve për periudhën në fjalë është rreth 77 për qind.

Importet drejt vendit tonë, gjatë periudhës korrik-nëntor, u zvogëluan me përafërsisht 11 për qind në terma vjetorë. Kontributin kryesor në këtë rënie e dhanë nëngrupet "Makineri dhe pajisje" dhe "Mallra të përpunuar", të cilat u zvogëluan me përkatësisht 16 dhe 7 për qind në terma vjetorë. Rënie vjetore të importeve regjistroi dhe grupi "Lëndë djegëse" por këtu ndikon edhe niveli i lartë i çmimeve me të cilin u përball ky sektor vitin e kaluar. Në të kundërt, grupi i importeve "Ushqime dhe kafshë të gjalla" përjetoi një rritje prej përafërsisht 2 për qind në nivel vjetor.

Grafik 22. Vlera e importeve, eksporteve dhe bilanci tregtar (milionë euro).




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Përsa i përket ecurisë së importeve të matura sipas vëllimit (ton), vërehet një rritje vjetore e këtij treguesi për periudhën e sipërpërmendur. Kështu, vëllimi i tyre në terma vjetorë është rritur me rreth 17.4 për qind. Vëllimi i eksporteve të vendit tonë drejt vendeve të ndryshme ka shënuar një rritje në vëllim prej 0.9 për qind në terma vjetorë gjatë periudhës korrik-nëntor'09. Analiza e ecurisë së importeve të ndara sipas përdorimit të tyre final në "Mallra kapitalë", "Mallra të ndërmjetëm" dhe "Mallra për konsum", paraqet një pririje rritëse të kategorisë së fundit dhe rënëse të dy kategorive të para.

Kështu, për periudhën e sipërpërmendur, importet e kategorive "Mallra kapitalë" dhe "Mallra të ndërmjetëm" u zvogëluan me përkatësisht 20 dhe

Grafik 23. Vëllimi i eksporteve, importeve dhe pririja e tyre historike në 1000 tonë.




Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Grafik 24. Ndryshimet vjetore në importin e kategorive mallra kapitalë, të ndërmjetëm dhe konsumi (në përqindje).




Burimi: Banka e Shqipërisë.

14 për qind në terma vjetorë. Në të kundërt, importet e kategorisë "Mallra për konsum" shënuan një rritje prej përafërsisht 1.6 për qind në terma vjetorë.

Partneriteti tregtar i Shqipërisë vijon të mbetet i orientuar kryesisht drejt vendeve të Bashkimit Evropian. Kështu, shkëmbimet tregtare me këto vende zënë përafërsisht 68 për qind të totalit të aktivitetit tregtar të vendit tonë. Përsa i përket eksporteve, Italia vijon të jetë destinacioni kryesor i tyre duke zënë mesatarisht rreth 61 për qind të totalit për periudhën korrik-nëntor. Në të kundërt, shtrirja gjeografike e origjinës së importeve drejt vendit tonë është më e larmishme. Këtu spikat rënia e importeve nga Kina dhe vendet e rajonit dhe rritja e importeve prej vendeve të BE-së.

*Hapësirë informuese 3: Remitancat, një mundësi zhvillimi.*

*Efektet dhe mësimet e krizës ekonomike dhe financiare që përfshiu tregjet botërore gjatë viteve 2008-2009 duhen konsideruar në hartimin e politikave ekonomike dhe strategjive që lidhin migrimin me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të një vendi. Një dimension i rëndësishëm i tyre është edhe ecuria e pritshme e remitancave dhe aftësia e tyre për të mbështetur objektivat e reduktimit të varfërisë dhe zhvillimin ekonomik të vendit. Në Shqipëri, dërgesat nga emigrantët - të cilat vlerësohen rreth nivelit 9-10 për qind të PBB-së - përfaqësojnë një fluks hyrës tepër të rëndësishëm si për familjet ashtu dhe për ekonominë në tërësi. Së bashku me investimet e huaja direkte dhe të ardhurat nga eksporti i mallrave dhe shërbimeve, ato përbëjnë një nga zërat kryesorë në financimin e importeve dhe mbështetjen e nevojave të ekonomisë për konsum e për investime. Duke filluar nga viti 2004, vlerat e raportit të dërgesave të emigrantëve ndaj PBB-së kanë qenë më të larta se ato të investimeve të huaja direkte, duke luajtur rolin e katalizatorit në zhvillimin ekonomik dhe financiar të vendit.*

Grafik 25. Dërgesat e emigrantëve, eksportet e mallrave dhe shërbimeve dhe IHD-të (në % të PBB–së).




Burimi: Banka e Shqipërisë.

*Efektet e remitancave në ekonomi janë komplekse. Në rastin e Shqipërisë, këto flukse përbëjnë një burim të ardhurash për përmbushjen e nevojave të konsumit dhe përmirësimin e kushteve të jetesës, si dhe një mundësi potenciale për financimin e investimeve dhe krijimin e vendeve të reja të punës. Nga ana tjetër, përfitimi i remitancave prej familjeve të emigrantëve mund të krijojë potencialisht presione në tregun e punës, nëpërmjet krijimit të varësive dhe inkurajimit të papunësisë afatgjatë. Këto faktorë duhen mbajtur parasysh në trajtimin e remitancave, jo vetëm në kontekstin aktual por edhe atë të pritshëm të tyre.*

*Dërgesat e emigrantëve gjatë nëntëmujorit të parë të vitit 2009 drejt Shqipërisë u zvogëluan me rreth 6 për qind ndaj të njëjtës periudhë të vitit paraardhës dhe me rreth 19 për qind ndaj të njëjtës periudhë të vitit 2007, duke lëkundur raportin e kërkesës dhe ofertës për valutë dhe duke ndikuar kështu në ecurinë e kursit të këmbimit. Ngadalësimi i remitancave gjatë vitit 2009, megjithëse ishte kryesisht një reflektim direkt i efekteve të krizës botërore, mund të konsiderohet edhe si një sinjal i parë në ecurinë e pritshme të tyre në të ardhmen. Reduktimi progresiv i vlerës dhe i peshës relative të tyre lidhet kryesisht me karakterin kohor të remitancave, të cilat sikurse pranohet dhe nga studime të ndryshme (Docquier, Rapoport 2005), kanë prirje afatgjatë rënëse. Emigrantët, me kalimin e kohës, stabilizohen në vendin pritës, krijojnë familjet e tyre e për pasojë përballen me presione të ndryshme për të ulur nivelin e dërgesave drejt vendit të origjinës. E njëjta prirje pritet të ndodhë edhe për Shqipërinë dhe, për këtë arsye, duhen shtuar përpjekjet për të gjetur burime alternative, të cilat gjenerojnë flukse hyrëse valutore të qëndrueshme, si dhe kanalizimi i tyre në sektorë ekonomikë prodhues e në investime.*

*Analistët pranë Bankës Botërore, Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Organizatës Botërore për Migracionin kanë arritur në të njëjtat rezultate: dërgesat e emigrantëve aktualisht shkojnë për financimin e konsumit të përditshëm ndaj, ato përfaqësojnë një burim kapitali të kufizuar për investime dhe për financimin e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të vendeve të origjinës. Ndaj, në ditët e sotme, kur vendet kanë një histori migracioni të gjatë, vëmendja, më shumë se në flukset e remitancave, duhet të përqendrohet në zhvillimin e instrumenteve financiare të përshtatshme për thithjen*

*e kursimeve të emigrantëve. Kursimet e emigrantëve vlerësohen të jenë 4.2 herë më të larta se niveli i remitancave në rastin e Shqipërisë[33].*

*Tabelë 8. Të dhëna mbi familjet emigrante, kursimet dhe remitancat e tyre.*

| | Shqipëri | Kosovë | Bosnje-Hercegovinë |
|---|---|---|---|
| Të ardhura mujore (familjare) – (Euro) | 2300 | 3900 | 2288 |
| Shpenzime mujore - (Euro) | 1477 | 2324 | 1938 |
| Vlera mujore e kursimit (Euro) | 835 | 1578 | 350 |
| Norma mujore e kursimit (në %) | 38 | 41 | 15 |
| Vlera vjetore e remitancave për familje - (Euro) | 1664 | 3212 | 1752 |
| Kursimet vjetore - Euro | 10260 | 15724 | 2448 |
| Kursimet në 2008 - (milionë Euro) | 3473 | 2340 | 1175 |
| Remitancat në 2008 (milionë Euro) | 833 | 479 | 841 |
| Kursime/Remitanca | 4.2 | 4.8 | 1.4 |
| Nr. familjeve emigrante | 404.000 | 149.000 | 480.000 |

*Burimi: IOM, IASCI dhe Banka e Shqipërisë.*

*Nga ana tjetër, emigrantët përfaqësojnë edhe një kanal të rëndësishëm për transferimin e njohurive të reja, mënyrave të reja të prodhimit, etikës së punës, teknologjive të reja si dhe një kulturë të re të të bërit biznes. Gërshetimi i këtyre dy përbërësve, kursimet dhe njohuritë e reja, do të përfaqësonin një burim potencial shumë të rëndësishëm për zhvillimin e vendeve të origjinës në përgjithësi.*

## *ECURIA E ZËRAVE TË TJERË TË LLOGARISË KORENTE*

Vlera e transaksioneve në kategorinë e shërbimeve gjatë periudhës korrik–shtator të vitit 2009 arriti nivelin 1.25 miliardë euro ose 31.4 për qind më të larta në terma vjetorë. Bilanci i llogarisë së shërbimeve për tremujorin e tretë të vitit 2009 regjistroi një suficit prej 88.1 milionë eurosh duke qëndruar thuajse në të njëjtin nivel në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar (87.2 milionë euro). Ndërkohë, rritjet vjetore të eksporteve dhe të importeve në shërbime kanë qenë përkatësisht 28.8 dhe 34.5 për qind. Shërbimet e udhëtimit kanë zënë peshën kryesore si në eksportin ashtu edhe në importin e shërbimeve, duke kontribuar me përkatësisht 81.5 dhe 78.2 për qind në vlerën e përgjithshme të shërbimeve. Bilanci neto i shërbimeve të udhëtimit gjatë këtij tremujori regjistroi një suficit prej rreth 91 milionë eurosh krahasuar me suficitin prej rreth 94 milionë eurosh që shënonte një vit më parë. Hyrjet valutore nga shërbimet e udhëtimit gjatë kësaj periudhe ishin 543.4 milionë euro duke shënuar një rritje vjetore prej rreth 40 për qind, lidhur kjo dhe me rritjen e numrit të vizitorëve gjatë sezonit turistik veror. Prurjet në valutë nga shërbimet e udhëtimit kanë qenë rreth 2.7 herë më të larta se të ardhurat nga eksporti i mallrave. Konsumi i rezidentëve jashtë Shqipërisë është vlerësuar në rreth 453 milionë euro, vëllim ky 54.2 për qind më i lartë krahasuar me periudhën korrik-shtator të vitit 2008.

Shërbimet e transportit regjistrojnë një suficit prej 0.2 milionë eurosh pas një periudhe disa tremujore gjatë të cilës kanë regjistruar vlera negative. Kategoria "shërbime të tjera" u mbyll me një suficit prej rreth 12 milionë eurosh, duke u ngushtuar në harkun kohor të një viti[34]. Sinjale pozitive brenda kësaj kategorie janë vërejtur në shërbimet e ndërtimit dhe ato qeveritare,

ndërsa zhvillime jo pozitive shënojnë shërbimet në sektorin e komunikimit dhe ato financiare[35].

Rezultati neto i transaksioneve në kategorinë e të ardhurave ishte negativ gjatë këtij tremujori dhe vlerësohet në rreth 34 milionë euro kundrejt vlerës pozitive prej 55 milionë euro që shënonte gjatë të njëjtës periudhë një vit më parë. Të hyrat në valutë të kësaj kategorie ranë me rreth 49 për qind, ndërsa daljet pothuajse janë dyfishuar në krahasim me tremujorin e tretë të vitit të kaluar. Dy burimet kryesore të të ardhurave kanë qenë puna e punëtorëve sezonalë dhe kufitarë dhe të ardhurat nga investimet në formën e interesave të depozitave të sistemit bankar jashtë. Të ardhurat hyrëse nga puna kanë rënë me 35 për qind. Ndërkohë, janë dyfishuar daljet në të ardhurat nga investimet direkte në formën e pagesave të dividendëve dhe fitimit të riinvestuar. Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2009, Shqipëria ka paguar 5 milionë euro për të shlyer interesat mbi borxhin e saj të jashtëm.

Bilanci i transfertave korente neto gjatë periudhës korrik – shtator 2009 regjistroi një suficit prej rreth 206 milionë eurosh me një rënie prej 24 milionë eurosh kundrejt një viti më parë. Peshën kryesore (rreth 90 për qind) të të ardhurave në këtë kategori vazhdojnë ta zënë prurjet e emigrantëve. Gjatë kësaj periudhe, këto transferta kanë arritur në 187.5 milionë euro, duke mbuluar rreth 32 për qind të deficitit të tregtisë së mallrave. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2008, këto transferta vlerësohen 6.6 për qind më të ulëta. Raporti i tyre ndaj PBB-së vlerësohet në 9.4 për qind kundrejt 10.2 për qind që vlerësoheshin një vit më parë.

### *LLOGARIA KAPITALE DHE FINANCIARE*

Shqipëria regjistroi një prurje neto prej 187.1 milionë eurosh në llogarinë kapitale dhe financiare gjatë tremujorit të tretë të vitit 2009. Nga këto, rreth 32 milionë euro kanë hyrë në vend në formën e granteve për investime kapitale, ndërsa 155 milionë euro në formën e flukseve financiare neto. Pozicioni neto i lëvizjeve të kapitalit për këtë periudhë ka mundësuar financimin e deficitit korent në masën 57 për qind. Vlen për t'u përmendur rritja e detyrimeve financiare të Shqipërisë ndaj botës me 285 milionë euro gjatë periudhës së mësipërme dhe rritja e konsiderueshme e mjeteve të rezidentëve jashtë (rreth 19 për qind). Lëvizjet më të mëdha në këtë llogari janë regjistruar në zërat e huamarrjes, të investimeve të huaja direkte dhe të mjeteve të rezidentëve jashtë. Lëvrimet e kredive afatgjata dhe të atyre të buta nga jashtë vlerësohen në 162 milionë euro. Huamarrja për sektorin publik ishte rreth 140 milionë euro, ndërsa huamarrja private shënoi 22 milionë euro. Rritja e këtyre detyrimeve ka çuar në rritjen e detyrimeve për pagesat e ardhshme të borxhit të jashtëm. Shërbimi i borxhit të jashtëm për tremujorin e tretë të vitit 2009 ka pakësuar detyrimet e rezidentëve me 20 milionë euro. Ndërkohë, fluksi hyrës i investimeve të huaja direkte në ekonominë shqiptare për tremujorin e tretë të vitit 2009 vlerësohet në rreth 143 milionë euro kundrejt vlerës prej rreth 178 milionë euro që shënonin një vit më parë. Vlen për t'u theksuar se për herë të parë pas disa tremujorësh shënohet rritje e pretendimeve të rezidentëve ndaj jorezidentëve. Mjetet valutore të investuara jashtë ekonomisë shqiptare

kanë regjistruar një rritje prej 130 milionë eurosh, kryesisht në formën e investimeve të portofolit (15.8 milionë euro) dhe të investimeve të rezervave të sistemit bankar në tregun ndërkombëtar në formën e depozitave (104.3 milionë euro). Rritje vihet re dhe në huadhënien afatshkurtër (10.5 milionë euro).

Mjetet e rezervës u rritën me 44 milionë euro. Stoku i rezervës valutore në fund të tremujorit të tretë të vitit 2009 shënoi nivelin 1,736 milionë euro, i mjaftueshëm për mbulimin e 4.2 muaj importesh të mallrave dhe të shërbimeve.

Grafik 26. Shuma rrëshqitëse e balancës primare për 12 muaj, nëntor 1999 – nëntor 2009.




Burimi: Ministria e Financave, llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

### IV.1.3 Zhvillimet në treguesit fiskalë dhe politika fiskale

Politika fiskale ka shfaqur karakter ekspansionist gjatë vitit 2009, sidomos në tremujorin e dytë të tij. Deficiti primar ka njohur ritme të shpejta zgjerimi gjatë këtij viti, duke pasqyruar rritjen e shpenzimeve korente dhe kapitale.

Deficiti primar ka reflektuar në pjesën më të madhe të tij rritjen e deficitit buxhetor. Në fund të muajit nëntor, deficiti buxhetor rezultoi rreth 64.5 miliardë lekë, duke tejkaluar me rreth 6 për qind nivelin e planifikuar për këtë periudhë. Burimet kryesore të financimit të deficitit kanë qenë të ardhurat e privatizimeve, kredia sindikaliste si edhe huamarrja nëpërmjet emetimit të instrumenteve të borxhit në tregun e letrave me vlerë të qeverisë.

*Tabelë 9. Realizimi i treguesve kryesorë fiskalë për 11-mujorin 2009, krahasim me vitet e mëparshme.*

| | Niveli faktik (në mld lekë) | Ndaj planit[36] (në %) | Ndryshim vjetor (në %) | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | 11-mujor 2009 | 11-mujor 2009 | 11-mujor 2007 | 11-mujor 2008 | 11-mujor 2009 |
| Të ardhura | 268.2 | 92.3 | 11.8 | 15.9 | 2.2 |
| - Tatimet dhe doganat | 192.0 | 95.8 | 13.9 | 16.7 | 2.7 |
| TVSH | 99.9 | 96.0 | 19.3 | 21.9 | 2.3 |
| Tatim fitimi | 15.8 | 100.1 | -7.9 | -11.4 | -5.7 |
| Akcizat | 30.5 | 91.3 | 24.8 | 14.8 | 1.8 |
| - Pushteti lokal | 11.1 | 72.8 | -12.8 | 19.8 | 7.4 |
| - Buxhetet e pavarura | 45.5 | 94.4 | 4.2 | 16.8 | 5.5 |
| - Të ardhura jotatimore | 17.1 | 78.1 | 53.4 | 5.9 | -16.5 |
| - Grantet | 2.5 | 51.8 | -68.8 | 24.6 | 68.8 |
| Shpenzime | 332.6 | 94.7 | 9.8 | 28.6 | 16.4 |
| - Shpenzime korente | 247.7 | 97.1 | 8.1 | 15.4 | 16.4 |
| Personeli | 55.9 | 102.7 | 4.2 | 14.0 | -3.6 |
| Interesat | 32.3 | 98.9 | -1.2 | 24.5 | 13.1 |
| Sigurimet shoqërore dhe pensionet | 86.8 | 99.8 | 17.0 | 9.8 | 27.4 |
| Shpenzime për pushtetin vendor | 29.3 | 90.4 | -2.1 | 34.1 | 31.1 |
| - Shpenzime kapitale | 84.9 | 90.5 | 3.4 | 110.7 | 22.8 |
| Balanca buxhetore | -64.5 | 106.1 | 2,031.8 | -664.9 | 175.2 |

*Burimi: Ministria e Financave.*

### TË ARDHURAT BUXHETORE

Të ardhurat buxhetore kanë shfaqur prirje ngadalësuese veçanërisht pas tremujorit të parë të vitit 2009. Kjo tendencë është pasqyruar pothuajse në të gjithë zërat kryesorë të të ardhurave të karakterit tatimor. Më konkretisht, rritja vjetore e të ardhurave për 11-mujorin rezulton rreth 2 për qind[37], kundrejt 14 për qind[38] të shënuar në fund të tremujorit të parë të vitit 2009. Kjo sjellje e të ardhurave është përcaktuar kryesisht nga të ardhurat nga TVSH-ja[39], ritmi vjetor i rritjes së të cilave përgjatë vitit është luhatur në intervalin 2-5 për qind. I njëjti interval i ndërtuar për vitin 2008, ka pasur kufi të poshtëm e të sipërm përkatësisht vlerat 21 dhe 25 për qind.

Të ardhurat buxhetore gjatë gjysmës së parë të vitit, krahas tendencës ngadalësuese kanë shfaqur dhe diferenca me nivelin e programuar. Ecuria e tyre gjatë gjashtëmujorit të parë, ka bërë të domosdoshëm rishikimin e buxhetit për vitin 2009[40]. Sipas buxhetit të rishikuar për vitin 2009, të ardhurat u ulën me 8.7 miliardë lekë, ndërsa shpenzimet u rritën me 16.1 miliardë lekë, krahasuar me nivelet përkatëse të planifikuara në fillim të vitit. Rrjedhimisht, deficiti buxhetor u rrit me 24.8 miliardë lekë nga niveli fillestar i planifikuar[41].

Grafik 27. Ritmi vjetor i rritjes të të ardhurave buxhetore, të ardhurave nga TVSH-ja dhe të ardhurave nga akcizat (në %), janar '99-nëntor '09.




Burimi: Ministria e Financave, llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

Në fund të 11-mujorit, të ardhurat totale janë realizuar me rreth 268.2 miliardë lekë, duke përmbushur rreth 92.3 për qind të planit[42] për të njëjtën periudhë. Diferenca me planin kanë shfaqur pothuajse të gjithë zërat e të ardhurave, me përjashtim të të ardhurave nga tatim fitimi, taksat doganore e taksat nacionale.

### SHPENZIMET BUXHETORE

Pothuajse gjatë gjithë periudhës 11-mujore politika fiskale ka shfaqur nota të ekspansionit fiskal, e udhëhequr në të njëjtën kohë nga shpenzimet afatshkurtra dhe afatgjata. Në terma vjetorë, shpenzimet buxhetore të realizuara gjatë 11-mujorit kanë shënuar një rritje me rreth 16 për qind, ku kontributi i shpenzimeve kapitale është me rreth 4 pikë përqindjeje. Kontributi i shpenzimeve kapitale në totalin e rritjes së shpenzimeve është bërë më evident në dy vitet e fundit, kryesisht si pasojë e shpenzimeve për ndërtimin e rrugës Durrës-Kukës[43].

Deri në fund të muajit nëntor janë realizuar gjithsej 332.6 miliardë lekë shpenzime, të cilat përfaqësojnë rreth 95 për qind të planit të hartuar për këtë periudhë kohore. Rreth 74 për qind të totalit të shpenzimeve e zënë shpenzimet afatshkurtra. Pas tremujorit të parë të vitit, pothuajse të gjithë komponentët e këtij zëri kanë shfaqur rritje të konsiderueshme në terma vjetorë, ku spikasin shpenzimet për sigurime shoqërore, shpenzimet për pushtetin vendor si edhe shpenzimet operative e të mirëmbajtjes[44].

Grafik 28. Ndryshimi vjetor (në %) i shpenzimeve dhe kontributi i shpenzimeve korente e kapitale, për periudhën janar 1999-nëntor 2009.




Burimi: Ministria e Financave, llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

Grafik 29. Të ardhurat, shpenzimet dhe balanca buxhetore (në miliardë lekë), për periudhën 11-mujore 1998-2009.




Burimi: Ministria e Financave.

Grafik 30. Deficiti buxhetor dhe financimi i tij sipas burimeve kryesore, për periudhën janar-nëntor 1999:2009, në miliardë lekë.




Burimi: Ministria e Financave.

## DEFICITI BUXHETOR DHE FINANCIMI I TIJ

Si pasojë e një politike fiskale më aktive në kahun e shpenzimeve, deficiti buxhetor ka ndjekur një trajektore rritëse duke filluar nga muaji shkurt i këtij viti. Ecuria e të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore, si nga ana e ritmit të rritjes ashtu edhe nga ana e realizimit të planit kanë favorizuar zgjerimin e deficitit buxhetor, i cili në fund të muajit nëntor vlerësohet rreth 6.2 për qind e PBB-së[45].

Deficiti buxhetor në fund të nëntorit 2009, është rreth 2 herë më i lartë se niveli i shënuar në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Në të njëjtën kohë, vlera nominale prej 65 miliardë lekësh e shënuar për periudhën 11-mujore, përfaqëson nivelin më të lartë të shënuar gjatë të njëjtës periudhë për 10 vjeçarin e fundit. Deficiti buxhetor gjatë dy viteve të fundit ka njohur ritme mjaft të larta rritjeje, duke devijuar disi nga trajektorja e konsolidimit fiskal të ndjekur gjatë viteve 2005-2007.

Një masë më e lartë e deficitit buxhetor është shoqëruar me nevoja më të larta për huamarrje (të brendshme dhe të huaj), krahasuar me vitet e mëparshme. Si rrjedhojë, krahas instrumenteve të përdorura gjerësisht në financimin e deficitit buxhetor gjatë viteve të mëparshme, në vitin 2009 ka gjetur përdorim dhe kredia sindikaliste[46]. Ky instrument i ri (në vlerën 24.6 miliardë lekë) ka financuar rreth 38 për qind të deficitit buxhetor 11-mujor. Rreth 75 për qind e kredisë sindikaliste është mundësuar nga bankat jorezidente dhe pjesa e mbetur përfaqëson kreditimin ndaj qeverisë të bankave dhe institucioneve rezidente në Shqipëri.

Rol të konsiderueshëm në financimin e deficitit për periudhën 11-mujore (me rreth 43 për qind) kanë luajtur dhe të ardhurat nga privatizimet e ndërmarrjeve me kapital shtetëror[47]. Deri në fund të muajit shtator, politika e huamarrjes së qeverisë ka qenë më shumë e orientuar drejt instrumenteve afatgjata të borxhit, ku obligacionet me maturim 5-vjeçar zinin një pjesë të konsiderueshme të totalit të borxhit të emetuar gjatë vitit 2009. Pas tremujorit të tretë të vitit, fokusi i Ministrisë së Financave u zhvendos drejt instrumenteve më afatshkurtra të borxhit, e kryesisht drejt bonove të thesarit 12-mujore. Ndryshimi në kahun e huamarrjes bazohej kryesisht në preferencat e aktorëve kryesorë në tregun

e letrave me vlerë të qeverisë, të cilët kanë shfaqur pririje drejt shkurtimit të horizontit të huadhënies, krahasuar me vitet paraardhëse[48]. Rrjedhimisht, deri në fundin e këtij viti përqindja e borxhit afatgjatë në totalin e borxhit pritet të ketë një reduktim të moderuar krahasuar me vitin 2008. Totali i borxhit publik deri në fund të tremujorit të tretë të vitit 2009, vlerësohet rreth 58.3 për qind e PBB-së, kundrejt 56 për qind të PBB-së në fund të vitit 2008.

*Tabelë 10. Deficiti buxhetor dhe mënyra e financimit të tij, gjatë 11-mujorit 2006-2009, në miliardë lekë.*

| | 11-mujori 2006 | 11-mujori 2007 | 11-mujori 2008 | 11-mujori 2009 |
|---|---|---|---|---|
| Të ardhura | 202.5 | 226.4 | 262.4 | 268.2 |
| Shpenzime | 202.3 | 222.3 | 285.9 | 332.6 |
| Balanca buxhetore | 0.2 | 4.1 | -23.4 | -64.5 |
| Financimi | -0.2 | -4.1 | 23.4 | 64.4 |
| Financim i brendshëm | -5.8 | -6.8 | -9.7 | 37.5 |
| Huamarrje e brendshme | 4.6 | 11.8 | 2.7 | 14.3 |
| Bono thesari | -29.7 | -20.9 | -13.2 | 8.9 |
| Obligacione | 34.3 | 38.4 | 15.9 | 8.4 |
| Eurobono | 0.0 | -5.8 | 0.0 | 0.0 |
| Kredi direkte | 0.0 | 0.0 | 0.0 | -3.0 |
| Të ardhurat e privatizimeve | 2.1 | 13.2 | 1.0 | 27.6 |
| Të tjera | -12.5 | -31.8 | -13.3 | -10.6 |
| Kredi sindikaliste | 0.0 | 0.0 | 0.0 | 24.6 |
| Financim i huaj | 5.6 | 2.6 | 33.1 | 26.9 |
| Projektet me burime të huaja | 5.6 | 2.6 | 33.1 | 8.5 |

*Burimi: Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë.*

*Hapësirë informuese 4. Kriza botërore dhe kostot fiskale të saj për vendet e Evropës Lindore.*

*Kriza ekonomike dhe financiare botërore i shtriu efektet e saj edhe mbi vendet e Evropës Lindore. Megjithëse në përmasa të ndryshme, ndikimi i krizës në këto vende u shfaq në reduktim të aktivitetit ekonomik, në rritje të papunësisë, në probleme të sektorit financiar si edhe në përkeqësim të pozicioneve fiskale dhe të bilanceve të pagesave.*

*Përballimi i krizës kërkoi ndërmarrjen e një sërë masash të fokusuara kryesisht në rimëkëmbjen e sistemit financiar dhe në nxitjen e kërkesës agregate. Reagimi i politikës fiskale ndaj krizës konsistoi në stimulimin fiskal të ekonomisë për të nxitur kërkesën agregate dhe në dhënien e garancive eksplicite për të garantuar stabilitetin financiar. Lënia e lirë e stabilizatorëve automatikë dhe programet e ndryshme diskrecionare të stimulimit fiskal u shoqëruan me rritjen e konsiderueshme të deficitit buxhetor si edhe të borxhit publik.[49] Politikat fiskale kundërciklike rritën nevojat për huamarrje, duke bërë që shumë vende të kërkojnë asistencën e institucioneve ndërkombëtare, si FMN dhe BE, për të ulur koston e tyre.*

*Grafiku 31 ilustron faktin se vendet të cilat u ndikuan më shumë nga kriza ekonomike, reaguan më shumë nëpërmjet dhënies së stimulit fiskal. Përvoja e fituar gjatë kësaj periudhe evidenton dy mësime të rëndësishme.*

Grafik 31. Shkalla e prekjes nga kriza botërore dhe ndryshimi i pozicionit fiskal[50].




Burimi: Komisioni Evropian, Directorate General ECFIN Economic and Financial Affairs.

Grafik 32. Deficitet e llogarisë korente (2008) dhe ndikimi nga kriza.




Burimi: Komisioni Evropian, DG ECFin dhe World Economic Outlook, FMN, tetor 2009.

Grafik 33. Ndryshimi në pozicionin fiskal, 2009[51].




Burimi: Komisioni Evropian Directorate General ECFIN Economic and Financial Affairs.

*Së pari, vendet të cilat gëzonin një stabilitet të mirë makroekonomik dhe financiar para krizës e përballuan me pasoja më të ulëta atë. Grafiku 32 ilustron faktin se vendet të cilat kishin çekuilibra makroekonomikë, të përafruara nga deficite të larta të llogarisë korente, patën një ndikim edhe më të madh nga kriza botërore.*

*Së dyti, vendet të cilat kishin një pozicion më të mirë fiskal, të shprehur në nivele të ulëta të borxhit publik dhe të deficitit buxhetor, patën mundësi për të dhënë një reagim më të fortë. Masat antikrizë kanë patur një lidhje të drejtë me hapësirat fiskale të disponueshme nga secili vend; ato vende të cilat kanë patur nivele më të kontrolluara të borxhit publik, kanë patur mundësi për të implementuar programe më të gjera të stimulit fiskal, ashtu si edhe ilustrohet në grafikun 33.*

*Në dritën e këtyre mësimeve, përpjekjet për konsolidim fiskal dhe forcimin e stabilitetit makroekonomik kanë marrë një theks më të madh në këto vende. Përmbushja e këtyre objektivave ul primet e rrezikut dhe nxit tërheqjen e investimeve të huaja, zbut rrezikun e goditjeve makroekonomike, dhe rrit mundësinë e reagimit ndaj ngjarjeve të paparashikuara. Krahasuar me vendet e Ballkanit Perëndimor, Shqipëria zotëron një nivel krahasimisht të lartë të borxhit publik. Në raport me PBB-në, ky tregues ishte rreth vlerës 56 për qind në vitin 2008, duke u rritur rreth vlerës 58.3 për qind në tremujorin e tretë të vitit 2009. Në këtë kontekst, nismat e fundit për uljen e deficitit buxhetor dhe kontrollin e nivelit të borxhit publik në Shqipëri i shërbejnë rritjes së qëndrueshme dhe afatgjatë të vendit.*

## IV.1.4 Zhvillimet monetare

Zhvillimet monetare u karakterizuan nga një ngadalësim i mëtejshëm i ofertës monetare deri në muajin shtator 2009. Ndërkohë në muajin tetor, vihet re një rritje e ndjeshme e ritmeve të rritjes së M3, kryesisht si pasojë e shuarjes së efektit të tërheqjes së depozitave. Gjithsesi, ngadalësimi i ekspansionit monetar shpreh më së shumti ndërprerjen e rritjes së shpejtë të portofolit të kredisë. Megjithë përmirësimin e likuiditetit të sistemit bankar, kreditimi i ekonomisë është kufizuar nga përkeqësimi i cilësisë së portofolit, nga pasiguritë për të ardhmen e aktivitetit ekonomik në vend dhe nga ulja e kërkesës. Krijimi i parasë në ekonomi është realizuar kryesisht nëpërmjet përbërësit në lekë të stokut monetar. Ndërkohë, situata e përmirësuar e depozitave dhe mungesa e kreditimit në valutë ka çuar në përmirësimin e komponentit valutor të kërkesës për para, duke rritur dhe kontributin e saj pozitiv në zgjerimin monetar në ekonomi.

## ECURIA E AGREGATËVE MONETARË

Ecuria e treguesve monetarë, pastruar nga efektet e kursit të këmbimit, ka rikonfirmuar tendencën ngadalësuese të aktivitetit kreditues. Agregati i gjerë i parasë M3 shënoi një rritje prej rreth 2 për qind në terma mesatarë vjetorë në pjesën e dytë të vitit, kundrejt 4 për qind në gjysmën e parë. Shuarja e efektit statistikor të rrjedhjes së depozitave nga sistemi bankar, është pasqyruar në ritmet më të larta të ofertës monetare prej 3.7 për qind mesatarisht në periudhën tetor-nëntor, kundrejt 1 për qind në tremujorin e tretë të vitit.

Grafik 34. Kontributi i aktivitetit bankar në ecurinë vjetore të M3 (në miliardë lekë).




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ndërkohë treguesit e parasë në lekë, M2 dhe paraja rezervë, kanë vijuar të shfaqin shenja ngadalësimi në terma vjetorë. Norma mesatare vjetore e rritjes së agregatit M2 arriti në rreth 8 për qind në gjysmën e dytë të vitit, kundrejt normës 10 për qind për gjysmën e parë të vitit. Baza monetare vijoi gjithashtu tendencën ngadalësuese, duke pësuar një rritje prej vetëm 11 për qind në muajin nëntor krahasuar me ritmin mesatar vjetor prej 25 për qind në pjesën e parë të vitit. Ecuria e këtyre treguesve ka reflektuar kryesisht reduktimin e

Grafik 35. Ecuria e agregatëve monetarë në lekë dhe shumëzuesi i parasë.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

parasë jashtë bankave gjatë kësaj periudhe si dhe ngadalësimin e kreditimit në lekë. Pjesëmarrja në rritje e individëve në financimin e deficitit buxhetor ka sjellë përdorimin e një pjese të parasë jashtë bankave në plotësimin e kërkesës së agjentit fiskal për financim. Kërkesa e lartë për instrumentet e bonove të thesarit nga individët, e cila statistikisht nuk përfshihet në llogaritjen e agregatit në lekë M2, ka ndikuar në dobësimin e ritmeve të rritjes së M2 për pjesën e dytë.

Ritmet e ngadalësuara të kreditimit në valutë kanë krijuar hapësira për akumulimin e rezervave valutore të sistemit bankar, më e theksuar kjo në tremujorin e fundit të vitit. Mjetet valutore neto të bankave tregtare në muajt tetor-nëntor rezultojnë në 3.5 për qind ndaj parasë së gjerë, krahasuar me rreth 0.1 për qind që përbënte ky raport në pjesën e parë të vitit. Ndërkohë, në përgjigje të nevojës së sistemit bankar për likuiditet në lekë, Banka e Shqipërisë me anë të marrëveshjeve repo të anasjellta ka rritur sasinë e likuiditetit të injektuar në treg. Në pjesën e dytë të vitit, likuiditeti i injektuar nga Banka e Shqipërisë përbën rreth 6 për qind të agregatit M2, duke mbështetur kështu ndërmjetësimin në lekë nga sistemi bankar.

### *ECURIA E DEPOZITAVE*

Dinamika e zhvillimeve të fundit në ofertën monetare konfirmon një përmirësim të situatës së depozitave gjatë gjysmës së dytë të vitit 2009, e përqendruar kryesisht në fundin e periudhës. Efekti statistikor i tërheqjes së depozitave në fund të vitit 2008 ka ndikuar në ritmin negativ vjetor të rritjes së depozitave deri në tremujorin e tretë. Ndërsa shuarja e këtij efekti në muajin tetor është pasqyruar në zgjerimin e totalit të depozitave në terma vjetorë, ku në muajin nëntor shënoi një rritje vjetore me 5 për qind. Ndryshimi i sjelljes së depozituesve në kuadrin e masave të marra për parandalimin e përhapjes së efekteve të krizës globale, si edhe flukset valutore në formën e remitancave gjatë muajve të verës, mendohet të kenë ndikuar më së shumti në rikuperimin dhe rritjen e nivelit të depozitave në lekë dhe në valutë në gjysmën e dytë të këtij viti.

Grafik 36. Rritja vjetore e depozitave sipas monedhës dhe strukturës kohore[52]
(në miliardë lekë dhe në %).




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Zhvillimet në stokun e depozitave pastruar nga efektet e kursit të këmbimit shfaqin një përmirësim të vazhdueshëm të gjendjes së depozitave të sistemit, të cilat në muajin nëntor rezultuan 1.2 për qind më të larta në terma vjetorë, krahasuar me reduktimin e këtij stoku prej më shumë se 6 për qind në fund të gjysmës së parë të vitit. Kontributin më të lartë në zgjerimin e tij e kanë dhënë depozitat në lekë, të cilat kanë vijuar të rikthehen në sistem më shpejt se depozitat në valutë. Gjatë tremujorit të fundit, depozitat në lekë u rritën gradualisht, me 1 dhe 3.5 për qind në terma vjetorë përkatësisht në muajt tetor e nëntor. Pastruar nga efektet e kursit të këmbimit, stoku i depozitave në valutë në fund të periudhës rezulton rreth 1.6 për qind më i ulët se një vit më parë, duke shënuar megjithatë përmirësim kundrejt një rënieje më të madhe në pjesën e parë të vitit.

Në gjysmën e dytë të vitit është vënë re një tendencë graduale e zhvendosjes së depozitave nga depozita pa afat në depozita me afat, e reflektuar edhe në rritjen e peshës së depozitave me afat ndaj stokut total në 78 për qind në fundin e periudhës. Depozitat pa afat njohën një rënie mesatare vjetore me 5 për qind në periudhën tetor-nëntor, ndërsa depozitat me afat u rritën me 1.2 për qind, duke dhënë kështu sinjale pozitive të rikthimit të besimit në sistemin bankar.

Grafik 37. Rritja vjetore e depozitave sipas monedhës dhe strukturës kohore (pa efekt kursi).




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Zhvillimet e depozitave sipas agjentëve ekonomikë konfirmojnë një rritje më të lartë të depozitave të individëve, kryesisht në llogari me afat në lekë. Stoku i depozitave të individëve në valutë vijon të jetë më i ulët se një vit më parë, edhe si pasojë e rrjedhjes më të madhe nga sistemi bankar që pësoi kjo kategori. Zhvillimet mujore në depozitat e biznesit kanë rezultuar më të paqëndrueshme, duke pësuar luhatje në varësi të aktivitetit të tyre. Ndërsa në terma vjetorë, depozitat e biznesit kanë rezultuar me rënie gjatë gjysmës së dytë të vitit në sajë të reduktimit të depozitave pa afat, nga muaji shtator në vijim vërehet një zhvendosje e dukshme e depozitave pa afat të biznesit në depozita me afat. Gjatë kësaj periudhe, depozitat pa afat të biznesit u

reduktuan mesatarisht me rreth 14 për qind në terma vjetorë, ndërsa ato me afat pësuan rritje me rreth 12 për qind. Zhvillimet në ecurinë e depozitave të bizneseve sinjalizojnë pritshmëritë e tyre për një ngadalësim të mundshëm të aktivitetit ekonomik në vend, fakt që mbështetet edhe nga të dhënat e deritanishme të sektorit real.

### *KREDIA PËR SEKTORIN PRIVAT*

Zhvillimet në kreditimin e sektorit privat gjatë gjysmës së dytë të vitit 2009, tregojnë për një ngadalësim të mëtejshëm të rritjes së kredisë. Rritja vjetore e portofolit të kredisë për sektorin privat u ngadalësua në 10 për qind në muajin nëntor. Pastruar nga efekti i kursit të këmbimit[53], kjo rritje ishte vetëm 3 për qind, 4 herë më e vogël se ajo e qershorit të këtij viti. Ndryshe nga gjashtë muajt e parë, në pjesën e dytë të vitit 2009[54], rënia e kërkesës për kredi po reflektohet në kreditimin me ritme gjithnjë e më të ulëta të sektorit privat. Ngadalësimi i aktivitetit ekonomik dhe pasiguria për të ardhmen përballë kritereve relativisht të shtrënguara në kredidhënie, kanë diktuar vendimet e agjentëve ekonomikë për të shtyrë planet e investimeve dhe për të financuar më pak aktivitetin e tyre nëpërmjet huamarrjes.

Grafik 38. Ecuria e portofolit të kredisë sipas monedhave.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ngadalësimi i theksuar i kredisë, sikurse edhe në gjashtëmujorin e parë të vitit, në një masë të madhe është diktuar nga ngadalësimi e më pas tkurrja e kredisë në valutë. Pas një ngadalësimi me ritme të shpejta gjatë gjithë vitit 2009, në periudhën shtator – tetor portofoli i kredisë në valutë filloi të zvogëlohet, duke u tkurrur mesatarisht me 3.5 për qind në terma vjetorë. Kreditimi gjithnjë e më i ulët në monedhë të huaj ka reflektuar një sjellje më të kujdesshme të bankave, të cilat faktorizojnë më shumë rrezikun indirekt të kursit të këmbimit në moskthimin e kredisë. Në të njëjtën kohë, edhe klientët duket të jenë më të ndërgjegjshëm për sa i përket rrezikut që marrin përsipër duke marrë kredi në një monedhë të ndryshme nga ajo në të cilën gjenerojnë të ardhura.

Kredia në lekë vazhdon të ruajë ritme relativisht të larta të rritjes. Megjithatë, në tre muajt e fundit vihen re shenja të ngadalësimit të saj. Portofoli i kredisë në lekë është zgjeruar mesatarisht me 28 për qind gjatë periudhës shtator - nëntor, kundrejt ritmit mesatar të rritjes vjetore prej 34 për qind të ruajtur përgjatë muajve të mëparshëm të vitit.

Grafik 39. Kontributet në rritjen vjetore të kredisë për sektorin privat (majtas) dhe rritjet vjetore të kredisë së re (djathtas), sipas kredimarrësve.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Rritja vjetore e kredisë për biznese gjatë gjysmës së dytë të vitit 2009 ka vijuar rënien e njëtrajtshme, duke arritur në 5 për qind në muajin nëntor. Kredia për likuiditet vazhdon të rritet me ritme më të larta se ajo për investime. Të dyja kanë ruajtur të njëjtin trend ngadalësimi dhe rritjet vjetore të tyre qëndrojnë përkatësisht në 10 dhe 2 për qind në nëntor. Kredia e re për qëllime likuiditeti ka ruajtur nivele të larta gjatë gjithë vitit 2009, të krahasueshme me ato të vitit 2008. Ndërkohë, ajo për qëllime investimi ka rënë në mënyrë të vazhdueshme, sidomos në tre muajt e fundit.

Grafik 40. Kontributet në rritjen vjetore të kredisë për biznese (majtas) dhe rritjet vjetore të kredisë për likuiditet dhe investime (djathtas).




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Sipas vrojtimeve të kredisë me specialistët e bankave, ngadalësimi më i lartë i kredisë për investime ka qenë rezultante e një kërkese në rënie nga agjentët ekonomikë, si dhe politikave më konservatore të vetë bankave në veçanti për këtë lloj kredie. Sektori më i rëndësishëm në kreditim mbetet tregtia, e cila edhe pse ka shfaqur ngadalësim të ritmeve të rritjes vazhdon të ruajë nivele relativisht të larta të zgjerimit të tepricës së kredisë me rreth 11 për qind. Tkurrja e aktivitetit kreditues është më e ndjeshme për sektorin e ndërtimit. Portofoli i kredisë për këtë sektor në pjesën e dytë të vitit është tkurrur me 1% krahasuar me vitin 2008, përkundrejt rritjes mesatare vjetore prej 24 për qind që dëshmoi në gjashtëmujorin e parë të vitit 2009. Përkeqësimi i ndjeshëm i cilësisë së portofolit të këtij sektori, perceptimi për mbiinvestime në këtë sektor si dhe pasiguria mbi ecurinë e tregut të pasurive të paluajtshme në të ardhmen, i kanë bërë bankat më konservatore në financimin e këtij sektori. Ndërkohë, sektori i industrisë ka shfaqur një ngadalësim të ritmeve të rritjes mesatarisht në 14%, krahasuar me mesataren prej 24% në pjesën e parë të vitit.

Grafik 41. Ecuria e portofolit të kredisë dhe e KNP sipas sektorëve të ekonomisë (në %).




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 42. Kontributet në rritjen vjetore të kredisë për individë (majtas) dhe rritjet vjetore të kredisë për banesa dhe konsum (djathtas).




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ndryshe nga kredia për biznese, ngadalësimi i kredisë për individë është shfaqur që prej dy vitesh tashmë. Pas një zgjerimi modest gjatë gjysmës së parë të vitit 2009, portofoli i kësaj kredie ka filluar të tkurret muajt e fundit, duke qëndruar në nëntor në nivele rreth 1 për qind më të ulëta se një vit më parë. Këto zhvillime në kredinë për individë reflektojnë si rënien e kërkesës konsumatore dhe ngadalësimin e tregut të banesave, ashtu edhe kushtet ende të shtrënguara të kreditimit të mbajtura nga bankat.

Kredia për konsum, ecuria e së cilës ka qenë e dobët përgjatë gjithë vitit 2009, është tkurrur në terma vjetorë, duke shënuar në dy muajt e fundit një ndryshim vjetor negativ prej 10 për qind. Individët kanë shfaqur një përqasje gjithnjë e më konservatore ndaj konsumit dhe në veçanti financimit të tij me kredi, gjë që tregohet edhe nga niveli në rritje i shlyerjeve në portofolin e kësaj kredie.

Kredia për blerje banesash, e cila përbën rreth 77 për qind të kredisë për individë, është ngadalësuar në mënyrë uniforme gjatë gjysmës së dytë të vitit. Në nëntor, portofoli i saj është rritur në terma vjetorë me vetëm 2 për qind, 8 pikë përqindje më pak se në muajin qershor. Vlera mesatare e kredive të reja të dhëna nga bankat për blerje banesash gjatë pesë muajve të fundit është rreth 30 për qind më e ulët se në gjashtë muajt e parë të vitit 2009.

*Hapësirë informuese 5. Përmbledhje e rezultateve të vrojtimit të aktivitetit kreditues.*

*Rezultatet e vrojtimit të aktivitetit kreditues mbështesin ecurinë e vërejtur të këtij treguesi dhe japin disa indikacione të vlefshme në lidhje me të ardhmen e tij.*

*Rezultatet e agreguara të vrojtimit sugjerojnë se standardet e aplikuara në kredidhënie janë shtrënguar më tej gjatë tremujorit të katërt. Pjesa më e madhe e bankave (7 nga 10 banka) nuk i kanë ndryshuar këto standarde gjatë kësaj periudhe, ndërkohë që bankat e tjera e kanë bërë këtë ndryshim kryesisht në kahun shtrëngues. Në terma sektorialë, standardet e zbatuara për kreditë dhënë bizneseve janë forcuar në një masë më të vogël sesa në tremujorin e tretë ndërsa standardet e zbatuara për kreditë dhënë individëve janë shtrënguar në një masë më të madhe. Standardet për ndërmarrjet e vogla e të mesme vijojnë të jenë më të shtrënguara se për korporatat e mëdha (balancat neto përkatëse janë -7.9 dhe -6.6 për qind). Sipas qëllimit të përdorimit të kredisë, shkalla e shtrëngimit të standardeve të kredisë ka qenë më e lartë për kredinë për investime sesa për kredinë për kapital qarkullues.*

*Të gjithë faktorët e konsideruar ndikuan në shtrëngimin e standardeve të kredidhënies në tremujorin e tretë të vitit 2009, si për bizneset ashtu edhe për individët, por në një masë më të ulët. Bankat kanë shtrënguar standardet e kreditimit kryesisht nëpërmjet kushteve që kanë të bëjnë me koston e kredimarrjes; bankat kanë rritur marzhin mesatar të kredive, marzhin për kreditë me rrezik më të lartë si dhe komisionet e kredisë.*

*Bazuar në opinionet e ekspertëve të bankave, kërkesa e bizneseve dhe e individëve për kredi është vlerësuar në rënie, por në një shkallë më të vogël se rënia e tremujorit të tretë të vitit të kaluar.*

*Pritjet për tremujorin e parë të vitit 2010 janë optimiste, si në terma të lehtësimit të kushteve të kreditimit të zbatuara për bizneset dhe për individët, si në kërkesën e pritur në rritje të tyre.*

## KREDIA PËR BIZNESET

*Në tremujorin e katërt të vitit 2009, shkalla e shtrëngimit të standardeve të kredisë për bizneset ka vijuar të ulet, duke ndjekur prirjen e filluar që në tremujorin e dytë të vitit 2009. Kështu, përqindja neto e bankave që raportojnë për një shkallë më të ulët të shtrëngimit të standardeve të kredisë u rrit krahasuar me tremujorin e mëparshëm: balanca neto e standardeve të kredisë për bizneset u rrit në -2.3 për qind nga -7.6 për qind në tremujorin e tretë të vitit 2009.*

Grafik 43. Ndryshimet në standardet e aplikuara në kreditë për bizneset dhe ndikimi i faktorëve të ndryshëm në to (balanca neto1), në përqindje).




Shënim 1. Balanca pozitive tregon për lehtësim të standardeve ose që faktori ka ndikuar në lehtësimin e standardeve të kredidhënies; ndërsa balanca negative tregon për shtrëngim të standardeve ose që faktori ka ndikuar në shtrëngimin e standardeve të kredidhënies.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 44. Ndryshimet në standardet e aplikuara në kreditë e individëve për banesa dhe për konsum, dhe ndikimi i faktorëve të ndryshëm (balanca neto*), në përqindje).




*) Shih shënimin 1.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

*Zbutja e shkallës së shtrëngimit të standardeve të kredisë gjatë tremujorit të katërt të vitit 2009 është reflektuar në standardet e aplikuara për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme: balanca neto u rrit në -7.9 për qind nga -12.2 për qind që ishte në tremujorin e tretë të të njëjtit vit. Balanca neto e standardeve të kredisë për korporatat në tremujorin e katërt rezultoi rreth 2 pikë përqindjeje më e lartë se ajo e tremujorit të tretë. Sipas qëllimit të përdorimit të kredisë, shtrëngimi i standardeve të kredisë ka qenë më i lartë për kredinë për kapital qarkullues sesa për kredinë për investime. Të gjithë faktorët e konsideruar në vrojtimin e tremujorit të katërt të vitit 2009 kanë ndikuar në uljen e shkallës së shtrëngimit të standardeve të kredisë për bizneset.*

*Në tremujorin e katërt të vitit 2009, bankat kanë forcuar standardet e kreditimit nëpërmjet kushteve që kanë të bëjnë me koston e kredimarrjes; bankat kanë rritur marzhin mesatar të kredive, marzhin për kreditë me rrezik më të lartë dhe kanë rritur komisionet. Në të kundërt, kushtet që nuk lidhen me kostot e kredisë kanë ndikuar në zbatimin e një politike më lehtësuese kreditimi; bankat kanë rritur mesatarisht madhësinë e kredisë dhe maturitetin maksimal të saj.*

*Kërkesa për kredi. Në vrojtimin e aktivitetit kreditues për tremujorin e katërt të vitit 2009, kërkesa neto për kredi vlerësohet në rënie, megjithëse në një shkallë më të ulët se në tremujorin e tretë të këtij viti. Faktorët kryesorë që kanë ndikuar në uljen e kërkesës janë ulja e nevojave për financimin e investimeve fikse dhe situata aktuale dhe e pritshme makroekonomike. Balancat neto të këtyre treguesve janë përkatësisht -30.4 dhe -27.7 për qind.*

*Pritjet. Për tremujorin e parë të vitit 2010, ekspertët e bankave presin një lehtësim të standardeve të kredisë. Balanca neto e pritjeve është +15.2 për qind. Lehtësimi i standardeve të kredisë akorduar bizneseve pritet si në kredinë dhënë ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme ashtu edhe në atë akorduar korporatave (balanca neto përkatësisht 20.0 për qind dhe 12.2 për qind).*

## KREDIA PËR INDIVIDË

*Standardet e aplikuara për kredinë dhënë individëve u shtrënguan disi më shumë në tremujorin e katërt të vitit, në krahasim me tremujorin paraardhës (balanca neto -4.0 për qind nga balanca 0.0 për qind tremujorin paraardhës). Shtrëngimi i standardeve është më i lartë për kredinë konsumatore sesa për kredinë për blerje banese; balanca neto e kredisë konsumatore shënoi -8.7 për qind krahasuar me*

*balancën neto të kredisë për blerje banese, -1.7 për qind. Bankat kanë shtrënguar standardet e kreditimit gjatë tremujorit të katërt të vitit 2009 nëpërmjet rritjes së marzhit për kreditë me rrezik më të lartë, balanca e të cilave është rritur në -7.8 për qind krahasuar me -3.8 për qind në tremujorin e kaluar.*

*Këto zhvillime në kredinë konsumatore janë ndikuar kryesisht nga gjendja financiare e individëve, e cila ka qenë faktori me ndikimin më të madh në forcimin e standardeve të kredisë gjatë tremujorit të katërt të vitit 2009.*

*Kërkesa për kredi. Kërkesa e individëve për kredi gjatë tremujorit të katërt 2009, sipas opinioneve të ekspertëve të bankave, vlerësohet në ulje por në një shkallë më të vogël se në tremujorin e kaluar (balanca neto e bankave që shprehen për rritje të kërkesës është -18.7 për qind, krahasuar me -21.2 për qind në tremujorin e kaluar). Kërkesa e konsumatorëve për kredi për blerje banese është vlerësuar më e ulët se kërkesa e tyre për kredi konsumatore. Në fakt, nevoja e individëve për financimin e konsumit është faktori që është renditur si më kryesori në nxitjen e kërkesës së individëve, balanca e të cilit u rrit në 25.0 për qind, krahasuar me 17.0 për qind në tremujorin e kaluar.*

*Pritjet. Për tremujorin e parë të vitit 2010, bankat parashikojnë një lehtësim të vogël të standardeve të kredidhënies për individët krahasuar me ato të aplikuara në tremujorin e katërt të vitit 2009. Ky lehtësim do të jetë më i madh për kreditë për blerje banese sesa për kreditë konsumatore (balancat neto janë përkatësisht +13.7 për qind dhe +4.4 për qind). Ndërkohë, ekspertët e bankave presin një rritje të kërkesës për kredi gjatë tremujorit të parë të vitit 2010 (balanca +14.8 për qind).*

## IV.2 TREGU I PUNËS DHE PAGAT

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2009, forca e aftë për punë u rrit me rreth 0.3 për qind, ndërsa numri i të punësuarve shënoi rritje rreth 0.2 për qind në terma vjetorë. Numri mesatar i personave të regjistruar si të papunë është rritur disi gjatë vitit, ku norma më e lartë vjetore është shënuar në tremujorin e tretë, rreth 1.4 përqind. Kështu, duke reflektuar këto zhvillime, norma e papunësisë në këtë periudhë arriti në 12.76 për qind, duke u luhatur pranë normës mesatare për vitin 2008.

Grafik 45. Kontributet e të punësuarve dhe të papunëve të regjistruar në rritjen vjetore të forcës së aftë për punë, në pp (grafiku majtas) dhe PBB me çmime bazë dhe numri i të punësuarve (ndryshime vjetore në për qind, grafiku djathtas).




Burimi: INSTAT dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

Punësimi sipas sektorit privat jobujqësor dhe atij shtetëror, nuk ka regjistruar ndryshime të ndjeshme gjatë tremujorit të tretë të vitit. Më konkretisht, të punësuarit në sektorin privat jobujqësor, rritën numrin e tyre në masën 0.7 për qind, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë duke shënuar normën më të ulët që prej vitit 2004.

*Tabelë 11. Ecuria e treguesve të tregut të punës.*

| Disa tregues të tregut të punës | T1 2009 | T2 2009 | T3 2009 | Ndryshimi (*) |
|---|---|---|---|---|
| Forca e aftë për punë | 1,114,161 | 1,114,166 | 1,113,580 | 0.33 |
| Të punësuar gjithsej | 972,851 | 972,831 | 971,518 | 0.17 |
| Të punësuar në sektorin shtetëror | 166,563 | 166,453 | 166,453 | -0.06 |
| Të punësuar në sektorin privat jobujqësor | 230,739 | 237,829 | 236,516 | 0.73 |
| Të punësuar në sektorin privat bujqësor | 568,549 | 568,549 | 568,549 | 0.00 |
| Të papunë të regjistruar | 141,310 | 141,335 | 142,062 | 1.42 |
| Norma e papunësisë (në %) | 12.68 | 12.70 | 12.76 | 0.14 |

*(*) Ndryshim vjetor i T3:2009 me T3:2008 në për qind, për normën e papunësisë është në pp.*
*Burimi: INSTAT. Konjuktura tregues kryesorë ekonomikë, korrik – shtator 2009.*

Ecuria e të punësuarve[56] në ndërmarrjet ekonomike jobujqësore shfaqi dinamika të ndryshme krahasuar në nivel sektorësh gjatë tremujorit të tretë të vitit 2009, ndërsa si tregues i agreguar nuk shënoi rritje. Më konkretisht, rritja më e lartë vjetore e numrit të të punësuarve u regjistrua nga aktiviteti i hotelerisë, rreth 18.3 për qind. Nga ana tjetër, aktivitetet e tjera të shërbimeve njohën një ngadalësim të ritmeve vjetore të rritjes së treguesit të punësimit në to, ku u regjistruan normat 9.6 për qind në degën e tregtisë me shumicë, 3.2 për qind në degën e postës, -8.7 për qind në degën e komunikacionit. Në sektorin prodhues, numri i të punësuarve në degën e industrisë vijoi të bjerë në nivel vjetor, me rreth 4.6 për qind. Në të kundërt, në degën e ndërtimit u regjistrua norma më e lartë e rritjes vjetore të këtij treguesi gjatë vitit 2009, rreth 9.5 për qind, ndonëse mbetet në nivele më të ulëta se një vit më parë.

Grafik 46. Ecuria e indeksit të punësimit sipas aktiviteteve ekonomike.




Burimi: INSTAT.

## PAGAT NË EKONOMI

Ecuria e pagave[57] në ekonomi, gjatë tremujorit të tretë të vitit 2009, vijoi të regjistrojë një prirje në rritje në sektorin shtetëror dhe përshpejtoi ritmin e rritjes në sektorin prodhues dhe të shërbimeve. Paga mesatare mujore në sektorin

shtetëror gjatë tre tremujorëve të parë të vitit 2009, u rrit me mesatarisht 12.7 për qind, një normë rreth 3.8 pikë për qind më e lartë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Kjo ecuri e pagës ka reflektuar vendimet e marra nga qeveria në lidhje me rritjen e pagës në sektorin shtetëror për disa kategori profesionesh. Në tremujorin e tretë, ky tregues regjistroi normën e rritjes vjetore më të lartë për vitin 2009; 16.4 për qind në terma nominalë ose rreth 13.9 për qind në terma realë.

Paga mesatare[58] nominale në sektorin prodhues dhe të shërbimeve, regjistroi normën më të lartë të rritjes vjetore në tremujorin e tretë të vitit 2009, rreth 8.4 për qind, 5.5 pikë përqindje më poshtë se rritja mesatare vjetore e vitit 2008. Në terma realë, paga mesatare e sektorit prodhues u rrit me 6.2 për qind krahasuar me tremujorin e tretë të një viti më parë.

Ecuria e pagës mesatare sipas aktiviteteve ekonomike, përshpejtoi ritmin e rritjes së saj në sektorin e shërbimeve, ndërkohë që u rrit me norma më të ulëta

Grafik 47. Ecuria e pagës mesatare mujore në sektorin shtetëror (grafiku majtas) dhe në sektorin prodhues dhe të shërbimeve (djathtas).




Burimi: INSTAT dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

Grafik 48. Ecuria e pagës mesatare në disa prej degëve të ekonomisë.




Burimi: INSTAT.

në sektorin prodhues, për tremujorin e tretë të vitit 2009. Kështu, paga mesatare vijoi të shënojë ritmin më të lartë të rritjes vjetore në degët e transportit dhe telekomunikacionit, rreth 17.2 për qind, për t'u ndjekur nga aktiviteti tregtar, ku ky tregues u rrit me 14.7 për qind. Në aktivitetet e sektorit prodhues, paga mesatare ngadalësoi rritjen, duke regjistruar një normë vjetore rreth 6.9 për qind në degën e industrisë dhe 2.9 për qind në degën e ndërtimit.

## IV.3 INFLACIONI I IMPORTUAR

Presionet inflacioniste nga ekonomia jashtë vendit mbi nivelin e përgjithshëm të çmimeve të konsumit kanë qenë të dobëta gjatë vitit 2009. Rënia ekonomike globale, krahas uljes së kostove të lëndëve të para krahasuar me nivelet e larta të vitit 2008, krijuan kushte për rënien e inflacionit në botë. Në linjë me trendin global, inflacioni mesatar vjetor në vend (2.2 për qind) ra me 1.2 pikë përqindje në krahasim me një vit më parë. Kjo rënie ishte më e ulët sesa ajo e vërejtur jashtë, ashtu siç dëshmohet dhe nga diferenca pozitive e inflacionit në vend me mesataren e inflacionit të Italisë dhe Greqisë. Kjo matje ka shfaqur një prirje të theksuar rritëse që nga fillimi i vitit. Në terma mesatarë, për këtë vit, ky tregues rezultoi 1.3 pikë përqindje, ndërkohë që një vit më parë ishte -0.3 pikë përqindje. Zgjerimi i këtij hendeku, veçanërisht në gjashtëmujorin e dytë të vitit (mesatarisht me 1.8 pikë përqindje), reflekton kryesisht përçimin në masë më të madhe të efektit inflacionist të nënçmimit të kursit të këmbimit.

Për të njëjtën periudhë, monedha vendase është nënçmuar mesatarisht me 7.6 për qind ndaj monedhës evropiane dhe 13.8 për qind ndaj dollarit amerikan, duke shkaktuar rritjen e inflacionit të importuar. Ecuria e këtij të fundit ka një rëndësi të madhe në formimin e normës së inflacionit në vend, veçanërisht të komponentit të mallrave të tregtueshme. Ky komponent zë rreth 60 për qind të shportës së mallrave të konsumit dhe përfaqëson atë pjesë të mallrave për konsum që vijnë kryesisht nga importet. Ndërsa për një periudhë

Grafik 49. Ndryshimet vjetore të inflacionit të importuar dhe të inflacionit të mallrave të tregtueshme (grafiku majtas) dhe ndryshimet vjetore të çmimeve të huaja dhe kursi i këmbimit (djathtas).




Burimi: Llogaritje të Bankës së Shqipërisë dhe Institutet statistikore Itali dhe Greqi.

disavjeçare, pozita e fortë e lekut ndaj monedhës evropiane ka shërbyer për zbutjen e presioneve inflacioniste që vinin nga jashtë, vitin e fundit ky faktor ka dhënë ndikim inflacionist. Inflacioni i importuar rezultoi mesatarisht 6.9 për qind në vitin 2009. Kjo shifër është rreth tre herë më e lartë se mesatarja e tij historike (2.4 për qind). Veprimi i këtij faktori është bërë më i ndjeshëm në tremujorin e katërt. Masa e përçimit të efektit të kursit të këmbimit, mbështetur dhe në studime empirike, arrin maksimumin (99%) pas tre tremujorëve.

Ndërkohë, ecuria e kursit të këmbimit të lekut ndaj dollarit amerikan nuk ka ushtruar presione rritëse mbi çmimin e naftës gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit. Leku është mbiçmuar me 5.2 për qind në krahasim me gjysmën e parë të vitit.

Ecuria e çmimit të naftës në tregun vendas vlerësohet të jetë udhëhequr tërësisht nga zhvillimet në konjukturat ndërkombëtare. Çmimi i naftës në tregun vendas, pasi shënoi rënie në dy tremujorët e parë shfaqi prirje rritëse deri në fund të vitit. Çmimi mesatar i një litri naftë në tregun me pakicë shënoi vlerën 114.8 lekë në gjashtëmujorin e dytë duke u rritur me rreth 10 për qind ndaj mesatares së regjistruar gjatë gjysmës së parë. Megjithatë ky nivel vazhdon të jetë më i ulët (rreth 20 për qind) se një vit më parë, kohë kur çmimi i këtij produkti njohu rritje të fortë. Zhvillimet në këtë treg gjejnë pasqyrim në indeksin e nëngrupit "Shërbime ndaj mjeteve personale të transportit" në shportën e mallrave të IÇK-së. Inflacioni vjetor i këtij indeksi shënoi 5.5 për qind në krahasim me gjashtëmujorin e parë. Ndërkohë që indeksi i nëngrupit "Shërbime transporti", i cili lidhet tërthorazi me tregun vendas të naftës, ka mbetur i pandryshuar në terma mesatarë.

Grafik 50. Ndryshimi vjetor i çmimit të naftës në vend dhe jashtë dhe i kursit të këmbimit lekë/usd.




Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë, EIA.

Grafik 51. Pritjet e konsumatorëve dhe ekspertëve të bankave për inflacionin vjetor pas një viti dhe norma vjetore aktuale e inflacionit (në %).




Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

## IV.4 PRITJET INFLACIONISTE NË EKONOMI

Pritjet e agjentëve të ndryshëm ekonomikë[59] për inflacionin pas një viti kanë mbetur në nivele të ulëta gjatë vitit 2009. Inflacioni i pritur i konsumatorëve ka vijuar rënien gjatë dy tremujorëve të parë të vitit, të nisur që në tremujorin e fundit të vitit 2008. Në tremujorin e tretë, këto pritje shfaqën një kthesë rritëse, por duke mbetur gjithsesi shumë afër kufirit të poshtëm të intervalit objektiv të Bankës së Shqipërisë.

Në të kundërt, pritjet e bizneseve për inflacionin pas një viti kanë vijuar rënien edhe në tremujorin e tretë të vitit 2009. Nga vrojtimi i organizuar me

ekspertë të bankave, vlera e inflacionit të pritur pas një viti në tremujorin e katërt të vitit 2009 është e pandryshuar që nga tremujori i kaluar, përkatësisht 2.7 për qind.

## V. TREGJET FINANCIARE, NORMAT E INTERESIT DHE KURSI I KËMBIMIT

Në muajin tetor, Banka e Shqipërisë uli normën bazë të interesit me 50 pikë përqindjeje duke sinjalizuar lehtësim të kushteve monetare. Ky orientim, së bashku me përmirësimin e gjendjes së likuiditetit dhe forcimin e sigurisë në treg, u ndoq nga një prirje rënëse e normave të interesit në tregun e parasë. Krahas reagimit të interesave në tregun ndërbankar, ulja e normës bazë është përcjellë dhe në tregun primar të letrave me vlerë të qeverisë, ku *yield*-et kishin ndjekur rritje të vazhdueshme që prej fillimit të vitit. Këto sinjale pozitive nuk janë reflektuar ende në aktivitetin kreditues të ekonomisë. Interesat për kreditë në lekë mbeten në nivele relativisht të larta dhe të luhatshme duke reflektuar rreziqet e larta të lidhura me pasigurinë për ecurinë e ekonomisë në vend.

### *TREGU NDËRBANKAR*

Gjashtëmujori i dytë i këtij viti është karakterizuar nga ecuri rënëse e normave të interesit në tregun ndërbankar si edhe nga një përmirësim i gjendjes së likuiditetit të bankave. Nga ana tjetër, vëllimi i shkëmbyer midis bankave ka regjistruar vlera më të ulëta gjatë kësaj periudhe dhe ka shfaqur prirje rritëse vetëm në tremujorin e fundit. Normat e interesit gjatë këtyre muajve kanë paraqitur prirje rënëse dhe luhatshmëri më të përmbajtur sesa gjashtëmujori paraardhës[60]. Gjatë kësaj periudhe, sistemi bankar ka vazhduar të karakterizohet nga mungesa e likuiditetit dhe Banka e Shqipërisë e ka injektuar atë nëpërmjet operacioneve të saj në treg të hapur me anë të marrëveshjeve të anasjella të riblerjes me afat njëjavor. Krahas këtij instrumenti, Banka e Shqipërisë ka përdorur dhe marrëveshjet e anasjella të riblerjes me maturitet më të gjatë ku veçanërisht në muajt e fundit janë përdorur ato me afat mujor dhe tremujor. Likuiditeti i ofruar ka vazhduar të jetë i lartë në një kohë që edhe niveli i depozitave pranë bankave të nivelit të dytë ka arritur vlerat e periudhës para muajit nëntor 2008 duke konfirmuar kështu sinjalet e përmirësimit të tyre. Banka e Shqipërisë ka vazhduar të përdorë formën e ankandit të anasjellë të riblerjes me çmim fiks dhe shumë të hapur. Vëllimi mesatar i ankandeve të anasjella të riblerjes me afat javor gjatë këtij gjashtëmujori ishte mesatarisht 21 miliardë lekë nga 14 miliardë lekë në periudhën e mëparshme duke plotësuar kërkesën e bankave pjesëmarrëse. Shpërndarja e likuiditetit në sistem ka qenë më e njëtrajtshme dhe është përcjellë në zbutjen e luhatshmërisë së normave të interesit.

Grafik 52. Ecuria e normave të interesit në tregun ndërbankar (majtas) dhe vëllimi i huamarrjes ditore (djathtas).




| | Norma e interesit ditor | Norma e interesit javor | Vëllimi ditor | Vëllimi javor |
|---|---|---|---|---|
| T 2 - 09 | 5.08 | 5.65 | 1,620 | 712 |
| T 3 - 09 | 5.30 | 5.67 | 1,319 | 228 |
| T 4 - 09 | 4.93 | 5.35 | 1,214 | 649 |
| Tetor -09 | 5.10 | 5.68 | 905 | 325 |
| Nëntor-09 | 4.90 | 5.19 | 1,281 | 817 |
| Dhjetor-09 | 4.78 | 5.17 | 1,472 | 650 |

Burimi. Banka e Shqipërisë.

Në fundin e muajit tetor, Banka e Shqipërisë duke vlerësuar ecurinë e inflacionit brenda korridorit të objektivit dhe me qëllim nxitjen e aktivitetit ekonomik dhe uljen e kostos së kreditimit vendosi uljen e normës bazë të lekut me 50 pikë bazë në 5.25 për qind. Vëllimi i tregtimit në tregun ndërbankar pas vlerave të ulëta që arriti në muajt shtator dhe tetor ka shënuar rritje gjatë muajve të fundit të vitit. Përmirësimi i kushteve të likuiditetit duket të jetë reflektuar në ulje të normave të interesit në tregun ndërbankar në një kohë që edhe financimi i bankave në tregun e parasë ka pasqyruar sjellje më eficiente. Normat e interesit në tregun ndërbankar kanë përcjellë uljen e normës bazë si dhe sheshimin e presioneve për likuiditet. Krahasuar me tremujorin paraardhës, huamarrja ditore është ulur lehtas në 1.21 miliardë lekë ndërsa vëllimi total i transaksioneve ndërbankare është rritur me 0.27 miliardë lekë duke arritur 1.76 miliardë lekë, ndonëse në terma gjashtëmujorë ai është më i ulët se pjesa e parë e këtij viti. Bankat vazhdojnë të preferojnë transaksionet ditore ndërkohë që dhe ato javore kanë paraqitur rritje gjatë këtyre muajve të fundit duke ndikuar pozitivisht në rritjen e vëllimit total të transaksioneve. Në terma mesatarë, interesi njëditor në këto muaj u ul në 4.93 për qind nga 5.30 për qind që ishte në tremujorin paraardhës, ndërsa ai 7-ditor është zvogëluar në 5.35 për qind, ose 32 pikë përqindjeje më pak. Në muajin dhjetor, vëllimi i shkëmbyer në tregun ndërbankar ka shënuar rritje dhe normat e interesit kanë vijuar në prirjet rënëse të ndikuara kryesisht nga faktorë të ofertës dhe të kërkesës.

*TREGU PRIMAR*

Ecuria e *yielde-ve* të tregut primar ka ndjekur prirje rritëse në pjesën më të madhe të këtij gjashtëmujori, për të kthyer kah më pas gjatë muajve nëntor dhe dhjetor si reagim ndaj lehtësimit të politikës monetare. Rritja e *yield*-eve është vërejtur për të gjitha maturitetet dhe ka qenë e pranishme që prej fillimit të vitit duke u theksuar në periudha të caktuara. Ulja e normës bazë në fundin e muajit tetor duket të jetë përcjellë tek *yield*-et në tregun primar në një kohë që pjesëmarrja e lartë e bankave në këtë treg, por edhe uljet e mëparshme të normës[61] dukej sikur nuk kishin ndikuar bindshëm në këtë kah.

Grafik 53. *Yield*-et e letrave me vlerë të qeverisë në tregun primar (majtas) dhe kurba e *yield*-eve (djathtas).




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në periudhën në fjalë, pjesëmarrja e bankave në ankandet e letrave me vlerë të qeverisë ka qenë e lartë por gjithsesi ajo nuk ka ndikuar në zbutjen e presioneve rritëse duke evidentuar kështu një rritje të vlerësimit të rrezikut nga ana e tyre. Një faktor tjetër që nuk ka ndihmuar në frenimin e prirjeve rritëse është edhe rritja e emetimeve gjatë kësaj periudhe. Rritja më e theksuar në *yield*-et e bonove të thesarit është vërejtur për maturitetin më të gjatë, 12-mujor, duke u përcjellë më pas dhe në *yield*-et e obligacioneve të parametruar me këtë tregues. Në fund të muajit tetor, interesi i bonove 12-mujore arriti vlerën 9.43 për qind duke zbritur më pas në vlerat 9.06 për qind ose në të njëjtin nivel me mesataren e 6-mujorit të parë. Ndonëse ecuria e *yield*-eve ka shfaqur prirje zbritëse në fundin e këtij 6-mujori, në terma mesatarë ato janë më të larta se periudha paraardhëse. Në nivel mesatar, *yield*-i i bonove njëvjeçare është 0.22 pikë përqindjeje me i lartë se gjashtëmujori i parë.

Të njëjtën ecuri kanë ndjekur dhe *yield*-et për maturitetet e tjera, 6- dhe 3-mujore, por në masë më të përmbajtur. *Yield*-i për afatin 6-mujor pasi arriti vlerën 7.73 për qind në muajin tetor vijoi në zbritje për të shënuar 7.52 për qind në fund të muajit dhjetor ose 0.15 pikë përqindje më pak se fundi i muajit qershor. *Yield*-i i bonove 3-mujore ka shfaqur luhatshmëri më të përmbajtur dhe ka qëndruar afërsisht në të njëjtin nivel.

Tregu primar i obligacioneve ka evidentuar të njëjtën prirje me atë të bonove të thesarit. *Yield*-et e obligacioneve janë rritur kryesisht gjatë tremujorit të tretë të ndikuar nga rritja e vlerësimit të rrezikut nga ana e bankave në një kohë që pjesëmarrja në ankande ka qenë në nivele të kënaqshme[62]. Në ankandet e zhvilluara në nëntor dhe më pas, *yield*-i i obligacioneve 2-vjeçare u ul duke ndjekur kështu uljen e përgjithshme që shfaqën edhe bonot e thesarit. Në fundin e këtij tremujori, *yield*-i i obligacioneve 2-vjeçare vlerësohej me 9.30 për qind ose 0.05 pikë përqindje më pak se mesatarja e gjashtëmujorit të parë. Ecuri të njëjtë kanë ndjekur edhe *yield*-et e obligacioneve 3- dhe 5-vjeçare (me interes të ndryshueshëm). Kështu në fund të këtij viti ato shënonin respektivisht 9.60 dhe 10.93 për qind. Vlen të theksohet se rritja e *yield*-it të obligacioneve me interes të ndryshueshëm ka qenë kryesisht e ndikuar nga ecuria e instrumenteve me të cilat ai parametrohet, pasi marzhi i pranuar ka ndjekur gjithmonë prirje rënëse gjatë kësaj periudhe. Nivelet e diferencave të *yield*-eve midis maturiteteve të ndryshme tregojnë një rritje kryesisht për ato me afat të shkurtër dhe të mesëm duke bërë kështu që pjerrësia e kurbës së *yield*-eve të jetë më e theksuar në pjesën e fillimit të saj.

Grafik 54. *Yield*-et e obligacioneve në tregun primar.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

### NORMAT E INTERESIT PËR DEPOZITAT E REJA

Në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2009, normat e interesit për dy monedhat kryesore, lekë dhe euro kanë vazhduar të ruajnë vlera të larta krahasuar me normat bazë. Të dhënat tregojnë që ulja e normës bazë me 0.50 pikë përqindjeje nga Banka e Shqipërisë nuk është ndjekur nga të gjitha bankat e sistemit si pasojë e konkurrencës së lartë për të ruajtur pjesët përkatëse të tregut (*market share*-t).

Norma mesatare e interesave për depozitat në lekë gjatë pjesës së dytë të vitit 2009 është mesatarisht 5.56 për qind, 0.18 pikë përqindjeje më lart krahasuar me gjashtëmujorin e parë të këtij viti. Rritje të normave të ponderuara të interesit, në vlerë mesatare, janë regjistruar për afatet 1- dhe 12-mujor. Pas përfundimit të sezonit veror, bankat kanë vazhduar të konkurrojnë me marzhe të larta (edhe pas uljes së normës bazë) duke aplikuar para kohe ofertat e fundvitit. Megjithatë, tendenca e mesatares së interesave të depozitave në lekë që pas muajit gusht 2009, ka ardhur në rënie, duke shënuar 5.28 për qind në nëntor. Kjo vlerë është 0.15 pikë përqindjeje më poshtë se muaji nëntor 2008 (norma bazë për lekun është ulur 1.00 për qind në këtë periudhë).

Interesat për depozitat me afat në euro, në përgjithësi, kanë ndjekur trend të anasjelltë lëvizjeje me ato në monedhën vendase. Ato kanë shënuar ulje me 0.28 pikë përqindjeje në gjashtëmujorin e dytë. Ulje të interesave janë regjistruar për të gjitha afatet e përdorimit. Megjithatë, normat e interesit për depozitat në euro kanë vazhduar të ruajnë vlera të larta[63] në krahasim

Grafik 55. Ecuria e interesave të depozitave 12-mujore në Shqipëri dhe BE me normat bazë.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 56. Ecuria e normës mesatare të ponderuar për kreditë në lekë.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

me normën bazë të BQE-së e cila shënoi 1.00 për qind gjatë gjithë pjesës së dytë të vitit 2009. Kjo është kushtëzuar nga gjendja e likuiditetit si dhe nga orientimi individual i politikave për normat e interesit nga bankat e sistemit. Bankat vazhdojnë të përdorin normat e interesit të depozitave si norma referencë për kreditë në euro. Norma mesatare e ponderuar e interesit për depozitat me afat në euro është ulur ndjeshëm vetëm në muajin nëntor (2.00 për qind). Deri në muajin tetor, kjo normë reflektonte vlera të larta e ndikuar nga zvogëlimi i peshës së depozitave me interesin më të ulët në totalin e depozitave (si rezultat i ponderimit).

### *NORMAT E INTERESIT PËR KREDITË E REJA*

Periudha korrik-nëntor 2009 është karakterizuar nga luhatshmëri e lartë e normave mesatare të interesit. Një nga faktorët kryesorë ka qenë efekti sezonal i biznesit për kapital qarkullues me qëllim rritjen e inventarëve. Ky efekt vazhdoi deri në muajin tetor, ndërkohë që muaji nëntor ka shënuar një ulje të normave të interesit për kreditë e reja në lekë. Prirja shtrënguese për kreditim është theksuar në monedhën evropiane, e cila ka zgjeruar diferencat me normat *benchmark* me të cilat ajo referohet (si euribor, libor euro dhe kosto e fondeve).

Në periudhën korrik-nëntor të vitit 2009, mesatarja e ponderuar e interesit për kreditë e reja në lekë është ulur mesatarisht vetëm me 0.04 pikë përqindjeje, në 13.61 për qind krahasuar me

Grafik 57. Ecuria e normës së interesave për kreditë e reja në lekë (djathtas) dhe në euro (majtas).




Burimi: Banka e Shqipërisë.

gjashtëmujorin e parë. Kjo ecuri pasqyron edhe vazhdimësinë e tendencës shtrënguese të kushteve të kredidhënies gjatë kësaj periudhe.

Sipas afateve të maturimit vihet re tendenca për të shtrënguar më tepër kreditë afatgjata dhe për investime si përgjigje e perceptimit të bankave për rritjen e pasigurisë për ecurinë ekonomike në vend. Interesat për afatin e shkurtër (0-6 muaj) kanë shfaqur prirje rritëse deri në muajin tetor, si pasojë e kërkesës së lartë sezonale për rritjen e inventarëve për bizneset dhe u ulën më pas duke u kthyer në normalitet në muajin nëntor.

Grafik 58. Ecuria e normës mesatare të ponderuar të interesit për kreditë në euro, Euribor 12-mujore dhe normës mesatare të ponderuar të depozitave në euro.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Norma mesatare e interesit për kreditë në euro ka treguar rritje në këtë periudhë duke iu larguar sërish normave referencë. Ajo ka rezultuar mesatarisht 8.05 për qind ose 0.37 pikë përqindjeje më e lartë se gjashtëmujori i kaluar. Perceptimi i përgjithshëm i pasigurisë, monitorimi më i rreptë i kredidhënies në valutë dhe faktorizimi i luhatshmërisë së kursit janë shprehur në rritje të çmimit nga ana e bankave. Ndërkohë që gjatë kësaj periudhe, norma e euribor-it në tregjet ndërkombëtare është ulur, interesat e kredisë në euro janë rritur për të gjitha afatet. Në afatin e shkurtër (për kapital qarkullues për biznese), norma e interesit ka ndjekur të njëjtën sjellje me monedhën vendase, duke theksuar prirjen shtrënguese të sistemit bankar për të siguruar likuiditet sezonal në valutë.

Kostoja e ndërmjetësimit (*diferenca* kredi-depozita) ka ruajtur nivel të lartë gjatë muajve korrik-nëntor 2009. Kjo diferencë ka lëvizur me kahe të kundërta duke u ulur për lekun me 0.22 pikë përqindjeje dhe duke u rritur për euron me 0.66 pikë përqindjeje. Ky tregues në nëntor rezultoi 8.23 për qind për lekun dhe 6.25 për qind për euron. Diferenca midis normave të interesit

Grafik 59. Normat mesatare të ndërmjetësimit për lekë dhe euro (majtas) dhe diferenca midis interesit mesatar të kredisë në lekë dhe asaj në euro (djathtas).




Burimi: Banka e Shqipërisë.

për kreditë në lekë me ato në euro në muajin nëntor ka ndryshuar kah. Ajo regjistroi rënie prej 0.98 pikë përqindjeje duke arritur nivelin 5.27 për qind.

### *ECURIA E KURSIT TË KËMBIMIT*

Gjashtëmujori i dytë i vitit 2009 është karakterizuar nga një nënçmim i lekut, në terma nominalë efektivë, me ritme relativisht të qëndrueshme. Gjatë kësaj periudhe, ndryshimet vjetore të indeksit NEER janë luhatur rreth një intervali të ngushtë (nga 7.42 për qind deri në 8.78 për qind) krahasuar me atë të gjashtëmujorit paraardhës (-4.2 për qind deri në -10.2 për qind). Ecuria e lekut në tregun e brendshëm të shkëmbimit valutor, gjatë këtij gjashtëmujori, ka rezultuar në kahun nënçmues. Në terma mesatarë, monedha vendase është nënçmuar me 9.57 për qind kundrejt euros dhe 2.36 për qind kundrejt dollarit amerikan krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraardhës.

Grafik 60. Ndryshimet vjetore të lekut në terma nominalë efektivë (NEER[64]) dhe mesatarja rrëshqitëse e tyre (djathtas). Ecuria ditore e raportit euro/lek dhe usd/lek (majtas).




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Zhvillimet në raportin euro/lekë, përtej faktorëve tashmë të njohur që kanë ndikuar në zhbalancimin e ofertë kërkesës, kanë reflektuar në një masë të madhe dhe efekte të natyrës sezonale. Kështu, në fillim të gjashtëmujorit, monedha vendase pasqyroi forcim si rrjedhojë e prurjeve valutore që karakterizojnë këtë periudhë. Ky efekt duket të ketë pësuar një shuarje të parakohshme, duke krijuar një zhvendosje të sjelljes paraprijëse ndaj fundit të ofertës sezonale që në muajin gusht. Në muajt në vazhdim, pozitat e lekut ndaj monedhës së huaj vijuan të luhaten në kahun nënçmues. Kjo ecuri ka ardhur si rrjedhojë e raporteve të lëkundura të ofertë kërkesës, të cilat janë shoqëruar gjithashtu dhe nga një pasiguri e agjentëve të tregut gjë që u reflektua në një luhatshmëri historike në tremujorin e fundit të vitit. Rritja e besimit ndaj monedhës vendase në kombinim me efektin sezonal të fundvitit kanë ndihmuar në reduktimin gradual të pozitave nënçmuese të lekut.

Grafik 61. Luhatshmëria[65] e këmbimit të lekut në tremujorë.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjithashtu, ecuria e lekut në raport me dollarin amerikan ka rezultuar në kahun rënës, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2008. Megjithatë, në terma gjashtëmujorë raporti usd/lekë ka paraqitur një mbiçmim prej 5.17 për qind. Ecuria e këtij raporti, gjatë gjashtëmujorit në fjalë ka rezultuar pjesërisht në përputhje me zhvillimet e raportit euro/dollar në tregun ndërkombëtar, pasi përçimi i pozitave të dobëta të dollarit amerikan kundrejt euros (nënçmim prej 9.17 % në terma gjashtëmujorë) nuk ka qenë i plotë.

Raporti euro/lekë pas një rritjeje të përshpejtuar në favor të monedhës evropiane gjatë tremujorit të tretë të vitit, duket se është stabilizuar dhe ka ndjekur pothuajse të njëjtën ecuri me atë të vendeve të tjera.

Grafik 62. Ecuria ditore e raportit euro/usd dhe usd/lek.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

## VI. ZHVILLIMET E PRITSHME EKONOMIKE PËR VITIN 2010

Aktiviteti ekonomik gjatë vitit 2009 është zhvilluar në kushte jo të favorshme kërkese dhe financimi. Në tërësi, treguesit kryesorë makroekonomikë janë prekur, si nga kontraktimi i ekonomive të rajonit dhe asaj botërore, ashtu edhe nga zhvillimet në tregun e brendshëm. Ngadalësimi i ekonomisë botërore është përcjellë në ekonominë shqiptare në formën e uljes së kërkesës së jashtme për mallra dhe shërbime si dhe tkurrje të prurjeve të tjera financiare

Grafik 63. Ecuria e raportit euro/lekë në krahasim me mesataren e rajonit.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

dhe kapitale. Gjithashtu, tendenca e agregatëve monetarë dhe e kredisë për ekonominë konfirmojnë ngadalësimin e kërkesës së brendshme në ekonomi.

Zhvillimet në sektorin e jashtëm të ekonomisë pasqyrojnë ndërthurjen e flukseve hyrëse të huaja financiare dhe kapitale si edhe të konkurrueshmërisë së ekonomisë shqiptare kundrejt ekonomive të tjera. Hapja tregtare gjatë dy viteve të fundit u stimulua nga prurjet financiare në formën e investimeve të huaja direkte dhe të huamarrjes së jashtme. Përveç rritjes së qëndrueshme ekonomike dhe ritmit të lartë të investimeve, injektimi i tyre në ekonomi favorizoi një konsum më të lartë dhe një rritje të deficitit tregtar e korent të vendit. Tkurrja graduale e financimit të jashtëm gjatë vitit 2009, e shoqëruar me ngadalësim të fortë të aktivitetit kreditues në tregun financiar, ka vënë në vështirësi ruajtjen e ritmit të investimeve në ekonomi ndërsa norma e konsumit mbart një prirje inercie. Pakësimi i burimeve të financimit të investimeve të brendshme dhe atyre të huaja, ka prekur rritjen ekonomike gjatë kësaj periudhe.

Të dhëna indirekte të tremujorëve të fundit, evidentojnë një tkurrje në kërkesën e brendshme kundrejt viteve të mëparshme si rezultat edhe i ngadalësimit të aktivitetit kreditues. Kreditimi i ekonomisë nga sistemi bankar në terma vjetorë është ngadalësuar në norma njëshifrore kundrejt ritmit mesatar prej mbi 40 për qind në dy vitet e mëparshme. Kredia për ekonominë, në pjesën më të madhe të saj, është financuar nga stoku i mjeteve valutore në bilancet e bankave të nivelit të dytë. Në kushtet e pakësimit të këtij stoku pas tërheqjes së një pjese të depozitave në fund të vitit 2008, financimi i rritjes ekonomike nëpërmjet ndërmjetësimit financiar është bërë më i vështirë. Për vitin 2010, shtesa e kredisë për sektorin privat të ekonomisë nga sistemi bankar parashikohet të jetë rreth 1/3 e asaj të injektuar në vitin 2008. Ecuria e cilësisë së portofolit të kredive dhe primi më i lartë i rrezikut, në prani të faktorëve të tjerë, do të vështirësojnë riaktivizimin e kreditimit nga sistemi bankar drejt sektorit privat të ekonomisë me ritmet e mëparshme.

Burimet e jashtme të financimit të rritjes ekonomike për vitin aktual janë gjithashtu më të pakta kundrejt dy viteve të mëparshme. Financimi i huaj nëpërmjet flukseve kapitale dhe financiare ka kontribuar në vazhdimësinë e zgjerimit të kërkesës agregate gjatë viteve 2008-2009. Flukset financiare në vitin 2009 pritet të rezultojnë në rreth 11-12 për qind të PBB-së, ndërsa në vitin 2008 financimi nga flukset financiare të huaja arriti në 17 për qind të PBB-së[66]. Përgjithësisht, këto prurje konsistojnë në investime të huaja direkte, pjesërisht në formën e privatizimeve të kompanive me pronësi publike, si edhe huamarrje e jashtme kryesisht e sektorit publik. Pakësimi i mëtejshëm i këtyre flukseve gjatë vitit aktual, si pasojë e reduktimit të investimeve të huaja direkte dhe e shtrëngimit të kushteve financiare të huamarrjes në tregjet ndërkombëtare, parashikohet të ushtrojë ndikim të mëtejshëm mbi ekonominë gjatë këtij viti.

Krahas zhvillimeve në tregjet financiare, faktorët afatgjatë që kanë kontribuar në rritjen ekonomike paraqiten më të reduktuar gjatë vitit 2010. Zhvillimi makroekonomik dhe rritja ekonomike gjatë viteve të fundit është mbështetur

nga prurjet e larta valutore në formën e remitancave, të cilat do të mbeten të ulëta gjatë vitit 2010, si pasojë edhe e situatës problematike në partnerët tanë tregtarë. Në terma të PBB-së, prurjet valutore nga remitancat janë luhatur në 12-15 për qind, ndërsa gjatë viteve 2008 dhe 2009, niveli i tyre pësoi rënie vjetore prej rreth 8 për qind çdo vit, duke arritur nën 10 për qind të PBB-së. Pakësimi i mëtejshëm i prurjeve valutore në formën e remitancave gjatë vitit të ardhshëm do të ndikojë negativisht në kërkesën agregate në ekonomi. Tendenca në rënie e vërejtur gjatë dy viteve të fundit, është amortizuar nga prurjet e larta financiare të investimeve të huaja dhe huamarrjes së jashtme. Kontraktimi i vazhdueshëm i tyre tenton të transmetohet në nivelin e konsumit dhe në rritjen e kostos oportune të investimeve në ekonomi duke u pasqyruar edhe në uljen e potencialit ekonomik në periudhën afatmesme.

Në prani të këtyre zhvillimeve, gjatë vitit 2010, ekonomia pritet të përballet me mundësi të reduktuara të financimit të kërkesës agregate dhe rrjedhimisht një ecuri të moderuar të konsumit e investimeve. Në kushtet e kufizimeve të burimeve financuese të konsumit dhe të investimeve, ekonomia reale pritet të qëndrojë nën potencialin e saj afatmesëm. Kjo do të sjellë presione të reduktuara inflacioniste të gjeneruara nga ekonomia e brendshme. Nga ana tjetër, ulja e kërkesës së brendshme do të reflektohet dhe në një përmirësim gradual të bilancit të jashtëm të ekonomisë.

# SHËNIME

[1] Shpenzimet konsumatore dhe investimet patën një rënie përkatësisht prej 0.1 dhe 0.8 në tremujorin e tretë të vitit 2009, krahasuar me një tremujor më parë.
[2] Brazil, Rusi, Indi dhe Kinë.
[3] Llogaritur nga diferenca e mesatares mujore të këtyre treguesve në qershor me muajin dhjetor.
[4] Eksportet për periudhën janar –nëntor 2009 ranë me 17% në nivel vjetor.
[5] Tregtia me pakicë ka rënë me 1.4% në nëntëmujorin e parë të vitit 2009, kredia konsumatore ka shënuar norma të ulëta rritjeje që nga fillimi i vitit, importi i mallrave për konsum ka ruajtur nivelet e vitit të kaluar, pagat në ekonomi kanë shënuar rritje të lehtë ndërsa remitancat kanë rënë me 6.6%.
[6] Shpenzimet korente dhe ato kapitale për periudhën janar-nëntor janë rritur përkatësisht me 16 dhe 23% në nivel vjetor.
[7] Për më shumë detaje shih analizën tek kapitulli IV.3.
[8] Hendeku i prodhimit matet si diferenca midis prodhimit aktual të një ekonomie dhe prodhimit që ajo do të gjeneronte potencialisht në kushtet e shfrytëzimit të plotë të kapaciteteve, me eficiencë maksimale.
[9] Istrefi K., Semi V., (2007). "Përçimi i kursit të këmbimit në Shqipëri: evidencë nga vektorët autoregresivë". Material diskutimi i Bankës së Shqipërisë.
[10] Në rastin e Shqipërisë, Indeksi i Kushteve Monetare (IKM) është një mesatare e peshuar e ndryshimeve të normës bazë të interesit dhe të kursit nominal efektiv të këmbimit (NEER), kundrejt vlerave përkatëse të tyre në një periudhë bazë. Duke nisur nga tremujori i dytë 2009, periudha bazë është muaji dhjetor 2005. Raporti i IKM në rastin e Shqipërisë është 1.82:1, çka nënkupton se efekti i një mbiçmimi në nivelin 1.82 për qind të NEER në kërkesën agregate, do të mund të neutralizohej nga një ulje e normës bazë të interesit me 1.0 pikë përqindjeje. Indeksi monitorohet për të parë kahun e kushteve monetare dhe jo si objektiv operacional.
[11] Pesha e kësaj kategorie në totalin e peshave në llogaritjen e indeksit të çmimeve të konsumit është afërsisht 19 për qind.
[12] Çmimi i naftës në tregun vendas ndikohet pothuajse plotësisht nga çmimi i naftës në tregun botëror, i cili kohët e fundit ka njohur rritje të vazhdueshme.
[13] Mesatarja e dy matjeve (me përjashtim të përhershëm dhe me mesatare të reduktuar). Për informacion më të detajuar shihni: Çeliku dhe Hoxholli (2008), "Matje të tjera të inflacionit bazë: përdorimi i tyre në parashikim dhe analizë", Material diskutimi, Nr. 1(24) 2008, Banka e Shqipërisë.
[14] Mesatarja e inflacionit bazë në terma vjetorë për dekadën e fundit rezulton rreth 0.8 për qind.
[15] Nga sektori i tregtueshëm i shportës së IÇK-së, janë përjashtuar efektet e çmimeve të grupeve "Fruta" dhe "Zarzavate përfshirë patate".
[16] Vlerësimi merr në konsideratë peshën e sektorit të tregtueshëm në shportë (62%), nënçmimin mesatar vjetor për kursin lekë/euro për vitin 2009 (+7.5%), inflacionin mesatar të sektorit të tregtueshëm për periudhën korrik-dhjetor 2009 (3.5%) dhe mesataren historike të tij (0.8%).
[17] Që përjashton nga sektori i patregtueshëm i IÇK-së, nëngrupet me çmime të administruara.
[18] Norma e rritjes së PBB-së për T3:2009, vlerë e publikimit të INSTAT, "Produkti i Brendshëm Bruto Tremujor", Publikimi i tremujorit të tretë për vitin 2009, dhjetor 2009. Normat e rritjes së PBB-së për T1:2009 dhe T2:2009, mund të jenë objekt rishikimi prej INSTAT.
[19] Publikimi i INSTAT "Produkti i Brendshëm Bruto Tremujor" tremujori i tretë 2009, dhjetor 2009.
[20] Bazuar në rezultatet e marra nga vrojtimet e besimit, janë llogaritur tregues besimi për sektorët e industrisë, të ndërtimit, të shërbimeve dhe për konsumatorët, si dhe treguesi i tendencës ekonomike, i cili përmbledh në një tregues të vetëm opinionet e shprehura nga të gjithë grupet e lartpërmendur.
[21] Sipas të dhënave nga vrojtimi i aktivitetit kreditues pranë bankave, standardet e kredidhënies janë shtrënguar në një masë më të madhe për kredinë për qëllime investimi sesa për kredinë për qëllime të inventarit dhe të kapitalit qarkullues.
[22] Rënia vjetore e eksporteve dhe e importeve gjatë kësaj periudhe ndikoi në një zgjerim me 0.12

*për qind të eksporteve neto.*

*[23] Analiza në nivel sektorial referuar publikimeve "Produkti i Brendshëm Bruto tremujor", Shtator 2009 dhe Dhjetor 2009, INSTAT.*

*[24] Indeksi i çmimit të banesave llogaritet bazuar në mënyrën hedonike të llogaritjes së indekseve, e cila mundëson një indeks të pastruar nga efektet e ndryshimit të cilësisë, duke u bazuar në të dhënat e njoftimeve për shitjeje të banesave në gazetën Çelësi. Pjesa më e madhe e çmimeve të shpallura janë të emërtuara në monedhën evropiane. Pjesa më e madhe e njoftimeve i takojnë rishitjeve nga pronarët dhe jo shitjeve për herë të parë. Gjithashtu, indeksi nuk mund të kapë në kohë ndryshimin e çmimit të shitjes si efekt i ndryshimit të tij nga ndërtuesit e banesave.*

*[25] Raporti çmim shitje ndaj qirasë së banesës është një tregues i thjeshtë që tregon nëse çmimi i banesave është i mbiçmuar, nga krahasimi i vlerave aktuale të raportit me vlerat historike të tij.*

*[26] Të dhënat e bilancit të energjisë elektrike janë të disponueshme deri në muajin nëntor 2009.*

*[27] Si të ardhurat ashtu dhe shpenzimet korente regjistruan një rritje vjetore prej përkatësisht 3.7 dhe 10.4 për qind gjatë periudhës korrik-shtator'09.*

*[28] Deficiti në kategorinë e të ardhurave arriti në rreth 34 milionë euro krahasuar me suficitin prej 55 milionë eurosh të regjistruar një vit më parë.*

*[29] Ky i fundit arriti në rreth 206 milionë euro kundrejt vlerës prej rreth 229 milionë eurosh që shënonte gjatë T3'08.*

*[30] Llogaritjet e PBB-së nominale për vitin 2009 janë bazuar në vlerësimin e FMN-së për PBB-në nominale: 1,129,000 milionë lekë (rishikimi i 6-të i marrëveshjes PRGF, shkurt 2009, http://www.imf.org/external/pubs/). Vlerat e treguesve të ndryshëm të shprehur në përqindje të PBB-së i referohen të dhënave kumulative për periudhën T4'08- T3'09.*

*[31] Vlerat e raporteve të mëposhtme i referohen të dhënave kumulative që përfshijnë periudhën nga T4 i vitit paraardhës deri në T3 të vitit të cilit i referohet.*

*[32] Në mungesë të të dhënave për muajin dhjetor, tregtia e jashtme do të trajtohet mbi periudhën e sipërpërmendur.*

*[33] Burimi: të dhënat e Bankës së Shqipërisë dhe "Maximising the development impact of migration related Financial Flows and Investment from Austria to BiH ", IOM (International Organization for Migration), IASCI (International Agency for Source Country Information).*

*[34] Ky bilanc regjistronte një suficit prej rreth 34.5 milionë eurosh gjatë periudhës korrik-shtator'08.*

*[35] Sektori i shërbimeve të komunikimit regjistron një ngushtim të suficitit të kësaj llogarie nga 19.3 milionë euro gjatë T3'08 në 6.6 milionë euro gjatë T3'09; ndërsa ato financiare regjistrojnë një zgjerim të mëtejshëm të deficitit të llogarisë në fjalë: nga 2.0 milionë euro gjatë T3'08 në 6.4 milionë euro në T3'09.*

*[36] Referuar planit të rishikuar për 2009, të miratuar në shtator të këtij viti.*

*[37] Ky nivel përfaqëson rritjen më të ulët të dekadës për periudhën 11-mujore.*

*[38] Niveli prej 14 për qind përfaqëson rritjen më të lartë vjetore të shënuar për vitin 2009.*

*[39] Kontributi i TVSH-së në rritjen e totalit të të ardhurave përgjatë këtij viti ka qenë në nivele modeste (nën 1 pikë përqindjeje), ndërkohë që në vitet e mëparshme, nisur nga fakti që ky zë ka peshën kryesore tek të ardhurat (35%), ai ka kontribuar mesatarisht me rreth 5 pikë përqindjeje në rritjen e totalit të të ardhurave.*

*[40] Rishikimi dhe miratimi i buxhetit për vitin 2009 u realizua në shtator të këtij viti.*

*[41] Niveli fillestar i planifikuar nga Ministria e Financave ishte 50 miliardë lekë, ndërkohë që sipas buxhetit të rishikuar planifikohet të jetë rreth 74.8 miliardë lekë.*

*[42] Sipas planit të rishikuar.*

*[43] Kontributi në rritje gjatë dy viteve të fundit i shpenzimeve kapitale duket qartë dhe nga grafiku.*

*[44] Sipas përkatësisë, rritja e këtyre zërave për 11-mujorin ka qenë me 27, 31 dhe 18 për qind.*

*[45] I referohet raportit të deficitit buxhetor 11-mujor ndaj PBB-së (FMN) 11-mujore.*

*[46] Kredia sindikaliste është një formë huaje e marrë nga qeveria shqiptare nga një grup bankash rezidente dhe jorezidente në territorin e Republikës së Shqipërisë, për financimin e deficitit buxhetor. Maturiteti i kësaj kredie nuk është shumë i gjatë.*

*[47] Këto të ardhura i përkasin privatizimit të ARMO (një pjesë e të cilave u transferuan në llogarinë e vitit 2009), OSSH, një pjese të aksioneve të AMC-së dhe Bankës së Bashkuar të Shqipërisë, si edhe licencës së telefonisë së katërt celulare.*

*[48] Ndërkohë në dy vitet paraardhëse, politika e huamarrjes së qeverisë ka synuar rritjen e emetimit*

*të obligacioneve të të gjitha maturiteteve, kundrejt bonove të thesarit.*

*[49] Pothuajse në të gjithë vendet e Ballkanit Perëndimor, u vërejt një thellim i deficitit buxhetor si pasojë e realizimit të të ardhurave buxhetore nën nivelin e parashikuar, si edhe një nivel i lartë i shpenzimeve si një reagim ndaj krizës së fundit ekonomike e financiare.*

*[50] Ndryshimi i rritjes reale të PBB-së në boshtin horizontal dhe i deficitit buxhetor ndaj PBB-së në 2009 në boshtin vertikal.*

*[51] Në boshtin horizontal jepet stoku i borxhit publik ndaj PBB-së për vitin 2009, ndërsa në atë vertikal jepet diferenca e balancës fiskale ndaj PBB-së për 2009 me 2008. Për Shqipërinë të dhënat i referohen T3 2009.*

*[52] Pa efekt kursi.*

*[53] Shifrat e paraqitura në vazhdim në analizën e kreditimit janë pa efektin e kursit të këmbimit.*

*[54] Gjatë pjesës së parë të vitit, frenimi i rritjes së kredisë ishte më shumë i ndikuar nga shtrëngimi i ofertës - kushtet e kreditimit nga bankat, situata e vështirë e likuiditetit.*

*[55] Vlera e PBB-së për T3:2009, referuar publikimit të INSTAT-it për T3:2009, "Produkti i Brednshëm Bruto Tremujor".*

*[56] Bazuar në të dhënat e Statistikave Afatshkurtra (INSTAT), treguesi i të punësuarve me pagesë.*

*[57] Referuar të dhënave nga "Statistikat Afatshkurtra", INSTAT, ku përjashtohet bujqësia dhe "Konjuktura Tregues Kryesorë Ekonomikë, Korrik-Shtator 2009", INSTAT.*

*[58] Indeksi i pagës mesatare është llogaritur si raport i indeksit të fondit të pagave me indeksin e numrit të punonjësve.*

*[59] Pritjet e agjentëve ekonomikë për inflacionin maten nga të dhënat e vrojtimit të besimit të bizneseve, vrojtimit të besimit të konsumatorëve dhe vrojtimit mujor të ekspertëve të bankave për parashikimin e disa treguesve makroekonomikë.*

*[60] Devijimi standard i normave të interesit në tregun ndërbankar gjatë këtij 6-mujori ishte 0.36 ndërsa ai i 6-mujorit të parë ishte 0.46.*

*[61] Në fund të janarit 2009 norma bazë u ul me 50 pikë bazë në 5.75 për qind.*

*[62] Raporti bid/cover në ankandet e obligacioneve ka qenë mesatarisht mbi 1.*

*[63] Mesatarja e ponderuar e depozitave në euro ishte 2.35 për qind.*

*[64] NEER – kursi nominal efektiv i këmbimit, i llogaritur kundrejt dy monedhave sipas një peshe të përafërt që zë në tregtinë me jashtë, euro (80 për qind ) dhe usd (20 për qind). Një rritje e NEER do të thotë mbiçmim i lekut.*

*[65] Llogaritur si mesatare tremujore e luhatshmërisë mujore të kursit të këmbimit. Luhatshmëria e kursit të këmbimit është matur nga treguesi i devijimit standard.*

*[66] Të dhënat e plota për vitin 2009 nuk janë ende të disponueshme.*

# FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z.ARDIAN FULLANI

Në konferencën e përbashkët për shtyp të misionit të FMN-së me Ministrinë e Financave dhe Bankën e Shqipërisë
27 tetor 2009

Fillimisht do të dëshiroja të falenderoja misionin e FMN-së dhe veçanërisht shefin e tij, z. Gerwin Bell, për punën e madhe që kanë kryer javën e fundit.

Kjo vizitë e radhës e FMN-së, në kuadrin e konsultimeve për Artikullin IV, përkon me një periudhë ende të vështirë përsa i takon presioneve që gjeneron kriza e madhe, që ka përfshirë ekonominë botërore që nga viti i kaluar.

Me kënaqësi kemi konstatuar se Banka e Shqipërisë ndan vlerësime të njëjta për shumë nga zhvillimet që ka kaluar ekonomia shqiptare në gjashtëmujorin e parë të vitit 2009. Përfitoj nga rasti që edhe njëherë të theksoj konkluzionin e artikuluar prej kohësh: (1) se ekonomia shqiptare dhe sistemi i saj financiar treguan një shkallë të kënaqshme rezistence, dhe (2) se politikat e ndërmarra nga të dy autoritetet, si nga Banka e Shqipërisë ashtu edhe nga ana e Ministrisë së Financave, kanë rezultuar të dobishme në krijimin dhe përcjelljen e stimujve të duhur në drejtim të stabilitetit financiar dhe aktivitetit ekonomik të vendit.

Duke u ndalur më konkretisht në politikën monetare të Bankës së Shqipërisë, dua të vlerësoj se ajo ka qenë e matur përgjatë gjithë kësaj periudhe, duke reflektuar me kujdes mbi zhvillimet e fundit makroekonomike, mbi zhvillimet në sistemin bankar dhe pritshmëritë e agjentëve. Pjesë e këtij kujdesi kanë qenë edhe taktikat e përdorura prej Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë me synim shtimin e injektimit të likuiditetit në sistem.

Gjithsesi, duke kthyer vështrimin në horizontin afatshkurtër dhe atë afatgjatë, do të doja që shkurtimisht të ndalesha në dy – tre çështje, të cilat Banka e Shqipërisë ka vendosur të ketë në axhendën e saj të prioriteteve, për muajt që vijnë.

Së pari, do të doja të theksoja edhe një herë një idenë time të lançuar në Forumin e Tretë të Bankës së Shqipërisë me sistemin bankar, në lidhje me zhvendosjen e ekonomisë drejt një ekuilibri të ri të ndryshëm nga ai i parakrizës. Ky është një argument që po mbizotëron debatin e ditës dhe personalisht mendoj se duhet ta faktorizojmë këtë konkluzion në projeksionet tona makro të zhvillimit të vendit për vitet që vijnë.

Së dyti, Banka e Shqipërisë vlerëson të domosdoshme për periudhën në vijim një kujdes dhe vigjilencë financiare në rritje. Kjo do të nënkuptonte një forcim të mëtejshëm të stabilitetit makrofinanciar, veçanërisht në harmonizimin më të mirë të dy politikave bazë në ekonomi, për të vazhduar stimulimin e domosdoshëm të aktivitetit ekonomik të vendit.

Së treti, do të vlerësoja si shumë të rëndësishme vazhdimësinë e kreditimit të ekonomisë, thithjen e investimeve të huaja si dhe thellimin e reformave strukturore. Banka e Shqipërisë është e angazhuar në sigurimin e stabilitetit afatgjatë të çmimeve dhe për këtë qëllim, vendimmarrja e saj do të vazhdojë të jetë e ankoruar me këtë objektiv ligjor të saj. Në kushtet e një realiteti të ri, post-krizë, nuk do të heqim vëmendjen nga proceset strukturuese të ekonomisë për të përshtatur më tej ekonominë shqiptare në përballjen e efekteve post-krizë dhe për ta kthyer atë në një ekonomi vibrante, jo vetëm në rajon, por edhe më gjerë.

# FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z.ARDIAN FULLANI

Në konferencën për shtyp mbi vendimin e Këshillit Mbikëqyrës për uljen e normës bazë të interesit me 0.5 pikë përqindjeje
28 tetor 2009

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, i mbledhur sot më datë 28 tetor 2009, pasi analizoi në detaje zhvillimet më të fundit ekonomiko-financiare në vend, projeksionet makroekonomike si dhe balancën e rreziqeve për muajt në vazhdim, vendosi të ulë me 0.5 pikë përqindjeje normën bazë të interesit. Pas kësaj uljeje, kjo normë shkon në nivelin 5.25 për qind.

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë ka arritur në përfundimin se tremujori i tretë i vitit 2009 është karakterizuar nga shenja pozitive në ekonominë dhe në tregjet financiare shqiptare. Në veçanti, tremujori i tretë shënoi një pikë kthese në drejtim të rikthimit të besimit në sistemin bankar. Stabilizimi i situatës së likuiditetit, ruajtja e qëndrueshmërisë financiare dhe e treguesve të kapitalizimit të këtij sistemi, përbëjnë një platformë solide për rigjallërimin e rolit të tij ndërmjetësues dhe financues të ekonomisë. Së bashku, me tendencat e fundit pozitive të ekonomisë botërore, të cilat mbeten ende të brishta, për nga natyra dhe qëndrueshmëria e tyre, këto zhvillime na nxisin ta shohim aktivitetin e ardhshëm ekonomik të vendit nën optikën e një optimizmi të kujdesshëm.

Gjatë vitit 2009, ekonomia shqiptare është ndikuar nga kriza ekonomike e financiare botërore, kryesisht si pasojë e pakësimit të kërkesës së huaj dhe të remitancave, e rritjes së primeve të rrezikut dhe e një mbështetjeje financiare të reduktuar e me kosto më të lartë. Megjithatë, ekonomia jonë vazhdoi të shënojë rritje ekonomike pozitive gjatë kësaj periudhe, ndërkohë që presionet e brendshme inflacioniste mbeten të kontrolluara.

Aktiviteti ekonomik në vend është mbështetur nga stimuli fiskal dhe ruajtja e niveleve relativisht të larta të kërkesës konsumatore, ndërkohë që investimet dhe kërkesa për eksporte kanë shënuar rënie gjatë nëntëmujorit të parë të vitit.

Në rrafshin botëror, tremujori i dytë i vitit 2009 dhe periudha në vazhdim janë karakterizuar nga tendenca stabilizuese në drejtim të aktivitetit ekonomik. Ndonëse në terma vjetorë ekonomia botërore vazhdon të tkurret, cikli i zëvendësimit të inventarëve të konsumuar muajt e fundit vendosi një dysheme në rënien e ekonomive të Eurozonës dhe të SHBA-së. Për më tepër, ky cikël ka shërbyer edhe si katalizator afatshkurtër i riaktivizimit të sektorëve të tyre industrialë e prodhues. Në një këndvështrim më afatgjatë, aktiviteti i qëndrueshëm ekonomik i vendeve aziatike, veçanërisht i Kinës, si dhe rritja e tregtisë botërore do të shërbejnë si mbështetës të rritjes ekonomike botërore. Megjithatë, rruga e ekonomisë botërore drejt një rritjeje të shëndetshme dhe të qëndrueshme është e gjatë. Modeli ekzistues i ekonomisë botërore është

mbështetur në konsumin e lartë dhe bilancet e rënduara me borxhe të ShBA-së, përkundrejt një strategjie të vendeve aziatike që favorizon eksportet dhe kursimet. Adresimi i këtyre çekuilibrave në nivel botëror do të kërkojë kohën e vet, duke u shoqëruar me rritje ekonomike nën potencial dhe presione të reduktuara inflacioniste për një periudhë relativisht të gjatë kohe.

Sistemi financiar botëror, tregjet e kapitalit, sektori bankar dhe ndërmjetësit e tjerë financiarë, duket se po rigjallërohen.

Stimuli monetar dhe fiskal në rang botëror e ka dhënë efektin e vet, duke ndihmuar më së pari rikapitalizimin e sistemit financiar dhe rivënien në punë të sistemit të kreditimit. Megjithëse ndër agjentët financiarë, perceptimi i rrezikut mbetet i lartë ndërkohë që gatishmëria për rrezik mbetet e ulët, rifillimi i qarkullimit të flukseve financiare botërore do të ndihmojë ekonomitë e vendeve në zhvillim nëpërmjet rritjes së fondeve të disponueshme.

Përballë zhvillimeve problematike në kontekstin botëror, ekonomia shqiptare ka shënuar një rritje ekonomike pozitive gjatë gjashtë muajve të parë të vitit 2009. Sipas të dhënave paraprake të raportuara nga INSTAT, rritja vjetore e Produktit të Brendshëm Bruto gjatë tremujorit të dytë të vitit ishte 5.3 për qind, duke ruajtur përafërsisht të njëjtin ritëm me atë të tremujorit të parë. Aktiviteti në sektorin e shërbimeve dha kontributin më kryesor në rritjen e PBB-së. Sektori prodhues i ekonomisë ndikoi gjithashtu në rritjen vjetore të PBB-së, kryesisht si rezultat i ecurisë së aktivitetit të ndërtimit, ndërsa aktiviteti industrial thelloi ritmet rënëse të nisura nga fillimi i vitit 2009.

Tendenca e rritjes ekonomike, ndonëse në përmasa më të reduktuara, është e lexueshme edhe në disa tregues të tërthortë të ekonomisë, si rritja e të ardhurave buxhetore, rritja e kreditit për ekonominë dhe stabiliteti i treguesve të tregut të punës. Megjithatë, treguesit e sipërcituar dhe veçanërisht ata monetarë dhe të besimit të biznesit dhe të konsumatorëve, pasqyrojnë një ngadalësim të ritmit të rritjes së ekonomisë krahasuar me vitin e shkuar.

Në kontekstin makroekonomik, ky ngadalësim reflekton më së shumti reduktimin e investimeve dhe të kërkesës së jashtme, ndërkohë që konsumi dhe shpenzimet publike kanë patur një ndikim në kahun rritës të aktivitetit ekonomik.

Megjithëse pozitive, ecuria ekonomike e gjashtëmujorit të parë të vitit reflekton një ngadalësim prej rreth 1.4 pikësh përqindje krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2008. Një situatë e tillë, krahas dobësimit të përgjithshëm të presioneve globale inflacioniste, është përkthyer në rënie graduale të presioneve inflacioniste në ekonominë e vendit. Inflacioni mesatar për periudhën janar – shtator 2009 shënoi vlerën 2.0 për qind, duke pasqyruar plotësisht eliminimin e efekteve të raundit të parë të shkaktuara nga rritja e çmimeve të lëndëve të para gjatë periudhës 2007-2008 si edhe shuarjen e efekteve të rritjes së fundit administrative të çmimit të energjisë elektrike. Prirja në rënie e inflacionit bazë dhe e atij të mallrave dhe të shërbimeve të sektorit të patregtueshëm të IÇK-së, tregojnë se presionet inflacioniste të

gjeneruara nga krahu i kërkesës së brendshme janë në rënie. Nga ana tjetër, lëvizjet relativisht të forta në kahun nënçmues të monedhës vendase gjatë vitit 2009, kanë ndikuar në prirjen rritëse të inflacionit të sektorit të mallrave të tregtueshme, i cili arriti në rreth 3.1 për qind në tremujorin e tretë. Zhvillimet në tregun e punës dhe në paga, nuk sinjalizojnë shtim të presioneve të ardhshme inflacioniste nga krahu i ofertës. Norma e papunësisë gjatë pjesës së parë të vitit 2009 rezultoi rreth 12.7 për qind, duke qëndruar në nivelin e fundvitit të kaluar. Për të njëjtat periudha krahasuese, ritmet e rritjes së pagës mesatare reale në ekonomi kanë qenë më të përmbajtura.

Parashikimet e Bankës së Shqipërisë si edhe ankorimi i pritjeve të agjentëve ekonomikë për çmimet e konsumit, mbështesin ruajtjen dhe konsolidimin e stabilitetit të çmimeve të konsumit në një horizont afatmesëm kohor, të shprehur në nivele të ulëta dhe të qëndrueshme inflacioni.

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2009, deficiti i llogarisë korente regjistroi një ngushtim të lehtë, prej rreth 1 pike përqindjeje, në terma vjetorë. Ky ngushtim pasqyron një ngadalësim si të importeve ashtu edhe të eksporteve të ekonomisë, ndërkohë që remitancat kanë regjistruar një reduktim relativisht më të ulët se në tremujorët paraardhës. Megjithatë, deficiti i llogarisë korente mbetet ende në nivele të larta duke reflektuar konsumin e lartë të ekonomisë shqiptare dhe pamundësinë e kapaciteteve prodhuese në vend për t'iu përgjigjur atij. Të ardhurat e privatizimit dhe huamarrja në valutë e sektorit publik gjatë kësaj periudhe kanë bërë që bilanci i pagesave të rezultojë pozitiv në tërësinë e tij, por qëndrueshmëria e ardhshme e tij duhet të mbështetet në faktorë më afatgjatë.

Politika fiskale ka patur një natyrë ekspansioniste gjatë tetë muajve të parë të vitit. Në terma vjetorë, shpenzimet buxhetore kanë shënuar një rritje prej 23 për qind gjatë kësaj periudhe, duke reflektuar kryesisht rritjen e shpejtë të shpenzimeve kapitale. Të ardhurat buxhetore kanë patur një ecuri më të ngadaltë se shpenzimet, si pasojë edhe e ngadalësimit të ritmit të rritjes ekonomike gjatë kësaj periudhe. Për rrjedhojë, shtimi i shpenzimeve buxhetore është financuar nëpërmjet përdorimit të të ardhurave të privatizimit dhe të rritjes së huamarrjes publike. Kjo politikë ka ushtruar presion për rritjen e normave të interesit të letrave me vlerë të borxhit të qeverisë me afat të gjatë maturimi.

Ndikimi i saj në tregjet e brendshme monetare ka rezultuar më i butë gjatë kësaj periudhe, për arsye se borxhi publik është tërhequr në një masë të madhe në tregjet ndërkombëtare të kapitalit. Gjithsesi, vazhdimi i kësaj politike në të ardhmen do të përballet me potenciale më të pakta financimi si të tregut shqiptar ashtu dhe atij të huaj. Ky fakt shtron nevojën për një kthim të shpejtë në trajektoren konsoliduese që ndoqi politika fiskale në vitet që i paraprinë krizës.

Treguesit monetarë të tremujorit të tretë kanë konfirmuar tendencën e ngadalësimit të rritjes së parasë. Oferta e parasë, M3, ka shënuar rritje vjetore prej 4.5 për qind në muajin gusht, kundrejt një ritmi mesatar prej rreth 7 për

qind në gjysmën e parë të vitit, kryesisht si pasojë e ngadalësimit të flukseve të kredisë për sektorin privat. E veçanta e muajit gusht ishte rritja e ndjeshme e depozitave – rreth 25.4 miliardë lekë në terma mujorë - në linjë me ecurinë e tyre sezonale për këtë periudhë të vitit. Rreth 70 për qind e rritjes së stokut total të depozitave në fundin e periudhës rezultoi të ishte në depozita me afat, duke sinjalizuar forcim të besimit në sistemin bankar.

Ngadalësimi i kredisë për sektorin privat ka vijuar me të njëjtin ritëm gjatë muajve korrik-gusht 2009, duke reflektuar si shtrëngim të ofertës për kredi ashtu edhe tkurrje të kërkesës për të. Së bashku me reduktimin e shkallës së shfrytëzimit të kapaciteteve të raportuar nga bizneset në vrojtimin e Bankës së Shqipërisë, ky zhvillim sinjalizon se investimet e sektorit privat në ekonomi paraqiten në rënie. Bankat vazhdojnë të aplikojnë kushte të shtrënguara për dhënien e kredisë, ndërkohë që njëkohësisht evidentohet rënie e kërkesës për konsum dhe investime nga sektori privat.

Rritja vjetore mesatare e kredisë për sektorin privat për muajt qershor – gusht rezultoi 16 për qind në terma nominalë, ndjeshëm më e ulët se mesatarja e pesë muajve të parë të vitit prej 29 për qind. Pavarësisht niveleve të ulëta të rritjes, kredia për biznese është kontribuesi kryesor në rritjen e kredisë për sektorin privat, duke përbërë rreth 65 për qind të saj. Trendi rënës i kredisë i atribuohet ngadalësimit të kredidhënies në valutë, ritmi i rritjes të së cilës në muajin gusht ishte zero. Ndërkohë, kredia në lekë vazhdon të ruajë ritmin mesatar të rritjes gjatë gjithë vitit 2009, prej 30 për qind. Si rrjedhojë, pesha e kredisë në valutë në portofolin e kredisë për sektorin privat ka zbritur në 67 për qind. Ndërgjegjësimi për pasojat e luhatjeve në kursin e këmbimit, si dhe shtrëngimi më i madh i kushteve për kredimarrësit që kanë të ardhura në monedhë të ndryshme nga ajo e marrjes së kredisë kanë bërë që individët të tërheqin më pak kredi në valutë se bizneset.

Tregjet financiare janë karakterizuar nga përmirësimi i likuiditetit dhe rifitimi i besimit të agjentëve në to. Furnizimi i vazhdueshëm nga ana e Bankës së Shqipërisë të tregut të parasë nëpërmjet operacioneve për injektimin e likuiditetit, ka ndihmuar për të qetësuar pjesëmarrësit e tregut si dhe për të furnizuar tregun me fonde, të cilat i kanë shërbyer ndërmjetësimit në monedhën vendase për sektorin privat. Nevojat për likuiditet në tregun ndërbankar kanë rezultuar në ulje, duke mos ushtruar presion tek normat afatshkurtra të interesit. Situata paraqitet e kundërt në tregun primar të letrave me vlerë të qeverisë, ku pavarësisht likuiditetit të mjaftueshëm, yield-et e bonove të thesarit me maturitet afatgjatë kanë rezultuar në rritje. Në ankandin e fundit të muajit shtator, yield-i 12-mujor shënoi 9.40 për qind, ose 0.64 pikë përqindjeje më lart se fundviti 2008.

Ruajtja e primeve të larta të rrezikut për afatet e gjata si dhe ekzistenca e një tregu të cekët financiar, kanë qenë arsyet kryesore që kanë mbajtur në nivele të larta yield-et afatgjata të letrave me vlerë të qeverisë. Nga ana tjetër, këto nivele kanë tërhequr investimet e individëve drejt këtij tregu, duke i krijuar atyre një instrument alternativ për ruajtjen e kursimeve dhe duke rritur peshën e financimit të deficitit buxhetor nga ky grup. Kursimet e individëve në depozita pranë sistemit bankar kanë fituar kthim të kënaqshëm. Interesi

mesatar i ponderuar për depozitat në lekë në muajin gusht shënoi 5.94 për qind ose 0.48 pikë përqindjeje më shumë se në fund të tremujorit të dytë. Rritja e tyre ka sjellë ulje të kostos së ndërmjetësimit në lekë gjatë muajve të fundit. Interesat për kredinë e re të akorduar në lekë tregojnë rënie në muajt korrik-gusht, mesatarisht në 12.86 për qind, 0.79 pikë përqindjeje nën nivelin mesatar të gjashtëmujorit të parë. Predispozita e sistemit bankar për lehtësimin e kostos së kredisë në lekë evidentohet nga ngushtimi i marzhit të saj me interesat referencë, bonot e thesarit. Kjo diferencë është ulur mesatarisht në 3.6 pikë përqindjeje në muajt e verës, nga 4.8 pikë përqindjeje në fillim të vitit.

Duke ju rikthyer vendimit të sotëm të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, më lejoni të theksoj se perspektiva afatgjatë e zhvillimit të ekonomisë shqiptare mbetet pozitive. Qëndrueshmëria makroekonomike dhe besimi në sistemin financiar shqiptar, para së gjithash janë rrjedhojë e politikave tona të përgjegjshme makroekonomike dhe financiare të ndërmarra në vazhdimësi këto vitet e fundit. Stabiliteti makrofinanciar është një pikënisje e mirë për nxitjen e zhvillimit të vendit në periudhën e ardhshme.

Në një masë të madhe, ky zhvillim do të varet nga aftësia e ekonomisë shqiptare për të tërhequr fonde të cilat do të mbështesin rritjen e saj. Lehtësimi i sotëm i kushteve monetare ndërmerret në përputhje me dinamikën e zhvillimeve ekonomiko-financiare në vend, në partnerët tanë kryesorë dhe më gjerë në ekonominë globale. Ky vendim përbën një stimul të ri për zhvillimet ekonomike në vend, duke synuar një ulje të mëtejshme të kostos së financimit të ekonomisë.

Në horizontin afatmesëm, ecuria e kreditimit të ekonomisë do të ketë një rëndësi prioritare. Banka e Shqipërisë gjykon se stabilizimi i treguesve të likuiditetit dhe atyre të bilancit të sistemit bankar duhet t'i hapë rrugë procesit të kreditimit. Në këtë drejtim, Banka e Shqipërisë ka marrë një rol aktiv nëpërmjet stimulimit si të kërkesës ashtu dhe të ofertës për fonde. Lehtësimi i kushteve monetare do të favorizojë rritjen e kërkesës së bizneseve dhe të konsumatorëve për fonde, ndërkohë që injektimet tona të likuiditetit i mundësojnë sistemit bankar t'i përgjigjet në aspektin sasior kësaj kërkese për fonde. Sistemi bankar shqiptar duhet ta kuptojë drejt rolin e tij, duke transmetuar të plotë dhe me shpejtësi këtë lehtësim të politikës monetare në ekonomi. Nga ana tjetër, një presion më i ulët i sektorit fiskal në tregjet financiare vendase në të ardhmen do të ulë primet e rrezikut në ekonomi, do të krijojë më shumë hapësira për kreditimin e sektorit privat të ekonomisë dhe do të favorizojë sheshimin e kurbës së normave të interesit, në favor të uljes së mëtejshme të kostos së kredisë. Efektiviteti i vendimit të sotëm do të varet nga sjellja e tregut dhe pjesëmarrësve në të, ku politika fiskale ka një rol parësor.

Në horizontin afatgjatë, tërheqja e investimeve të huaja direkte dhe e formave të tjera të hyrjes të qëndrueshme të kapitalit duhet të përbëjë një fokus më të madh të politikave tona të zhvillimit. Këto fonde i shërbejnë jo vetëm stabilitetit të pozicionit të jashtëm, por edhe rritjes së qëndrueshme e afatgjatë të vendit. Ka ardhur momenti që të gjithë aktorët duhet të analizojnë

me kujdes modelin e rritjes ekonomike të vendit në dekadën që po hyjmë. Në veçanti, modeli i ardhshëm i rritjes ekonomike duhet të faktorizojë më shumë avantazhet konkurruese të ekonomisë shqiptare, duke zbutur varësinë e saj nga flukset afatshkurtra hyrëse të kapitalit dhe duke zgjeruar bazën ekonomike e cila gjeneron flukse të qëndrueshme dhe afatgjata kapitali. Banka e Shqipërisë në periudhat që do të vijojnë mbetet e angazhuar që të jetë një zë i rëndësishëm në këtë drejtim.

Në zbatim të angazhimit tonë ligjor e institucional, politika monetare e Bankës së Shqipërisë do të synojë, krijimin e kushteve të përshtatshme për një zhvillim të ekuilibruar, të karakterizuar nga një inflacion i ulët i çmimeve të konsumit, luhatje të buta të treguesve monetarë dhe bilance të shëndosha të agjentëve makroekonomikë.

# FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z.ARDIAN FULLANI

Në konferencën ndërkombëtare për 10-vjetorin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës,
30 tetor 2009, Prishtinë

I nderuar Guvernator Rexhepi,
Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Është një kënaqësi për mua që marr pjesë në këtë konferencë jubilare, të organizuar në mënyrë kaq të përsosur nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, dhe që të jem dëshmitar i progresit të mahnitshëm, që ky institucion ka arritur në një periudhë kohore kaq të shkurtër, por intensive. Energjia dhe dëshira e personelit vendas për të kontribuar në historinë e këtij institucioni është kanalizuar në mënyrën e duhur nga vizioni dhe përvoja e mjaft profesionistëve drejtues, të cilët kanë dhënë një kontribut të çmuar në drejtimin e këtij institucioni gjatë viteve të fundit. Duke patur parasysh përkushtimin e nivelit drejtues të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për të arritur dhe vepruar në përputhje me standardet më të mira të organizimit dhe eficiencës në punë, duke zbatuar një politikë të qartë dhe afatgjatë të investimit në cilësinë e personelit të saj, si dhe duke mbështetur masa që kontribuojnë në ruajtjen e një bashkëpunimi të frytshëm ndërinstitucional, jam i sigurt se kjo histori do të vijojë të jetë e suksesshme.

Dëshiroj gjithashtu, të falenderoj organizatorët për nderin që më dhanë që të flas përpara jush sot, lidhur me një çështje kaq të rëndësishme gjatë vitit të fundit, pas kësaj krize të paprecedent financiare ndërkombëtare. Duke patur parasysh faktin, se shkaqet dhe pasojat e kësaj krize janë identifikuar dhe diskutuar gjerësisht, në pjesën e parë të fjalës sime do të përqendrohem më tepër në gjetjet kryesore të diskutimit profesional që po zhvillohet në ditët e sotme, me qëllim identifikimin e një përqasjeje të re të mbikëqyrjes financiare. Jam i sigurt, se këto aspekte do të diskutohen më tej gjatë punimeve të kësaj konference. Në pjesën e dytë të fjalës sime, do të përpiqem të ofroj informacione më të hollësishme mbi atë që ne, në Bankën e Shqipërisë, po mendojmë si një përqasje të ardhshme të autoriteteve publike dhe të industrisë financiare, në lidhje me masat e nevojshme për forcimin e stabilitetit financiar.

Shumë shkurt, do të doja të përsërisja atë që tashmë është bërë e qartë për të gjithë: kriza e fundit ishte një rrjedhojë e incentivave të gabuara, të cilat mbështetën një zhvillim të çekuilibruar të aktivitetit financiar dhe një vlerësim të gabuar të rrezikut, të çmimvënies dhe të administrimit. Këto incentiva të gabuara ishin të pranishme jo vetëm në industrinë dhe tregjet financiare, por edhe në bilancet e individëve, bizneseve dhe në mbarë vendet e tjera. Duke patur parasysh natyrën, përmasat dhe ndikimin e kësaj krize, jo vetëm mbi industrinë dhe tregjet financiare, por edhe mbi ekonominë reale, autoritetet publike në mjaft vende u detyruan të adoptonin masa të shpejta, të koordinuara dhe të jashtëzakonshme, si në fushën e politikës monetare,

ashtu dhe në atë fiskale. Bankat qendrore hoqën dorë nga pothuajse çdo kufizim; ato madje, adoptuan disa masa të pazakonta, me qëllim sigurimin e likuiditetit të mjaftueshëm dhe me kosto të ulët për tregjet financiare. Qeveritë e vendeve shfaqën një përkushtim të madh në drejtim të uljes së rrezikut sistemik, duke shpëtuar institucione të rëndësishme financiare, duke siguruar garanci për kredidhënien ndërbankare, duke rritur kufirin e sigurimit të depozitave të publikut etj. Këto masa, të cilat në shumicën e rasteve ishin të përkohshme, duket se kanë rezultuar të suksesshme në rikthimin e besimit të tregut dhe në orientimin e ekonomisë globale drejt rrugës së përmirësimit gradual të saj.

Duke u fokusuar në tregjet dhe institucionet financiare pas krizës, një numër çështjesh, të njohura më parë por shpeshherë të neglizhuara, janë rishfaqur, duke nxitur kështu reagimin serioz dhe gjithëpërfshirës nga ana e autoriteteve. Mjaft prej këtyre çështjeve lidhen me vetë aktivitetin financiar, ndërkohë që të tjerat lidhen më së shumti me ambientin ekonomik rrethues.

Mund të thuhet tani, se autoritetet mbikëqyrëse të tregjeve dhe institucioneve financiare janë pjesërisht përgjegjëse për atë që ndodhi. Pavarësisht retorikës, ato nuk arritën të identifikonin dhe kontrollonin rrezikun në industrinë financiare në mënyrën dhe në kohën e duhur. Këtu mund të përmenden: lehtësimi i kontrollit mbi huatë e marra nga bankat me qëllim financimin e kredive në monedhë të huaj në një juridiksion të caktuar, neglizhenca e treguar ndaj entiteteve me qëllim të posaçëm, të krijuara për të shmangur kërkesat prudente të bilancit financiar etj.. Ka mjaft arsye për këto dobësi dhe sipas mendimit tim, mjaft prej tyre shkojnë përtej kapaciteteve ligjore, logjistike dhe njerëzore të autoriteteve mbikëqyrëse për të vepruar. Nga ana e tyre, autoritetet mbikëqyrëse gabuan në mbështetjen e punës mbi konceptin e gabuar se institucionet financiare individualisht të forta janë të mjaftueshme për stabilitetin e të gjithë sistemit financiar. Duke vepruar kështu, ato nuk arritën të identifikonin efektet negative dhe çrregullimet, që rezultojnë si pasojë e sjelljes së pakoordinuar në grup të institucioneve financiare, shpeshherë si pasojë e prociklikalitetit që bartet nga vetë aktiviteti financiar dhe kuadri rregullativ. Vëmendja e mbikëqyrjes përqendrohej në sektorin bankar, ndërkohë që bashkëveprimit të tij me sektorin financiar jobankar i kushtohej një vëmendje e pamjaftueshme, në një kohë kur ky i fundit ishte shumë më pak i rregulluar e ndërkohë që rritej si në përmasë, ashtu dhe në rëndësi. Gjithashtu, si pjesë e objektivit të tyre të përgjithshëm dhe të mandatuar për të fokusuar përqasjen e tyre mbikëqyrëse në burimet më të rëndësishme të rrezikut të industrisë financiare, por gjithashtu si një shenjë e vështirësisë së tyre objektive për të qenë në një hap me zhvillimet dhe risitë në tregjet financiare, autoritetet mbikëqyrëse u mbështetën gjithnjë e më shumë në disiplinën e tregut dhe në modele të paqarta, komplekse dhe të sofistikuara të rrezikut të industrisë financiare, gjë e cila gjithashtu rezultoi të kishte mjaft mangësi. Në disa raste, struktura e autoriteteve mbikëqyrëse ka rezultuar e fragmentuar ose mjaft komplekse, duke nxitur kështu arbitrazh rregullativ nga ana e vetë aktorëve të tregut. Në të tjera raste, burimet e nevojshme për kryerjen me eficiencë të rolit mbikëqyrës kanë qenë të kufizuara, duke ndikuar negativisht mbi performancën e mbikëqyrësit.

Por, kjo krizë tregoi se rreziku buroi gjithashtu nga burime të tjera, jashtë kontrollit të drejtpërdrejtë të autoriteteve mbikëqyrëse në një juridiksion të caktuar. Për shembull, rritja e çmimit të aktiveve u nxit nga likuiditeti i bollshëm dhe nga kushtet e favorshme krediduese, të cilat shpesh ndikoheshin nga zhvillimet ndërkombëtare dhe nga flukset financiare. Huamarrja në tregjet ndërkombëtare nga institucionet financiare u ndikua gjithashtu dhe nga rritja e deficiteve fiskale dhe të atyre të llogarisë korente. Rritja e këtyre të fundit ishte rrjedhojë e politikave të gabuara, të cilat krijuan zhbalancime në sjelljen kursim-konsum të aktorëve më të rëndësishëm ekonomikë në ekonomi, përfshirë këtu edhe individët. Tashmë shtrohet pyetja nëse disa prej këtyre çështjeve mund të adresoheshin nga një rol më i fuqishëm i politikës monetare. Integrimi financiar, ndër të tjera, ka kontribuar gjithashtu në zgjerimin e shpejtë të aktivitetit financiar dhe mjaft institucione financiare janë shndërruar në institucione shumë të mëdha për një shtet të vetëm. Një gjë e tillë ka ndodhur në një kohë kur, për të njëjtën arsye, autoriteti "de facto" i rregullimit është zhvendosur nga mbikëqyrësit vendas drejt atyre të vendeve të origjinës. Kështu, pavarësisht tendencës së qëndrueshme të konvergimit ndërmjet legjislacionit financiar në shumë vende, ende mbeten ndryshime të theksuara të cilat, veçanërisht në një situatë krize, krijojnë tensione të mëdha midis autoriteteve publike në vende të ndryshme.

Autoritetet publike në mbarë botën po bëjnë përpjekje të mëdha për adresimin e çështjeve të lartpërmendura, me qëllim përmirësimin e standardeve dhe të superstrukturës mbikëqyrëse. Si Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ashtu dhe Bashkimi Evropian, po parashikojnë krijimin e institucioneve të veçanta, roli i të cilave do të jetë identifikimi dhe kontrolli i rrezikut sistemik, përmes një përqasjeje të ndryshme mbikëqyrëse për institucionet financiare me rëndësi sistemike. Në të njëjtën kohë, pritet që këto institucione financiare t'i nënshtrohen një kuadri më shtrëngues rregullativ, në drejtim të kërkesave të kapitalit dhe të likuiditetit, përbërjes dhe zgjerimit të bilancit, si dhe të marrëdhënieve në drejtim. Një tjetër fushë, e cila do t'i përballë autoritetet publike në mbarë botën me një sfidë akoma dhe më të madhe, është dhe rishikimi i procedurave të likuidimit për institucione të ngjashme financiare me prezencë në vende të tjera.

Qëllimi kryesor i reformës në kuadrin rregullativ financiar do të jetë akomodimi i incentivave të reja, të cilat do të krijojnë një mjedis akoma dhe më të përshtatshëm për administrimin e rrezikut në industrinë financiare. Parimi kryesor që ndiqet këtu është: "parandalimi është kura më e mirë". Në këtë drejtim, perimetri i kuadrit rregullativ mbikëqyrës do të zgjerohet më tej, me qëllim përfshirjen e institucioneve të tjera të rëndësishme jobankare dhe ka të ngjarë, edhe të kompanive bankare zotëruese. Kuadri i ri rregullativ pritet që gjithashtu, të prezantojë kërkesa më tepër automatike (dhe më pak fleksibile), duke synuar në të njëjtën kohë, më tepër thjeshtësi dhe qartësi. Zhvendosja drejt thjeshtimit dhe qartësisë do të ulë ndjeshëm mundësinë e manipulimit dhe do të përmirësojë transparencën dhe besueshmërinë e aktivitetit bankar dhe të atij financiar. Këto ndryshime do të plotësohen me ndryshime të ngjashme në fushën e mbrojtjes së konsumatorit dhe të transparencës së tregut. Kuadri rregullativ i industrisë financiare pritet që gjithashtu, të jetë

më pak prociklik, duke qenë se po identifikohen propozime të reja dhe mjaft interesante në drejtim të adoptimit të një përqasjeje kundërciklike për kërkesat e kapitalit, provigjonimin dhe kontabilitetin. Garantimi i drejtimit të përgjegjshëm për institucionet bankare dhe financiare do të jetë një fushë tjetër zhvillimi. Aktualisht, po identifikohen kërkesa të reja rregullative dhe instrumente, të cilat do të kërkojnë një nivel përfshirjeje dhe përgjegjësie më të madhe nga ana e bordit të drejtorëve, në drejtim të administrimit të rrezikut dhe të dekurajimit të sipërmarrjeve me rrezik të pakontrolluar. Nga ana tjetër, është e nevojshme që autoritetet mbikëqyrëse të forcojnë kapacitetet e tyre të vlerësimit të rrezikut makroprudencial, duke u përqendruar më tepër mbi sjelljet sistemike të institucioneve financiare. Banka qendrore pritet të marrë më tepër përgjegjësi në këtë drejtim, veçanërisht në ato vende ku ajo deri më tani, nuk ka patur një rol të madh mbikëqyrës. Pavarësisht përqasjes që do të adoptohet në këtë drejtim, mbikëqyrësit duhet të gëzojnë autoritet më të madh ligjor, i cili do t'u sigurojë ndërmarrjen e veprimeve në kohën e duhur dhe në mënyrë fleksibile. Siç e përmenda dhe më lart, procedurat për administrimin e institucioneve financiare në vështirësi dhe ato për administrimin e krizës duhet të rishikohen, me qëllim sigurimin e një bashkëpunimi më të madh dhe eficient ndërinstitucional dhe ndërkombëtar, si dhe për të zgjidhur më mirë konfliktin e mundshëm midis mbikëqyrjes ex-ante dhe ndërhyrjes ex-post.

Ky proces i rëndësishëm i reformës rregullative financiare nuk është pa risk. Unë besoj se autoritetet publike do t'i kushtojnë një vëmendje të veçantë kontrollit të tendencës së mbirregullimit dhe shmangies së adoptimit "të verbër" të ndryshimeve rregullative dhe përqasjes asimetrike/të njëanshme. Më tepër rregullim duhet të nënkuptojë rregullim më të mirë. Ndërmarrja e rreziqeve është diçka e natyrshme për industrinë bankare, duke patur parasysh rolin e saj të çmuar të ndërmjetësimit financiar. Nëse kjo ndërmarrje rreziku është e miridentifikuar dhe e administruar siç duhet, ajo ndihmon për rritjen e eficiencës dhe të kthimit të aktivitetit – dy elemente të rëndësishme këto për një performancë financiare të vazhdueshme, të shëndetshme dhe të qëndrueshme. Çdo shtet duhet të ndjekë me vëmendje të veçantë diskutimin dhe ndryshimet e propozuara për reformën në rregullimin financiar, duke qenë se ky proces pa dyshim do të ndikojë edhe mbi to. Në këtë aspekt, është e rëndësishme për autoritetet publike që të ndërmarrin një proces të analizimit dhe të vlerësimit të impaktit të ndryshimeve të propozuara, të pritshme dhe të miridentifikuara, në industrinë e tyre financiare. Pa dyshim, adoptimi praktik i ndryshimeve të propozuara duhet të orientohet nga objektivi për arritjen e një konvergimi më të madh me standardet ndërkombëtare, megjithatë ai duhet të përcaktohet edhe në varësi të karakteristikave të sistemit financiar kombëtar ose rajonal dhe të objektivave të tij të zhvillimit. Për më tepër, fokusimi në vetëm rregullimin sa më të mirë të industrisë financiare, pa adresuar në të njëjtën kohë zhvillime të tjera të rëndësishme dhe ndoshta të paqëndrueshme ekonomike, përfaqëson një përqasje asimetrike që nuk do të trajtojë në mënyrën e duhur rreziqet ndaj stabilitetit financiar. Në këtë kontekst, qeveritë, bizneset dhe individët duhet të identifikojnë dhe të marrin masa për reduktimin e zhbalancimeve në bilancet e tyre, duke qenë se nga ana tjetër, kjo do të përmirësonte cilësinë e industrisë financiare dhe do të reduktonte rrezikun.

Të nderuar pjesëmarrës,

Më lejoni tani të ndalem në mënyrën se si ekonomia shqiptare dhe sistemi ynë financiar u përball me krizën ndërkombëtare, si dhe disa nga masat që Banka e Shqipërisë i gjykon të rëndësishme për të ardhmen, me qëllim forcimin e stabilitetit të sistemit financiar dhe të ekonomisë shqiptare.

Kriza globale e kohëve të fundit tregoi se në kushtet e rritjes së integrimit financiar dhe thellimit të pandalshëm të globalizimit ekonomik, ekonomitë e vogla, si ajo e Shqipërisë apo e vendeve të tjera të rajonit, nuk duhet të mbështeten vetëm në mbrojtjen natyrale që vjen nga tregjet financiare më pak të zhvilluara dhe nga niveli shumë më i ulët i borxhit prej individëve dhe bizneseve, për të kompensuar me kalimin e kohës rreziqet potenciale, të cilat mund të vijnë nga rritja ekonomike më pak e diversifikuar, mbështetja e tepërt në dërgesat e emigrantëve, kultura e pamjaftueshme për menaxhimin e rrezikut në institucionet financiare dhe në agjentët e tjerë ekonomikë – veçanërisht rrezikun e kursit të këmbimit dhe të likuiditetit, si dhe hapësira shumë e kufizuar që kanë autoritet publike për të aplikuar masa financiare antikrizë të ngjashme me ato të vendeve të zhvilluara. Kështu, masat e politikës duhet t'i drejtojnë këto dhe mangësitë e tjera drejt gjetjes së një zgjidhjeje të përshtatshme në periudhën afatmesme. Këto masa duhet të pasqyrojnë përparësinë për veprime parandaluese.

Në fakt, gjatë 4 - 5 viteve të fundit, Banka e Shqipërisë është treguar vigjilente për identifikimin e fushave të veprimtarisë bankare që kërkojnë vëmendjen e industrisë. E kemi shprehur shqetësimin tonë lidhur me rritjen e shpejtë të kredidhënies, pasi besonim se kjo do të ndikonte negativisht në cilësinë e kredisë. Një shqetësim tjetër është edhe përbërja e portofolit të kredive, i cili mbizotërohet nga kredi në euro. Pavarësisht nga fakti se ky pozicion mbështetet nga prania e lartë e detyrimeve valutore në bilancet e bankave dhe nga lidhjet e fuqishme ekonomike me vendet e Zonën së Euros, si Italia dhe Greqia, Banka e Shqipërisë ka qenë e vendosur në përqasjen e saj për zbatimin gradual të masave rregullative, të cilat dekurajojnë rritjen e shpejtë të kredidhënies, nxitin bankat për të dhënë më shumë kredi në monedhën kombëtare dhe rritin transparencën ndaj klientëve të bankave për shërbimet dhe produktet bankare. Nga ana tjetër, politika monetare i ka ankoruar me sukses pritjet për një rritje të moderuar të nivelit të çmimeve dhe ka mbështetur kërkesën për mjete financiare të shprehura në monedhën kombëtare, duke ofruar kështu një fitim pozitiv real të mjaftueshëm.

Ndikimi i parë i krizës ndërkombëtare në ekonominë tonë u shfaq në bilancin e pagesave, duke pasqyruar marrëdhëniet e ekonomisë tonë me botën. Rritja e papunësisë dhe shtrëngimi i kushteve financiare në vendet fqinje të Bashkimit Evropian, u pasuan nga rënia e dërgesave të emigrantëve shqiptarë që jetojnë dhe punojnë në këto vende. Ndërkohë që hendeku ndërmjet kërkesës së brendshme dhe asaj të jashtme thellohej, kjo u shoqërua me një rritje të deficitit të llogarisë korente dhe shtim të presioneve mbi kursin e këmbimit. Në të njëjtën kohë, sektori bankar, që mbizotëron dukshëm sistemin financiar në Shqipëri, tkurri kontributin financues për ekonominë vendase si

përgjigje ndaj rritjes së kërkesës për likuiditet, pasojë e tërheqjes së depozitave nga publiku dhe e rritjes së kërkesës huamarrëse të Qeverisë. Gërshetimi i efekteve të këtyre zhvillimeve ndikoi negativisht në sektorin real të ekonomisë, veçanërisht në biznesin. Gjatë tremujorit të parë të këtij viti, indeksi i besimit të biznesit ra nën mesataren e tij historike, duke treguar për një situatë më të vështirë financiare. Kjo e fundit u pasqyrua edhe nga realizimi i të ardhurave fiskale në nivel më të ulët se plani, si dhe nga rënia e cilësisë së portofolit të kredive që sektori bankar ka hasur gjatë gjithë kësaj periudhe.

Në periudhën afatshkurtër, autoritetet publike morën masa për të zvogëluar ndikimin e krizës financiare globale në ekonomi. Nëpërmjet rritjes së konsiderueshme të pjesës së shpenzimeve fiskale të destinuar për investime, kryesisht në infrastrukturë, qeveria i dha një stimul të rëndësishëm sektorit real të ekonomisë për të përballuar efektet e krizës globale. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë ka qenë aktive për pajisjen e tregut ndërbankar me likuiditet, me qëllim ruajtjen e stabilitetit të sektorit bankar dhe minimizimin e rënies të rolit të saj ndërmjetësues. Ne hoqëm kufijtë sasiorë në madhësinë e injektimit të likuiditetit nëpërmjet marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes njëjavore dhe zgjatëm afatin e maturimit të instrumenteve të injektimit në tre muaj. Pas një uljeje të normës së interesit me 0.5 pikë përqindjeje në muajin janar dhe pas zbutjes së presioneve inflacioniste në vend, politika monetare i kushtoi një rëndësi të veçantë stabilitetit financiar, duke mbajtur të pandryshuar normën bazë të interesit për të gjithë periudhën.* Nëpërmjet kësaj politike, u synua që në periudhën afatshkurtër të mbështetej kërkesa për mjete financiare të shprehura në monedhën kombëtare. Njëkohësisht, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, Banka e Shqipërisë inicioi ndryshime legjislative për të rritur nivelin e sigurimit të depozitave, si një masë e domosdoshme për të rikthyer besimin e publikut për sigurinë e depozitave bankare. Nga këndvështrimi mbikëqyrës, Banka e Shqipërisë përforcoi kontrollin e përditshëm të zhvillimeve të sektorit bankar, duke u përqendruar veçanërisht në gjendjen e likuiditetit. Kjo ishte pjesë e një përqasjeje më të gjerë që përfshiu edhe ndryshimet në kuadrin rregullativ, komunikimin më të fuqishëm me sektorin bankar, rritjen e numrit të publikimeve dhe praninë më të madhe në media. Besojmë se këto politika ishin të rëndësishme për administrimin efektiv të nevojave të sektorit bankar për likuiditet. Ato ofruan një orientim të kreditimit drejt monedhës kombëtare dhe ndikuan në ruajtjen e parametrave të qëndrueshëm të kapitalizimit për bankat tona. Situata hyri në fazën e një përmirësimi cilësor, pas rifillimit të procesit të rritjes së depozitave të publikut pranë sektorit bankar. Ky proces, i cili u zhvillua në mënyrë graduale dhe të qëndrueshme në tremujorin e dytë të vitit 2009, vijon me ritme të kënaqshme.

Besojmë se, pas kapërcimit të efekteve afatshkurtra të krizës financiare globale dhe përmirësimit të situatës ndërkombëtare, autoritetet publike në vend duhet të nisin një proces vlerësimi të kuadrit të veprimeve ligjore dhe financiare, me qëllim rivendosjen e ekuilibrave në veprimtarinë fiskale,

** Dy ditë më parë, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi një vendim për uljen e mëtejshme të normës bazë të interesit me 0.5 pikë përqindje, duke e çuar atë në nivelin e ri prej 5.25 për qind.*

monetare e bankare, në mbështetje të një rritjeje të qëndrueshme ekonomike dhe ruajtjes së stabilitetit financiar. Për këtë arsye, është e rëndësishme që politika fiskale të ndërmarrë masat përkatëse korrektuese, në mënyrë që të forcojë besimin e agjentëve të tregut dhe të investitorëve, vendas dhe të huaj. Në të njëjtën kohë, politika monetare duhet të vlerësojë efektet e mundshme mbi inflacion të stimulit financiar që i është dhënë sektorit bankar dhe ekonomisë, si edhe të shqyrtojë më pas hapësirat që ekzistojnë për të mbështetur ndërmjetësimin financiar të sektorit bankar në ekonomi me një kosto më të ulët. Për t'i dhënë një përgjigje më afatgjatë rritjes së qëndrueshme ekonomike, autoritetet publike duhet të këmbëngulin për të hartuar dhe zbatuar strategji për zhvillimin e ardhshëm ekonomik, të cilat në afat të mesëm do të mundësonin:

a) Vendosjen e një ekuilibri më të mirë në kontributin që japin sektorë të ndryshëm për rritjen ekonomike. Në këtë drejtim, është e rëndësishme të rritet mbështetja për sektorët e ekonomisë me potencial të fuqishëm në rritjen ekonomike, si bujqësia dhe turizmi;

b) Rritjen e konkurrueshmërisë së ekonomisë tonë dhe formalizimin e mëtejshëm të saj. Në këtë drejtim, debatet duhet të përqendrohen në gjetjen e stimujve për të rritur prodhimin vendas dhe për të mbështetur kursimet e brendshme. Me kalimin e kohës këto do të përmirësonin bilancin e llogarisë korente dhe disponueshmërinë e mjeteve valutore;

c) Shtimin e burimeve të financimit. Në këtë drejtim, autoritetet duhet të zbatojnë politika që mbështesin zhvillimin e sektorit financiar jobankar dhe krijimin e tregjeve të kapitalit dhe të borxhit për subjekte private. Realizimi i këtyre objektivave do të kërkonte paraprakisht forcimin e standardeve të raportimit financiar, plotësimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor për zhvillimin e marrëdhënieve të biznesit, dhe mbrojtjen më të mirë të të drejtave të kreditorëve e të konsumatorëve, lidhur me institucionet dhe produktet financiare. Në terma më praktikë, këto masa pritet të zgjerojnë burimet e financimit për rritjen ekonomike dhe gradualisht të ulin varësinë e tij nga sektori bankar;

d) Përmirësimin dhe plotësimin e kuadrit ligjor dhe operacional për të forcuar kapacitetet e autoriteteve publike për përballimin me eficiencë të krizës. Në këtë kuadër, autoritetet publike duhet të identifikojnë masat e nevojshme për parandalimin, përballimin dhe eliminimin e pasojave të krizës financiare. Banka e Shqipërisë gjykon se secili autoritet publik, duhet të rivlerësojë kapacitetet dhe aftësitë e tij ligjore, financiare, njerëzore dhe teknologjike, për të përmbushur rolin e tij në situata të ngjashme krizash. Në të gjithë këtë proces, koordinimi ndërmjet autoriteteve publike duhet të jetë në nivelin më të lartë.

Edhe vetë industria bankare duhet të realizojë një rivlerësim të objektivave dhe formave të zhvillimit të veprimtarisë bankare në të ardhmen, me qëllim sigurimin e fitimeve të vazhdueshme dhe të qëndrueshme. Për rrjedhojë,

është e nevojshme që organet drejtuese të bankave të ndërmarrin një proces, me qëllim që: a) të rivlerësojnë përparësitë e zhvillimit; b) të vendosin një ekuilibër më të mirë në lidhje me burimet e të ardhurave dhe të kontrollojnë kostot; c) të orientojnë veprimtarinë e tyre drejt një specializimi më të madh dhe krijimit të përparësive konkurruese; d) të arrijnë një ekuilibër më të mirë përsa i përket përbërjes së mjeteve dhe detyrimeve të tyre sipas monedhës, sipas afatit të maturimit etj.; e) të ndjekin politika më aktive në drejtim të afrimit dhe mbajtjes së publikut (klientëve) pranë institucionit; f) të forcojnë strukturat e kontrollit të brendshëm dhe kapacitetet për punë kërkimore dhe për administrimin e rreziqeve.

Aktualisht, Banka e Shqipërisë po punon me synimin që, në hapësirën e nevojshme kohore dhe pas konsultimit me industrinë financiare, ta mbështesë këtë proces nëpërmjet prezantimit të ndryshimeve në kuadrin rregullativ dhe mbikëqyrës. Për këtë qëllim, synohet që në veprimtarinë bankare, të forcohen mekanizmat e brendshëm që ofrojnë stimuj për një zhvillim të ekuilibruar dhe të kontrolluar, me karakteristika të përshtatshme të likuiditetit dhe të kapitalizimit. Njëkohësisht, Banka e Shqipërisë, do të vlerësojë nevojën për një përqasje të re mbikëqyrëse ndaj bankave me rëndësi sistemike. Transparenca e veprimtarisë bankare në marrëdhëniet e saj me klientët dhe publikun në përgjithësi, do të mbetet në qendër të veprimtarisë mbikëqyrëse të Bankës së Shqipërisë. Në përgjithësi, në këtë proces, Banka e Shqipërisë do të mbajë në konsideratë ndryshimet që do të ndodhin në standardet evropiane, duke mbështetur bashkëpunimin e fuqishëm me bankat e tjera qendrore dhe me autoritetet e tjera mbikëqyrëse.

Në përfundim, më lejoni të theksoj se qëllimi final i ndryshimeve rregullative financiare që po identifikohen në nivel ndërkombëtar duhet të ofrojnë stimujt e duhur, të cilët me kalimin e kohës do të sigurojnë një veprimtari më të qëndrueshme, më të ekuilibruar dhe me më pak rrezik për institucionet dhe tregjet financiare në të ardhmen. Në nivel global dhe kombëtar, këto ndryshime duhet të plotësohen me masa të tjera ekonomike më të përgjithshme, që të mundësojnë një proces përshtatjeje, për të siguruar një pozicionim më të mirë të mjeteve dhe detyrimeve në bilancet e agjentëve të ndryshëm ekonomikë. E gjithë kjo duhet realizuar, ndërkohë që duhet të ruajmë përfitimet sociale që rrjedhin nga integrimi ekonomik dhe financiar. Kjo do të thotë që e ardhmja do të përballet me një përpjekje të vazhdueshme dhe sfiduese, për gjetjen dhe vendosjen e një ekuilibri të ri dhe më të përshtatshëm ndërmjet shkallës së rrezikut të marrë përsipër dhe fitimeve më të qëndrueshme nga agjentët ekonomikë, si dhe ndërmjet çështjeve kombëtare afatshkurtra dhe objektivave afatgjata të integrimit rajonal politik dhe ekonomik.

Edhe një herë i uroj Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, drejtuesve dhe stafit të saj suksese të mëtejshme.

Faleminderit për vëmendjen!

# FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z.ARDIAN FULLANI

Në forumin e Bankës së Shqipërisë me përfaqësuesit e bizneseve kryesore që operojnë në Shqipëri
23 nëntor 2009

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Është kënaqësi për mua të ndodhem sot mes jush, për të ndarë së bashku pikëpamjet tona mbi ecurinë aktuale dhe perspektivat e zhvillimit të ekonomisë shqiptare. Si pjesa më dinamike e ekonomisë shqiptare, kontributi juaj ka qenë i prekshëm në zhvillimin ekonomik të vendit gjatë viteve të tranzicionit. Iniciativa, vullneti dhe përkushtimi juaj, kanë sjellë rezultate të prekshme në zhvillimin e vendit. Në një shifër të vetme, ecuria e ekonomisë shqiptare mund të përmblidhet në rritjen mbi 65 për qind të prodhimit të brendshëm bruto dhe të mirëqenies për banor gjatë këtyre viteve tranzicion. Perspektiva jonë e zhvillimit mbetet po kaq pozitive. Stabiliteti makroekonomik i vendit, vazhdimi dhe thellimi i reformave strukturore, si dhe realitetet gjeopolitike të afrimit me ekonomitë e zhvilluara të Bashkimit Evropian, do të ndihmojnë në çlirimin dhe shpërblimin më të plotë të potencialit dhe të energjive tuaja.

Forumi i sotëm do të synojë të evidentojë zhvillimet ekonomike të vendit dhe do të ndërmarrë një diskutim të gjerë publik mbi alternativat e modeleve të rritjes ekonomike në të ardhmen.

Më lejoni fillimisht, të bëj një pasqyrë të shkurtër të zhvillimeve më të fundit në ekonominë shqiptare, për t'u ndalur më tej në disa pikëpamje tonat për zhvillimin ekonomik të vendit në të ardhmen.

## *ECURIA E EKONOMISË GJATË PERIUDHËS SË KRIZËS*

Zhvillimet e vitit 2009 kanë treguar se ekonomia shqiptare është ndikuar nga kriza globale e kohëve të fundit, kryesisht si pasojë e pakësimit të kërkesës së huaj dhe të remitancave, e rritjes së primeve të rrezikut, reduktimit të burimeve të financimit dhe rritjes së kostos së këtij të fundit. Megjithatë, ekonomia jonë vazhdoi të shënojë rritje ekonomike pozitive gjatë kësaj periudhe, ndërkohë që presionet e brendshme inflacioniste mbeten të kontrolluara. Aktiviteti ekonomik në vend është mbështetur nga stimuli fiskal dhe ruajtja e kërkesës konsumatore në nivele të qëndrueshme, ndërkohë që investimet dhe eksportet kanë shënuar rënie gjatë nëntëmujorit të parë të vitit.

Megjithëse pozitive, ecuria ekonomike e nëntëmujorit të parë të vitit karakterizohet nga një ngadalësim i ritmit të rritjes, duke u reflektuar edhe në rënien graduale të presioneve inflacioniste. Pavarësisht një korrektimi të lehtë gjatë vitit 2009, deficiti i llogarisë korente mbetet ende në nivele të larta, duke reflektuar konsumin e lartë të ekonomisë shqiptare dhe pamundësinë e

kapaciteteve prodhuese në vend për t'iu përgjigjur. Politika fiskale ka patur një natyrë ekspansioniste gjatë vitit 2009, e pasqyruar kryesisht në rritjen e shpenzimeve buxhetore, më së shumti si rezultat i rritjes së shpejtë të shpenzimeve kapitale.

Të ardhurat buxhetore kanë patur një ecuri më të ngadaltë se parashikimet, si pasojë edhe e ngadalësimit të ritmit të rritjes ekonomike gjatë kësaj periudhe.

Për rrjedhojë, shtimi i shpenzimeve buxhetore është financuar nëpërmjet përdorimit të të ardhurave të privatizimit dhe të rritjes së huamarrjes publike.

Kjo politikë ka ushtruar presion për rritjen e normave të interesit të letrave me vlerë të borxhit të qeverisë me afat të gjatë maturimi. Tregjet financiare janë karakterizuar nga përmirësimi i likuiditetit dhe rifitimi i besimit të agjentëve në to. Furnizimi i vazhdueshëm nga ana e Bankës së Shqipërisë të tregut të parasë nëpërmjet operacioneve për injektimin e likuiditetit, ka ndihmuar për të qetësuar pjesëmarrësit e tregut si dhe për të furnizuar tregun me fonde, të cilat i kanë shërbyer ndërmjetësimit në monedhën vendase për sektorin privat. Nevojat për likuiditet në tregun ndërbankar kanë rezultuar në ulje, duke mos ushtruar presion tek normat afatshkurtra të interesit.

Politika e matur monetare e Bankës së Shqipërisë ka ndihmuar në qetësimin e tensioneve në tregun financiar, ndërkohë që ulja e fundit e normës bazë të interesit duhet të përkthehet në kreditim më të madh të sektorit privat.

Ashtu si kemi deklaruar dhe më parë, Banka e Shqipërisë e shikon të ardhmen e vendit me optimizëm të kujdesshëm. Them me optimizëm sepse, me gjithë goditjen e madhe që pësuam, stabiliteti makroekonomik dhe financiar i vendit nuk u prekën. Për më tepër, rivendosja e besimit në sistemin bankar i hap rrugën rikuperimit të procesit të kreditimit dhe mbështetjes së ekonomisë me fonde. Nga ana tjetër, Banka e Shqipërisë mbetet ende në pozita kujdesi sepse rreziqet financiare mbi ekonominë nuk janë tejkaluar plotësisht. Sistemi bankar ka ende mungesa likuiditeti ndërsa ekonomia botërore mbetet e dobët. Për këtë arsye, zhvillimi i ardhshëm ekonomik do të varet si nga puna jonë e përbashkët, ashtu edhe nga ecuria e tregjeve ekonomike dhe financiare botërore.

Të nderuar pjesëmarrës,

Nën optikën e zhvillimit historik dhe sidomos të ngjarjeve të fundit, në vazhdim do të ndalem në disa probleme që ne, si autoritet politik, mbikëqyrës dhe rregullator, kemi evidentuar si mësime që duhen nxjerrë dhe çështje që duhen adresuar në zhvillimin e mëtejshëm ekonomik të vendit.

## *MËSIMET QË NXJERRIM NGA KRIZA*

Që në fillim, dua të theksoj se, në vija të përgjithshme, filozofia e zhvillimit ekonomik të vendit ka qenë e saktë. Hapja e tregjeve dhe rritja e konkurrencës

i kanë mundësuar ekonomisë shqiptare përfitimin e fryteve të iniciativës së lirë të sektorit privat. Praktika e ekonomive të bazuara mbi parimet e tregut të lirë, ka treguar gjerësisht se iniciativa private mbetet gjeneratori më eficient i aktivitetit ekonomik.

Ky proces është mbështetur nga reduktimi i vazhdueshëm i peshës së shtetit në ekonomi, si dhe nga përqendrimi i tij në prokurimin e të mirave publike dhe në zhvillimin e infrastrukturës. Zhvillimi progresiv i tregjeve financiare, ka gjeneruar fondet e nevojshme për mbështetjen e investimeve dhe të konsumit në ekonomi.

Megjithëse për arsye kryesisht historike, sistemi bankar e ka bazuar aktivitetin e tij në ndërmjetësimin e fondeve të brendshme të ekonomisë, zhvillimet e kohëve të fundit treguan se ai mbetet po aq i aftë në gjenerimin e fondeve të huaja në mbështetje të nevojave për likuiditet dhe kapital të ekonomisë shqiptare. Nga ana tjetër, integrimi i sistemit tonë financiar me atë evropian, ka rritur qëndrueshmërinë e ekonomisë shqiptare ndaj goditjeve të ndryshme, më e fundit nga të cilat është ende në veprim. Ai ka sjellë gjithashtu një ekspertizë të nevojshme në drejtim të administrimit financiar dhe atij ekonomik të një biznesi, ka zhvilluar infrastrukturën dhe mjetet e pagesave në ekonomi si dhe ka ndihmuar në transferimin efecient të rrezikut në ekonomi.

Me gjithë arritjet, personalisht gjykoj se modeli i zhvillimit të vendit ka nevojë për modifikime dhe përmirësime, të cilat duhet të synojnë rritjen e eficiencës dhe të qëndrueshmërisë së tij. Në kushtet e një ekonomie që kërkon dinamizëm për kalimin nga një ekonomi në tranzicion në një ekonomi në zhvillim, angazhimi për një zhvillim të qëndrueshëm dhe afatgjatë duhet të jetë kryefjala e reformave aktuale dhe të ardhshme ekonomike, si në nivel institucional e politik, ashtu edhe në nivel ndërmarrjeje dhe konsumatori.

## *CILAT JANË MANGËSITË E VËREJTURA NË KËTË DREJTIM?*

Së pari, përfituesit kryesorë të rritjes ekonomike kanë qenë konsumi i brendshëm dhe investimet, ndërkohë që ekonomia shqiptare nuk ka arritur ende të krijojë një sektor eksporti konkurrues, të aftë për të gjeneruar të ardhura të qëndrueshme valutore të cilat do të mundësojnë ruajtjen e balancave të jashtme ekonomike. Në një prizëm tjetër, ky zhvillim nuk duket i balancuar në terma sektorialë. Kështu, disa sektorë, si tregtia, ndërtimi dhe shërbimet kanë kontribuar në mënyrë disproporcionale në zhvillimin e vendit ndërsa të tjerë si, bujqësia dhe industria, më pak.

Së dyti, ekonomia shqiptare vazhdon të vuajë nga dobësi strukturore, të cilat tkurrin konkurrueshmërinë e saj në tregjet ndërkombëtare të produkteve dhe të kapitalit. Kjo sjellje ilustrohet edhe nga indekset e konkurrueshmërisë ndërkombëtare të përpiluar së fundmi nga Forumi Ekonomik Botëror, ku Shqipëria renditet poshtë vendeve të rajonit. Disa nga problemet më akute i referohen nevojës për përmirësimin e edukimit dhe zhvillimin e infrastrukturës,

në të gjitha dimensionet e saj. Të dy këto probleme frenojnë tërheqjen e investimeve të huaja dhe mbajnë mbrapa zhvillimin e vendit.

Së treti, dhe në nivel më mikro, eficienca e përdorimit të fondeve të ekonomisë duhet përmirësuar. Kjo nënkupton nevojën për përmirësimin e sistemeve të drejtimit dhe të kontrollit të bizneseve private, rritjen e aftësive parashikuese dhe analitike, si dhe rritjen e transparencës së tyre.

Më lejoni në vijim të ndalem pak më në detaje në çështjet e ngritura më sipër.

## *ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM EKONOMIK I VENDIT*

Ashtu siç e kemi theksuar në vazhdimësi në raportet tona periodike, rritja ekonomike e viteve të fundit është mbështetur fuqishëm në kreditimin e sistemit bankar. Shtesa e kredisë bankare ka dhënë një impuls prej mesatarisht 7 pikësh përqindjeje të PBB-së gjatë pesë viteve të fundit, duke kontribuar dukshëm në rritjen e konsumit dhe të investimeve në ekonomi. Rritja e tyre ka krijuar premisat për zgjerimin e bazës prodhuese dhe për rritjen e mirëqenies, por ajo ka sjellë edhe zhbalancime makro dhe mikroekonomike.

Në nivel makroekonomik, konsumi dhe investimet e larta u shoqëruan me forcim të presioneve inflacioniste, zgjerim të deficitit tregtar dhe të atij të llogarisë korente. Këto shenja mbinxehjeje ishin sinjale të qarta se ai nivel konsumi nuk mund të mbahej për shumë kohë, duke kërkuar eventualisht marrjen e masave frenuese nga autoriteti monetar.

Ky është çelësi për të kuptuar politikën tonë të kujdesshme monetare gjatë viteve 2006-2008. Investimi institucional që ne kemi bërë gjatë këtyre viteve në drejtim të konsolidimit të stabilitetit makroekonomik dhe financiar u shpërblye me një ndikim shumë më të butë se vendet e rajonit nga kriza botërore. Në përputhje me filozofinë moderne të administrimit makroekonomik, Banka e Shqipërisë mbetet e vendosur të mos lejojë që një rritje e shpejtë dhe afatshkurtër ekonomike të dëmtojë perspektivat afatgjata të zhvillimit të vendit.

Në nivel mikroekonomik, rritja e konsumit në ekonomi u shoqërua me rritjen e borxheve në bilancet e bizneseve dhe të familjeve shqiptare, si dhe me mbi-investime në sektorë të caktuar. Të dy këta tregues janë në nivele relativisht të ulëta krahasuar me vendet e rajonit apo ato në nivele të ngjashme zhvillimi, dhe nuk mund të cilësohen si problematike. Megjithatë, shkalla e shpejtë e rritjes së tyre të krijon idenë e një vizioni afatshkurtër nga agjentët ekonomikë dhe në raste të veçanta, edhe shmangie nga racionaliteti.

Duke qëndruar te konsumi familjar, Banka e Shqipërisë fton të gjithë agjentët ekonomikë të jenë më largpamës dhe realistë në planet e tyre të konsumit dhe të kursimit. Kjo ftesë nuk nënkupton tkurrjen e konsumit dhe as ndryshimin e preferencave për të, por thjesht vendosjen e tij në kontekstin e planeve

afatgjata që barazojnë të ardhurat me shpenzimet në nivel familjar. Përtej dimensionit kohor, siç jemi përpjekur vazhdimisht të tërheqim vëmendjen, kredimarrësit duhet të jenë të kujdesshëm edhe në monedhën e marrjes së kredisë.

Kjo do të thotë që mbrojtja më e mirë për ta do të ishte përputhja e monedhës në të cilën përftohet kredia me monedhën në të cilën kanë të ardhurat. Në një këndvështrim më pragmatist, kjo këshillë mund të reduktohet në një thirrje për një konsultë më të ngushtë me sistemin bankar dhe agjentët e specializuar të tregut financiar.

Kriza e fundit botërore tregoi me forcë, veçanërisht në SHBA dhe në Angli, se bilancet e dëmtuara të konsumatorit familjar janë premisë për goditje të forta ekonomike dhe kushtëzojnë rritjen afatgjatë të vendit. Nga ana tjetër, ajo ilustroi se vendet të cilat mundën të ruajnë një certifikatë të pastër të shëndetit financiar të konsumatorit, vende ndër të cilat futet edhe Shqipëria, patën një ndikim më të moderuar dhe gëzojnë premisa për një rritje më të shpejtë. Në një kuptim filozofik, mësimi bazë i ekonomisë së tregut është se çdo gjë që konsumohet do të paguhet: dreka falas nuk ka.

Duke u kthyer te bizneset dhe kredia për investime, portofoli i së cilës përbën edhe 2/3 e kredisë totale të sistemit bankar, mesazhi im është në thelb i njëjtë: rritni horizontin kohor të vendimmarrjes dhe të investimeve tuaja dhe mbështetini ato në analiza e plan-biznese të detajuara. Ajo që dua të theksoj është se ky mesazh duhet të perceptohet më me urgjencë nga ana juaj, pasi ju dispononi resurset e nevojshme financiare dhe njerëzore për të qenë më të kujdesshëm në huamarrje dhe në investime. Ka ardhur koha që bizneset shqiptare të shmangin sjelljen në grup, ku një ide biznesi ndiqet në mënyrë pothuajse automatike nga biznese të tjerë, pa studiuar madhësinë e tregut, avantazhet konkurruese, shkallën e ekspertizës, apo eficiencën financiare të përdorimit të fondeve, sipas të gjitha hallkave në të cilat duhet të kalojë një vendimmarrje e kujdesshme.

Tendenca e kohëve të fundit për diversifikimin e bizneseve shqiptare është një gjë e dobishme në parim, por ajo nuk duhet bërë në dëm të specializimit dhe uljes së eficiencës, apo aq më pak pa kryer analizat makroekonomike dhe sektoriale.

Një çështje tjetër që dua të diskutoj me Ju, të cilën e preka tërthorazi në ekspozenë fillestare të mësimeve të krizës, është edhe ecuria ndërsektoriale e ekonomisë.

Zhvillimi ekonomik i vendit është karakterizuar nga një model rritjeje e investimi i cili ka favorizuar bizneset e shërbimit dhe të ndërtimit, përkundrejt industrive eksportuese apo konkurruese me importet. Edhe pse kjo ecuri reflekton deri diku tendencën për të shkuar drejt strukturës ekonomike të vendeve të zhvilluara, ajo ka rezultuar në mbi-investime në sektorë të caktuar. Zhvillimi i ekonomisë nuk mund të jetë i qëndrueshëm në qoftë se alokimi i fondeve nuk realizohet duke ndjekur produktivitetin dhe parimin e eficiencës

sektoriale. Keqpërdorimi i fondeve financiare dëmton agjentët dhe të gjithë ekonominë, duke lënë pasoja afatgjata në bilancet dhe borxhet e kompanive, në tregun e punës dhe në shpërndarjen e kapitalit dhe teknologjisë midis sektorëve në ekonomi.

Për të minimizuar këto lloj rreziqesh, Banka e Shqipërisë ju këshillon që të ndërprisni lëvizjet inerciale në sjelljet tuaja dhe të vlerësoni me realizëm kontekstin rajonal dhe evropian të zgjedhjeve tuaja. Avantazhet krahasuese të Shqipërisë nuk duhen kërkuar vetëm në pasuritë e mbitokës dhe të nëntokës, apo në plotësimin e kërkesave ende të pashërbyera të tregut shqiptar, por edhe në forcën e lirë punëtore të vendit dhe në pozicionimin e tij si një anëtar i ardhshëm i Bashkimit Evropian. Ndërveprimi në rritje me sistemin bankar do të ndihmonte qartësimin e planeve tuaja dhe do të ulte rrezikun financiar, duke ju krijuar juve mundësinë të fokusoheni në administrimin e rrezikut të biznesit për të cilin edhe jeni të specializuar.

Për ta mbyllur diskutimin tim në lidhje me zhvillimin e qëndrueshëm të vendit, dëshiroj të theksoj se edhe sistemi bankar mund dhe duhet të bëjë më shumë në këtë drejtim.

Sistemi financiar është truri i një ekonomie tregu; ai i cili përcakton kthimin dhe rrezikun e pritur të investimeve në ekonomi duke mundësuar pastaj edhe përdorimin prioritar të fondeve të kufizuara financiare. Me gjithë performancën e tij të mirë, sistemi bankar shqiptar duhet të bëjë më shumë për të inkuadruar në vendimmarrjen e tij analizat makroekonomike dhe ato në nivel sektorial, si dhe stabilitetin financiar të vendit. Zhvillimi i njësive të kërkimit brenda bankave të mëdha është tashmë një kërkesë e kohës. Gjithashtu, përpjekje më të mëdha duhen bërë për të rritur mbështetjen me fonde të bizneseve të vogla dhe të mesme. Po ashtu, marketimi më agresiv i instrumenteve derivative të cilat do të ulin rrezikun financiar të bizneseve, veçanërisht të atyre që operojnë në sektorin e eksportit, duhet të ketë një vëmendje më të madhe nga sistemi bankar.

Këto që sapo përmenda do të jenë një pjesë e rëndësishme e filozofisë së ardhshme të Bankës së Shqipërisë në fushën e reformave strukturore në tregun financiar dhe në zhvillimin e funksionit të saj mbikëqyrës dhe rregullues në të.

## *DOBËSITË STRUKTURORE DHE NEVOJA PËR REFORMA*

Një mësim i vlefshëm që Banka e Shqipërisë ka nxjerrë nga kriza është nevoja për vazhdimin dhe thellimin e reformave strukturore në ekonomi, Këto reforma, jo vetëm që krijojnë një ambient më të përshtatshëm për zhvillimin e sipërmarrjes private, por ato rritin edhe qëndrueshmërinë e ekonomisë ndaj goditjeve. Ato ndihmojnë gjithashtu edhe në thithjen e investimeve të huaja direkte, të cilat janë mbështetësi më i mirë i zhvillimit të vendit në periudhën afatmesme dhe afatgjatë. Megjithatë, siç theksohet edhe në raportin e BERZH, Shqipëria është nga vendet e pakta që ka vazhduar reformat strukturore edhe gjatë vitit 2009.

Në këtë drejtim, Shqipëria mbetet ende mbrapa vendeve të rajonit, duke tërhequr në total vetëm rreth 1100 USD për frymë investime të huaja direkte gjatë 20 viteve tranzicion.

Në gjithë kuadrin e gjerë të problemeve të reformës, dëshiroj të ndalem sot në nevojën për investime në edukim dhe në infrastrukturë. Një parim i njohur biznesi thotë se pasuria më e çmuar e një ndërmarrjeje janë punonjësit e saj. Ne në Bankën e Shqipërisë e kuptojmë: Sa më i lartë të jetë profesionalizmi aq më e lartë është pavarësia jonë institucionale.

Në një shkallë më të madhe, kjo vlen edhe për ekonomitë kombëtare. Progresi i vendit tonë, konvergjenca me vendet e zhvilluara të Evropës Lindore dhe më tej me ato të Bashkimit Evropian, do të varet nga shkalla jonë e arsimit dhe e edukimit dhe nga krijimi i një tregu pune të lirë dhe konkurrues. Konkurrenca në tregjet kombëtare dhe ndërkombëtare bazohet mbi të gjitha në gjenerimin e ideve dhe zbërthimin e tyre në produkte përfundimtare. Duke iu referuar përsëri Indeksit të Konkurrueshmërisë Botërore, Shqipëria renditet e 90-a në shkallën e edukimit dhe trajnimit të lartë, dhe vetëm e 109-a dhe e 126-a respektivisht në shkallën e sofistikimit të biznesit dhe të inovacionit. Këto mangësi do të fillojnë të bëhen gjithnjë e më tepër pengesë në rritjen ekonomike të vendit në të ardhmen, nëse nuk adresohen shpejt dhe në kohën e duhur.

Reformat publike të sistemit arsimor dhe nevoja për mbështetje më të madhe me fonde të tij duhet të jenë një përparësi e çdo politike zhvillimi. Nga ana tjetër, gjykoj se edhe biznesi shqiptar mund dhe duhet të bëjë më shumë për të mbështetur arsimin shqiptar. Së pari, biznesi mund dhe duhet të mbështesë më shumë institucionet e edukimit të lartë, duke bashkëpunuar njëkohësisht me to në fushën e studimeve të tregut dhe të trajnimit të studentëve. Historia e zhvillimit ekonomik ka treguar se vendet që kanë investuar në edukim janë sot në grupin e vendeve më të zhvilluara të ekonomisë botërore. Së dyti, gjykoj se më shumë përpjekje duhen bërë në thithjen e trurit në administrimin e bizneseve tuaja.

Investimi në edukim dhe në rritjen e profesionalizmit është investimi më i mirë që mund të bëjmë së bashku për të ardhmen e vendit.

Paralelisht me këtë, përmirësimi sasior dhe cilësor i infrastrukturës sonë të zhvillimit, duhet të jenë çështje me vëmendje prioritare. Përtej zhvillimit të infrastrukturës rrugore, e cila me të drejtë është një përparësi e sektorit publik, biznesi shqiptar mund dhe duhet të bëjë më shumë në këtë drejtim. Shfrytëzimi i resurseve të përbashkëta të bizneseve për të ndërtuar zgjidhje të përbashkëta të problemeve në furnizimin me energji elektrike, me ujë e kanalizime, dhe me rrugë lokale, duhet të konsiderohet si një opsion efektiv i tejkalimit të këtyre problemeve. Krijimi i zonave të diferencuara dhe të specializuara të zhvillimit, do iu krijojë atyre më shumë mundësi për të përfituar nga ekonomitë e shkallës dhe zgjidhjen e përbashkët të problemeve. Gjithashtu, infrastruktura informatike dhe ajo e telekomunikimit janë sektorë të cilët mund dhe duhen të adresohen më me eficiencë nga sektori privat.

*ADMINISTRIMI DHE TRANSPARENCA E BIZNESEVE*

Megjithëse një pjesë të problemeve i preka dhe më lart, dëshiroj të ndalem edhe për një moment në problemin e përmirësimit të cilësisë së administrimit dhe të rritjes së transparencës së bizneseve.

Administrimi i biznesit është ura lidhëse midis ideve dhe rezultateve. Ai ndikon eficiencën e përdorimit të fondeve dhe përcakton bizneset fituese nga ato jofituese.

Në këtë aspekt, gjykoj se çështjet e përmendura më sipër, rritja e horizontit kohor të investimeve, mbështetja e tyre në studime tregu dhe në plan-biznese të kujdesshme, orientimi i pozicionit të biznesit në kontekstin kombëtar, rajonal dhe global, rritja e specializimit dhe profesionalizimit, forcimi i bashkëpunimit me sistemin financiar, kërkojnë investime të vazhdueshme në drejtim të administrimit tuaj.

Së fundi, një aspekt që mendoj se meriton vëmendje më të madhe është edhe transparenca e bizneseve tuaja. Rritja e saj do të ndihmonte më së pari transaksionet tregtare dhe financiare midis bizneseve, duke rritur besimin dhe duke ulur rrezikun në to. Gjithashtu, lidhja e qëndrueshme dhe afatgjatë me sistemin financiar ka si kusht transparencën e dyanshme të palëve. Përtej marrëdhënieve me sistemin bankar, problemi i transparencës është një pengesë serioze në krijimin dhe funksionimin e tregut të kapitaleve në Shqipëri. Në këtë drejtim, mendoj se biznesi shqiptar duhet të ndërgjegjësohet se rritja e transparencës dhe e formalizimit janë në interesin e tij afatgjatë.

Të nderuar pjesëmarrës,

Vizionet afatgjata përkthehen në sukses nëpërmjet punës dhe sakrificave afatshkurtra. Banka e Shqipërisë ju fton të punojmë së bashku dhe në interes reciprok në zgjidhjen e këtyre problemeve.

Ju faleminderit!

# FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z.ARDIAN FULLANI

Në konferencën për shtyp mbi vendimmarrjen e politikës monetare të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë
25 nëntor 2009

Në mbledhjen e tij të datës 25 nëntor 2009, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë mori në shqyrtim Raportin Mujor të Politikës Monetare për muajin nëntor. Pasi u njoh me zhvillimet më të fundit ekonomike dhe financiare në vend dhe në përfundim të diskutimeve mbi ecurinë e pritshme të tyre në të ardhmen, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendosi të mbajë të pandryshuar normën bazë të interesit, në nivelin 5.25 për qind. Këshilli Mbikëqyrës vlerëson se kjo normë interesi është në përputhje me synimin e Bankës së Shqipërisë për mbajtjen e inflacionit afër nivelit objektiv të Bankës së Shqipërisë në një periudhë afatmesme.

Zhvillimet ekonomike e monetare të muajve të fundit janë karakterizuar nga presione të ulëta inflacioniste. Inflacioni vjetor i çmimeve të konsumit në muajin tetor shënoi vlerën 2.3 për qind, duke qenë pothuajse në linjë me ecurinë e tij gjatë tremujorit të fundit. Ecuria e qëndrueshme dhe në nivele të ulëta e inflacionit është kushtëzuar nga presionet e moderuara që vijnë nga ekonomia e brendshme, si pasojë e:

- ngadalësimit të aktivitetit ekonomik gjatë kësaj periudhe;
- përcjelljes së ulët të nënçmimit të kursit të këmbimit në çmimet në lekë të mallrave të importit;
- si dhe e pritjeve të stabilizuara inflacioniste.

Lehtësimi i kushteve monetare nga Banka e Shqipërisë, nëpërmjet uljes së normës bazë të interesit në muajin tetor si dhe vazhdimit të operacioneve injektuese të likuiditetit, kanë dhënë impulset e duhura për nxitjen e aktivitetit ekonomik në të ardhmen. Këto impulse, si gjithnjë, administrohen në kushtet e një ecurie të pritshme të inflacionit afër objektivit 3 për qind të Bankës së Shqipërisë, si dhe pritjeve të stabilizuara të agjentëve ekonomikë për të. Ulja me 0.5 pikë përqindjeje e normës bazë nga Banka e Shqipërisë në fund të muajit tetor synon forcimin e kërkesës së brendshme dhe rigjallërimin e kreditimit. Efekti i këtij sinjali në ekonomi nuk është shfaqur ende i plotë, si pasojë e kohës së shkurtër dhe vonesave kohore në transmetimin e politikës monetare. Megjithatë, përcjellja e tij në tregun e parasë, hallkën e parë të zinxhirit të transmetimit, është premisë për reflektimin e tij në koston e kredisë në një kohë të dytë. Ndërkohë, operacionet tona injektuese të likuiditetit kanë qenë të suksesshme në garantimin e mbështetjes së ekonomisë me fonde, kryesisht afatshkurtra, gjatë kësaj periudhe.

Më lejoni të bëj një përshkrim më të detajuar të zhvillimeve ekonomike e monetare gjatë kësaj periudhe.

Në rang botëror, aktiviteti ekonomik është mbështetur nga përmirësimi i klimës së përgjithshme ekonomike, i cili ka ndikuar në përmirësimin e aktivitetit ekonomik botëror, uljen e primeve të rrezikut dhe qëndrueshmërinë e tregjeve financiare globale. Megjithatë, ekonomia botërore dhe ajo evropiane vazhdojnë të shfaqin dobësi ekonomike të cilat transmetohen më tej në presione të ulëta inflacioniste. Kjo situatë kushtëzon edhe ndjekjen e një politike monetare dhe fiskale stimuluese, nëpërmjet ruajtjes së normave të interesit në nivele minimale historike dhe injektimeve të larta të likuiditetit.

Duke u kthyer tek ekonomia e brendshme, duhet thënë se të dhënat e reja ekonomike kanë qenë të pakta gjatë muajit tetor. Zhvillimet në inflacion, ato në treguesit monetarë dhe fiskalë, të dhënat e tregtisë së jashtme si dhe indekset e besimit të biznesit dhe të konsumatorit, konfirmojnë se ekonomia shqiptare vijon të shënojë ritme pozitive rritjeje ekonomike. Kjo rritje është mbështetur nga ruajtja e niveleve të qëndrueshme të kërkesës konsumatore dhe stimuli fiskal i dhënë gjatë vitit 2009. Megjithatë, të dhënat e disponueshme ekonomike flasin për një ngadalësim të aktivitetit ekonomik gjatë vitit 2009. Kërkesa e jashtme për produktet shqiptare është reduktuar, sikurse ilustrohet edhe nga ngadalësimi i eksporteve gjatë kësaj periudhe, ndërsa investimet paraqiten në rënie.

Prirja e qëndrueshme e inflacionit bazë dhe vlerat e ulëta të atij të mallrave të patregtueshme tregojnë gjithashtu praninë e presioneve të ulëta inflacioniste të gjeneruara nga krahu i kërkesës agregate në ekonominë e vendit gjatë periudhës janar-tetor 2009. Kjo ecuri ka kontribuar në amortizimin e goditjeve të gjeneruara nga inflacioni i sektorit të tregtueshëm të mallrave për shkak të dobësimit të pozitave të monedhës vendase në tregun e brendshëm të këmbimeve valutore.

Inflacioni gjatë vitit 2009 është luhatur rreth kufirit të poshtëm të objektivit të Bankës së Shqipërisë. Inflacioni vjetor në muajin tetor rezultoi 2.3 për qind, duke shënuar një rritje të lehtë në krahasim me muajin shtator, por duke qëndruar poshtë niveleve të vërejtura një vit më parë. Inflacioni mesatar vjetor shënoi 2.1 për qind, duke qëndruar në të njëjtin nivel me atë të muajit shtator. Paralelisht me faktorët e kërkesës, ecuria e inflacionit është mbështetur edhe nga zhvillimet e disa faktorëve të ofertës, si tendenca e lehtë rënëse në koston e punës për njësi, rëniet në çmimet e importit dhe prodhimit, efekti statistikor i çmimeve të administruara, duke krijuar një ambient të përgjithshëm me presione të reduktuara inflacioniste.

Politika fiskale, gjatë tremujorit të tretë të vitit 2009 ka treguar shenja të zbutjes së karakterit të saj ekspansionist. Të ardhurat kanë shënuar një rritje të lehtë krahasuar me muajt paraardhës, ndërkohë që vihet re një ulje e ritmit të kryerjes së shpenzimeve. Në terma vjetorë, gjatë nëntë muajve të parë të vitit, të ardhurat buxhetore kanë shënuar një rritje prej 6 për qind kurse shpenzimet buxhetore prej rreth 22 për qind. Deficiti buxhetor mbetet në nivele krahasimisht të larta historike, por brenda limiteve të buxhetit të rishikuara së fundmi.

Në një masë të madhe, ky deficit reflekton nivelin e lartë të shpenzimeve kapitale publike gjatë vitit 2009. Shpenzimet publike dhe politika fiskale ekspansioniste kanë dhënë një kontribut të prekshëm në ruajtjen e aktivitetit ekonomik gjatë kësaj periudhe, por ato janë shoqëruar edhe me rritjen e presioneve në tregjet monetare. Banka e Shqipërisë gjykon se politika fiskale duhet të vijojë të jetë e kujdesshme ndaj këtyre balancave në të ardhmen, si dhe të faktorizojë qëndrueshmërinë afatgjatë fiskale në hartimin dhe zbatimin e planeve buxhetore afatmesme dhe afatgjata.

Aktiviteti i tregtisë së jashtme është karakterizuar nga dobësimi i vëllimit tregtar gjatë nëntë muajve të parë të vitit. Megjithatë, vlera e shkëmbimeve tregtare e shënuar gjatë muajit shtator është më e larta e regjistruar që prej fillimit të vitit 2009. Pas afro tre muajsh ngushtimi të vazhdueshëm, deficiti tregtar këtë muaj u zgjerua me rreth 9 për qind në terma vjetorë. Eksportet shënuan një reduktim të vlerës së tyre me rreth 18 për qind në terma vjetorë, ndonëse pozita e dobët e monedhës vendase kundrejt monedhës së përbashkët evropiane është faktor favorizues për eksportuesit. Importet drejt vendit tonë kanë shënuar ritme pozitive rritjeje për herë të parë që prej muajit janar të këtij viti. Në terma vjetorë, ato u rritën me përafërsisht 1 për qind, shkaktuar nga norma pozitive e rritjes së importit të mallrave për konsum, ndërkohë që importet e mallrave të ndërmjetëm dhe ato kapitalë kanë rënë.

Treguesit monetarë të muajit shtator paraqesin një ecuri më të ngadaltë të aktivitetit ndërmjetësues të sistemit bankar. Në terma vjetorë, paraja e gjerë ka shënuar një rritje nominale prej 2.8 për qind në muajin shtator, kundrejt vlerës 4.5 për qind të shënuar në muajin gusht.

Kontraktimi i aktivitetit kreditues në valutë si dhe ndërmjetësimi i huadhënies së sektorit publik nga agjentë jobankarë, ka ndikuar në ngadalësimin e ritmeve të rritjes së treguesve monetarë.

Në muajin shtator, portofoli i kredisë për ekonominë është rritur me ritme më të ulëta krahasuar me muajt e mëparshëm. Ritmi vjetor i rritjes së kredisë zbriti në nivelin 13.2 për qind. Ngadalësimi i kredisë është thuajse tërësisht pasojë e tkurrjes së kredisë në valutë, ndërkohë që kredia në lekë u rrit me 31 për qind në terma vjetorë. Pjesa më e madhe e kredisë së re, rreth 85 për qind e saj, është thithur nga bizneset dhe ka shkuar kryesisht për të mbuluar nevojat për likuiditet ndërsa kredia për investime afatgjata paraqitet e reduktuar. Gjithashtu, rritja e portofolit të kredisë për individë është zvogëluar, kryesisht si pasojë e tkurrjes së kredisë për konsum. Kredia për shtëpi dhënë individëve vazhdon të ruajë ritme rritjeje pozitive, duke mbetur në nivelin 5 për qind në terma vjetorë.

Ndërmjetësimi i kredisë së brendshme tërësisht në lekë ka rritur nevojën e pranisë së Bankës së Shqipërisë në injektimin e likuiditetit. Nevojat për likuiditet në sistemin bankar janë plotësuar nga operacionet në treg të hapur të Bankës së Shqipërisë, duke ruajtur një strukturë të përshtatshme kohore të këtij injektimi. Normat afatshkurtra të interesit në tregun ndërbankar kanë reflektuar uljen e kostos huamarrëse nga banka qendrore dhe kanë

qenë të qëndrueshme. Më tej, tregu primar ka dëshmuar për një reagim të agjentëve në vendosjen e çmimit të huadhënies duke reduktuar yield-in e bonove të thesarit. Yield-i 12-mujor, i cili shërben shpesh si normë referencë në përcaktimin e kostove të tjera, ka zbritur me 0.15 pikë përqindjeje gjatë muajit nëntor, duke arritur në nivelin 9.28 për qind.

Oferta për financimin e kërkesës së qeverisë ka qenë e mjaftueshme duke mos ushtruar presione rritëse mbi interesin. Ecuria e normave të interesit të depozitave të reja në lekë dhe në euro ka rezultuar gjithashtu e qëndrueshme gjatë muajit shtator, duke mundësuar kthimin e depozitave në sistem. Ndërkohë, interesat për kreditë e reja në lekë dhe në valutë vazhdojnë të mbartin politikat shtrënguese të kredidhënies nga sistemi bankar në përgjithësi dhe luhaten nga politika të izoluara preferenciale.

Në përfundim të diskutimeve, Këshilli Mbikëqyrës ra dakord të mbajë të pandryshuar normën bazë të interesit. Ky vendim synon ruajtjen dhe konsolidimin e mëtejshëm të ekuilibrave makroekonomikë, duke e konsideruar qëndrueshmërinë makroekonomike si një parakusht të domosdoshëm për një rritje të qëndrueshme dhe afatgjatë. Ai gjithashtu garanton mbështetjen e duhur monetare për ekonominë në këtë fazë të zhvillimit të saj. Në të ardhmen, Banka e Shqipërisë mbetet e gatshme të veprojë në linjë me ecurinë e faktuar dhe të pritshme të treguesve ekonomikë. Zhvendosja në kahun rënës e balancës së rreziqeve inflacioniste, konsolidimi i stabilitetit financiar dhe i pritjeve inflacioniste në ekonomi do të faktorizohen në vendimmarrjen e ardhshme të Bankës së Shqipërisë.

# FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z.ARDIAN FULLANI

Në takimin "Ndërtimi i kapaciteteve për hartimin dhe zbatimin e politikave"
3 dhjetor 2009

Të nderuar pjesëmarrës,

Është kënaqësi e madhe për mua të hap punimet e këtij takimi dyditor me temë "Ndërtimi i kapaciteteve për hartimin dhe zbatimin e politikave", të cilin Banka e Shqipërisë e organizon për herë të parë në Shqipëri në bashkëpunim me Qendrën e Ekselencës Financiare në Lubjanë (CEF), si dhe me mbështetjen e Komisionit Evropian, Bankës Qendrore Evropiane dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar. Duke ju uruar mirëseardhjen në qytetin e Tiranës më lejoni të shpreh falenderimet e mija për punën e jashtëzakonshme që CEF ka kryer gjatë këtyre viteve në dobi të vendeve të rajonit tonë.

Qysh nga takimi i muajit prill në qytetin e Uashingtonit, efektet e krizës globale shtuan praninë e tyre në rajonin tonë. Megjithatë, siç e kam theksuar dhe herë të tjera, ato nuk shkaktuan probleme të menjëhershme dhe të mëdha ekonomike dhe financiare. Shtrirja e ndikimeve të krizës në sektorin e ekonomisë reale, në buxhetet qeveritare si dhe në sektorët financiarë të rajonit, u pengua nga politikat e shëndosha makroekonomike të ndërmarra vitet e fundit si dhe nga mbështetja e pashembullt me fonde nga ana e FMN-së, në bashkërendim me Komisionin Evropian dhe BERZH-in.

Për shkak të kësaj ndërhyrjeje, por kryesisht për meritë të politikave shumë të kujdesshme të ndjekura prej bankave qendrore në lidhje me stabilitetin financiar dhe mbikëqyrjen financiare, rajoni shmangu jo vetëm krizat binjake të sistemit bankar dhe të tregut valutor, por edhe çdo formë tjetër kolapsi.

Megjithatë, kriza ka qenë një alarm zgjimi. Ne e pranuam këtë gjë në takimin tonë në Uashington gjatë muajit prill, me politikëbërësit e nivelit të lartë nga rajoni, nga BE-ja dhe nga institucionet financiare ndërkombëtare.

Tashmë që ne kemi arritur të shmangim krizën, duhet të nisim vlerësimin e dëmeve anësore që ka shkaktuar reagimi ynë ndaj presioneve të krizës. Në këtë drejtim, është shumë e rëndësishme të vlerësojmë jo vetëm qëndrueshmërinë afatgjatë të ekuilibrave të rajonit, por duhet të analizojmë me kujdes dhe efektivitetin e politikave tona afatshkurtra. Unë e vlerësoj thelbësor planifikimin dhe zbatimin e lëvizjeve tona të së ardhmes në mënyrë inteligjente për kthimin e krizës në drejtim të kundërt, drejt normaliteteve të reja.

Ndërkohë që ende nuk jemi jashtë rrezikut, është e rëndësishme të sigurohemi që oreksi i madh fiskal i vitit të kaluar që karakterizoi tërë rajonin, nuk do të vazhdojë të jetë fenomen mbizotërues i këtij normaliteti të ri. Aksioni ynë i momentit duhet të ndalet imtësisht në gjykimin e thellë të secilit prej

elementeve të veçanta të regjimeve të politikave tona, duke filluar që nga hartimi i politikave monetare e duke vazhduar me ankorimin e tyre si dhe ndërtimin e kapaciteteve të nevojshme për efikasitet më të madh të politikës monetare në të ardhmen.

Janë këto argumentet për të cilat ne ramë dakord që të organizojmë këtë takim të sotëm, vazhdim i një procesi të pandërprerë reflektimi dhe reformash.

Në diskutimet tona këtu në Tiranë, do të trajtojmë fillimisht çështje që lidhen me hartimin e politikës, të cilat janë themelore për të përgatitur kushtet për kalimin te çështjet e tjera. Kemi sugjeruar paraprakisht disa pyetje që mund të inkurajojnë diskutimin, duke mbuluar disa nga çështjet kyçe që si profesionist i fushës, më kanë mbetur në mendje pas një lundrimi të gjatë nëpër krizë.

Çështjet e hartimit të politikës përfshijnë pyetjet si: Sa hapësirë ka pasur për të manovruar në përdorimin e masave të veprimit të politikës në nivel makro? Sa larg (në të ardhmen) duhet që politika fiskale të ndërtojë një amortizator kundër rreziqeve makro-financiare? Deri ku kanë qenë në gjendje regjimet mbikëqyrëse dhe ato të politikës monetare të na mbrojnë nga kriza? Dhe, a ka nevojë të tërheqim lloje të reja fluksesh kapitali – ndoshta për të ndryshuar modelin e rritjes në rajon?

Ky diskutim lidhur me hartimin e politikës do të na çojë tek çështja e dytë, e cila përfshin rolin e ankorave të jashtme të politikës monetare. Një pikë konsensusi në takimin tonë në Uashington ishte rishikimi i disa aspekteve të këtij procesi ankorues dhe i mënyrës se si ai bashkëvepron me përpjekjet e vendeve, për të ndërtuar ankorat e tyre të brendshme përgjatë kohës.

Ka disa pyetje rreth rolit të ardhshëm të ankorave të brendshme dhe të jashtme. Ato përfshijnë gjykimin nëse nevojitet më shumë bashkërendim dhe sinergji në dialogun tonë mbi politikën realizuar me FMN-në dhe Komisionin. Si mund të thellohet mbikëqyrja fiskale e Komisionit (nëpërmjet Programit Ekonomik dhe Fiskal, Programit Ekonomik të Para-Aderimit, Programeve të Konvergjencës) për të shërbyer më shumë si mjet angazhimi?

Deri ku arrijnë mësimet e nxjerra për ankorat monetare dhe mekanizmat e matura të bashkërendimit për pranimin e rajonit tonë në BE? Si mund të zhvillojmë ne - përfshirë këtu edhe aktorët e jashtëm –ankora të brendshme më të fuqishme në forma të ndryshme, duke variuar nga strukturat fiskale afatmesme deri te mekanizmat më të efektshëm të bashkërendimit të politikave?

Në përfundim, do të trajtojmë çështjen e ndërtimit të kapaciteteve. Ne ramë dakord të trajtojmë këtë çështje në këtë seminar, për të sjellë informacion e të dhëna operacionale në CEF, pasi kjo qendër zhvillon programin e punës së saj në këtë fushë. Ka kaluar shumë kohë ndërmjet etapës së parë të programit dhe rezultatit për efektivitetin në ndërtimin e kapaciteteve, ndonëse fatmirësisht CEF e kishte ndërmarrë iniciativën disa vite më parë, duke rritur kontributin

e saj në fushat si stabiliteti financiar dhe bashkërendimi i politikave, pra CEF kryeson nisjen e kësaj iniciative.

Në fushën e ndërtimit të kapaciteteve, ne duhet të gjykojmë cilat janë prioritetet kryesore dhe ku janë boshllëqet që duhet të plotësohen nëpërmjet iniciativave në drejtim të seminareve e aktiviteteve trajnuese, si dhe në shkëmbimet e eksperiencave jashtë vendit.

Kjo do të na bëjë të gjykojmë me maturi mbi hartimin dhe zbatimin e politikës fiskale, ndërmjet të tjerave, si dhe mbi mënyrën se si politikat përshtaten me proceset e brendshme të bashkërendimit. Gjithashtu, ne duhet të identifikojmë nevojat në fushat e politikave të kujdesshme monetare, fusha ku edhe vendet anëtare të CEF nxitin shtrirjen e aktivitetit.

Kjo është axhenda e plotë dhe jam i sigurt se nuk do të jetë hera e fundit që ne takohemi për të shkëmbyer pikëpamjet tona lidhur me këto çështje.

Jam i bindur se trajtimi i këtyre sfidave në bazë rajonale do të na sjellë përfitime të pamatshme.

Ne mund të përfitojmë nga eksperienca e njëri-tjetrit. Ne mund të angazhohemi herë pas here në një dialog të përbashkët me aktorët e jashtëm në rajon dhe ndoshta udhëheqësit tanë politikanë mund të gjejnë mundësi të lançojnë paralelisht iniciativa reformash – për shembull, zhvillimi i reformave strukturore për të ndihmuar tërheqjen e flukseve të kapitalit në rajon.

Në këtë frymë, pres me kënaqësi të dëgjoj diskutime të frytshme – tani në Tiranë dhe në të ardhmen!

# FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z.ARDIAN FULLANI

Në pritjen e organizuar nga Shoqata Shqiptare e Bankave, me rastin e mbylljes së vitit 2009
18 dhjetor 2009

Të nderuar drejtorë bankash,

Të nderuar kolegë dhe miq,

Është kënaqësi që jam me ju sot, për të festuar përvjetorin e Shoqatës Shqiptare të Bankave. Ky eveniment përkon me përfundimin e vitit 2009, duke na dhënë një arsye më shumë për të analizuar ecurinë e sistemit bankar shqiptar gjatë këtij viti dhe kontributin që ka dhënë Shoqata në këtë drejtim.

Në përgjithësi, kjo periudhë ka pasur uljet dhe ngritjet e veta, por gjithsesi është një periudhë që ka shënuar përparim të dukshëm të sektorit bankar shqiptar, duke e kthyer atë në motorin kryesor të rritjes ekonomike të vendit tonë.

Më lejoni, fillimisht të nënvizoj disa nga elementet kryesore që tregojnë përparimin e sektorit bankar shqiptar gjatë këtyre viteve. Sektori bankar, që dominon sektorin financiar në Shqipëri, ka kaluar nga një sektor me 3 banka, ku të gjitha ishin pronë shtetërore dhe kishin mangësi të ndryshme, në një sektor i cili sot numëron 16 banka, të gjitha me pronësi private, ku mbizotëron kapitali i huaj.

Gjatë kësaj kohe, sektori bankar e ka zgjeruar aktivitetin e tij, duke zënë 77% të PBB-së së vendit, ka rritur numrin e degëve, ka ofruar më shumë produkte ndaj publikut dhe ka përmirësuar cilësinë e tyre, si dhe ka rritur rolin ndërmjetësues financiar, duke dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të vendit. Njëkohësisht, hyrja e grupeve të njohura bankare evropiane nga Greqia, Austria, Italia dhe Franca, është shoqëruar me episode të konsolidimit në industrinë bankare.

Janë miratuar standarde të larta për një qeverisje më të mirë të bankave dhe marrëdhënie më transparente me publikun. Gjatë këtyre viteve, sektori bankar ka qenë mjaft fitimprurës dhe ka operuar në përputhje me kuadrin rregullator dhe mbikëqyrës në lidhje me kapitalin dhe likuiditetin. Bordi i Drejtorëve dhe aksionerët kanë prezantuar menjëherë masat e nevojshme për ruajtjen e gjendjes së shëndoshë financiare dhe në mbështetje të zgjerimit të bankave të tyre me kapital shtesë. Puna mbikëqyrëse e Bankës së Shqipërisë ka ndjekur dhe monitoruar zhvillimin e sektorit bankar gjatë kësaj kohe, në përpjekje për të adoptuar standardet më të mira ndërkombëtare në këtë fushë.

Por sigurisht, asgjë nuk është absolute. Industria bankare është përballur me një numër çështjesh, shumë prej të cilave janë pjesë e fazës së zhvillimit

të sektorit tonë financiar në drejtim të konsolidimit të tij dhe zhvillimit të ekonomisë dhe shoqërisë. Ne kemi diskutuar në lidhje me këto çështje në shumë raste të tjera, por kurrsesi nuk do të lija pa përmendur rëndësinë e mekanizmave të duhura për menaxhimin e rrezikut, zgjerimin e balancuar të aktivitetit, procedura të qarta e transparente, e shumë çështje të tjera.

Por, do të doja të ritheksoja rëndësinë e një elementi të vetëm që i përfshin të gjitha këto: qeverisja e mirë. Për ekipin e menaxhimit të një banke, kjo do të thotë:

- Profesionalizëm, apo aftësi për të marrë vendime të drejta biznesi, pasi të peshohen rreziqet dhe përfitimet;
- Përkushtim, ose aftësi për të rrënjosur në një institucion një mjedis punëdashës;
- Përgjegjësi, ose aftësi për të përmbushur objektivat në mënyrë cilësore;
- Vizion, apo aftësi për të qenë largpamës në planifikimin e ecurisë së institucioneve tuaja; dhe
- Llogaridhënie, apo aftësi për të krijuar një sistem efikas kontrolli dhe balancimi për proceset dhe strukturat në institucionet tuaja.

Këto elemente, të cilat janë një domosdoshmëri për filozofinë e administrimit, duhet të rrënjosen në mendjen e çdo punonjësi të institucioneve që ju drejtoni, si një kulturë normale në punë. Jam i sigurt se të gjithë ne jemi dakord që këto çështje duhet të përmirësohen më tej në sektorin tonë bankar.

Të nderuar miq,

Gjatë vitit 2009, sektori ynë bankar u përball me një situatë unike dhe sfiduese. Kriza ndërkombëtare ekonomike dhe financiare, ndikoi dukshëm në besimin e publikut ndaj sektorit tonë bankar. Ajo tregoi se sa i ndjeshëm është mjedisi ynë social ndaj goditjeve financiare dhe se sa e rëndësishme është që të jemi të përgatitur për më të keqen. Krizat financiare janë më të vështirat për t'u administruar dhe pasojat e tyre kërkojnë një kohë të gjatë për t'u absorbuar.

Në të vërtetë, falë likuiditetit të sektorit bankar, mbështetjes së aksionerëve dhe masave të marra nga Banka e Shqipërisë, sektori bankar e përballoi gjendjen e shkaktuar nga tërheqja e depozitave në fillim të këtij viti. Me siguri, goditjen afatshkurtër tashmë e kemi lënë pas, por horizonti nuk është ende i qartë. Për të menaxhuar situatën e likuiditetit, ju u detyruat të pakësonit kreditimin. Kjo ka përkuar me vështirësi më të theksuara në sektorin real të ekonomisë, i cili ka ndikuar në kërkesën për kredi. Tashmë po përballemi me një përkeqësim të cilësisë së portofolit të kredisë, i cili do të rëndojë në rezultatin tuaj financiar për një periudhë afatmesme.

Banka e Shqipërisë i njeh dhe i mbështet përpjekjet e sektorit bankar për të identifikuar sa më herët dhe për të mbuluar me fonde rezervë sa më shpejt

kreditë me probleme. Ne ju inkurajojmë që të vazhdoni të tregoni maturinë e duhur, kur vlerësoni cilësinë e kredisë. Nga ana tjetër, ju duhet të mbështesni klientët tuaj dhe të vazhdoni kreditimin e huamarrësve të besueshëm, pasi kjo është e dobishme për klientët tuaj, për ju dhe për gjithë ekonominë. Unë do të vazhdoj t'ju theksoj këtë gjë, pasi jam i bindur se keni mundësi reale për ta bërë këtë në kushte konkurruese, veçanërisht për kreditë në monedhën kombëtare. Nga ana jonë, Banka e Shqipërisë do të vazhdojë të japë mbështetjen e nevojshme, duke ruajtur rrjedhjen e likuiditetit në përmbushje të nevojave tuaja. Kreditimi kërkon më shumë punë dhe analizë jo vetëm nga zyrat, por edhe në terren. Kërkon njohje të thellë të klientit dhe ndjekje të tij dhe të tregut. Por ai është vital për bilancet e bankave dhe aktivitetin ekonomik të vendit.

Ndikimi i krizës financiare ndërkombëtare në sektorin tonë bankar duhet të shërbejë si një mësim për të ardhmen. Siç e kemi përmendur në botimet e fundit, është e nevojshme që të kryeni një proces rivlerësimi të objektivave dhe të modeleve tuaja të zhvillimit për të ardhmen, në mënyrë që të siguroni një aktivitet të vazhdueshëm, të qëndrueshëm dhe fitimprurës.

Gjithashtu, ju duhet të zhvilloni politika dhe struktura që përmirësojnë aftësinë tuaj për veprim në rrethana të pazakonta dhe për të ruajtur "biznesin si zakonisht" për fushat më të rëndësishme. Banka e Shqipërisë tashmë është duke punuar, me synimin që brenda një periudhe të caktuar kohore dhe pas konsultimit me ju, të mbështesë këtë proces nëpërmjet futjes së ndryshimeve në kuadrin rregullator dhe mbikëqyrës. Me gjykime më të thella dhe pas ndryshimeve në standardet mbikëqyrëse në nivel evropian, ne duhet të punojmë së bashku për të siguruar një treg financiar më të balancuar, pa rrezik dhe të qëndrueshëm, si dhe një veprimtari të tillë të institucioneve në të ardhmen. Dua të shpreh besimin tim se industria bankare në Shqipëri do të jetë një aktor aktiv në përmbushjen e këtyre objektivave.

Më lejoni tani të përfundoj me një urim të sinqertë për një Vit të Ri të lumtur dhe të suksesshëm për ju, familjet tuaja dhe institucionet që ju drejtoni! Për Shoqatën e Bankave, uroj që Viti i Ri të përfaqësojë një periudhë përparimi kuptimplotë dhe arritje të mëtejshme!

Faleminderit!

# FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z.ARDIAN FULLANI

Në konferencën për shtyp mbi vendimmarrjen e politikës monetare të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë
23 dhjetor 2009

Në mbledhjen e tij të datës 23 dhjetor 2009, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë mori në shqyrtim Raportin Mujor të Politikës Monetare. Pasi u njoh me zhvillimet më të fundit ekonomike dhe financiare në vend, projeksionet e tyre për të ardhmen dhe balancën e pritshme të rreziqeve, në përfundim të diskutimeve Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendosi të mbajë të pandryshuar normën bazë të interesit, në nivelin 5.25 për qind.

Zhvillimet më të fundit në ekonominë botërore kanë dhënë sinjale pozitive në drejtim të përmirësimit të ecurisë së aktivitetit ekonomik. Vendet kryesore të zhvilluara dhe ato në zhvillim kanë përjetuar rritje ekonomike në nivel tremujor, ndërkohë që tregtia botërore dhe indekset e besimit kanë shfaqur shenja përmirësimi. Ekonomia botërore mbetet ende larg shfrytëzimit të plotë të kapaciteteve, gjë që ndikon në ruajtjen e papunësisë në nivele të larta. Shkalla e kufizuar e shfrytëzimit të kapaciteteve ndikon edhe në ruajtjen e presioneve inflacioniste në nivele të ulëta.

Megjithatë, këto presione kanë patur tendenca rritëse gjatë muajve të fundit, si pasojë e faktorizimit të lajmeve optimiste në çmimet e naftës e të lëndëve të para.

Të dhënat më të fundit të zhvillimeve në ekonominë e brendshme, tregojnë për një ngadalësim të aktivitetit ekonomik. Në ndryshim nga gjashtëmujori i parë, ku rritja ekonomike është mbështetur nga ruajtja e kërkesës konsumatore dhe nga stimuli fiskal i dhënë në këtë periudhë, të dhënat ekonomike për tremujorin e tretë dhe për muajt në vazhdim sinjalizojnë një ecuri më të moderuar të kërkesës dhe të prodhimit në ekonomi. Kjo dëshmohet nga një sërë treguesish të publikuar gjatë muajit nëntor, si: ecuria e ngadaltë e rritjes së indekseve të shitjeve me pakicë; të dhënat e ekonomisë së jashtme, të cilat vijojnë të karakterizohen nga ulja e eksporteve; performanca e treguesve fiskalë, të cilët duken të jenë nën nivelin e planifikuar; dhe frenimi i kreditimit si pasojë e rënies së kërkesës për të. Ngadalësimi i ekonomisë perceptohet gjithashtu edhe nga konsumatori dhe biznesi, treguesit e besimit të të cilëve vijojnë të jenë të ulët. Ecuria e ekonomisë në të ardhmen do të varet ndjeshëm nga riaktivizimi i shpenzimeve konsumatore dhe investimeve në vend, si dhe shkalla e mbulimit të tyre me kredi bankare, investime të huaja direkte, apo forma të tjera financimi afatgjatë.

Në përgjithësi, situata makroekonomike në vend ka krijuar një ambient me presione të dobëta inflacioniste. Gjithashtu, edhe faktorët e ofertës apo ato që origjinojnë jashtë ekonomisë shqiptare nuk kanë prodhuar presione të forta inflacioniste për këtë periudhë.

Inflacioni vjetor i çmimeve të konsumit shënoi vlerën 2.8 për qind në muajin nëntor, duke qëndruar pranë objektivit të Bankës së Shqipërisë. Inflacioni mesatar vjetor qëndroi për të tretin muaj radhazi në nivelin 2.1 për qind. Mungesa e presioneve nga ana e kërkesës së brendshme dhe vlerat e ulëta të inflacionit në vendet partnere kanë balancuar presionet e ushtruara nga nënçmimi i monedhës vendase gjatë vitit 2009. Kjo ecuri manifestohet edhe nga ecuria e qëndrueshme e inflacionit bazë, nivelet e ulëta të të cilit konfirmojnë praninë e një ambienti të kontrolluar inflacionist.

Tendenca e fundit rritëse e inflacionit të çmimeve të konsumit ishte një zhvillim i pritshëm për Bankën e Shqipërisë. Ai reflekton në masën më të madhe faktorë të përkohshëm apo teknikë, të cilët, ndonëse mund të veprojnë edhe për një periudhë afatshkurtër, nuk përbëjnë burim presionesh të qëndrueshme inflacioniste.

Të dhënat më të fundit të ekonomisë së jashtme tregojnë për një zgjerim të deficitit tregtar gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2009, duke shënuar një rritje prej 20 për qind kundrejt një viti më parë. Në terma relativë, niveli i deficitit korent është rritur në 17.3 për qind të PBB-së. Nga ana tjetër, hyrjet e valutës në llogarinë kapitale dhe financiare rezultuan 21 për qind më të larta se një vit më parë. Raporti i tyre ndaj PBB-së vlerësohet në nivelin 19.8 për qind, duke bërë të mundur që bilanci i pagesave të vendit të rezultojë pozitiv gjatë tre tremujorëve të parë të vitit 2009. Megjithatë, nivelet e larta dhe në rritje të deficitit të llogarisë korente do të kërkojnë sasi gjithnjë e më të mëdha fondesh në valutë të huaj për financimin e tij.

Për këtë arsye, qëndrueshmëria afatgjatë e bilancit të pagesave kërkon një vëmendje më të madhe të politikëbërësve, duke parashikuar edhe marrjen e masave politike apo të reformave strukturore.

Zhvillimet afatshkurtra në tregtinë e jashtme për muajin tetor shfaqin një ecuri të ndryshme në krahasim me nëntë muajt e parë të vitit, duke treguar për tentativa korrektimi të trendeve të vërejtura më parë. Eksportet e vendit ranë me rreth 9 për qind në terma vjetorë, ndërkohë që importet shënuan një rënie vjetore prej 21.4 për qind. Për pasojë, deficiti tregtar për dhjetë muajt e parë të vitit është tkurrur me 5 për qind në krahasim me vitin e kaluar, duke dhënë sinjale për një ecuri të qëndrueshme të tij.

Politika fiskale ka vazhduar të ruajë një karakter ekspansionist përgjatë vitit 2009, por ky tipar i saj ka ardhur duke u zbehur gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit. Ngadalësimi i aktivitetit ekonomik në vend është reflektuar edhe në ecurinë e treguesve fiskalë. Zhvillimet fiskale gjatë dy muajve të fundit janë karakterizuar nga një rritje më e vogël e të ardhurave buxhetore – vetëm 4.5 për qind në terma vjetorë - ndikuar kryesisht nga kontributi në rënie i të ardhurave nga TVSH-ja dhe i tatimit mbi fitimin. Ndërkohë, shpenzimet publike vazhdojnë të ruajnë norma të larta rritjeje - prej 16 për qind. Pjesa më e madhe e deficitit është financuar nga huamarrja e jashtme dhe nga të ardhurat nga privatizimet, duke mos ushtruar presion në tregun vendas.

Ndonëse ritmet e rritjes së deficitit buxhetor janë ngadalësuar gjatë dy muajve të fundit dhe niveli i tij në fund të tetorit i është përmbajtur kufirit të programuar për këtë periudhë kohore, ky deficit vazhdon të jetë i lartë në krahasim me nivelet historike.

Banka e Shqipërisë gjykon se përmbushja e objektivit afatmesëm fiskal për reduktimin e borxhit publik (në terma relativë) duhet të jetë udhërrëfyesi i politikës fiskale për periudhën e ardhshme. Përmbushja e tij do të forcojë besimin e publikut te politikat makroekonomike të vendit, do të jetë një bazë e qëndrueshme për stabilitetin makroekonomik të vendit, do të ulë primet e rrezikut në ekonomi dhe do të krijojë më shumë frymëmarrje për sektorin privat. Ky objektiv duhet të materializohet në praktikë nëpërmjet ndjekjes së politikave fiskale të kujdesshme dhe gjithnjë të rakorduara me zhvillimet e ekonomisë reale.

Duke u kthyer në zhvillimet monetare, Banka e Shqipërisë gjykon se tabloja e tyre e paraqitur në muajin nëntor është mikse. Ritmi i rritjes së ofertës monetare është përshpejtuar dhe normat e interesit kanë shënuar rënie, por kreditimi i ekonomisë është ngadalësuar gjatë kësaj periudhe. Në muajin nëntor, paraja e gjerë është rritur me 5.6 për qind në terma vjetorë duke reflektuar stabilizimin e likuiditetit të sistemit bankar si pasojë e vazhdimit të rikthimit të depozitave dhe përmirësimit të pozicionit valutor. Zhvillimet pozitive në ecurinë e depozitave gjatë këtij muaji dhe zhvendosja e tyre kohore drejt depozitave me afat konfirmojnë tendencën e rivendosjes së besimit në sistemin bankar.

Ndërkohë, aktiviteti kreditues i bankave është ngadalësuar, duke shënuar një rritje vjetore të portofolit të kredisë prej vetëm 12 për qind. Kredia për biznese mban peshën kryesore në zgjerimin e portofolit të kredisë, ndërkohë që kredia konsumatore dhe ajo hipotekare janë kontraktuar.

Nivelet e ulëta të zgjerimit të portofolit të kredisë reflektojnë jo vetëm problemet e likuiditetit në sistemin bankar, por së fundi dhe në një masë jo të vogël, edhe rënien e kërkesës për konsum dhe investime si rrjedhojë e dobësimit të aktivitetit ekonomik. Ecuria e kredisë në të ardhmen do të jetë një përcaktues i rëndësishëm i aktivitetit ekonomik. Banka e Shqipërisë gjykon se sistemi bankar mund dhe duhet të bëjë më shumë përpjekje për të transmetuar politikën lehtësuese monetare të ndjekur prej saj në një kreditim më të madh të ekonomisë. Pa cënuar përmbushjen e mandatit tonë për kontrollin e inflacionit, ne mbetemi të gatshëm të ndihmojmë sistemin bankar nëpërmjet marrjes së masave të nevojshme për të riaktivizuar tregun e kreditit.

Në këtë linjë, edhe gjatë muajit nëntor, Banka e Shqipërisë ka vazhduar të mbështesë plotësisht kërkesat për likuiditetit të sistemit bankar nëpërmjet instrumentit të repo-ve. Tregues të tregut ndërbankar dëshmojnë për një rritje të vëllimit të tregtimit në të, ndërkohë që normat e interesit kanë shfaqur një prirje rënëse, duke ndjekur uljen e normës bazë të interesit në fund të muajit tetor. Ulja e normës bazë është reflektuar edhe në tregun primar, ku për herë të parë gjatë vitit 2009 yield-et e letrave me vlerë të qeverisë kanë

shënuar rënie, për të gjitha maturitetet e tyre. Sistemi bankar ka reaguar për reflektimin e kësaj uljeje edhe në interesat e kredisë dhe të depozitave në lekë. Reagimi i agjentëve ndaj uljes së normës bazë pritet të përcillet më tej edhe në tregun e depozitave dhe kredive, duke iu përmbajtur vonesave kohore në transmetimin e politikës monetare.

Ecuria e kursit të këmbimit ka vijuar tendencën nënçmuese edhe gjatë muajit nëntor, por me ritme më të ngadalësuara. Nënçmimi i lekut, i cili ka qenë i pranishëm gjatë gjithë këtij viti, është balancuar nga çmime më të ulëta të mallrave të importuara, duke mos përbërë rrezik material për tejkalimin e nivelit të synuar të inflacionit.

Në përfundim të diskutimeve mbi ecurinë aktuale dhe të pritshme të zhvillimeve ekonomike, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë konkludoi se presionet inflacioniste pritet të jenë të ulëta gjatë periudhës afatmesme, të shprehura në një inflacion të çmimeve të konsumit rreth gjysmës së poshtme të objektivit të Bankës së Shqipërisë. Nga ana tjetër, rreziqet ndaj stabilitetit të çmimeve për periudhën në vazhdim vlerësohen të jenë relativisht të balancuara. Faktorët me ndikim frenues, si ngadalësimi i ofertës monetare, vlerësimet për ngadalësimin e kërkesës së brendshme dhe të ritmeve të aktivitetit ekonomik, niveli i ulët i shfrytëzimit të kapaciteteve të lira në ekonomi dhe normat e ulëta të rritjes së çmimeve në vendet kryesore partnere, gjykohet se do të balancojnë presionet inflacioniste ushtruar nga kursi i këmbimit dhe rritja e çmimeve në tregjet botërore.

Këshilli Mbikëqyrës vendosi të mbajë të pandryshuar normën bazë të interesit. Ky vendim synon ruajtjen dhe konsolidimin e mëtejshëm të ekuilibrave makroekonomikë, duke e konsideruar qëndrueshmërinë makroekonomike si një parakusht të domosdoshëm për një rritje të qëndrueshme dhe afatgjatë. Ai gjithashtu garanton mbështetjen e duhur monetare për ekonominë në këtë fazë të zhvillimit të saj.

Në të ardhmen, Banka e Shqipërisë mbetet e gatshme të veprojë në linjë me ecurinë e faktuar dhe të pritshme të treguesve ekonomikë. Zhvendosja në kahun rënës e balancës së rreziqeve inflacioniste, konsolidimi i stabilitetit financiar dhe i pritjeve inflacioniste në ekonomi do të faktorizohen në vendimmarrjen e ardhshme të Bankës së Shqipërisë.

# ARTIKUJT E BOTUAR NË BULETININ EKONOMIK 2009

## PËRCAKTUESIT E MARZHIT NETO TË INTERESAVE NË SISTEMIN BANKAR SHQIPTAR

*Mars 2009*

Irini Kalluci

Ky material trajton marzhin neto të interesave si një matës i eficiencës së bankave që operojnë në sistemin bankar shqiptar dhe fokusi kryesor është në identifikimin e faktorëve që ndikojnë në masën e këtij treguesi. Marzhi neto i interesave mund të llogaritet si raport i të ardhurave neto nga interesat me totalin e aktiveve apo me aktivet që sjellin të ardhura. Megjithatë, një reduktim i këtij treguesi jo në të gjitha rastet sinjalizon përmirësim eficience. Në këto kushte, studimi i faktorëve që mund të shkaktojnë ndryshime në kostot e ndërmjetësimit, përbën një fushë interesante dhe gjerësisht të trajtuar nga literatura e huaj. Sistemi bankar është elementi më i rëndësishëm i sistemit financiar shqiptar, aktivet e të cilit zënë rreth 97 për qind të aktiveve të të gjithë sistemit financiar. Për rastin e Shqipërisë, bankat funksionojnë si aktorët kryesorë në kanalizimin e fondeve nga huadhënësit te huamarrësit, prandaj është e rëndësishme që roli ndërmjetësues i tyre të sigurojë një mirëqenie më të lartë për shoqërinë, mundësisht me kosto sa më të ulëta. Në këtë kontekst mori fillesën edhe ky studim, duke synuar që nëpërmjet tij të identifikohen faktorët që ndikojnë marzhin neto të interesave për sistemin bankar shqiptar dhe duke shpresuar që do të kontribuojë në literaturën e shkruar rreth kësaj çështjeje, meqenëse një studim i tillë realizohet për herë të parë për rastin e Shqipërisë. Grupe të ndryshme interesi, por sidomos politikëbërësit janë të interesuar në ngritjen dhe funksionimin e sistemeve bankare që gëzojnë stabilitet dhe eficiencë. Stabiliteti kërkon kthime të mjaftueshme, ndërsa eficienca ekonomike kërkon marzhe në nivele të pranueshme, të aplikuara nga bankat. Rezultatet e marra nga analiza e faktorëve që ndikojnë marzhin neto të interesave, mund të jenë të dobishme për hartimin e masave specifike të politikave ekonomike.

## REZERVA VALUTORE NË SHQIPËRI: MATJA DHE NIVELI I NJË ANALIZE KRAHASUESE ME VENDET E RAJONIT

Olta Manjani

Ky material synon të paraqesë një përshkrim të përgjithshëm të treguesve për mbajtjen e rezervës valutore nga autoriteti monetar. Strategjia e Bankës së Shqipërisë për administrimin e rezervës valutore parashikon rritjen e vazhdueshme të saj në përputhje me tiparet kryesore të ekonomisë: deficit i lartë dhe në rritje i llogarisë korrente, rritje e shpejtë e borxhit të jashtëm afatshkurtër si dhe zhvendosje e theksuar e parasë së gjerë drejt përbërësit të

saj valutor. Në këto kushte, aplikimi i kritereve të mjaftueshmërisë për matjen e rezervës valutore duhet të mbajë parasysh kritere të tilla si mbulimi me rezervë në vlerë i 3 - 4 muajve importe mallrash dhe shërbimesh, mbulimi me rezervë në vlerë i një ose mbi një vit i borxhit të jashtëm afatshkurtër apo mbulimi me rezervë nga 5 deri në 20 për qind të sasisë së parasë së gjerë. Zbatimi i këtyre kritereve, përveçse shërben për t'u paraprirë faktorëve potencialë të rreziqeve që mund të cënojnë ekonominë shqiptare, gëzon një shkallë të lartë kredibiliteti dhe siguron një bazë të mirë krahasuese midis vendeve të ndryshme.

*Qershor 2009*

KRIZA FINANCIARE DHE VENDET E RAJONIT
Eglent Kika, Erblin Maçi, Medvin Shehu

Ky artikull synon të paraqesë një retrospektivë të evoluimit të krizës financiare prej vendeve të zhvilluara në vendet në zhvillim ku në fokus janë disa prej vendeve të Evropës Qendrore, disa prej vendeve të rajonit dhe Shqipëria. Në këtë kontekst, interes i veçantë i kushtohet mënyrës së reflektimit të krizës në treguesit realë të këtyre ekonomive si dhe lëvizjet fiskale, monetare apo operacionale të institucioneve përkatëse sipas profilit ekonomik të secilit vend.

MATJA E PRITSHMËRIVE TË INFLACIONIT
Gent Hashorva, Elona Bollano, Elvana Troqe

Në këtë material, autorët janë përpjekur të zbatojmë disa teknika të kuantifikimit të përgjigjeve të mbledhura nëpërmjet Vrojtimit të Besimit të Konsumatorit, që kryhet nga Banka e Shqipërisë. Në të njëjtën kohë bëhen përpjekje për të kuptuar më mirë natyrën e pritjeve të konsumatorëve shqiptarë. Materiali është i organizuar si vijon: Në seksionin e parë zbatohet metodologjia dhe testet në rastin e Shqipërisë. Seksioni i dytë trajton rëndësinë e pritjeve në procesin e kontrollit të inflacionit dhe mënyrën e matjes së tyre. Seksioni i tretë vijon me metodologjinë e konvertimit të të dhënave nga cilësore në sasiore, duke përdorur disa lloje funksionesh të metodës së kuantifikimit probabilitar si dhe trajtohen testet e treguesit të inflacionit të pritur, për të arritur në konkluzione në lidhje me natyrën e pritjeve të konsumatorëve. Materiali mbyllet me disa konkluzione paraprake.

*Shtator 2009*

ANALIZA E NDËRMJETËSIMIT FINANCIAR
Erjona Suljoti, Sofika Note

Sistemi bankar shqiptar përbëhet nga 16 banka universale, private dhe ku dominon dukshëm kapitali i huaj, i cili përbën rreth 92% të kapitalit të mbajtur të sistemit bankar. Ndonëse një numër jo i vogël bankash kanë qenë të pranishme në Shqipëri që prej vitit 2000, aktiviteti i mirëfilltë ndërmjetësues i sistemit bankar ka marrë hov në 4-5 vitet e fundit. Ndërmjetësimi financiar

i bankave deri në vitin 2004 karakterizohej nga grumbullimi i kursimeve të agjentëve ekonomikë dhe nga mobilizimi i ulët i tyre në kredidhënie, veçanërisht për sektorin privat. Ndërkohë, financimi i borxhit publik përbënte 55% të aktiveve, duke dëshmuar mobilizimin e lartë të fondeve drejt sektorit publik. Kjo tablo e aktiveve të sistemit bankar ishte pasojë e shtrirjes së ulët gjeografike të sistemit bankar, rrezikut më të lartë të kredidhënies, integrimit më të ulët të sektorit real me sistemin bankar si dhe e elementeve rregullative mbikëqyrëse prezente në atë kohë.

## REZULTATET E VROJTIMIT PRANË FAMILJEVE PËR TË ARDHURAT NGA EMIGRANTËT (VITI 2008)

Godiva Rëmbeci

Studimi ofron informacion mbi karakteristikat e përgjithshme të familjeve që përfitojnë dërgesa nga emigrantët, karakteristikat e emigrantëve dhe të ecurisë së dërgesave të tyre në Shqipëri, në bazë të të dhënave të vrojtimeve tremujore të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë gjatë vitit 2008. Rezultatet e këtyre vrojtimeve janë jo vetëm një burim i mirë informacioni për të plotësuar dhe në një të ardhme, zëvendësuar vlerësimin për dërgesat nga emigrantët në bilancin e pagesave, por ato mund të përdoren si seri kohore nga analistët për të ndjekur, kuptuar dhe parashikuar fenomenin e dërgesave në kriteret më kryesore të tij.

## ZHVILIMI FINANCIAR DHE RRITJA EKONOMIKE: RASTI I SHQIPËRISË

Elona Dushku

Ky material investigon lidhjen shkak-pasojë midis zhvillimit financiar dhe rritjes ekonomike për rastin e Shqipërisë, duke përdorur testin e Granger-causality për pesë tregues të ndryshëm të zhvillimit financiar. Kështu, për seritë që nuk janë as stacionare, as të kointegruara është ndërtuar modeli VAR dhe më pas është aplikuar testi i mësipërm. Ndërsa, për seritë jo stacionare, por që midis tyre gjendet një lidhje kointegruese, testi i Granger-causality është aplikuar pas ndërtimit të vector error correction model (VECM). Gjetjet empirike të këtij materiali tregojnë, që në afatin e gjatë vërtetohet lidhja pozitive midis të gjithë treguesve që matin zhvillimin financiar dhe rritjes ekonomike. Ndërsa, në afatin e shkurtër kjo lidhje nuk është mjaft e qartë, pasi tregues të ndryshëm japin rezultate të ndryshme. Të dhënat që analizuam i përkasin periudhës 1996-2007.

# ARTIKUJ

## FAKTORËT PËRCAKTUES TË RRITJES EKONOMIKE NË SHQIPËRI.

Vasilika Kota*, kryespecialiste, Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë

### HYRJE

Ky material paraqet një analizë të burimeve të rritjes ekonomike në Shqipëri pas periudhës së tranzicionit. Vlerësimi i përcaktuesve themelorë të rritjes ekonomike është i rëndësishëm për të kuptuar çfarë roli kanë luajtur në të kaluarën dhe si mund të jetë perspektiva e zhvillimit të tyre në të ardhmen. Krahasuar me vende të tjera të Evropës Qendrore apo Lindore, rritja ekonomike në Shqipëri pas viteve '90 është më e lartë se në shumicën e këtyre vendeve. Kështu, duke përjashtuar Poloninë dhe Turqinë të cilat kanë shfaqur një rritje ekonomike të qëndrueshme pas vitit '91, Shqipëria është e para midis vendeve të marra në konsideratë e cila në vitin 1999 (së bashku me Hungarinë) arriti të tejkalojë nivelin e PBB-së reale të vitit 1990. Për vendet e tjera, goditja e tranzicionit do të ishte mjaft e fortë dhe rimëkëmbja ekonomike mbi nivelin e vitit '90 filloi vetëm pas vitit 2003. Ndërkohë që Maqedonia, Bullgaria apo Letonia ende nuk kanë arritur nivelin real të PBB-së që kanë pasur në vitin '90.

Grafik 1. Indeksi i PBB-së reale (1990=100) për Shqipërinë (majtas) dhe për vende të Evropës Qendrore dhe Lindore[1] për vitin 2009 (djathtas).




Burimi: World Economic Outlook (Prill 2010).
1) Të dhënat për periudhën para vitit 1994 për një pjesë të vendeve, janë marrë nga materiali "Rapid Growth in Transition Economies: Growth-Accounting Approach", Garbis Iradian (2007).

Një vështrim më i detajuar i rritjes ekonomike në Shqipëri paraqitet në grafikun 2. Gjatë fillimit të tranzicionit 1990-1992, PBB-ja reale në Shqipëri ra me një përqindje kumulative prej 39 për qind. Politikat e zbatuara gjatë vitit 1993 me qëllim stabilizimin makroekonomik të vendit, ndihmuan në ripërtëritjen dhe rritjen e qëndrueshme ekonomike. Ndërmjet viteve 1993 deri 1996, rritja mesatare vjetore arriti në 9.3 për qind. Kriza e skemave piramidale gjatë vitit 1997, shkaktoi një rënie ekonomike prej 11 për qind. Megjithatë, ekonomia u ripërtëri shpejt dhe norma e rritjes së PBB-së reale për vitin 1998

arriti 8.6 për qind. Kjo rritje ishte edhe më e lartë për vitet në vazhdim dhe u stabilizua gjatë viteve 2001-2002, me një normë mesatare 6.5 për qind. Gjatë krizës ekonomike të vitit 2002, ekonomia u rrit vetëm me 4.3 për qind. Ndërkohë duke filluar nga viti 2003 rritja mesatare vjetore ka qenë 6 për qind. Pas një niveli prej 7.85 për qind të rritjes vjetore në vitin 2008, kriza financiare botërore u reflektua në ngadalësimin e rritjes ekonomike duke shënuar vetëm 3.3 për qind në vitin 2009.

Grafik 2. Norma e rritjes reale ekonomike në Shqipëri gjatë periudhës 1990-2009 (boshti djathtas) dhe përbërja sektoriale e PBB-së (boshti majtas).




Burimi: World Development Indicators (2003) për PBB-në dhe peshat e sektorëve gjatë periudhës 1990-1995, INSTAT për periudhën 1996-2009. Peshat e sektorëve për vitin 2009 janë vlerësim paraprak bazuar në vlerësimin e INSTAT-it për tremujorin e parë 2009 publikuar në korrik 2009.

Për shkak të strukturës joeficiente të organizimit të ekonomisë që Shqipëria trashëgoi nga sistemi komunist, procesi i tranzicionit u shoqërua me ristrukturimin e aktiviteteve ekonomike. Duke filluar nga viti 1990, pesha e sektorit të industrisë është zvogëluar nga 39 për qind, në rreth 7.6 për qind në vitin 2009. Ndërkohë një zgjerim të dukshëm ka pësuar sektori i ndërtimit i cili u zgjerua nga niveli rreth 3 për qind i PBB-së në vitin 1990, në 14.5 për qind në vitin 2009. Ngushtimi i sektorit të industrisë lejoi përdorimin e faktorëve të prodhimit nga sektorët e tjerë. Një zgjerim të konsiderueshëm pësoi sektori i shërbimeve, pesha e të cilit në PBB u rrit nga 33 për qind në 63 për qind. Sektori i bujqësisë pësoi fillimisht një rritje nga 23 në 32 për qind deri në vitin 1997 dhe më pas, u ngushtua në nivelin 19 për qind të PBB-së në vitin 2009. Kriza financiare duket se u reflektua më shumë mbi sektorin e industrisë, i cili në vitin 2009 u ngushtua me 2.5 pikë përqindjeje në raport me PBB-së ndërkohë që sektori i shërbimeve vazhdoi të zgjerohej me 5.4 pikë përqindjeje ndaj PBB-së krahasuar me vitin 2008.

Pas pasqyrimit të zhvillimeve në rritjen ekonomike, është e rëndësishme të kuptojmë cilat kanë qenë burimet kryesore të rritjes që kanë përcaktuar zhvillimin ekonomik të vendit. Për të shpjeguar përcaktuesit kryesorë të rritjes ekonomike, literatura empirike sugjeron dy përqasje (Khan, 2004):

1. Së pari, modeli neoklasik i rritjes ekonomike sugjeron shpërbërjen e normës së rritjes ekonomike sipas kontributit të burimeve themelore të rritjes ekonomike të tillë si: kapitali njerëzor, stoku i kapitalit fizik dhe rritja e Produktivitetit Total të Faktorëve të Prodhimit (e njohur si TFP).
2. Së dyti, gjatë ndërtimit të analizave krahasuese të rritjes ekonomike midis vendeve të ndryshme, janë identifikuar burimet strukturore të rritjes ekonomike të tilla si: norma e investimeve, norma e regjistrimit në shkollë, integrimi në tregtinë ndërkombëtare, stabiliteti makroekonomik, infrastruktura dhe cilësia e institucioneve. Kuptohet se këta variabla strukturorë kontribuojnë në zhvillimin e një apo disa burimeve themelore të rritjes ekonomike të cilat përdoren në përqasjen e parë.

Gjatë këtij materiali, do të analizohet rritja ekonomike në Shqipëri duke identifikuar burimet themelore të saj përmes përqasjes së parë.

## METODOLOGJIA DHE TË DHËNAT

Për të identifikuar burimet e rritjes ekonomike, përqasja e parë bazohet në ndërtimin e modelit Solow ose i njohur ndryshe si modeli Neoklasik i rritjes ekonomike. Ky model identifikon si përcaktues të rritjes ekonomike, produktivitetin e punës, produktivitetin e kapitalit si dhe normën e TFP. Norma e TFP përcaktohet nga mbetja e modelit dhe është një vlerësim për ndryshimin në Produktivitetin Total të Faktorëve dhe ndër të tjera reflekton edhe supozimet metodologjike dhe gabimet në matje të faktorëve të prodhimit. Kjo mbetje përcaktohet si rritja në nivelin e prodhimit që ndodh kur faktorët e rritjes ekonomike (punë dhe kapital) nuk ndryshojnë. Pra, interpretimi i saj varet nga përcaktimi që i jepet faktorëve punë dhe kapital. Duke qenë se te modeli bazë Solow nuk identifikohen variabla të tillë si niveli i shkollimit apo i eksperiencës në punë (të cilët ndikojnë faktorin punë) si dhe kapaciteti i përdorimit të kapitalit (që ndikon faktorin kapital), atëherë në mënyrë automatike këto përfshihen në vlerësimin e TFP. Modeli Solow prezantohet në formën e një funksioni agregat prodhimi Cobb Douglass si më poshtë:

$$Y = A \cdot L^{\alpha} \cdot K^{1-\alpha} \tag{1}$$

Ku A është produktiviteti total i faktorëve të Prodhimit (TFP), L është faktori punë i prodhimit, K është stoku i kapitalit dhe $\alpha$ është elasticiteti i punës (gjithashtu edhe pjesa e të ardhurave nga puna në të dhënat totale). Linearizimi i funksionit të prodhimit është si më poshtë:

$$\underbrace{\frac{dY}{Y}}_{rritja-e-PBB} = \underbrace{\alpha\frac{dL}{L}}_{kontributi-nga-punësimi} + \underbrace{(1-\alpha)\frac{dK}{K}}_{kontributi-nga-kapitali-fizik} + \underbrace{\frac{dA}{A}}_{kontributi-nga-TFP} \tag{2}$$

Ku produktiviteti total i faktorëve të prodhimit (TFP) përfitohet si një mbetje e ekuacionit:

$$A = \log(Y) - \left[\alpha \log(L) + (1-\alpha)\log(K)\right] \tag{3}$$

Për shkak se mungojnë të dhënat mbi pjesën e të ardhurave të faktorit punë ($\alpha$) është përdorur supozimi i njohur gjerësisht në literaturë sipas të cilit 70 për qind e totalit të të ardhurave janë nga faktori i prodhimit punë dhe vetëm 30 për qind e të ardhurave vijnë nga stoku i kapitalit.

Problemi i dytë është vlerësimi i stokut të kapitalit pasi në Shqipëri mungojnë të dhënat mbi këtë seri. Për këtë qëllim, është përdorur një vlerësim i stokut të kapitalit për vitin 1996[2] dhe më pas janë shtuar të dhënat mbi investimet të cilat janë marrë nga INSTAT. Norma vjetore e zhvlerësimit të kapitalit është supozuar 8 për qind dhe vlerësimi i stokut të kapitalit është si më poshtë:

$$K(t+1) = K_t + I_t - \delta * K_t \tag{4}$$

Ku Kt është stoku i kapitalit në kohën t, It është norma e investimeve dhe $\delta$ është norma e zhvlerësimit të kapitalit. Një informacion më i plotë mbi ndërtimin e këtyre të dhënave prezantohet në materialin Kota (2009).

Analiza e burimeve të rritjes ekonomike është ndërtuar me të dhëna vjetore për periudhën 1996-2009. Të dhënat mbi punësimin total për këtë periudhë janë marrë nga INSTAT. Stoku i kapitalit është vlerësuar sipas metodologjisë të prezantuar më lart për periudhën 1996-2007 pasi këtu përfundojnë të dhënat mbi investimet nga INSTAT. Ndërkohë që ekstrapolimi i investimeve për periudhën 2008-2009 është bërë duke përdorur kalibrimin. Të dhënat e Bankës së Shqipërisë mbi përdorimin e kredive nga ana e klientëve të bankave, tregojnë se rreth 1/3 e totalit të kredive shkon për investime. Duke përdorur normat e rritjes së kredisë për 2008-2009 është ekstrapoluar ecuria e investimeve private gjatë kësaj periudhe, të cilat më pas janë përdorur për të vlerësuar stokun e kapitalit. Duke qenë se investimet publike zënë rreth 15 për qind të investimeve totale, ecuria e investimeve private është thelbësore për të përcaktuar zhvillimet në stokun e kapitalit. Gjithsesi, ky mbetet një vlerësim i ecurisë reale të investimeve ndaj periudha 2008-2009 mund të përdoret thjesht për të krijuar një ide mbi kontributin e faktorëve të prodhimit dhe analiza mbi të mund të konsiderohet si orientuese dhe jo përfundimtare.

## *BURIMET E RRITJES EKONOMIKE - REZULTATET*

Kontributi i faktorëve të prodhimit (punë dhe kapital) në rritjen ekonomike duke e matur nëpërmjet normës së rritjes së këtyre faktorëve të peshuar me pjesën e tyre në totalin e të ardhurave, prezantohet në grafikun 3.

Rezultatet sugjerojnë se deri në vitin 2000, kontributi kryesor në rritjen ekonomike është dhënë nga rritja e TFP-së, ndërkohë që zgjerimi i kreditimit të ekonomisë që filloi pas vitit 2000 është reflektuar në rritjen e kontributit të stokut të kapitalit në periudhën e dytë të marrë në studim. Duke u ndalur më gjerësisht, gjatë periudhës së rimëkëmbjes ekonomike pas krizës së vitit '97 (1998-2000), kur norma e rritjes ekonomike ishte mesatarisht 9.7 për qind , TFP-ja u rrit mesatarisht me 9.3 për qind, ndërkohë që stoku i kapitalit gjatë së njëjtës periudhë është rritur me 1.4 për qind. Gjatë viteve 2001-2007, rritja mesatare vjetore e ekonomisë është 5.8 për qind dhe kontributi kryesor në rritjen ekonomike vjen nga stoku i kapitalit mesatarisht me 3 për qind, ndërkohë që rritja e TFP-së është faktori i dytë përcaktues me një rritje mesatare prej 2.45 për qind. Për sa i përket faktorit të prodhimit punë, i matur nëpërmjet punësimit zyrtar, kontributi i tij ka qenë mjaft i ulët dhe me raste edhe negativ (para vitit 2000). Një ndër arsyet kryesore mund të jetë edhe problemi i të dhënave statistikore në lidhje me punësimin, të cilat nuk përfshijnë vlerësime për tregun joformal të punës i cili është mjaft i përhapur në Shqipëri. Gjithsesi, duhet të mbajmë parasysh se faktori punë në rastin tonë përfshin kontributin e punësimit në rritjen ekonomike, ndërkohë që përmirësimet e mundshme në cilësinë e punës reflektohen në rritjen e TFP.

Grafik 3. Rritja ekonomike dhe faktorët e prodhimit.




Burimi: Llogaritje të autorit.

Rezultate të ngjashme për rastin e Shqipërisë janë provuar edhe nga autorë të tjerë. Këtu mund të përmendim Khan (2004) i cili evidenton rolin përcaktues të TFP-së në rritjen ekonomike në Shqipëri. Si në rastin e rezultateve të paraqitura më lart, Khan (2004) gjithashtu gjen se normat e rritjes së TFP-së gjatë viteve të fundit kanë ardhur drejt rënies, duke u shoqëruar nga një rritje modeste e kontributit të punës dhe kapitalit. Sipas Khan (2004) tre mund të jenë burimet e rritjes së TFP-së në vendet në tranzicion:

- Rritja e menjëhershme e TFP-së gjatë tranzicionit për shkak të rishpërndarjes së faktorëve të prodhimit dhe transformimit të ekonomisë.
- Përmirësimi i TFP-së për shkak të përmirësimit të shpërndarjes së burimeve si rezultat i reformave strukturore.
- Përmirësimi i TFP-së si rezultat i gjetjeve të reja dhe mësimit nga ana e sipërmarrësve.

Gjetjet sugjerojnë se burimi kryesor i rritjes së TFP-së ka qenë burimi i parë. Në fillimet e tranzicionit, për shkak të rishpërndarjes së burimeve të ekonomisë është e pritshme që TFP-ja të luajë një rol të rëndësishëm. Por kontributi i këtij faktori zvogëlohet me kalimin e kohës dhe stoku i kapitalit dhe punësimi fillojnë të ndikojnë ndjeshëm mbi rritjen ekonomike. Një rezultat i ngjashëm duket edhe në rastin e Shqipërisë, ku ngadalësimi i rritjes së TFP-së u pasua me një rritje të kontributit të kapitalit të akumuluar. Gjithsesi, roli i rëndësishëm i kombinimit të faktorëve të prodhimit përmes TFP-së është rikthyer gjatë krizës financiare botërore 2008-2009. Për shkak të reduktimit të ndjeshëm të normës së rritjes së kredisë, e cila nga 53 për qind rritje vjetore në 2007, u zvogëlua në 44 për qind në 2008 ndërkohë që gjatë vitit 2009 kjo normë u përgjysmua në 25 për qind, kontributi i stokut të kapitalit u ngadalësua.

Së fundi, rezultatet e analizës sugjerojnë se punësimi nuk ka kontribuar në rritjen ekonomike (këtu duhet të kujtojmë edhe një herë se përmirësimi i cilësisë së punës reflektohet në termin TFP). Gjithsesi, një proces i rëndësishëm i mbështetjes së rritjes ekonomike nëpërmjet burimeve njerëzore, është përdorimi i tyre me produktivitet. Sipas Kota (2007) pavarësisht se faktori punë nuk ka dhënë kontribut në rritjen ekonomike totale, produktiviteti i punës në Shqipëri është përmirësuar. Ky proces është mjaft i rëndësishëm për konvergimin e ekonomisë shqiptare drejt ekonomive më të zhvilluara. Ekonomitë e vendeve me shkallë të ndryshme zhvillimi shfaqin mjaft heterogjenitet dhe dinamikë në nivelin sektorial apo të firmave. Këto vende karakterizohen nga nivele të ndryshme produktiviteti dhe rritja e tij është burimi kryesor i rritjes ekonomike afatgjatë.

Nëse punësimi është i përqendruar në sektorë me nivel të ndryshëm produktiviteti që shoqërohen me mungesë eficience, atëherë stimulimi i rritjes ekonomike kërkon fillimin e procesit të ristrukturimit të ekonomisë. Punësimi do të zhvendoset nga sektorët më pak produktivë te sektorët më produktivë. Procesi do të përfundojë me rishpërndarjen eficiente të punësimit që stimulon rritjen e produktivitetit sektorial, agregat dhe ekonomik të vendit.

Siç u diskutua në grafikun 2, procesi i tranzicionit në Shqipëri u shoqërua me ristrukturimin e aktiviteteve ekonomike. Një ristrukturim i tillë duhet të pasohej edhe me riorganizim të tregut të punës. Grafiku 4 paraqet ecurinë e punësimit sipas sektorëve dhe të produktivitetit të punës sipas sektorëve. Produktiviteti i punës është përcaktuar si raporti midis vlerës së shtuar dhe punësimit në çdo sektor.

Grafik 4. Produktiviteti i punës dhe punësimi sipas sektorëve.




Burimi: INSTAT, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për vitin 2008.

Ndërkohë që sektori i bujqësisë ka produktivitetin më të ulët, rezulton se ai ka nivelin e punësimit më të lartë. Problem në këtë rast përbëjnë të dhënat mbi nivelin e punësimit pasi INSTAT përdor supozimin se çdo person që zotëron tokë është i punësuar. Gjithsesi një sjellje e ngjashme shfaqet dhe në sektorët e tjerë. Kështu, sektori i shërbimit me nivelin më të lartë të produktivitetit të punës ka rreth 60 për qind të totalit të të punësuarve. Ndërkohë që sektori i ndërtimit, i dyti për nga niveli i lartë i produktivitetit ka vetëm 6 për qind të punësimit total. Një vështrim i thjeshtë mbi këto të dhëna sugjeron se shpërndarja e punësimit sipas sektorëve nuk është eficiente, të paktën duke përdorur të dhënat zyrtare mbi punësimin të cilat gjithsesi nuk përfshijnë tregun joformal. Por në nivel agregat (për të gjithë ekonominë), produktiviteti i punës është rritur mesatarisht me 6.4 për qind për të gjithë periudhën 1996-2008. Për këtë arsye është me interes identifikimi i faktorëve kryesorë pas këtij zhvillimi.

## *PRODUKTIVITETI I PUNËS - BURIMET E RRITJES SË TIJ*

Për të identifikuar burimet kryesore të zhvillimeve në produktivitetin e punës në Shqipëri është përdorur metodologjia e zbatuar nga Kota (2007) sipas së cilës faktorët përcaktues të përmirësimit të produktivitetit të punës janë: rritja brenda sektorit e produktivitetit të punës, rishpërndarja e punësimit midis sektorëve dhe konvergimi i sektorëve drejt një niveli mesatar produktiviteti, i cili mund të konsiderohet si niveli ekuilibër. Kjo metodologji e ka fillesën në

punën e Maliranta dhe Ilmakunnas (2005) dhe është përdorur gjerësisht për të analizuar produktivitetin e punës (për shembull, Fagerberg, 2000; Timmer dhe Szirmai, 2000; Jalava dhe të tjerë, 2002; Van Ark dhe Timmer, 2003). Shpërbërja e normës së rritjes së produktivitetit të punës është si më poshtë:

$$\frac{\Delta LP_t}{LP_t} = \underbrace{\sum_i \overline{LSH_i} \cdot \frac{\Delta LP_i}{\overline{LP_i}}}_{Efekti-brenda-sektoral} + \underbrace{\sum_i \overline{LSH_i} \cdot \left( \frac{\overline{LP_i}}{\overline{LP_t}} - 1 \right) \cdot \frac{\Delta LP_i}{LP_i}}_{Termi-i-konvergjencës} + \underbrace{\sum_i \frac{\overline{LP_i}}{\overline{LP_t}} \cdot \Delta LSH_i}_{Efekti-i-rishpërndarjes-së-punësimit} \quad (5)$$

Ku LP është produktiviteti i punës në ekonomi në kohën t, $\overline{LSH_i}$ është pesha mesatare e punësimit për sektorin i për periudhat 1 dhe 0, $\Delta LP_i$ është diferenca e produktivitetit të punës për sektorin i për të njëjtat periudha, $\overline{LP_i}$ është niveli mesatar i produktivitetit përkatës dhe $\Delta LSH_i$ është diferenca në peshën e punësimit për sektorin i, për periudhat 1 dhe 0.

Të dhënat e përdorura janë produktiviteti i punës, i llogaritur si raporti midis vlerës së shtuar dhe punësimit për çdo sektor si dhe niveli i punësimit. Të dhënat janë vjetore për periudhën 1996-2008 dhe janë marrë nga INSTAT dhe Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për punësimin sipas sektorëve në vitin 2008.

Për sa i përket efekteve të cilat përcaktojnë edhe burimet kryesore të zhvillimeve në produktivitetin e punës, ato përcaktohen si më poshtë:

- Efekti brendasektorial - Rritja e produktivitetit të punës për shkak të përmirësimit të eficiencës së sektorit.

- Termi i konvergjencës – Rritja e produktivitetit të punës për shkak të konvergimit të sektorëve drejt nivelit ekuilibër (mesatarja e ekonomisë).

- Efekti i rishpërndarjes së punësimit - rritja e produktivitetit të punës për shkak të lëvizjes së punësimit nga sektorët joproduktivë drejt atyre produktivë.

Bazuar në këto përkufizime, në rastin e sektorit të bujqësisë i cili ka nivelin më të ulët të produktivitetit të punës, do të pritej zhvillimi i të dy proceseve të mundshme:

- Niveli i ulët i produktivitetit bujqësor do të shoqërohet nga rishpërndarja e faktorit punë nga ky sektor drejt sektorëve me produktivitet më të lartë.
- Në rast se zhvillohet procesi i konvergimit ndërsektoral, atëherë sektori i bujqësisë duhet të reflektojë norma më të larta rritjeje të produktivitetit të brendshëm, në mënyrë që të arrijë mesataren agregate të produktivitetit për të gjithë sektorët.

Ndërkohë që për sektorët e tjerë, zhvillimi i këtyre fenomeneve do të varej nga ecuria e produktivitetit të punës në nivel sektorial dhe gjithashtu edhe nga zhvillimet e përgjithshme në ekonomi. Aplikimi i metodologjisë së prezantuar në këtë pjesë do të paraqitet në vijim.

## *REZULTATET E ZBËRTHIMIT TË RRITJES SË PRODUKTIVITETIT AGREGAT SIPAS EFEKTEVE PËRCAKTUESE TË TIJ*

Grafiku 5 paraqet rezultatet e zbërthimit të rritjes së produktivitetit agregat të punës sipas efektit brendasektorial, termit të konvergjencës dhe efektit të rishpërndarjes së punësimit midis sektorëve.

Grafik 5. Produktiviteti i punës në Shqipëri.




Burimi: Llogaritje të autorit.

Rezultatet sugjerojnë se termi kryesor i cili ka kontribuar në rritjen e produktivitetit të punës në Shqipëri është efekti brendasektorial që nënkupton rritje të produktivitetit për shkak të përmirësimit të eficiencës së sektorit. Në vitin 2001 ka një thyerje strukturore të të dhënave për shkak të ndryshimit të metodologjisë së matjes së punësimit nga INSTAT, ndaj ky vit nuk merret në konsideratë në analizë.

Rezultatet e analizës sugjerojnë se efekti i rishpërndarjes së punësimit nuk ka dhënë një kontribut të lartë në zhvillimet e produktivitetit. Punësimi zyrtar sipas sektorëve vit pas viti është i qëndrueshëm dhe kjo mund të jetë ndikuar nga mospërfshirja e tregut informal të punësimit. Duke përjashtuar bujqësinë për shkak të peshës së lartë që ka në totalin e punësimit, kontribuesi më i madh në efektin e rishpërndarjes së punësimit është sektori i shërbimeve. Niveli i lartë i produktivitetit në këtë sektor është shoqëruar me rritjen e nivelit të punësimit në të. Sektori i ndërtimit tregon gjithashtu një efekt pozitiv të rishpërndarjes së punësimit, sidomos para vitit 2001. Për shkak të rritjes së produktivitetit në këtë sektor, pesha e tij në punësim është rritur konsiderueshëm duke kontribuar pozitivisht në rritjen totale të produktivitetit.

Një ndër arsyet pse sektori i bujqësisë nuk karakterizohet nga norma të larta të lëvizjes së punësimit si mund të pritej, mund të jetë se forca punëtore që duhet të lëvizë, nuk shfaq aftësitë e duhura të cilat kërkohen nga sektorët më produktivë. Ky problem, thekson nevojën për rritjen e aftësive të forcës punëtore, me qëllim stimulimin e produktivitetit dhe rrjedhimisht, edhe të rritjes ekonomike në Shqipëri. Gjithsesi, duke qenë se sektori i bujqësisë është i vetmi sektor me nivelin e produktivitetit më të ulët se niveli mesatar agregat, ai ka konverguar vazhdimisht drejt mesatares së ekonomisë duke pasur norma pozitive të rritjes së produktivitetit. Por nga ana tjetër, sektorët më produktivë (ndërtimi dhe shërbimet) vazhdojnë të kenë norma të larta rritjeje vjetore të eficiencës së tyre dhe pavarësisht konvergimit të sektorit të bujqësisë, ekonomia nuk ka arritur ende një nivel të qëndrueshëm produktiviteti.

Procesi i rritjes së vazhdueshme të sektorëve produktivë i shoqëruar me procesin e konvergimit të sektorit joeficient, pritet të stimulojë një rritje të mëtejshme të produktivitetit në Shqipëri. Kjo do të jetë dhe një bazë e mirë për rritjen e kontributit të faktorit punë në rritjen ekonomike në të ardhmen.

## *PËRFUNDIME*

Burimi kryesor i rritjes ekonomike në Shqipëri ka qenë përmirësimi i TFP, ndërkohë që pas vitit 2000 një rol të rëndësishëm ka luajtur stoku i kapitalit. Rrjedhimisht, për shkak se pas tranzicionit rritja e TFP për shkak të riorganizimit të ekonomisë do të vijë gradualisht drejt zvogëlimit dhe zhvillimet në normën e rritjes së investimeve kanë treguar luhatje nga viti në vit, është e rëndësishme që Shqipëria të krijojë burime alternative të rritjes ekonomike. Në këtë kuadër, akumulimi i kapitalit përmes stimulimit të investimeve merr një rëndësi të veçantë. Gjithashtu, është e rëndësishme të krijohen edhe përmirësime të tjera të TFP nga burime alternative, siç mund të jetë përfitimi nga njohuritë teknologjike, rritja e eficiencës sipërmarrëse gjatë kohës etj. Së fundi, për shkak të konvertimit të sektorëve drejt rritjes së produktivitetit të punës në Shqipëri, është e rëndësishme të përmirësohet cilësia e këtij faktori prodhimi.

## SHËNIME

** Pikëpamjet e shprehura në këtë material janë të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bankës së Shqipërisë.*

*[1] Akronimi i emërtimeve të vendeve është si më poshtë:*
*ALB-Shqipëri, BIH- Bosnje dhe Hercegovinë, BGR-Bullgari, HRV-Kroaci, EST-Estoni, HUN-Hungari, LVA-Letoni, LTU-Lituani, MAC-Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, POL-Poloni, ROM-Rumani, TUR-Turqi.*

*[2] Të dhënat janë një vlerësim dhe janë siguruar në bazë të kërkesës së autorit drejtuar Geoffrey B.Oestreicher, FMN*

REFERENCA

Fagerberg, Jan, (2000), Technological Progress, Structural Change and Productivity Growth: A Comparative Study. Structural Change and Economic Dynamics 11: 393-411.

Iradian Garbis, (2007)," Rapid Growth in Transition Economies: Growth-Accounting Approach" , IMF working paper, No. 164

Jalava, Jukka, S. Heikkinen, and R. Hjerppe, (2002), "Technology and Structural Change: Productivity in the Finnish Manufacturing Industries, 1925-2000". Paper presented at "XIII Economic History Congress," Buenos Aires, 28 June 2002.

Khan Faruk, (2004), "Albania: Growth during Transition and Growth Prospects", Working Paper, World Bank.

Kota, Vasilika, (2009), "Metoda alternative të matjes së produktit potencial në Shqipëri", Material Diskutimi, Banka e Shqipërisë, 3(30).

Kota, Vasilika (2007), "Produktiviteti i punës në Shqipëri: Procesi i konvergimit sektorial", Buletini Ekonomik, Vëllimi 10, Nr. 4, faqe 87-102, Dhjetor 2007.

Maliranta Mika, Ilmakunnas Pekka, (2005), "Decomposing productivity and wage effects of Intra-establishment labor restructuring", Nr. 993.

Timmer, Marcel P. and A. Szirmai, (2000), "Productivity Growth in Asian Manufacturing: The Structural Bonus Hypothesis Examined". Structural Change and Economic Dynamics 11: 371-392.

Van Ark, Bart and M. Timmer, (2003), "Asia's Productivity Performance and Potential: The Contribution of Sectors and Structural Change", Paper presented at the conference "Leading East Asia in the 21st Century," Tokyo, 30 May 2003.

# INDEKSET E KUSHTEVE MONETARE DHE FINANCIARE. RASTI I SHQIPËRISË

Oriela Kodra*, Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë.

## 1. INDEKSET E KUSHTEVE MONETARE DHE FINANCIARE

Indeksi i Kushteve Monetare është paraqitur fillimisht nga Banka e Kanadasë e më pas ka filluar të përdoret nga shumë banka të tjera dhe institucione ndërkombëtare. Ky indeks shërben si një mekanizëm për të interpretuar drejtimin e politikës monetare dhe efektet që ajo ka në ekonomi.

Indeksi i Kushteve Monetare (IKM) vlerëson efektin e kombinuar të treguesve që përfaqësojnë kanalet kryesore të transmetimit të politikës monetare në një ekonomi të hapur: normat reale të interesit dhe kursi real i këmbimit, ku koeficientët e tyre përfaqësojnë efektet përkatëse mbi kërkesën agregate. Qëllimi kryesor i IKM-së është dhënia e një sërë informacionesh shtesë mbi situatën e kushteve monetare të një ekonomie të caktuar. Ai konsideron njëkohësisht ecurinë e normave të interesit dhe të kursit të këmbimit, të shprehura në terma realë. Mund të themi se ky indeks është një mesatare e ponderuar e dy treguesve të sipërpërmendur dhe përcakton nëse kushtet monetare të një ekonomie të caktuar janë "të lehtësuara" apo "të shtrënguara", duke përmbledhur në një shifër të vetme presionin që politika monetare ushtron mbi ekonominë e si rrjedhojë mbi inflacionin. Në një situatë të karakterizuar nga kushte monetare "të lehtësuara", pritet që politika monetare të përkrahë rritjen ekonomike; ndërsa në një situatë me kushte monetare neutrale edhe politika monetare pritet të jetë neutrale.

Duhet theksuar se përbërësit e kushteve monetare jo detyrimisht ndikojnë ekonominë në të njëjtin drejtim. Për shembull, kursi i këmbimit mund të vlerësohet "i lehtësuar" dhe normat e interesit "të shtrënguara", dhe anasjelltas. Në përcaktimin e kushteve monetare, përbërësi i normës së interesit luan rolin kryesor, ndërsa kursi i këmbimit i përshtatet normave të interesit: norma më të ulëta interesi në një periudhë të caktuar nxisin një zhvlerësim të kursit të monedhës vendase, dhe vice versa. Politika monetare ndikon mbi inflacionin nëpërmjet dy drejtimesh: normave të interesit dhe kursit të këmbimit. Një rritje e njëërës prej tyre shkakton një ngadalësim të rritjes ekonomike dhe një ulje të presioneve inflacioniste. Në mënyrë të ngjashme, një ulje e normave të interesit ose e kursit të këmbimit stimulon ekonominë dhe në këtë mënyrë mund të çojë drejt presioneve inflacioniste më të larta. Për këto arsye, duhen konsideruar të dyja këto kanale për ndërtimin e IKM-së.

Indeksi i Kushteve Monetare, në periudhën t, përcaktohet si shuma e ponderuar e ndryshimeve të normës së interesit (i) dhe kursit të këmbimit (e) nga niveli i tyre në vitin bazë (t=0), dhe mund të paraqitet si:

$$MCI = \theta_i (i - i_b) + \theta_e (e - e_b)$$

Ku, $\theta_i$ dhe $\theta_e$ përfaqësojnë respektivisht peshat e normave reale të interesit dhe të kursit real të këmbimit.

Në bazë të studimit të kryer nga Manjola Tase (Gusht 2006), në rastin e Shqipërisë, Indeksi i Kushteve Monetare është mesatarja e ponderuar e ndryshimeve të normës bazë të interesit (REPO) dhe të kursit nominal efektiv të këmbimit të Lekut (NEER) ndaj një periudhe bazë. Raporti i këtij indeksi ishte vlerësuar i barabartë me 1.82:1, që do të thotë se efekti i nënçmimit të kursit të këmbimit me 1.82 pikë përqindje kompensohet nga 1 pikë përqindje rritje të normave të interesit. Periudha bazë e vlerësimit të IKM-së ishte shtator 2000.

Ky vlerësim i raportit të Indeksit të Kushteve Monetare për rastin e Shqipërisë ishte kryer nëpërmjet një metode kalibrimi të ndërtuar nga FMN (2004). Kjo mënyrë mund të vlerësohet disi indirekte dhe jo plotësisht e saktë. Nisur nga nevoja për një mënyrë të re vlerësimi dhe falë të dhënave të disponueshme për një periudhë kohore rreth dhjetëvjeçare, kam përllogaritur peshat mesatare të normave reale të interesit dhe të kursit real të këmbimit për rastin e Shqipërisë. Metodologjia bazohet mbi një vlerësim OLS dhe konsideron të dhëna tremujore për periudhën T1 1998 – T4 2008. Raporti i ri i llogaritur me këtë metodë është i barabartë me 3.8, që do të thotë se efekti i një vlerësimi të kursit real efektiv të këmbimit (REER) me 3.8 pikë përqindje mund të neutralizohet me 1 pikë përqindje rritje të normave reale të interesit.

Të dhënat që janë përdorur për vlerësimin e raportit të IKM-së janë si më poshtë:

- REER, kursi real efektiv i këmbimit të monedhës vendase, i bazuar në Indeksin e Çmimeve të Konsumit të jashtëm dhe të brendshëm;
- Normat reale të bonove të thesarit 3-mujore;
- Normat reale të bonove të thesarit 6-mujore;
- Normat reale të bonove të thesarit 12-mujore;
- Inflacioni;
- Prodhimi i Brendshëm Bruto;
- Output Gap, si përqindje devijimi e PBB-së reale nga PBB-ja potenciale.

Janë ndërtuar tre ekuacione, për bono 3, 6 dhe 12-mujore, ku output gap është treguesi i varur. Në këto ekuacione, Adjusted R-squared ka një vlerë të lartë dhe kjo tregon se një përqindje e lartë e modelit shpjegohet prej treguesve të konsideruar; gjithashtu edhe F-statistic ka vlerë të lartë çka vërteton rëndësinë e modelit; këto tregojnë se modeli është statistikisht i rëndësishëm. Më pas janë kryer testet diagnostike të stabilitetit të koeficientëve dhe të rezidualëve. Pasi është vërtetuar se modelet e përdorura nuk shfaqin probleme, është përllogaritur raporti i koeficienteve të secilit ekuacion. Më pas është kryer një mesatare e thjeshtë e vlerave të përllogaritura, e cila është e barabartë me -3.8. Meqenëse një rritje numerike e REER tregon një zhvlerësim të Lekut, atëherë kjo vlerë do të shumëzohet me (-1), duke arritur në konkluzionin se raporti i ri i Indeksit të Kushteve Monetare është i barabartë me 3.8.

Gjithashtu duhet konsideruar edhe Indeksi i Kushteve Financiare (IKF) i cili vlerëson kushtet financiare të një vendi. Në këtë rast konsiderohet ecuria e normave reale të kredive për të analizuar aktivitetin financiar. Në rastin e IKF-së përdoret i njëjti raport me Indeksin e Kushteve Monetare.

## 2. ECURIA E IKM DHE IKF

### Indeksi i Kushteve Monetare

Për të ndërtuar Indeksin e Kushteve Monetare për rastin e Shqipërisë janë përdorur të dhëna mujore dhe analizohet periudha Janar 1996 – Prill 2010. Periudha bazë e vlerësimit për IKM-në është Janar 1996, dhe shprehet si më poshtë:

IKM = (B_Reale - B_Reale(bazë)) * 3.8 + (log(REER) – log(REER)(bazë)) + 100

Ku:

- B_Reale është norma reale mesatare e bonove të thesarit;
- B_Reale(bazë) është norma reale e bonove të thesarit në vitin bazë;
- REER është kursi real efektiv i këmbimit;
- (REER)(bazë) është kursi real efektiv i këmbimit në vitin bazë.

Një rritje e Indeksit të Kushteve Monetare tregon një përkeqësim të kushteve monetare; në të kundërt një ulje e këtij indeksi sugjeron se kushtet monetare të ekonomisë janë përmirësuar në krahasim me vitin bazë. Në grafikun e mëposhtëm mund të shohim ecurinë e IKM-së për periudhën Janar 2006 - Prill 2010, duke e krahasuar edhe me ecurinë e REER dhe të normave reale të bonove të thesarit.

Grafik 1. IKM në krahasim me REER dhe normat reale të interesit.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në këtë grafik shohim se aktiviteti monetar, gjatë vitit 2007 deri në tremujorin e tretë të vitit 2008, ndryshe nga kushtet mesatare të 15 viteve të fundit, ka shfaqur përmirësime të rëndësishme. Këto përmirësime kanë ardhur si rrjedhojë e zhvlerësimit të kursit të këmbimit, i cili përkthehet në kushte ekonomike të lehtësuara dhe si rrjedhojë e uljes së lehtë e normave reale të interesit. Fillimi i krizës financiare karakterizohet nga kushte monetare të shtrënguara, kryesisht për shkak të rritjes së normës reale të interesit të bonove të thesarit. Në muajt e parë të vitit 2010 shohim se pas një periudhe të karakterizuar nga kushte monetare të përmirësuara, që prej muajit mars ky indeks shpreh një shtrëngim të kushteve monetare; ky përkeqësim vjen si efekt i rritjes së mëtejshme të normave të interesit të bonove të thesarit në terma reale; ndërkohë që monedha vendase vazhdon të karakterizohet nga një zhvlerësim i mëtejshëm i saj.

Indeksi i Kushteve Financiare

Për të ndërtuar Indeksin e Kushteve Financiare për rastin e Shqipërisë janë përdorur të dhëna mujore dhe analizohet periudha Gusht 2000 – Prill 2010. Periudha bazë e vlerësimit për IKF-në është Gusht 2000, dhe shprehet si më poshtë:

IKF = (Kr_Reale - Kr_Reale(bazë)) * 3.8 + (log(REER) – log(REER)(bazë)) + 100

Ku:

- Kr_Reale është norma reale mesatare e kredive;
- Kr_Reale(bazë) është norma reale e kredive në vitin bazë;
- REER është kursi real efektiv i këmbimit;
- (REER)(bazë) është kursi real efektiv i këmbimit në vitin bazë.

Grafik 2. IKF në krahasim me REER dhe normat reale të kredive.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në këtë grafik vërejmë se, ndryshe nga termat mesatare të 15 viteve të fundit, aktiviteti financiar është karakterizuar nga përmirësime të rëndësishme në periudhën 2007 deri në tremujorin e tretë 2008. Por me fillimin e krizës financiare edhe aktiviteti financiar karakterizohet nga kushte të shtrënguara dhe kjo për shkak të rritjes së normave reale të kredive. Vetëm pas mesit të vitit 2009 kushtet financiare fillojnë të përmirësohen si rrjedhojë e nënçmimit të lekut dhe e rënies së normave reale të kredive.

** Pikëpamjet e shprehura në këtë material janë të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bankës së Shqipërisë.*

REFERENCA

Tase, M. (2006), "Vlerësimi i Indeksit të Kushteve Monetare/Financiare për Shqipërinë", Banka e Shqipërisë, material i pa publikuar.

Muço, M, Sanfey, P and Taçi, A. (2004), "Inflacioni, kurset e këmbimit dhe roli i politikës monetare në Shqipëri", EBRD, Working Paper Nr: 88.

Kolasi, G, Shijaku, H and Shtylla, D. (2007), "Mekanizmi i transmisionit i politikës monetare në Shqipëri", Banka e Shqipërisë, Kërkime dhe materiale diskutimi, Korrik 2007.

Vika, I. (2007), "Roli i Bankave në Transmetimin e Politikës Monetare në Shqipëri", Working Papers, Materiale jo- periodike, 2009.

Shijaku, H. (2007), "An Investigation of Monetary Policy Trasmission Mechanism in Albania", Lambert Academy Publishing, 2010.

Peters, M. (2005), "Çfarë mund të thuhet për transmetimin e politikës monetare në Shqipëri? A është (akoma) kursi i këmbimit kanali kryesot?", Konferenca e Pestë e Bankës së Shqipërisë, Mars 2005.

Kesriyeli, M and Kocaker, I.I. (1999), "Monetary Conditions Index: A monetary policy indicator for Turkey", Central Bank of Turkey Discussion Paper, No: 9908.

Torój, A. (2008), "Estimation of Weights for the Monetary Conditions Index in Poland", Department of Applied Econometrics Working Papers, Working Paper No. 6-08.

Chang, H.S. (2005), "Estimating the Monetary Policy Reaction Function for Taiwan: A VAR Model", The International Journal of Applied Economics, 2005, Vol.2, issue 1, 50-61.

Jacobson, T. (1999), "A VAR Model for Monetary Policy Analysis in a Small Open Economy", Journal of Applied Econometrics, 2001, 487-520.

Lack, C.P. (2003), "A financial conditions index for Switzerland", Monetary policy in a changing environment, Bank for International Settlements, 2003, vol.19, 398-413.

# BANKA E SHQIPËRISË NË HARKUN KOHOR TETOR - DHJETOR 2009

*Forumi i Tretë i Hapur me sistemin bankar në Shqipëri*

Në vijim të takimit teknik të zhvilluar me bankat gjatë muajit gusht, në datën 13 tetor 2009, Banka e Shqipërisë organizoi Forumin e Tretë të Hapur të sistemit bankar shqiptar. Si edhe në forumet e mëparshme të kësaj natyre, të pranishëm ishin drejtues dhe specialistë të Bankës së Shqipërisë dhe të bankave që operojnë në sistemin bankar shqiptar.

Diskutimet u ndalën në një sërë çështjesh të rëndësishme jo vetëm të momentit, por edhe lidhur me pritshmëritë për të ardhmen. Kështu, linja e parë e diskutimit e trajtuar gjatë Forumit lidhej me përgjegjshmërinë në drejtim, e parë kjo në kuadër të forcimit të sistemeve të kontrollit, përmirësimit të kapaciteteve të administrimit të rrezikut, investimeve në burime njerëzore dhe teknologji, si dhe të transparencës me klientin dhe me tregun. Linja e dytë e diskutimeve trajtoi zhvillimin e veprimtarisë, duke u ndalur në vendosjen e një ekuilibri më të mirë përsa i takon përbërjes së aktiv-pasive sipas monedhës, afatit të maturimit, normës së interesit; qëndrueshmërinë e burimeve të financimit dhe zgjidhjen e sfidave të likuiditetit; dhe ciklikalitetin dhe nevojën për trajtimin e tij. Në përfundim, duke diskutuar mbi pritshmëritë e sistemit bankar për të ardhmen, u fol për zhvillimet kryesore në standardet ndërkombëtare dhe shkallën e ndikimit të tyre në veprimtarinë bankare dhe kuadrin rregullativ mbikëqyrës, si dhe për mënyrën me të cilën pritet që këto zhvillime të ndikojnë veprimtarinë bankare në afat të shkurtër dhe të mesëm.

*Takim i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani me Zëvendësministrin e Zhvillimit Ekonomik të Republikës së Italisë, z. Adolfo Urso*

Në datën 14 tetor 2009, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë z. Ardian Fullani, zhvilloi një takim me Zëvendësministrin e Zhvillimit Ekonomik të Republikës së Italisë, z. Adolfo Urso, në krye të një delegacioni të përbërë nga përfaqësues të kompanive të ndryshme italiane, të cilët morën pjesë në panairin Fiera del Levante të organizuar në Tiranë, në datat 14-17 tetor 2009.

Guvernatori Fullani njohu delegacionin italian me zhvillimet kryesore në ekonominë shqiptare dhe me masat konkrete që ka ndërmarrë Banka e Shqipërisë për ruajtjen e stabilitetit makroekonomik dhe financiar të vendit, dhe minimizimin e efekteve të krizës botërore, duke ndikuar në zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë dhe krijimin e një klime pozitive biznesi. Nga ana e tij, Zëvendësministri Urso vlerësoi reformat e kryera nga Shqipëria, e cila ka hedhur hapa të fuqishëm dhe të konsoliduar vitet e fundit në shumë drejtime, ku padyshim një kontribut të veçantë ka dhe Banka e Shqipërisë, si autoriteti monetar i vendit me politika të kujdesshme dhe vizionare. Duke përfituar nga rasti, Guvernatori Fullani ka ftuar investitorët italianë të vazhdojnë mbështetjen dhe investimet e tyre në Shqipëri, e cila ofron një potencial të fuqishëm, me burime natyrore ende të pashfrytëzuara, kapital njerëzor të kualifikuar dhe infrastrukturë moderne në zhvillim.

*Leksion i Guvernatorit në Universitetin e Prishtinës*

Në datë 29 tetor 2009, në kuadër të pjesëmarrjes në konferencën e organizuar me rastin e 10-vjetorit të krijimit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani ka dhënë një leksion në Universitetin e Prishtinës, me temë "Ekonomia shqiptare përballë sfidave të kohës dhe perspektivës evropiane". Në këtë leksion morën pjesë studentë të Fakultetit Ekonomik dhe atij Juridik të Universitetit të Prishtinës si dhe stafi pedagogjik i këtij universiteti.

*Leksion i Guvernatorit në Universitetin Bujqësor të Tiranës dhe "Dita e Bankës"*

Në datën 16 nëntor 2009, me ftesë të z. Drini Salko, Përgjegjës i Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani mbajti në Universitetin Bujqësor të Tiranës leksionin me temë "Politikat e Bankës së Shqipërisë në kuadrin e krizës globale". Duke folur për krizën globale dhe ndikimet e saj në ekonominë shqiptare, Guvernatori Fullani u ndal në mënyrë të veçantë mbi rëndësinë dhe nevojën e ndjekjes së politikave agrare të përshtatshme për të stimuluar ekonominë.

Leksioni i Guvernatorit Fullani u shoqërua edhe me organizimin e "Ditës së Bankës" në Universitetin Bujqësor të Tiranës. Gjatë këtij aktiviteti, studentët por edhe akademikët e universitetit u njohën më nga afër me botimet e Bankës së Shqipërisë. Me këtë rast, atyre iu shpërndanë shumë raporte dhe buletine periodike, materiale studimi dhe kumtesa të konferencave shkencore, broshura edukative dhe fletëpalosje informuese, të cilat publikohen nga Banka e Shqipërisë në kuadër të transparencës dhe përgjegjshmërisë për informimin e publikut.

*Forumi i Bankës së Shqipërisë me përfaqësuesit e bizneseve kryesore që operojnë në Shqipëri*

Në kuadër të zhvillimit të dialogut të hapur me aktorët e ndryshëm të ekonomisë si dhe nisur nga zhvillimet e fundit në ekonominë shqiptare dhe atë botërore, në datën 23 nëntor 2009, Banka e Shqipërisë organizoi një takim me përfaqësuesit e bizneseve kryesore që operojnë në Shqipëri.

Si pjesa më dinamike e ekonomisë shqiptare, kontributi i biznesit ka qenë i prekshëm në zhvillimin ekonomik të vendit gjatë viteve të tranzicionit. Iniciativa, vullneti dhe përkushtimi i këtij sektori kanë sjellë rezultate të prekshme në zhvillimin e vendit. Duke vlerësuar kontributin e sektorit të biznesit, Forumi i Bankës së Shqipërisë diskutoi çështje që lidhen me situatën aktuale të ekonomisë shqiptare, daljen e vendit nga kriza dhe vështirësitë potenciale që mund të ketë ekonomia jonë gjatë vitit 2010. Gjithashtu, Forumi synoi fillimin e një diskutimi të gjerë publik mbi alternativat e modeleve të rritjes ekonomike në të ardhmen.

*Takimi "Ndërtimi i kapaciteteve për hartimin dhe zbatimin e politikave"*

Në datat 3-4 dhjetor 2009, Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me Center of Excellence in Finance (CEF) – Sllloveni, si dhe me mbështetjen e Komisionit Evropian, Bankës Qendrore Evropiane dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar, organizoi takimin "Ndërtimi i kapaciteteve për hartimin dhe zbatimin e politikave". Ky takim adresoi sfidat kryesore që shoqërojnë hartimin dhe ankorimin e politikave, me një theks të veçantë në ndërtimin e kapaciteteve individuale dhe institucionale në këtë fushë shumë të rëndësishme.

Takimi u organizua për herë të parë në Shqipëri dhe mblodhi përfaqësues nga bankat qendrore dhe ministritë e financave të vendeve të Evropës Juglindore si: Bosnje – Hercegovina, Bullgaria, Kosova, Kroacia, Mali i Zi, Maqedonia, Moldavia, Rumania, Turqia, Serbia, Shqipëria. Lektorët kryesorë ishin nga Center of Excellence in Finance (CEF), Komisioni Evropian, Banka Qendrore Evropiane dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar.

Në fjalën e tij të hapjes, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani theksoi rëndësinë e ndërtimit të politikave të duhura ekonomike për të identifikuar, modelin e ri të rritjes ekonomike, post krizë, në qendër të të cilit do të jetë thithja e kapitalit të huaj në rajon. Ai sugjeroi ndërmarrjen e politikave fiskale që shmangin rrezikun si dhe ndërmarrjen e reformave të duhura strukturore për përmirësimin e mjedisit të biznesit, të cilat natyrshëm do të ndihmojnë në rritjen e flukseve të reja hyrëse të kapitalit dhe do të çojnë drejt një rritjeje të fuqishme dhe të qëndrueshme të tyre.

Gjatë diskutimit me pjesëmarrësit, Guvernatori Fullani parashtroi nevojën për të kthyer institucionet evropiane dhe procesin e integrimit në një ankorë të jashtme të mirëfilltë, të fortë dhe eficiente. Sipas Guvernatorit, forcimi i ankorave të jashtme në një periudhë afatmesme është një domosdoshmëri, dhe politikat evropiane apo vetë institucionet e BE-së mund dhe duhet ta luajnë këtë rol. Njësoj të rëndësishme janë dhe ankorat e brendshme të vendeve të rajonit, duke nënkuptuar hartimin e politikave ekonomike financiare të shëndosha nga njëra anë dhe krijimin e kapaciteteve të duhura për asimilimin dhe zbatimin e tyre në praktikë nga ana tjetër.

*Faza finale e konkursit "Vlera e vërtetë e parasë" për vitin shkollor 2008-2009*

Në datën 13 dhjetor 2009, në sallën kryesore të Akademisë së Arteve në Tiranë u organizua takimi final i konkursit "Vlera e vërtetë e parasë" për vitin shkollor 2008-2009. Konkursi "Vlera e vërtetë e parasë" është një sfidë midis ekipeve të shkollave të mesme, mbi njohuritë e tyre për Bankën e Shqipërisë, politikën e saj monetare, instrumentet që ajo përdor si dhe ndikimin e vendimeve të bankës qendrore në ekonominë e vendit.

Të vendosura përballë Jurisë së Konkursit, të kryesuar nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani, ishin shkollat fituese të këtij konkursi për rrethet e Vlorës, Shkodrës, Korçës, Gjirokastrës dhe Tiranës. Kështu, rrethet e mësipërme u përfaqësuan nga shkollat: "Ali Demi' - Vlorë; "28 Nëntori" - Shkodër; "Themistokli Gërmenji" – Korçë; "Siri Shapllo" – Gjirokastër; dhe "Tirana Jonë" – Tiranë. Përveç pyetjeve të shpejta, finalistëve të konkursit iu desh ta vendosnin veten në pozitat e Këshillit Mbikëqyrës të një banke qendrore, për të analizuar situatën hipotetike të ekonomisë së një vendi dhe për të marrë një vendim mbi normën bazë të interesit të politikës monetare. Në përfundim të konkurrimit, Juria e Bankës së Shqipërisë i vlerësoi skuadrat jo vetëm mbi njohuritë e tyre, por edhe mbi aftësitë analitike të argumentimit të përgjigjeve dhe punës në grup dhe bazuar në pikët e grumbulluara shpalli fituese të konkursit shkollën "Themistokli Gërmenji" nga qyteti i Korçës.

*Takim i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani, me gazetarë, analistë dhe drejtues të mediave, 22 dhjetor 2009*

Me rastin e mbylljes së vitit, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë z. Ardian Fullani zhvilloi një takim me gazetarë të njohur të shtypit të shkruar dhe medias elektronike, analistë të politikës dhe të ekonomisë, drejtues dhe përfaqësues të tjerë të mediave në Shqipëri. Guvernatori vlerësoi kontributin e gazetarëve për përcjelljen e mesazheve të Bankës së Shqipërisë dhe shprehu besimin e tij se edhe në të ardhmen analizat dhe komentet mediatike do të vazhdojnë të jenë objektive dhe realiste.

Fillimisht, Guvernatori ravijëzoi një ekspoze të ekonomisë shqiptare, duke theksuar se 2009 ishte një vit, i cili u karakterizua nga shumë ngjarje përfshirë këtu edhe krizën globale. Ai theksoi se falë punës së Bankës së Shqipërisë është bërë e mundur ruajtja dhe konsolidimi i stabilitetit makroekonomik të vendit si dhe i qëndrueshmërisë financiare të sistemit bankar. Përveç kontributit të saj në ruajtjen dhe konsolidimin e stabilitetit makroekonomik të vendit, Banka e Shqipërisë është e përfshirë edhe në shumë projekte të tjera, të cilat kanë një vlerë specifike të shtuar për gjithë shoqërinë shqiptare. Në këtë kontekst, Guvernatori prezantoi disa nga angazhimet e bankës qendrore për edukimin e publikut, për inaugurimin e Institutit të Kërkimeve të Bankës së Shqipërisë në qytetin e Beratit dhe për prezantimin e kalendarit 2010 të Bankës së Shqipërisë, si një mënyrë për promovimin e qyteteve ilire dhe monedhave që janë prerë dhe përdorur në to.

*Seminari i të Premtes*

Departamenti i Kërkimeve në Bankën e Shqipërisë organizon dy herë në muaj të ashtuquajturin "Seminari i të Premtes". Kjo iniciativë fton nëpunësit e Bankës së Shqipërisë, kërkuesit e sferës akademike dhe të institucioneve të tjera financiare, kërkimore dhe shkencore, të prezantojnë dhe diskutojnë me njëri-tjetrin materialet e tyre kërkimore teorike dhe empirike, me fokus mbi rastin e Shqipërisë dhe mbi aplikimin e metodave më të reja kërkimore.

Pjesë e Seminarit të të Premtes, gjatë tremujorit të fundit të vitit 2009, kanë qenë pesë studime. Punimi i parë i prezantuar ishte ai i Lorina Green dhe Rezart Erindi, Departamenti i Operacioneve Monetare të Bankës së Shqipërisë, me temë "Përdorimi i modelit KMV-Merton për të parashikuar mundësinë e dështimit të firmave në shlyerjen e borxhit të emetuar". Për shkak të shtimit të produkteve të borxhit të emetuar nga firmat dhe të përdorimit gjithnjë e më të madh të derivatëve të kreditit ka pasur një interes në rritje për modele që parashikojnë mundësinë e dështimit të firmave në shlyerjen e borxhit të tyre. Një model që sjell risi në parashikime, i aplikuar gjerësisht si në praktikë ashtu dhe në kërkimet akademike, është një zbatim i veçantë i modelit të Merton-it (1974) zhvilluar nga korporata KMV. Ky material ka si qëllim prezantimin e këtij modeli dhe parashtron mundësinë për vënien në përdorim të tij brenda Bankës së Shqipërisë.

Studimi i radhës me autorë Rezart Erindi dhe Valbona Luga, Departamenti i Operacioneve Monetare të Bankës së Shqipërisë, titullohej "Përzgjedhja e benchmark-ut strategjik. Aspekte teorike dhe praktike". Përzgjedhja e benchmark-ut strategjik mund të përshkruhet si procesi nëpërmjet të cilit një institucion vendos për mënyrën e shpërndarjes neutrale të investimit

(instrumenteve financiare) në çdo moment të kohës, për të arritur objektivat afatgjata të investimit. Në këtë material, autorët përqendrohen në hapat e fundit të procesit duke përshkruar metodologjinë që ndiqet për ndërtimin e propozimeve për benchmark-un strategjik dhe vlerësimin në kohë të kësaj metodologjie. Gjithashtu, ata përcaktojnë dhe klasat e instrumenteve të lejuara për investim.

Në muajin nëntor, Armela Mançellari nga Departamenti i Kërkimeve të Bankës së Shqipërisë, prezantoi materialin "Nowcasting GDP - Vlerësimi afatshkurtër i PBB-së reale". Qëllimi i këtij materiali është ndërtimi i modeleve për parashikimin afatshkurtër të vlerës së PBB-së së vendit për tremujorin aktual. Meqenëse, të dhënat mbi PBB-në tremujore në Shqipëri publikohen me 12 javë vonesë, për të realizuar një vendimmarrje të mirinformuar nevojitet parashikimi i ecurisë së këtij treguesi përpara publikimit të tij. Autorja përdor të dhëna nga: shitjet reale, shitja dhe riparimi i automjeteve dhe komponentët e indekseve të besimit, për të parashikuar PBB-në e tremujorit aktual me ndihmën edhe të modeleve ekonometrike.

"A ekziston multiplikatori i politikës fiskale? Reagimet fiskale dhe monetare, kredibiliteti dhe multiplikatorët fiskalë në Hungari" ishte studimi i prezantuar nga Zoltan Jakab, Drejtor i Analizës Makroekonomike, Zyra e Këshillit Fiskal, Republika e Hungarisë. Materiali ka për qëllim vlerësimin e multiplikatorëve të politikës fiskale në Hungari nëpërmjet përdorimit të modelit DSGE. Rezultatet tregojnë se multiplikatorët e treguesve të ndryshëm të politikës fiskale ndryshojnë nga njëri tjetri. Ata ndryshojnë edhe kur merren parasysh mënyrat se si do të financohet ekspansioni i politikës fiskale në të ardhmen. Perceptimi i agjentëve të ekonomisë mbi vazhdueshmërinë e stimulit fiskal ka një ndikim të rëndësishëm mbi multiplikatorët. Gjetjet sugjerojnë se në një ekonomi të vogël dhe të hapur, ku politika monetare reagon më së shumti ndaj inflacionit, akomodimi që ajo i bën politikës fiskale nuk ka ndikim mbi multiplikatorët fiskalë.

Për vitin 2009, "Seminari i të Premtes" u mbyll me diskutimin e materialit me temë "Modelimi i PBB-së tremujore - roli i treguesve ekonomikë dhe atyre të vrojtimeve", i punuar nga Evelina Çeliku, Ermelinda Kristo, Merita Boka, Departamenti i Politikës Monetare në Bankën e Shqipërisë. Qëllimi i materialit është vlerësimi në terma afatshkurtër i prirjes së PBB-së tremujore në rastin e Shqipërisë nëpërmjet tri përqasjeve kryesore: a. Modele Arima me përbërës sezonalë; b. Modele indikatore – urëlidhës; dhe c. Modele VAR. Këto modele kanë mundësuar përfitimin e vlerësimeve paraprake mbi dinamikat e aktivitetit ekonomik rreth prirjes kryesore për tremujorin referues (nowcast) dhe për deri në dy tremujorë në vijim (parashikim). Materiali arrin në përfundimin se variablat nga vrojtimet përmbajnë informacion të vlefshëm për parashikimet afatshkurtra të PBB-së tremujore. Gjithashtu, parashikimi "më i mirë", merret nga mesatarja e parashikimeve nga modelet e ndryshme (pa përfshirë modelet ARIMA). Së fundi, performanca e parashikimit jashtë periudhës do të jetë ajo që do të luajë rol ponderues në përzgjedhjen e modeleve më të përshtatshme në llogaritjen e parashikimit mesatar.

# KRONOLOGJI E VENDIMEVE TË POLITIKËS MONETARE

12 korrik 2006

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendos të rrisë normën bazë të interesit me 0.25 pikë përqindjeje, në 5.25 për qind.

30 nëntor 2006

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendos të rrisë me 0.25 pikë përqindjeje normën bazë të interesit, në 5.5 për qind.

04 prill, 02 maj dhe 06 qershor 2007

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendos të mbajë të pandryshuar normën bazë të interesit, në 5.5 për qind.

27 qershor 2007

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendos të rrisë me 0.25 pikë përqindjeje normën bazë të interesit në 5.75 për qind.

19 korrik dhe 29 gusht 2007

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendos të mbajë të pandryshuar normën bazë të interesit në 5.75 për qind.

26 shtator 2007

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendos të rrisë me 0.25 pikë përqindjeje normën bazë të interesit në 6.00 për qind.

31 tetor 2007

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendos të mbajë të pandryshuar normën bazë të interesit në 6.00 për qind.

27 nëntor 2007

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendos të rrisë me 0.25 pikë përqindjeje normën bazë të interesit në 6. 25 për qind.

27 dhjetor 2007

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendos të mbajë të pandryshuar normën bazë të interesit në 6.25 për qind.

30 janar, 27 shkurt, 26 mars, 30prill, 27 maj, 25 qershor, 30 korrik, 29 gusht, 29 shtator, 29 tetor, 26 nëntor dhe 24 dhjetor 2008

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendos të mbajë të pandryshuar normën bazë të interesit, në 6.25 për qind, gjatë gjithë vitit 2008.

28 janar 2009

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendos të ulë me 0.50 pikë përqindjeje normën bazë të interesit, në 5.75 për qind.

25 shkurt, 25 mars, 29 prill, 17 maj, 24 qershor, 29 korrik, 26 gusht dhe 30 shtator 2009

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendos të mbajë të pandryshuar normën bazë të interesit në 5.75 për qind.

28 tetor 2009

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendos të ulë me 0.50 pikë përqindjeje normën bazë të interesit, në 5.25 për qind.

25 nëntor dhe 23 dhjetor 2009

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendos të mbajë të pandryshuar normën bazë të interesit në 5.25 për qind.

# NGJARJET JURIDIKE, TETOR - DHJETOR 2009

## STABILITETI FINANCIAR

Në datën 14.10.2009, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi me vendimin nr. 72, deklaratën "Mbi stabilitetin e sistemit financiar në Shqipëri për gjashtëmujorin e parë të vitit 2009". Në deklaratë konstatohet se, nën ndikimin e efekteve të krizës financiare ndërkombëtare dhe si rezultat i rënies së depozitave në banka dhe rritjes së kërkesës për borxh nga ana e qeverisë, sektori bankar në vend tkurri vëllimin e financimit për ekonominë e vendit në përgjigje të kërkesës së rritur për likuiditet. Gjatë këtij gjashtëmujori, zhvillimi i sistemit financiar në vend u ndikua prej ndalesës së rritjes së sektorit bankar, ndërsa pjesa tjetër e tregut financiar ka shënuar një rritje të mirë të veprimtarisë. Sidoqoftë, në fund të kësaj periudhe, sektori bankar shënoi një rezultat financiar pozitiv në vlerën 0.66 miliardë lekë dhe kapitalizimi i veprimtarisë ka mbetur i qëndrueshëm e në nivele të kënaqshme.

## POLITIKA MONETARE

Në datën 28.10.2009, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi vendimin nr. 76 "Për uljen me 0,50 pikë për qind të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes". Përmes uljes me 0.50 pikë përqindje, me një normë bazë interesi që zbret nga 5.75 në 5.25 për qind, Banka e Shqipërisë synon të krijojë premisa për kreditimin e ekonomisë si dhe të vazhdojë procesin e minimizimit të efekteve të krizës financiare ndërkombëtare, duke mbështetur aktivitetin ekonomik të vendit.

## MBIKËQYRJA BANKARE

Në datën 14.10.2009, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi me vendimin nr. 71 rregulloren "Për administrimin e rrezikut të likuiditetit". Rregullorja ka objekt të saj përcaktimin e kërkesave dhe standardeve minimale për administrimin efektiv të rrezikut të likuiditetit nga bankat, përmes ngritjes së një sistemi i cili duhet të përfshijë: strategjinë dhe politikat e hartuara nga banka për administrimin e këtij rreziku; strukturën organizative dhe kontrollin e brendshëm, si dhe planin e emergjencës.

Në datën 11.11.2009, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi me vendimin nr. 78, rritjen e pjesëmarrjes influencuese të Çalik Holding A.S. Turqi (aksioner i tërthortë), nga 25.2 në 45.6 për qind në kapitalin aksioner të Bankës Kombëtare Tregtare sh.a.

## EMISIONI

Në datën 14.12.2009, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi vendimin nr. 85 "Për tërheqjen nga qarkullimi të disa monedhave me kurs ligjor". Sipas vendimit, kartëmonedha e prerjes 500 Lekë, emetim i vitit 1991, 1992, 1993, 1996, 1997, imazhi lule dielli dhe kartëmonedha e prerjes 500 Lekë, emetim i vitit 1992, 1994, 1996, imazhi i Naim Frashërit, do të kenë kurs ligjor deri në datën 30.06.2010. Këto kartëmonedha do të mblidhen për këmbim kundrejt pagesës së vlerës fillestare të emetimit, me kartëmonedha dhe monedha të tjera me kurs ligjor, deri në datën 31.12.2012.

## POLITIKAT EKONOMIKE

Në datën 14.10.2009, Këshilli i Ministrave miratoi me vendimin nr. 1011 "Marrëveshjen e grantit PHRD, No. TF 093096, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për përgatitjen e projektit të qeverisjes, financave dhe dhënies së shërbimeve bashkiake". Projekti, për zbatimin e të cilit do të përdoret granti prej nëntëqind e tetëdhjetë mijë dollarësh (980, 000 USD), është faza e parë e një programi afatgjatë për bashkitë në Shqipëri, që synon të arrijë qëndrueshmëri në sigurimin e shërbimeve bashkiake, nëpërmjet forcimit të financave të qeverisjes vendore. Granti do të përdoret për të financuar aktivitete që synojnë të mbështesin dhe përmirësojnë shërbimet e ujërave, kanalizimeve, rrugët lokale, administrimin e mbetjeve inerte, etj.

Në datën 15. 10.2009, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 10 157 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet", të ndryshuar". Ndryshimet parashikojnë ngritjen e Agjencisë së Koncesioneve, si një institucion publik buxhetor, i ngarkuar me mbikëqyrjen e verifikimin e zbatimit të procedurave të koncesioneve, hetimin administrativ dhe propozimin e masave disiplinore në raste shkeljesh.

Në datën 15.10.2009, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 10 158 "Për obligacionet e shoqërive aksionere dhe të qeverisjes vendore". Ligji përcakton llojet, mënyrat e shpërndarjes dhe maturimin e obligacioneve të emetuara nga shoqëritë aksionere dhe qeveria vendore. Ai rregullon organizimin dhe funksionet e grupit të zotëruesve të obligacioneve, kujdestarit dhe agjentit të zotëruesve të obligacioneve.

Në datën 14.10.2009, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 1020 "Për krijimin e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian". Agjencia, e cila ka objektiv të veprimtarisë së saj auditimin dhe kontrollin e zbatimeve të programeve të asistencës të akredituar nga Bashkimi Evropian, është përgjegjëse për funksionimin efikas e të shëndoshë të sistemit të menaxhimit të asistencës dhe funksionalisht e pavarur nga të gjithë aktorët e këtij sistemi.

Në datën 15.10.2009, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ratifikoi me ligjin nr. 10 155 "Marrëveshjen ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës për bashkëpunim në luftën kundër krimit". Përmes kësaj marrëveshjeje, ndër të tjera, të dy vendet angazhohen të bashkëpunojnë më ngushtësisht në luftën kundër formave të ndryshme të krimit financiar si: kontrabandës, pastrimit të parave, falsifikimit dhe shpërndarjes mashtruese të monedhës dhe mjeteve të tjera të pagesës, si dhe akteve kriminale kundër financave publike përfshirë dhe invazionin fiskal.

Në datën 15.10.2009, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ratifikoi me ligjin nr. 10 162 "Marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Çekisë për bashkëpunim në luftën kudër krimit". Përmes nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, qeveritë e dy vendeve synojnë të përmirësojnë bashkëpunimin për parandalimin dhe zbulimin e krimit dhe formave të ndryshme të tij si: krimet kundër jetës, terrorizmin dhe financimin e tij, korrupsionin dhe kontrabandën, transaksionet financiare të paligjshme, etj.

Në datën 21.10.2009, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 1081 "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit". Sipas këtij vendimi, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit është përgjegjës për planifikimin dhe bashkërendimin e kontrollit zyrtar të ushqimeve, ushqimeve për kafshët, si dhe për mbrojtjen e bimëve në shkallë vendi.

Në datën 22.10. 2009, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 10 169 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9482 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar". Ndryshimet përcaktojnë që pagesa e parcelës ndërtimore e ndërtimit pa leje në proces legalizimi mund të bëhet me bono privatizimi, deri në 50 për qind të vlerës së saj. Kjo mënyrë pagese vlen për ndërtesa të ngritura brenda vijës së verdhë, jashtë saj, si dhe në territore të tjera.

Në datën 27.10.2009, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi me ligjin nr. 1077, dokumentin strategjik kombëtar "Për hetimin e krimit financiar". Dokumenti synon të krijojë një platformë afatgjatë veprimi dhe të luftojë në mënyrë të pandërprerë krimin ekonomiko-financiar, pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, përmes hartimit të legjislacionit me standarde evropiane, rritjes së efektivitetit të kontrollit të zbatimit të këtij legjislacioni dhe rritjes së bashkëpunimit ndërinstitucional.

Në datën 29.10.2009, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 10 180 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen për të drejtën e patentave të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale". Përmes këtij ligji, Republika e Shqipërisë aderon në Marrëveshjen e Ligjit për Patentat, miratuar në Gjenevë, më 1 qershor 2000. Dispozitat e kësaj marrëveshjeje dhe rregullat që dalin prej tyre zbatohen në aplikimet ndërkombëtare për patentat e shpikjes dhe për patentat shtesë, ashtu si dhe për patentat kombëtare dhe rajonale të shpikjeve, për ato kombëtare dhe rajonale shtesë.

Në datën 29. 10.2009, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ratifikoi me ligjin nr. 10 181 "Marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar". Përmes kësaj marrëveshje, Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i jep mundësinë Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW), Frankfurt mbi Majn, një shumë financimi me vleftë prej shtatë milionë e pesëqind mijë euro (7 500 000 euro) për projektin "Programi i mbrojtjes së mjedisit të liqenit të Shkodrës".

Në datën 29.10.2009, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 10 183 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9374 "Për ndihmën shtetërore". Ky ligj e pasuron ligjin "Për ndihmën shtetërore"me parimet dhe procedurat sipas të cilave lejohet dhe kontrollohet ndihma shtetërore për punonjësit në vështirësi dhe me aftësi të kufizuara, ndihma për mbrojtjen e mjedisit dhe ajo për riskun e kapitalit.

Në datën 29.10.2009, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 10 179 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Patentave Evropiane". Kjo Konventë vendos, për të gjithë shtetet aderues, një sistem ligjor të përbashkët për dhënien e patentave për shpikjet, procedura unike dhe disa rregulla standarde që rregullojnë patentat e dhëna në këtë mënyrë.

Në datën 05.11.2009, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 10 186 "Për rregullimin e pronësisë mbi truallin shtetëror në zonat me përparësi turizmin". Ligji synon të rregullojë marrëdhëniet e pronësisë mbi truallin dhe objektet e ndërtuara në zonat e stimuluara me përparësi turizmin, që janë dhënë për realizimin e veprimtarive të stimuluara, të krijuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Në datën 20.11.2009, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 10 168 "Për miratimin e formës dhe formulës së privatizimit të INSIG, sh.a.-së". Sipas këtij ligji, forma e transferimit të 100 për qind të aksioneve të shoqërisë tregtare INSIG sh.a., të cilat zotërohen nga shteti shqiptar, është transferimi me anë të shitjes, në favor të investitorëve, nëpërmjet procedurës "Tender i hapur ndërkombëtar".

Në datën 20.11.2009, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 10 170 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar". Ndryshimet, ndër të tjera, përcaktojnë ngritjen dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik si organi më i lartë në fushën e prokurimeve publike, i ngarkuar me shqyrtimin e ankesave për procedurat e prokurimit, vendimet e të cilit janë administrativisht përfundimtare.

Në datën 25.11.2009, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 1151 "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë". Sipas këtij vendimi, në njësitë e qeverisjes së përgjithësime do të krijohet fondi i veçantë, me peshë në masën 5% të fondit të përgjithshëm të pagave, i cili do të përdoret për shpërblimin e punonjësve, për dhënie ndihmash të menjëhershme në raste fatkeqësish, etj.

Në datën 25.11.2009, Këshilli i Ministrave miratoi me vendimin nr. 1177 "Marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës mbi bashkëpunimin dhe ndihmën reciproke për çështjet doganore". Përmes kësaj marrëveshjeje, dy vendet synojnë që të bëjnë më efektive përpjekjet për të parandaluar shkeljet e legjislacionit doganor dhe për të siguruar mbledhjen e saktë të detyrimeve të import-eksportit, taksave dhe detyrimeve të tjera, nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet autoriteteve të tyre doganore.

Në datën 29.11.2009, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 10190 "Për buxhetin e vitit 2010". Me një deficit prej afërsisht 50 miliardë lekë, të ardhura që i kalojnë 360 miliardë lekë dhe shpenzime pak më shumë se 410 miliardë lekë, buxheti i vitit 2010 synon të garantojë stabilitetin makroekonomik të vendit dhe rritjen e mëtejshme ekonomike.

Në datën 03.12.2009, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 10 192 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë". Ligji përcakton procedurat, kompetencat dhe kriteret për marrjen e masave parandaluese kundër pasurisë së personave të dyshuar për pjesëmarrje në krimin e organizuar dhe trafikim. Ai synon parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar përmes konfiskimit të pasurisë së personave të cilët kanë një nivel të pajustifikuar ekonomik, si rezultat i pjesëmarrjes në veprimtari kriminale.

Në datën 10.12.2009, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 10 196 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9072, datë 22.05.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar". Ndryshimet e parashikuara përmes këtij ligji, prekin kryesisht nenin qe rregullon burimet e energjisë së rinovueshme. Kështu, Këshilli i Ministrave autorizohet që të ndërmarrë nisma nxitëse dhe mbështetëse për ndërtimin e centraleve që shfrytëzojnë energjinë e rinovueshme për prodhimin e energjisë elektrike, e cila do të konsumohet tërësisht brenda vendit.

Në datën 10.12.2009, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 10 197 "Për fondet e pensionit vullnetar". Ligji synon të rregullojë krijimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e fondeve të pensionit vullnetar me kontribute të përcaktuara. Ai vendos standardet e nevojshme për administrimin dhe mbikëqyrjen me efektivitet të këtyre fondeve, duke ngarkuar Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare me përgjegjësinë e ndjekjes së tij.

Në datën 10.12.2009, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 10 198 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive". Ligji ka për qëllim përcaktimin e kushteve dhe kritereve për themelimin, regjistrimin dhe funksionimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive, duke bërë të mundur funksionimin e drejtë të tregut të kapitaleve dhe nxitjen e lëvizjes së lirë të tyre. Mbikëqyrja e veprimtarisë së sipërmarrjeve të investimeve kolektive, të shoqërive administruese, depozitarëve dhe personave të përfshirë në shitjen e kuotave dhe të aksioneve do të realizohet nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Në datën 15.12.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë miratoi vendimin nr. 100 "Për përcaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tariforë për periudhën 1 janar-31 dhjetor 2010". Vendimi përcakton tarifat e shërbimit dhe shitjes me pakicë të energjisë elektrike për vitin 2010, sipas kategorive të konsumatorit. Kështu, çmimi i energjisë elektrike gjatë vitit 2010 për familjarët do të jetë 7.70 lekë/kwh për konsumin deri në 300 kwh, dhe 13.50 lekë/kwh për konsumin mbi 300 kwh.

Në datën 16. 12. 2009, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 1216 "Për dhënie asistence ekonomike të menjëhershme personave, që përfitojnë pension". Sipas këtij vendimi, personat që përfitojnë pension pleqërie, invaliditeti dhe familjar, ashtu si dhe ata që trajtohen me shpërblim mujor si veteranë lufte apo trajtim të veçantë financiar, do t'i jepet një asistencë ekonomike e menjëhershme, në shumën 2 500 (dy mijë e pesëqind) lekë.

Në datën 23.12.2009, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 1290 "Për përcaktimin e kritereve bazë, të sektorëve që do të mbështeten dhe masave të përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural". Përmes këtij vendimi, fondet e miratuara në buxhetin e vitit 2010 për Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjen e Konsumatorit, në zërin "Transfertë në buxhetet familjare" të përdoren për mbështetjen e prodhimit bujqësor, blegtoral dhe të agropërpunimit. Fondet e siguruara synojnë të nxisin mbjelljen e ullishtave, pemëtoreve dhe vreshtave, zbatimin e teknologjive moderne të ujitjes, prodhimin e perimeve në serat diellore, prodhimin e produkteve bio, si dhe rritjen e kreditimit bankar në sektorin e bujqësisë.

# DREJTIMI I BANKËS SË SHQIPËRISË, 31 DHJETOR 2009

## KËSHILLI MBIKËQYRËS

| | |
|---|---|
| *ARDIAN FULLANI* | *Kryetar* |
| *FATOS IBRAHIMI* | *Zëvendëskryetar* |
| *TEFTA ÇUÇI* | *Anëtare* |
| *LIMOS MALAJ* | *Anëtar* |
| *KSENOFON KRISAFI* | *Anëtar* |
| *ADRIAN CIVICI* | *Anëtar* |
| *ARJAN KADAREJA* | *Anëtar* |
| *HALIT XHAFA* | *Anëtar* |
| *BENET BECI* | *Anëtar* |

## GUVERNATORI

*ARDIAN FULLANI*

## KABINETI I GUVERNATORIT

*GENC MAMANI*

## DREJTUES PËR KOORDINIMIN PRANË KABINETIT TË GUVERNATORIT

*GRAMOZ KOLASI*

## ZËVENDËSGUVERNATORËT

| | |
|---|---|
| *FATOS IBRAHIMI* | *Zëvendësguvernator i Parë* |

## INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM

*TEUTA BALETA*

## DEPARTAMENTET DHE NJËSITË E TJERA

| | |
|---|---|
| *DEPARTAMENTI I BURIMEVE NJERËZORE* | *Roden Pajaj* |
| *DEPARTAMENTI I POLITIKËS MONETARE* | *Erald Themeli* |
| *DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE* | *Altin Tanku* |
| *DEPARTAMENTI I OPERACIONEVE MONETARE* | *Marjan Gjermeni* |
| *DEPARTAMENTI I MBIKËQYRJES* | *Indrit Banka* |
| *DEPARTAMENTI I STABILITETIT FINANCIAR* | *Klodion Shehu* |
| *DEPARTAMENTI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT* | *Xhilda Kanini* |
| *DEPARTAMENTI I STATISTIKËS* | *Diana Shtylla* |
| *DEPARTAMENTI I EMISIONIT* | *Valer Miho* |
| *DEPARTAMENTI I KONTABILITETIT DHE FINANCËS* | *Artan Toro* |
| *DEPARTAMENTI I SISTEMEVE TË PAGESAVE* | *Dashmir Halilaj* |
| *DEPARTAMENTI JURIDIK* | *Toni Gogu* |
| *DEPARTAMENTI I KONTROLLIT* | *Teuta Baleta* |
| *DEPARTAMENTI I MARRËDHËNIEVE ME JASHTË, INTEGRIMIT EVROPIAN DHE I KOMUNIKIMIT* | *(vakant)* |
| *DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT* | *Agron Skënderaga* |
| *DEPARTAMENTI I SIGURIMIT DHE MBROJTJES* | *Eduard Sinani* |

## DEGËT

| | |
|---|---|
| *Shkodër* | *Ermira Istrefi* |
| *Elbasan* | *Valentina Dedja* |
| *Gjirokastër* | *Anila Thomaj* |
| *Korçë* | *Liljana Zjarri* |
| *Lushnje* | *Shpresa Meço* |

# LISTA E SUBJEKTEVE TË LICENCUARA NGA BANKA E SHQIPËRISË*

## BANKA DHE DEGË TË BANKAVE TË HUAJA

*1. BANKA RAIFFEISEN SH.A.*
*Licenca nr. 2/1998, datë 11.01.1999.*
*Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 163, datë 11.12.1998.*
*Certifikata nr. 2 "Për sigurimin e depozitave".*
*Drejtori:* *Oliver WHITTLE*
*Adresa:* *Bulevardi "Bajram Curri", Qendra Tregtare Evropiane, Tiranë.*
*Telefon:* *+355 4 2274 910*
*Faks:* *+355 4 2275 599*
*E – mail:* *info@raiffeisen.al*
*Website:* *www.raiffeisen.al*

*2. BANKA E BASHKUAR E SHQIPËRISË SH.A.*
*Licenca nr. 3/1998, datë 11.01.1999.*
*Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 165, datë 11.12.1998.*
*Certifikata nr. 3 "Për sigurimin e depozitave".*
*Drejtori:* *Hikmet GÜLER*
*Adresa:* *Rruga "Durrësit", sheshi "Rilindja" (Zogu i Zi), Godina Teknoprojekt, P.O. BOX 128, Tiranë.*
*Telefon:* *+355 4 2228 460 / 2223 873 / 2227 408*
*Faks:* *+355 4 2228 460 / 2228 387*
*E-mail:* *info@ubaal.com*
*Website:* *-*

*3. BANKA VENETO SH.A.*
*Licenca nr. 5/1998, datë 11.01.1999.*
*Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 164, datë 11.12.1998.*
*Certifikata nr. 4 "Për sigurimin e depozitave".*
*Drejtori:* *Libero CATALANO*
*Adresa:* *Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Ndërtesa Kullat Binjake, Tiranë.*
*Telefon:* *+355 4 2280 555*
*Faks:* *+355 4 2280 356*
*E – mail:* *info@bisbanca.com*
*Website:* *www.bisbanca.com*

*4. BANKA KOMBËTARE TREGTARE SH.A.*
*Licenca nr. 6/1998, datë 11.01.1999.*
*Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 162, datë 11.01.1999.*
*Certifikata nr. 5 "Për sigurimin e depozitave".*
*Drejtori:* *Seyhan PENCAPLIGIL*
*Adresa:* *Bulevardi "Zhan D'Ark", Tiranë.*

** Deri në 31 dhjetor 2009.*

Telefon: +355 4 2250 955
Faks: +355 4 2250 956
E – mail: info@bkt.com.al
Website: www.bkt.com.al

5. BANKA TIRANA SH.A.
Licenca nr. 07, datë 12.09.1996.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 9, datë 12.09.1996.
Certifikata nr. 6 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: Dimitrios SANTIXIS
Adresa: Rruga "Dëshmorët e 4 Shkurtit", PO BOX 2400/1, Tiranë.
Telefon: +355 4 2269 616 / 7 / 8,+355 4 2233 441 / 42 / 43 / 44 / 45 / 46 / 47
Faks: +355 4 2233 417 / 2369 707
E – mail: info@tiranabank.al
Website: www.tiranabank.al

6. DEGA E BANKËS KOMBËTARE TË GREQISË, TIRANË
Licenca nr. 08, datë 25.11.1996.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 4, datë 14.03.1996.
Certifikata nr. 7 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: Ioannis KOUGIONAS
Adresa: Rruga e Durrësit, Godina Comfort, Tiranë.
Telefon: +355 4 2274 802 / 2274 822
Faks: +355 4 2233 613
E – mail: nbgalbania@icc-al.org
Website: -

7. BANKA NDËRKOMBËTARE TREGTARE SH.A.
Licenca nr. 09, datë 20.02.1997.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 9, datë 30.04.1996.
Certifikata nr. 8 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: Mahendra Sing RAWAT
Adresa: Qendra e Biznesit, Rruga "Murat Toptani", Tiranë.
Telefon: +355 4 2254 372 / 2256 254
Faks: +355 4 2254 368
E – mail: info@icbank-albania.com
Website: -

8. DEGA E BANKËS ALPHA – ALBANIA
Licenca nr. 10, datë 07.01.1998.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 01/03/96, datë 27.12.1997.
Certifikata nr. 9 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: Andreas GALATOULAS
Adresa: Rruga "Kavajës", G – KAM Business Center, kati II, Tiranë.
Telefon: +355 4 2278 500
Faks: +355 4 2232 102
E – mail: tiranabranch@alpha.gr
Website: -

9. BANKA INTESA SANPAOLO ALBANIA SH.A.
Licenca nr. 11, datë 10.08.1998.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 105, datë

*10.08.1998.*
*Certifikata nr. 10 "Për sigurimin e depozitave".*
*Drejtori:* *Stefano FARABBI*
*Adresa:* *Rruga "Ismail Qemali", Nr. 27, P.O. BOX 8319, Tiranë.*
*Telefon:* *+355 4 2248 753 / 4 / 5 / 6,+355 4 2276 000*
*Faks:* *+355 4 2248 762*
*E – mail:* *helpdesk@intesasanpaolobank.al*
*Website:* *www.intesasanpaolobank.al*

*10. BANKA PROCREDIT SH.A.*
*Licenca nr. 12, datë 15.03.1999.*
*Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 22, datë 03.03.1999.*
*Certifikata nr. 11 "Për sigurimin e depozitave".*
*Drejtori:* *Borislav KOSTADINOV*
*Adresa:* *Rruga "Durrësit", Laprakë, Tiranë.*
*Telefon:* *+355 4 2271 272 / 3 / 4 / 5*
*Faks:* *+355 4 2271 276*
*E mail:* *info@procreditbank.com.al*
*Website:* *www.procreditbank.com.al*

*11. BANKA EMPORIKI – SHQIPËRI SH.A.*
*Licenca nr. 14, datë 28.10.1999.*
*Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.105, datë 19.10.1999.*
*Certifikata nr.13 "Për sigurimin e depozitave".*
*Drejtori:* *George CARACOSTAS*
*Adresa:* *Rruga "Kavajës", Nr. 59, "Tirana Tower", Tiranë.*
*Telefon:* *+355 4 2258 755 / 56 / 57 / 58 / 59 / 60*
*Faks:* *+355 4 2258 752*
*E – mail:* *headoffice@emporiki.com.al*
*Website:* *-*

*12. BANKA E KREDITIT TË SHQIPËRISË SH.A.*
*Licenca nr. 15, datë 28.08.2002.*
*Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 66, datë 28.08.2002.*
*Certifikata nr. 14 "Për sigurimin e depozitave".*
*Drejtori:* *Sherine KAMEL (e komanduar).*
*Adresa:* *Rruga Perlat Rexhepi, Al-Kharafi Group Admistration Building, Kati 1&2, Tiranë.*
*Telefon:* *+355 4 2272 168,+355 4 2272 162*
*Faks:* *+355 4 2272 162*
*E-mail:* *creditbkalb@icc-al.org*
*Website:* *-*

*13. BANKA CREDINS SH.A.*
*Licenca nr. 16, datë 31.03.2003.*
*Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 22, datë 26.03.2003.*
*Certifikata nr. 15 "Për sigurimin e depozitave".*
*Drejtori:* *Artan SANTO*
*Adresa:* *Rruga "Ismail Qemali", Nr. 21, Tiranë.*
*Telefon:* *+355 4 2234 096*
*Faks:* *+355 4 2222 916*
*E –mail:* *info@bankacredins.com*
*Website:* *www.bankacredins.com*

*14. BANKA POPULLORE SH.A.*
*Licenca nr. 17, datë 16.02.2004.*
*Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 06, datë 11.02.2004.*
*Certifikata nr. 16 "Për sigurimin e depozitave".*
*Drejtori:* *Hubert de SAINT JEAN*
*Adresa:* *Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Kullat Binjake, Kulla 1, Kati i 9-të, Tiranë.*
*Telefon:* *+355 4 2280 442 / 3*
*Faks:* *+355 4 2280 441*
*Mobile:* *068 (69) 20 60 974*
*E-mail:* *bp.info@socgen.com*
*Website:* *www.bpopullore.com*

*15. BANKA UNION SH.A.*
*Licenca nr. 18, datë 09.01.2006.*
*Miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 101, datë 28.12.2005.*
*Certifikata nr. 17 " Për sigurimin e depozitave".*
*Drejtori:* *Gazmend KADRIU*
*Adresa:* *Bulevardi "Zogu I", pallati 13-katësh, përballë Stacionit të Trenit, Tiranë.*
*Telefon:* *+355 4 2250 653 / 2258 081*
*Faks:* *+355 4 2272 880*
*E – mail:* *info@unionbank.com.al*
*Website:* *www.unionbank.com.al*

*16. BANKA E PARË E INVESTIMEVE, ALBANIA SH.A.*
*Licenca nr. 19, datë 06.07.2007.*
*Miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 35, datë 27.06.2007.*
*Certifikata nr. 12 " Për sigurimin e depozitave".*
*Drejtori:* *Bozhidar TODOROV*
*Adresa:* *Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Kullat Binjake, Kulla 2, Kati 14, Tiranë.*
*Telefon:* *+355 4 2276 702 / 3*
*Faks:* *+355 4 2280 210*
*E – mail:* *-*
*Website:* *www.fibank.al*

*Përveç bankave dhe degëve të bankave të huaja, Banka e Shqipërisë ka licencuar deri më 31 dhjetor 2009 edhe subjektet e mëposhtme:*

| Nr | Subjekte |
|---|---|
| 13 | SUBJEKTE JOBANKA |
| 221 | ZYRA TË KËMBIMIT VALUTOR |
| 2 | UNIONE TË SHOQËRIVE TË KURSIM-KREDITIT |
| 135 | SHOQËRI TË KURSIM-KREDITIT |
| 1 | ZYRË E PËRFAQËSIMIT TË BANKAVE TË HUAJA |

# PUBLIKIME TË BOTUARA NGA BANKA E SHQIPËRISË QË PREJ VITIT 2008

Kjo listë u përpilua për të informuar lexuesit mbi botimet e Bankës së Shqipërisë që prej vitit 2008. Duke vizituar adresën tonë elektronike (www.bankofalbania.org) mund të plotësoni e dërgoni formularin në public@bankofalbania.org ose në faks (04) 223 558 dhe të regjistroheni për t'u bërë pjesë e listës së shpërndarjes të botimeve të Bankës së Shqipërisë. Gjithashtu, ju mund të përfitoni nga shërbimi i njoftimeve automatike të Bankës së Shqipërisë. Nëpërmjet këtij shërbimi, çdo mesnatë, sistemet e Bankës do t'ju njoftojnë në postën tuaj elektronike rreth ndryshimeve apo të rejave në argumentet që keni përzgjedhur. Më poshtë mund të gjeni të gjithë titujt e publikimeve të Bankës së Shqipërisë të botuar nga viti 2008 deri në dhjetor të vitit 2009. Kjo listë nuk përfshin vrojtimet e kryera nga Banka e Shqipërisë, të cilat publikohen vetëm në formë elektronike (http://www.bankofalbania.org/web/vrojtime_3405_1.php).

*RAPORTI VJETOR:*

*Raporti Vjetor 2007.*
*Raporti Vjetor 2008.*

*RAPORTET PERIODIKE TË POLITIKËS MONETARE:*

*Vlerësimi tremujor i gjendjes së ekonomisë për tremujorin e parë të vitit 2008.*
*Vlerësimi tremujor i gjendjes së ekonomisë për tremujorin e tretë të vitit 2008.*
*Deklarata e politikës monetare për gjashtëmujorin e parë 2008.*
*Deklarata e politikës monetare për gjashtëmujorin e dytë 2008.*
*Vlerësimi tremujor i gjendjes së ekonomisë për tremujorin e parë të vitit 2009.*
*Deklarata e politikës monetare për gjashtëmujorin e parë të vitit 2009.*
*Dokumenti i politikës monetare për vitin 2008.*
*Dokumenti i politikës monetare për periudhën 2009 - 2011.*

BOTIME PËR STATISTIKAT :

*Raporti Mujor Statistikor (Botohet çdo muaj të vitit).*
*Buletini i Bilancit të Pagesave 2007*
*Buletini i Bilancit të Pagesave 2008*

*BULETINI ZYRTAR:*

*Treguesi i Buletinit Zyrtar të Bankës së Shqipërisë (1998-2009)*
*Buletini Zyrtar - Vëllimi 10, nr.1, Viti 2008*
*Buletini Zyrtar - Vëllimi 10, nr.2, Viti 2008*
*Buletini Zyrtar - Vëllimi 10, nr.3, Viti 2008*
*Buletini Zyrtar - Vëllimi 10, nr.4, Viti 2008*
*Buletini Zyrtar - Vëllimi 10, nr.5, Viti 2008*

*Buletini Zyrtar - Vellimi 10, Nr.6, Viti 2008*
*Buletini Zyrtar - Vëllimi 10, nr.7, Viti 2008*
*Buletini Zyrtar - Vëllimi 10, nr.8, Viti 2008*
*Buletini Zyrtar - Vëllimi 10, nr.9, Viti 2008*
*Buletini Zyrtar - Vëllimi 10, nr.10, Viti 2008*
*Buletini Zyrtar - Vëllimi 10, nr.11, Viti 2008*
*Buletini Zyrtar - Vëllimi 11, nr.1, Viti 2009*
*Buletini Zyrtar - Vëllimi 11, nr.2, Viti 2009*
*Buletini Zyrtar - Vëllimi 11, nr.3, Viti 2009*
*Buletini Zyrtar - Vëllimi 11, nr.4, Viti 2009*
*Buletini Zyrtar - Vëllimi 11, nr.5, Viti 2009*
*Buletini Zyrtar - Vëllimi 11, nr.6, Viti 2009*
*Buletini Zyrtar - Vëllimi 11, nr.7, Viti 2009*
*Buletini Zyrtar - Vëllimi 11, nr.8, Viti 2009*
*Buletini Zyrtar - Vëllimi 11, nr.9, Viti 2009*
*Buletini Zyrtar - Vëllimi 11, nr.10, Viti 2009*
*Buletini Zyrtar - Vëllimi 11, nr.11, Viti 2009*

*BULETINI EKONOMIK:*

*Buletini Ekonomik - Vëllimi 11, nr.1, Viti 2008*
*Buletini Ekonomik - Vëllimi 11, nr.2, Viti 2008*
*Buletini Ekonomik - Vëllimi 11, nr.3, Viti 2008*
*Buletini Ekonomik - Vëllimi 11, nr.4, Viti 2008*
*Buletini Ekonomik - Vëllimi 12, nr.1, Viti 2009*
*Buletini Ekonomik - Vëllimi 12, nr.2, Viti 2009*
*Buletini Ekonomik - Vëllimi 12, nr.3, Viti 2009*

*RAPORTI I STABILITETIT FINANCIAR:*

*Raporti i Stabilitetit Financiar 2007*
*Raporti i Stabilitetit Financiar 2008*

*RAPORTI VJETOR I MBIKËQYRJES:*

*Raporti Vjetor i Mbikëqyrjes 2007*
*Raporti Vjetor i Mbikëqyrjes 2008*

*PUBLIKIME NJOHËSE DHE INFORMATIVE:*

*Katalogu i publikimeve 2007*
*Katalogu i publikimeve 2008*

*MATERIALET E DISKUTIMIT:*

*Artikuj të botuar në Buletinin Ekonomik të Bankës së Shqipërisë gjatë një dekade - Vëllimi I Periudha 1998-2000*
*Artikuj të botuar në Buletinin Ekonomik të Bankës së Shqipërisë gjatë një dekade - Vëllimi II Periudha 2001-2004*
*Artikuj të botuar në Buletinin Ekonomik të Bankës së Shqipërisë gjatë një dekade - Vëllimi III Periudha 2005-2007*
*Indeksi i çmimeve/vlerave njësi të huaja të importeve shqiptare*
*Përçimi i kursit të këmbimit në Shqipëri: Evidencë nga vektorët autoregresivë*
*Matja e funksioneve të Import-Eksportit në Shqipëri*
*Matje të reja të inflacionit bazë: Përdorimi i tyre në parashikim dhe analizë*

*Roli i kursit të këmbimit në shënjestrimin e inflacionit. Si veprohet?*
*Matja e efektit Balassa-Samuelson: Rasti i Shqipërisë*
*Roli i bankave në transmetimin e politikës monetare në Shqipëri*
*A është i qëndrueshëm deficiti i llogarisë korente? Rasti i Shqipërisë*
*Strategjitë e politikës monetare për ekonomitë e vogla - Ideoi dhe përgatiti, Ardian Fullani*
*Metoda alternative të matjes së produktit potencial në Shqipëri*

*TË REJA SHKENCORE NË BANKËN E SHQIPËRISË:*

*Të reja shkencore në Bankën e Shqipërisë Nr. 1*
*Të reja shkencore në Bankën e Shqipërisë Nr. 2*

*PUBLIKIME TË KARAKTERIT JURIDIK:*

*Ligj nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë"*

*PUBLIKIME EDUKATIVE -INFORMATIVE:*

*Guidë rreth llogarisë tuaj të parë bankare*
*Guida e studentit*
*Historia e Akullores (ribotim)*
*Të flasim thjesht për inflacionin (ribotim)*
*Tërheqja nga qarkullimi i parave (fletëpalosje)*
*"Vlera e Vërtetë e Parasë"*
*Banka e Shqipërisë - Banka jonë qendrore (ribotim)*
*IBAN - Numri Ndërkombëtar i Llogarisë Bankare (fletëpalosje)*
*Instrumentet e Politikës Monetare të Bankës së Shqipërisë dhe procedurat për realizimin e tyre ( i ripunuar)*
*Sistemi i pagesave (i ripunuar)*
*"Vlera e Vërtetë e Parasë" Vlorë, 2008*
*Edukimi - sfida e re e Bankës së Shqipërisë*